


GËZIM **ÇELA** URIM ELEZI NEVRUS
GOLKA BARJAM DERVISHAJ NURI
STEPA NDUE HOTI MUSA HO**XHA**
NIKOLL PRENGA SHKËLOIM A**BAZI**
YLBER MERDANI FATOS LUB**ONJA**
AGRON HOXHA HYSEN HA**XHIAJ**
ILJAS KAJO YLLI KANINA **NJAZI**
BYLYKE RASHI EDMOND HA**ALIMI** ILIR
MALINDI DERVISH BEJ**KO** NJAZI
PETRO **ÇELA**

**50 VJET NGA REVOLTA
NË BURGUN E SPAÇIT**

VOL 1



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

VOL. 1

50 VJET NGA REVOLTA NË BURGUN E SPAÇIT

DËSHMOJNË TË MBIJETUARIT
DHE FAMILJARËT E TYRE

Maj 2024, Tiranë



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETËTIT

50 VJET NGA REVOLTA NË BURGUN E SPAÇIT

Dëshmojnë të mbijetuarit dhe familjarët e tyre

Botuar në Maj 2024, Tiranë

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Koordinatorë e botimeve AIDSSH

Dr. Orneta Arapi

Përgatitën botimin

Dr. Brunilda Çërraga

Rovena Rrozhani

Konsulent dhe redaktor shkencor

Dr. Mirela Sinani

Redaktore letrare

Brunilda Loci

Elona Baçi

Design

HL Branding

Shtypshkronja "Inpress sh.p.k."

AIDSSH falënderon të gjithë të intervistuarit: ish-të dënuar të mbijetuar nga burgu i Spaçit dhe nga internimet e gjata, si edhe familjarët e tyre që, pavarësisht moshës, gjendjes shëndetësore e lëndimit shpirtëror, u shprehën të gatshëm dhe bashkëpunuan për të dhënë dëshmitë e tyre autentike, tepër të vlefshme e të pazëvendësueshme për revoltën e të burgosurve në burgun e Spaçit, në 21 maj 1973.

Përmbajtja e këtyre dëshmimeve është përgjegjësi vetëm e të intervistuarve dhe nuk mund të konsiderohet, në asnjë rrethanë, si pasqyrim i qëndrimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Intervistuan

Marçel Hila

Dr. Brunilda Çërraga

Bukurie Sokoli

Luan Ismaili

Agron Hoxha

Regjistrimi i

dëshmimeve

dhe fotografitë

Dorian Zanaliu

Përzgjedhja e fotove

Rovena Rrozhani

Zbardhën dëshmitë

Armela Elezi

Flutura Koçana

Vilma Mileti

Aleksandra Stevfanidhi

Elton Kryemadhi

Artjola Lika

Valbona Shoti

Manuel Jorgji

Hartuan pyetësorët

Dr. Orneta Arapi

Dr. Brunilda Çërraga

Falënderime për

bashkëpunimin

Gjergj Marku

Anton Dukagjini

Irma Bataj

Aldi Dedndreaq

Vojsava Deliaj

Luan Ismaili

Media dhe komunikimi

Migena Dermixhiu

Përmbajtja

HYRJE - SPAÇI NË DRITË, QASJE NË BURIMET PARËSORE PËR NJË KUJTESË TË DREJTË DHE GJITHËPËRFSHIRËSE NGA DR. GENTIANA SULA, KRYETARE E AIDSSH

PËRMBLEDHJE - DËNIMI I KRIMIT DHE KUJTESA SI THEMEL I NJË SHOQËRIE TË DREJTË E PAQËSORE: BURGU I SPAÇIT DHE SKLLAVËRIMI I TË BURGOSURVE POLITIKË NGA DR. MIRELA SINANI

DËSHMI NGA ISH-TË DËNUAR POLITIKË DHE FAMILJARË TË TYRE

ISH-TË DËNUAR

Gëzim Çela
Urim Elezi
Nevrus Golka
Barjam Dervishaj
Nuri Stepa
Ndue Hoti
Nikoll Prenga
Shkëlqim Abazi
Ylber Merdani
Fatos Lubonja
Agron Hoxha
Hysen Haxhiaj
Iljas Kajo
Ylli Kanina
Edmond Halimi
Musa Hoxha
Ilir Malindi

FAMILJARËT

Leonard Dervishi
Menduhije Pojani
Ioann Çeli

METODOLOGJIA - NGA MBLEDHJA E DËSHMIVE TEK ARKIVIMI

VENDIMET GJYQËSORE MBI TË DËNUARIT E SPAÇIT - SHPËRFAQJE E BOTËKUPTIMIT ANTILIRI SHPREHJEJE NGA JONIDA DERVISHI, EKSPERTE LIGJORE PRANË AIDSSH

AIDSSH, HETIM ADMINISTRATIV PËR 44 TË ZHDUKURIT NË BURGUN E SPAÇIT

EKSPOZITA - "GJURMË QËNDRESE DHE SOLIDARITETI"

AKTIVITETET E AIDSSH-SË NË PËRKUJTIM TË NGJARJES HISTORIKE

Hyrje

Spaçi në dritë, qasje në burimet parësore për një kujtesë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse



Dr. Gentiana Sula

Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

I. Prezantimi i temës dhe rëndësia e trajtimit të saj

Kthimi në të shkuarën e Shqipërisë komuniste sjell dhe përkujtimin e një errësire të thellë. Kampi i punës së detyruar në Spaç, një plagë e hapur e historisë sonë, ishte vend ku liria dhe të drejtat u shkelën dhe rreth 2000 burra, por dhe familjet e tyre u trajtuan në mënyrë çnjerëzore. Sot përpjekja për të kuptuar këtë të kaluar të rëndë është e domosdoshme që të mos përsëritet asnjëherë.

Me mundësimin e qasjes në burime parësore që realizojnë mendimin kritik dhe analiza më të thelluara në këtë episod të errët, u bë evidentimi i dokumenteve në renditjen e arkivave për Spaçin dhe të personave që vuajtën aty, si dhe u mblodhën dëshmi, foto e letra etj. duke sjellë një kontribut të pazëvendësueshëm të AIDSSH-së.

Botimi me temë “50 vjet nga revolta në burgun e Spaçit - Dëshmojnë të mbijetuarit dhe familjarët e tyre” mbart rëndësinë e njohjes së historisë së burgut dhe kampit të punës së detyruar të Spaçit si një vend emblemantik ku shfaqet egërsia e diktaturës komuniste. Brenda këtij kampi gjejmë viktimat e regjimit, profilin e tyre në shoqërinë e atëhershme shqiptare, gremisjen në burgun më

të egër të vendit, vuajtjet, mundimet dhe pasojat e tmerrshme që ranë mbi ta në gulagun shqiptar.

Në errësirën e burgut gjejmë edhe nota rezistence ndaj regjimit, gjë mjaft e rrallë në atë kohë e në atë kontekst. Për këtë arsye, në këtë botim është marrë në shqyrtim edhe revolta e të dënuarve të Spaçit datuar më 21-23 maj 1973. Kjo revoltë, për nga përmasat që mori, konsiderohet si më e rëndësishmja në burgjet e Shqipërisë komuniste. Pas shtypjes me dhunë të revoltës, 4 të dënuar politikë u ekzekutuan me pushkatim ndërsa rreth 70 të tjerë u ridënuan. Trupat e të pushkatuarave rezultojnë ende dhe sot të pagjetur.

Edhe pse është trajtuar tipologjia e këtij kampi-burg, shumë fakte mbeten ende të zbehta. Ky studim vjen në dritën e botimit për t'i dhënë përgjigje shumë pyetjeve, të tilla si: A e njohim plotësisht punën e detyruar si një mjet ndëshkimi për të burgosurit politikë? Cilat ishin tiparet më të shprehura dehumanizuese të sistemit? Në cilat momente dëshmohen shkelje të të drejtave të njeriut ndaj të burgosurve?

Përmes këtij botimi dhe të tjerave të kësaj natyre, Autoriteti synon përbushjen e objektivave të

Planit Strategjik 2023-2028, ku cilësohet prezantimi i Autoritetit si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri. Faktet e mbledhura mbështetësin procesin e identifikimit dhe rigjetjes së mbetjeve të viktimitave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.

Konteksti historik dhe social i ngjarjeve të mbuluara në botim

Kampi nr. 2 u stacionua në Spaç në vitin 1968, pas më shumë se 17 vite si një kamp lëvizës pune ku angazhoheshin kryesisht të dënuarit politikë, i cili në dokumentet zyrtare quhet "Reparti i riedukimit 303, Spaç-Mirditë". Vetëm në korrik të vitit 1991, me rënien e regjimit komunist, kampi-burg i Spaçit u mbyll përfundimisht.

Vitet '60 përfaqësojnë në historinë e diktaturës në Shqipëri, vitet e izolimit të madh që në kontekstin e jashtëm zuri fill pas ndarjes së Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe rënies së marrëdhënieve me të gjitha vendet komuniste të Lindjes.

Por kjo periudhë përputhet edhe me nisjen një miqësie të re të regjimit të Tiranës dhe përafrimit me modelin kinez të totalitarizmit, një tjetër version stalinist i qasjes së diktaturës ndaj lirisë dhe njerëzve që e shfaqnin atë.

Në këtë periudhë, për shkak të rënies së shpejtë ekonomike dhe mungesës së burimeve, regjimi shtoi represionin, ndërkohë që kjo kohë u ndoq edhe me rënien e besimit mes vetë udhëheqjes komuniste. U zbuluan kështu grupe të reja armiqësore.

Shkeljet e të drejtave të njeriut arritën kulmin e tyre gjatë kësaj faze. Më 1961 në Shqipëri rezultoni 4345 të burgosur, të ndarë në gjashtë kampe pune dhe katër burgje. Gjatë viteve '60 lufta e klasave u rikthye edhe më shumë në metodat staliniste. Rifilluan gjykimet dhe dhëniet e dënimeve me vdekje. Në këto vite u kryen 139 ekzekutime.

II. Konteksti i punës së detyruar në kampin e Spaçit

Puna e detyruar u përdor gjerësisht si një mekanizëm shtypës dhe shfrytëzues për të burgosurit

politikë përgjatë 45 viteve të historisë së regjimit. Sipas një raporti të Departamentit të Shtetit drejtuar Kombeve të Bashkuara në vitin 1955, puna e detyruar është përdorur në masë në Shqipëri që me ardhjen në fuqi të regjimit komunist në nëntor 1944. Më 25 maj të vitit 1951, Ministri i Punëve të Brendshme urdhëroi krijimin e kampit nr.2, i quajtur më vonë "Reparti 303". Në harkun kohor 1951-1968, të burgosurit politikë të këtij kampi punuan me detyrim dhe në kushte të vështira në hapjen e kanalit Peqin-Kavajë, Vjosë-Levan-Fier, Devoll-Thanë. Ndërtuan fushën e aviacionit në Urën Vajgurore, aeroportin e Rinasit, Sanatoriumin, Kombinatin e Mishit, Peliçerinë, fermën "Gjergj Dimitrov", Uzinën e Traktorëve, Uzinën e Sodës Kaustike, Fabrikën e Çimentos në Elbasan. Në 1968 të burgosurit politikë u transferuan në minierën e bakrit dhe të piriteve në Spaç.

Minerali i bakrit ishte i kërkuar në tregjet e huaja dhe çmimi i tij ishte mjaft i leverdishëm për ekonominë e mbyllur shqiptare. Vetë regjimi kishte nisur përpjekjet për të ndërtuar një cikël të mbyllur të përpunimit të mineralit, ndërkohë që me ndihmën e Kinës u ngrit edhe një repart për ndarjen e arit nga minerali. Plani për nxjerrjen e bakrit dhe piritit përcaktohej nga komanda. Norma ditore njoftohej çdo ditë gjatë apelit.

Plotësimi i normës dhe realizimi i planit ishte një kusht i padiskutueshëm për drejtuesit e kampit. Norma ditore për një vagonist ishte 4 vagonë. Një vagon pirit ishte 2 tonë dhe një vagon bakër ishte 1.5 ton. Në rast të mosrealizimit të normës, të dënuarit ndëshkoheshin dhe mbylleshin në birucat e izolimit.

Të dhënat që dolën nga arkivi i "Albakrit" treguan se në vitin 1969 sistemi i minierave nxirrte vetëm 50 mijë tonë bakër, ndërsa në viti 1981 prodhimi u rrit me rreth 200 mijë tonë në vit. Nga kryqëzimi i dokumenteve arkivore, grupi i punës në Autoritet doli në përfundimin se përgjatë 23 viteve Spaçi u kthye në një kamp të punës së detyruar, ku 2000 të burgosur politikë kanë prodhuar 2.82 milionë tonë bakër dhe 1.3 milionë tonë pirit, nga të cilat u përftuan 2500 kg ar.

Çdo i dënuar që realizonte normën paguhej me 10% të pagës së një minatori në liri. Në vitin 1953 u vendos se kur i dënuari kur tejkalonte normën

100% kishte të drejtën e uljes së dënimit me 0.02 ditë në muaj dhe një pagesë prej 35% të vlerës së kryer. Në rast të mosrealizimit të normës, i zbritet pagesa në proporcion të kundërt. Në korrik të vitit 1968 u hoq shpërblimi me pagesë dhe zbritje të ditëve në burg, për ata të dënuar politikë që kalonin planin me 25%, duke argumentuar se puna e detyruar nuk po shërbente për riedukim, por për përfitime personale.

Vendndodhja dhe statusi i kampit

Spaçi është i vendosur në pjesën verilindore të Mirditës, në një zonë të shkretë shkëmbore, pa bimësi, larg qendrave të banimit. Relievi i ashpër ndiqet nga një përrua me ujëra që kanë marrë ngjyrën e zbehtë të mineralit të bakrit. Klima me një vapë të padurueshme në verë dhe acar në dimër, e bënte Spaçin një terren të përsosur për izolimin e të burgosurve.

Ndërtimi i kampit nisi me ngritjen e disa ndërtesave të vjetra, por më pas u konsolidua duke ndërtuar dy pallate, ndërsa në të njëjtën kohë u hapën edhe galeritë e minierës së bakrit jo shumë larg nga vendi ku u ngrit kampi. Pak kilometra më tutje u ngrit fabrika e pasurimit të bakrit në Repts, ndërkohë që afro 10 km më në jug ishte Uzina e Shkrires së Bakrit në Rubik bashkë me impiantin e ndarjes së arit nga minerali.

Në janar të vitit 1969, Drejtoria e Punëve të Brendshme të Mirditës (ana e Sigurimit të Shtetit), hapi dosjen e "Objektit të rëndësishëm së veçantë për repartin e riedukimi 303, Spaç-Mirëditë", duke përcaktuar kështu edhe statusin e veçantë të tij, në lidhje me kontrollin e rreptë që u ushtrua duke dhe qëllimin e "sigurimit fizik të të dënuarve, riedukimin dhe aktivizimin në punë". Deri në fillim të vitit 1980 numri i të burgosurve ishte midis 900 dhe 1200 vetëve. Në raportet e këtij viti rëndësia e tij përcaktohej si "politike, ekonomike dhe strategjike".

Kushtet e jetesës dhe të punës së të burgosurve në kamp

Dëshmitë dhe dokumentet e përfshira në këtë botim flasin për torturë, dhunë, ndëshkime në birucë nën temperaturat -15 gradë, vdekje nga shembja e galerive, vetëvrasje nga dëshpërimi.

Ilias Kajo, i dënuar më akuzën "për agjitacion

e propagandë" vuajti dënimin me 8 vite burg në Spaç. *"Çanga e zgjimit binte në orën 5. Pas apelit, në orën 6, dilnim nga kampi dhe i ngjiteshim malit. Ecnim një orë e gjysmë, derisa mbërrinin në galeri. Aty përshëndeteshim me shprehjen 'Mirëdalsh!', se edhe mund të mos dilnim më gjallë".*

Të burgosurit politikë në këtë kamp ishin një makineri pune. Nga puna e të burgosurve siguroheshin të ardhura të konsiderueshme që përdoreshin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Ministria e Financave për investime.

Puna ishte në tre turne, i pari niste në 6.30 ndërsa i fundit në 22.30. Ushqimi ishte i pakët, konsiderohej një ditë festive nga të burgosurit kur servirej fasule dhe darka mbyllet me çaj e pak bukë. Kujdesi shëndetësor ishte i pamjaftueshëm, higjiena e pastërtia ishin alarmante.

III. Dëshmitë e të mbijetuarve

Grupi i punës i ngritur me urdhrin e nr. 22, datë 06.02.2023 të Kryetares së Autoritetit, për organizimin e aktiviteteve përkujtimore me rastin e 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit realizoi mbi 50 dëshmi audio-vizuale të të mbijetuarve nga dënimi në Spaç dhe familjarëve të atyre që u pushkatuan.

Për Spaçin është folur shumë ndër vite. Për të kanë dhënë dëshmi njerëz të njohur të kohës, si: Visar Zhiti, poet, ish-ministër, Fatos Lubonja, publicist e aktivist në media, piktori Maks Velo, por AIDSSH-ja u thellua më tej duke zgjeruar rrethin e dëshmitarëve. Zërat e tyre deri dje të heshtur tani janë pjesë e historisë. Pyetësi i hartuar nga ekspertë të AIDSSH-së ndihmoi që të sigurohen dëshmi autentike nga ky kamp.

Intervistat në vijim flasin për punën e rëndë, trajtimin mizor, arsyet e revoltës, solidaritetin dhe qëndresën e familjes, ëndrrat e fëmijëve për arsim, të prera në mes, stigmën e "armikut të popullit" si dhe shpresën kuptimplotë që eshtrat e familjarëve të pagjetur do të kthehen një ditë në familje.

Gëzim Çela ishte vetëm 21 vjeç kur u arrestua "për tentativë arratisje". Ai tregon se bënte më tepër se normën e punës. "Po të bëje normën nuk

të binin në qafë. Ngarkoja katër vagonë në ditë me pirit, në të kundërt më priste biruca.”

Musa Hoxha, i dënuar “për agjitacion e propagandë” në moshën 21-vjeçare, punoi në zonën më e vështirë të minierës, zona 2, pa sigurim teknik dhe në temperatura 45-50 gradë. “Shpesh kur nuk mundesha ta bëja normën, më lidhnin për dy tre orë me pranga tek shtylla, në dëborë. Në një nga këto ndëshkime hekurat më shpërthyen damarët dhe me ra të fikët. Pas kësaj bëja ç’është e mundur të realizoja normën se nuk mund të duroja birucën apo qëndrimin lidhur pas shtyllës. Biruca ishte e tmerrshme. 2-3 metra katorrë, vetëm me çorape, të hiqnin dhe pallton dhe trikon e leshit. Të jepnin batanije vetëm në orën 7.”

Ilir Malindi, i dënuar në moshën 20-vjeçare, tregon: “Unë, si minator që isha, punoja në zonën e dytë, në zonën e piritit. Piriti është material nga nxirret acidi sulfurik, një vagon pirit peshon 2 tonë. Duhet të nxirrim katër vagonë për çdo njërin, d.m.th. 6 tonë për person.

Ne ishim të organizuar në grupe, 3 veta në grup, të ngarkuar të nxirrim rreth 20 tonë material jashtë. Piriti ka veçanti, krijon temperaturë të lartë në reaktion me ujin, lagështinë, kështu që temperaturat në vendin e punës shkonin deri në 45 -50 gradë.

Nga 45 gradë dilje në -15 gradë, për të zbratur materialin. Jashtë ishte ngricë, ftohtë dhe këtë punë do ta bëje gjatë ditës. Nëse nuk realizohej norma, ata kishin një shprehje: **‘o normën, o shpirtin!’**. Kjo ishte dilema, mosrealizimi i normës nënkuptonte birucë.”

Shkëlqim Abazi ishte vetëm 16 vjeç kur u dënua. “Revolta e Spaçit nuk ishte spontane, kishte 30 vjet dhunë të pandërprerë, do vinte një ditë do shpërthente. Para se të shpërthente revolta, ka qenë e diel. Një pjesë e madhe e të burgosurve politikë, nuk donte të dilte në punë, sepse ligjërisht e diela u njihej pushim”, tregon Abazi.

Gëzim Çela, ish-i burgosur, thotë se të dënuarit fillimisht hodhën parulla kundër punës së rëndë në minierë, po më pas ato u shndërruar në thirrje politike si: *Poshtë komunizmi!, Rroftë Shqipëria e Lirë!, Na i veshët nëna me të zeza!, E duam Shqipërinë si gjithë Evropa!*”.

Napoleon Gumeni ishte 10 vjeç në prill të vitit 1970, kur iu arrestua babai, Izet Gumeni, dënuar me 25 vjet heqje lirie me akuzën për bashkëpunim me bandat: “Nuk harroj. Isha 14 vjeç. Bashkë me motrën e vogël mbërritëm rreth orës dy në Spaç. Polici nuk na lejoj ta takonim babanë atë ditë, pasi na tha që ishte në punë. Fjetëm pas një barake të komandës, të rrahur nga era e ftohtë e grykës së Spaçit”.

Menduhije Pojani, vajza e Njazi Bylykbashit, ish-i dënuar “për agjitacion e propagandë” i cili vuajti dënimin në burgun e Spaçit: “Pas dënim-it të babait, mamaja duhet të rriste katër fëmijët. Punonte gjithë ditën në bujqësi, mbante dru në kurriz, për të na ngrohur e ushqyer. Na ndihmonte edhe gjyshja në moshë të thyer” .

Lirie Alibali, gruaja e Ylli Alibalit dhe kunata e Xhevat Alibalit, ish-të dënuar me akuzën “agjitacion e propagandë”. “Pas arrestimit të bashkëshortit, m’u mbyllën të gjitha dyert para fytyrës. Askush nuk donte të kishte të bënte me mua. Të afërmit më thonin: “Erdhe sot, mos hajde përsëri!” Njerëzit largoheshin dhe ndërronin rrugë, ngaqë nuk donin të më flisnin, pasi isha me njëjllë në biografi. Nuk mund të ndaja babain e vajzave të mia. Pranova fatin tim!”

Ioann Çeli ishte 16 vjeç kur i arrestohet i ati, ushtarak i dënuar me akuzën “për akte të dhunshme kundër pushtetit popullor”: “Pas arrestimit të babait, motra e madhe, që ndiqte studimet në Fakultetin e Filozofisë, në Tiranë, u përjashtua nga shkolla me ceremoni. Kërkuan ta nxirrin për demaskim para shkollës”.

Leonard Bejko ishte 5 vjeç kur iu pushkatua babai, Dervish Bejko, i dënuar në vitin 1971 me akuzën “tentativë për arratisje”. Ai është një nga të dënuarit me vdekje të Revoltës së Spaçit, që shpërtheu më 21 maj të vitit 1973: “Babanë e kam brenjë. Kam shumë boshllëk, se u rrita pa të. Në Pogradec i kam ngritur një varr në kujtim të tij. Kur e vizitoj, ndez një cigare. Po kujt t’ia ndez?! Nuk ka eshtra. Ia ndez tokës, mermerit të ftohtë”. Dëshmitë e mbledhura, të administruara me kujdes, do t’i vihen në dispozicion çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes

marrëveshjes së nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH-ja merr përsipër t'i administrojë dhe t'i ruajë këto regjistrime me standardin e një arkivi të vyer historik.

Njëzet intervistat e përzgjedhura janë burime me vlerë për kërkimin shkencor që plotëson dokumentin arkivor dhe nxjerr në pah ato ngjarje që janë anashkaluar me qëllim në dokumentet zyrtar të ish-Sigurimit.

Krahas problemeve që mbartim me rishkrimin e historisë, të së shkuarës sonë diktatoriale, këto dëshmi përbëjnë një vlerë të jashtëzakonshme pasi koha biologjike ecën dhe rreziku i harresës është gjithmonë dhe më i pranishëm.

IV. Rëndësia historike dhe akademike e botimit

Në kuadër të studimeve akademike mbi punën e detyruar gjatë diktaturës, nisur edhe nga nevoja e ripërsëritur se historia duhet të rishkruhet dhe asnjëherë nuk merr vulën përfundimtare, hedhja dritë mbi kampin-burg të Spaçit i shton burimet arkivore dhe historike në funksion të njohjes nga ana e shoqërisë shqiptare mbi mekanizmat shtypës dhe dehumanizues që shteti përdori gjatë viteve 1944-1991.

Si burim kryesor për këtë botim u përdor arkivi i AIDSSH-së me dokumente nga dosja e "Objektit të rëndësisë të veçantë të repartit 303, Spaç", dosjet hetimore-gjyqësore të të dënuarve në këtë burg etj. Botimi u pasurua nga arkivi gojor, i cili, dhe pse është një burim sekondar, është po aq i rëndësishëm sa i pari sepse ofron dëshmi të gjalla. Ato janë një kampanë reflektimi për shoqërinë e sotme, e cila nuk duhet të përsërisë gabimet e së shkuarës.

Autoriteti thelloi më tej punën në drejtim të krijimit të koleksionit arkivor, ku dokumente arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit iu shtuan edhe dokumente të tjera, zyrtare, të siguruar në kuadër të bashkëpunimit institucional. Nga mbajtja e një tryeze teknike, u përfutuan të dhëna nga ekspertiza e profesorëve dhe inxhinierët e minierave që kishin punuar gjatë periudhës në sektorët dhe galeritë ku ishin aktivizuar edhe të burgosurit e Spaçit.

Kontributi

Dëshmitë dhe informacionet e siguruar nga komunikimi me institucione lokale, e vendosën AIDSSH-në përpara disa fakteve të reja atë të trupave të zhdukur të personave të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit, në burgun e Spaçit.

Kërkimet e bëra në dokumentet e institucioneve, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, vërtetuan faktin se një pjesë e ish-të dënuarve, të ekzekutuar, të vrarë ose të vdekur nga mundimi dhe sëmundjet gjatë vuajtjes së dënimit, aksidentet në punë apo në tentativë arratisje, ende nuk kanë një varr.

Nisur nga të gjitha këto, Autoriteti vendosi edhe nisjen e procedurës së hetimit administrativ për verifikimin e vendvarrimeve të dyshuara dhe qartësimin e fatit të 44 të zhdukurve, bashkëpunimin me organet e pushtetit lokal për ruajtjen nga tjetërsimi, si dhe bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese për rikuperimin e eshtrave të personave të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Spaçit.

Zhdukjet e varreve, siç është vënë re, janë përdorur nga regjimi me dy qëllime: jo vetëm t'u mbyllin gojën kundërshtarëve dhe kritikëve, por gjithashtu të krijonin pasiguri dhe frikë tek të tjerët, për t'i detyruar të heshtnin dhe të mos kundërshtonin autoritetet.

Botimi nxjerr në pah se zhdukja e trupave është shkelje e të drejtave themelore të njeriut të deklaruar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara (UDHR). Viktima janë edhe familjet e tyre, të cilat e kalojnë pjesën tjetër të jetës duke kërkuar informacione për të zhdukurit.

Botimi sjell një raport të progresit të hetimit administrativ për 44 të zhdukurit në burgun e Spaçit, si dhe një pasqyrë të aktiviteteve që AIDSSH-ja ka mbajtur në përkujtim të revoltës antikomuniste të Spaçit.

Rëndësia e ruajtjes së kujtesës kolektive për këto ngjarje të rënda

Ruajtja e kujtesës kolektive mbi ngjarjet e rënda po bëhet gjithnjë edhe më e rëndësishme për të ardhmen demokratike të vendit. Mosnjohja me të kaluarën rrezikon të shfaqë remishineca në kulturën shoqërore, por edhe në politikbërjen e qeverisjes së vendit. Ndërkohë hapësira publike, institucionale dhe arsimore vazhdon të mbetet e painformuar në disa aspekte të regjimit diktatorial.

Rënia e regjimit komunist në Shqipëri nuk u pa-sua me një hetim të krimeve të kryera prej tij, aq më tepër që autorët e këtyre krimeve nuk u përballën asnjëherë seriozisht me drejtësinë dhe nuk u kërkuan falje publike viktimave të gjenocid-it komunist. Deri më sot ka munguar përfshirja e këtyre ngjarje në kurrikulat zyrtare të mësimi-t të historisë, e cila sipas vlerësimeve të ekspertëve shmang diskutimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera ndaj grupeve të tjera, apo edhe të temave të tjera sensitive lidhur me këtë periudhë, përbën ende një sfidë. Pavarësisht projekteve të shumta me qëllim përmirësimin e mësimdhënies së historisë në shkolla, ende nuk është arritur të nxitet të menduarit kritik, empatia historike dhe këndvështrimet e shumëfishta.

Në funksion të njohjes së historisë dhe ruajtjes së kujtesës, Autoriteti vjen me botime të veçanta për revoltën e Spaçit me tekste për grup-moshat e sistemit parauniversitar shkruar nga shkrimtarë për fëmijë që asistohen nga ekspertiza akademike e historianëve më të mirë të kësaj periudhe. Libri për fëmijë dhe një film i përshtatur rreth ngjarjes dhe historisë është pjesë e platformës arsimore *“Të mësojmë mbi të kaluarën- burime arsimore të hapura 1944-1991”*, e cila synon t’u vijë në ndihmë mësuesve të historisë, edukimit qytetar, filozofisë, gjuhës dhe letërsisë me qëllim përcjelljen e ngjarjes tek nxënësit e sistemit parauniversitar.

Nëpërmjet këtij ansambli prodhimesh mediatike, mësimore dhe edukuese synohet që jehona e kësaj ngjarjeje historike të kthehet në një ditë simbolike kujtese për shoqërinë, si dhe të nxitin akte reflektimi të mëtejshme si në drejtim të rehabilitimit të të gjithë ish-të dënuarve, kthimit të kampit-burg të Spaçit në muze të kujtesës kolektive për të kujtuar se aty janë kryer krime kundër jetës dhe dinjitetit njerëzor.

V. Falënderime dhe mirënjohje

Për realizimin e këtij botimi falënderoj për punën e dedikuar të punonjësve të AIDSSH-së në të gjitha drejtoritë. Format i pyetjeve u zhvillua nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar. Transkriptimi u bë në zyrat e AIDSSH-së, rrëfimet e regjistruara me zë dhe figurë u përpunuan nga sektori audio-vizual. Fondi me dokumente arkivore u mblodh dhe u përpunua nga Drejtoria e Arkivit.

Falënderoj Drejtorinë e Marrëdhënies Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur për komunikimin me ish-të dënuarit për realizimin e intervistave, si dhe punës në terren për kryerjen e hetimeve administrative për të zhdukurit në Spaç.

Falënderoj për ekspertizën e tyre profesorët e inxhinierët e minierave, Dr. Viktor Doda, ish-ministër i Energjetikës dhe Minierave, ish-inxhinier në këtë minierë, prof. dr. Kimet Fetau, pedagog në Gjeologji-Miniera, eksperti i ekonomisë Fran Gjergji nga “Albakër” dhe Dr. Femi Sufaj, studiues dhe nëndrejtor i përgjithshëm i burgjeve.

Kjo është punë shumë voluminoze dhe e kujdesshme dhe falënderoj të gjithë kontribuuesit, por sidomos të mbijetuarit nga burgu i Spaçit dhe nga internimet e gjata, si edhe familjarët e tyre që, pavarësisht moshës, gjendjes shëndetësore e lëndimit shpirtëror, u shprehën të gatshëm dhe bashkëpunuan për të dhënë dëshmitë e tyre, tepër të vlefshme e të pazëvendësueshme për revoltën e të burgosurve në burgun e Spaçit, në 21 maj 1973, si dhe të dhëna nga trajtimi çnjerëzor dhe puna e rëndë në minierë.

Konkluzione

Regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës që qeverisi Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990, u karakterizua nga: dhunimi masiv i të drejtave të njeriut, vrasjet dhe ekzekutimet individuale e kolektive (me dhe pa gjyq), vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet nga uria, torturat, dëbimet, puna skllavëruese, terrori fizik dhe psikologjik, gjenocidi për shkak të origjinës politike apo trashëgimisë së pronës, si dhe dhunime të lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit, lirisë së besimit fetar

dhe lirisë së pluralizmit politik. Ndërgjegjësimi i opinionit publik shqiptar, sidomos ndërgjegjësimi i brezit të ri për krimet çnjerëzore të kryera nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës mbetet ende një sfidë për Shqipërinë.

Zbardhja e historisë së kampit të punës së detyruar në Spaç, na vendos përballë disa çështjeve ende të pazgjidhura, të tilla si:

- *Mungesa e llogaridhënies.* Edhe pse janë kaluar 30 vjet, ende ka mungesë llogaridhënieje për krimet e kryera në atë kamp dhe në sistemin e punës së detyruar në përgjithësi. Shumë nga përgjegjësit e drejtpërdrejtë për këto krime kanë shmangur përgjegjësinë dhe nuk janë ndëshkuar.
- *Rifuqizimi i viktimave.* Zbardhja e historisë u jep mundësi të mbijetuarve që të tregojnë dëshmitë e tyre dhe të riafirmojnë identitetin e tyre si viktimat të regjimit. Kjo është një mënyrë për të rimarrë kontrollin mbi narrativën dhe të ndihmojë në shërimin e plagëve psikologjike.
- *Ndërtimi i një shoqërie të drejtë.* Mungesa e llogaridhënies dhe e drejtësisë deri më sot tregon se procesi i ndërtimit të një shoqërie të drejtë është ende i pazgjidhur. Zbardhja e historisë duhet të shërbejë si hap drejt një procesi gjithëpërfshirës të ndërtimit të një shoqërie të vërtetë demokratike.
- *Mungesa e kujtesës institucionale.* Institucionet shtetërore kanë treguar mungesë vullneti për të zbardhur dhe ruajtur kujtesën kolektive për këto ngjarje. Kjo tregon se ekziston ende një nevojë për rritjen e përgjegjësisë dhe angazhimit institucional në këtë drejtim. Në fund të fundit, kjo zbardhje e historisë së Spaçit tregon se ende kemi shumë për të mësuar nga e kaluara, për të ndërtuar një të ardhme të drejtë dhe demokratike, duke u ballafaquar plotësisht me të vërtetën e asaj kohe.

Bibliografia

Vendime dhe urdhra

- AIDSSH, urdhri me nr. 22, datë 06.02.2023 të Kryetares së Autoritetit, “Për organizimin e aktiviteteve përkujtime me rastin e 50-vjetorit të revoltës së Spaçit”
- AIDSSH, vendimi nr. 374, datë 02.06.2023 “Për fillimin e hetimit administrativ me qëllim qartësimin e fatit, gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit”
- AIDSSH, vendimi nr.724, datë 21.12.2023 “Mbi miratimin e raportit për hetimin administrativ me qëllim qartësimin e fatit, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të burgosurve të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit”
- Plani Strategjik i Autoritetit 2023-2028.

Arkivi i AIDSSH-së

- Arkivi i AIDSSH-së, dosje hetimore-gjyqësore të të dënuarve dhe ridënuarve për revoltën e Spaçit.
- Arkivi i AIDSSH-së, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Mirditë, dosje ORV nr. 123 e repartit nr. 303 Spaç, me 244 fletë.
- Arkivi i AIDSSH-së, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pukë, fashikull për masat që merren kur arratisen të burgosurit nga repartit i Spaçit, me 14 skica.
- Arkivi i AIDSSH-së, fondi nr. 4, dosje nr. 335 “Disa përfundime nga revolta në kampin e Spaçit”, me 11 fletë.
- Arkivi i AIDSSH-së, fondi nr. 4, dosje nr. 217 “Për disa shqetësime në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik të Laçit, si dhe në minierën e bakrit Spaç”, me 9 fletë.
- Fondi Drejtorial e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 7, viti 1975, dosje nr. 114: “Informacione dërguar udhëheqës së Partisë e të Shtetit mbi dëmtimet shpërdorimet e të meta të tjera në sektorin e industri-miniera”

- Fondi dega IV, dosje nr. 801: "Dosje drejtimi, industria e rëndë dhe minierave"
 - Fondi dega IV, dosje nr. 95: "Dosje drejtimi, industria e rëndë dhe minierave", volumni I
 - Fondi dega IV, dosje nr. 95: "Dosje drejtimi, industria e rëndë dhe minierave", volumni II
 - Fondi dega IV, dosje nr. 95. "Dosje drejtimi, industria e rëndë dhe minierave", volumni III
 - Fondi dega IV, dosje nr. 95."Dosje drejtimi, industria e rëndë dhe minierave", volumni IV
 - Fondi dega IV, dosje nr. 95. "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave" volumni V
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni I
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni II
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni III
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni IV
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni V
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni VI
 - Fondi dega IV, "Dosje drejtimi industria e rëndë dhe minierave", volumni VII
 - Fondi D.P.B Tiranë, dosje nr.173, "Dosje drejtimi industria e rende dhe minierave", volumni I
 - Fondi D.P.B Tiranë, dosje nr.173 "Dosje drejtimi industria e rende dhe minierave", volumni II
 - Fondi D.P.B Tiranë, vosje nr.173 "Dosje drejtimi industria e rende dhe minierave", volumni III
- Studime shkencore*
- Meta, Beqir. *Vështrim analitik mbi sistemin e burgjeve, internimeve dhe përdorimin e punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri*, Të Mohuar nga regjimi, AIDSSH, 2021.
 - Sufaj, Femi; Sota, Marinela. *Jeta në kampet e punës së detyruar, nga vështrimi i raporteve zyrtare*, Të Mohuar nga regjimi, AIDSSH, 2021.
 - Boriçi, Gjon. *Pohimi nga Byroja Politike e PPSH të dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në 1953*, Të Mohuar nga regjimi, AIDSSH, 2021.
 - Pandelejmoni (Papa), Enriketa. *Kujtesa dhe rrëfimi i historive jetësore mbi kampet e punës së detyruar, internimet dhe burgjet në Shqipërinë Komuniste*.Të Mohuar nga regjimi, AIDSSH, 2021.
 - Studim kornizë. *Mbi sistemin e burgjeve, internimit dhe punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri me fokus ngritjen e një muzeu kujtese në ish-kampin e internimit të Tepelenës*. AIDSSH,2019.
 - Grup autorësh. *Përndjekja Politike, Sifidat e tranzicionit shqiptar*. Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës. Tiranë, 2014.
 - Grup autorësh, *Historik i Shkurtër i Repartit të Edukimit 303 në Spaç-Mirëditë, 1951-1991*. Botimi i organizatës "Trashëgimia Kulturore pa kufi."



Përmbledhje

Dënimi i krimit dhe kujtesa si themel i një shoqërie të drejtë e paqësore:

Burgu i Spaçit dhe skllavërimi i të burgosurve politikë

Përgatiti Dr. Mirela Sinani

Parlamenti Europian, në rezolutën e 19 shtatorit 2019, theksoi rëndësinë e kujtesës europiane për të ardhmen e Europës [2019/2819 (RSP)] me “qëllim që të nderojmë viktimat, të dënojmë autorët e krimeve dhe të hedhim bazat e një pajtimi të bazuar mbi të vërtetën dhe veprën e kujtesës”.

Në fondin e madh të dijeve, tashmë njerëzimi ka përcaktuar sistemet skllavopronare si sisteme të bazuara te skllavëria e njeriut nga njeriu, në të cilat rregullat e pronësisë shtriheshin edhe mbi njerëzit, që shiteshin e bliheshin si çdo mall në treg, si të ishin thjesht sende, me dallimin që këto lloj “sendesh” flisnin, ecnin apo kishin edhe ndjenja (?!)...Por historia e shoqërisë njerëzore është e mbushur me shekuj skllavërimi të njerëzve edhe përtej sistemit skllavopronar.

Në shek. XVIII dhe XIX, forcat më të përparuara të frymëzuara nga idetë filozofike të lirisë, të barazisë e të vëllazërisë u ngritën kundër skllavërimin si një njollë e turpshme në ballin e njerëzimit. Me aktin e heqjes së skllavërisë, ato ishin të ndërgjegjshme se, sidoqoftë, turpërimi për këtë traditë skllavërimi do të duhej të ndihej për disa breza me radhë e më pastaj, me largimin në kohë, ky turpërim do të ndihej gjithnjë e më pak, gjersa të mbetej thjesht, si diçka që i përkiste historisë. Realiteti politik, shumë shpejt e rrëzoi poshtë këtë ide.

Komunizmi, fashizmi dhe nazizmi, tre totalitarizma të lindura mu në zemër të Europës në shekullin XX, dy luftëra të njëpasnjëshme botërore, provokuan rëndë njerëzimin dhe tronditën gjer në palcë idetë dhe realitetin e lirisë. Historikisht, totalitarizmi komunist u shfaq më herët dhe nisi që me revolucionin proletar të vitit 1917 në Rusinë cariste.

Pas Luftës së Dytë Botërore, sistemi komunist zgjeroi hapësirën e vet në të gjitha vendet e Europës Lindore. Urrejtja dhe revanshi ndaj tjetrit që i përkiste racës tjetër, kombit tjetër, atje, matanë kufijve u zëvendësua me urrejtjen dhe revanshin ndaj tjetrit këtu, brenda kufijve të vendit, brenda vetë kombit, ndaj tjetrit të klasës së ndryshme nga klasa proletare, ndaj tjetrit me mendim ndryshe nga ideologjia marksiste.

Një sistem i tillë totalitar rrëmbeu me dhunë pushtetin edhe në Shqipëri, duke goditur ekonominë dhe shoqërinë shqiptare dhe duke kundërvënë shqiptarët me njëri-tjetrin.

Shqipëria, ky vend kaq i vogël nga sipërfaqja dhe nga popullsia, iu nënshtrua një regjimi të rreptë spastrimi të vazhdueshëm, të njerëzve me ide të ndryshme prej ideve komuniste ose me prejardhje të ndryshme nga prejardhja proletare, zbrazje fshatrash e krahinash nga familje dhe fise të tëra, shpërngulje dhe internime familjesh në kampe internimi dhe kampe pune.

Ndër burgjet e shumta, të ngritura nga veriu në jug dhe të mbushura plot me shqiptarë të moshave nga më të ndryshmet, dallohej burgu i Spaçit.

Nëse dikush do të mendonte se skllavëria ishte një nocion që i përkiste historisë së largët të njerëzimit, se ajo strukej vetëm nëpër filmat e së shkuarës, gabohej. Skllavëria mbeti gjallë dhe u përdor masivisht nën shtetin e diktaturës së proletariatit.

Burgu i Spaçit, i njohur edhe me emrin *kamp pune*, ishte një ndër burgjet ku të dënuarit politikë shfrytëzoheshin edhe me punë të detyruar. Zyrtarisht, ky burg mban emërtimin *kamp*

riedukimi(?!). Të etiketuar si armiq, të përbuzur, të poshtëruar, të lënë në vetmi, pa familjarë, pa shokë e miq, pa askënd, të izoluar në një vend të shkretë mes malesh, të torturuar, të shfrytëzuar sa t'u dilte shpirti, të masakruar dhe poshtëruar edhe së vdekuri: këta ishin skllëvërit e kohës së re, që figuronin vetëm në pasqyrat e realizimit të planit të prodhimit të minierave si fuqi punëtore, madje me një pagesë sa 10% e pagesës së një punëtori, kundrejt një shfrytëzimi të jashtëzakonshëm, që figuronin në listat e fuqisë punëtore për të ndërtuar uzinat e fabrikat dhe që torturoheshin për vdekje për çdo mosrealizim norme, që edhe vriteshin barbarisht, një fenomen i panjohur për pjesën tjetër të popullsisë, që nanurisej me iluzionet e propagandës komuniste mbi rezultatet e punëtorëve të minierave që tejkalonin planet, mbi rininë që hapte kanalet e mëdha kulluese, thante kënetat, ndërtonte uzina dhe fabrika, dhe lulëzonte atdheun.

Diktatura e proletarietit dhe lufta e klasave u përdorën nga partia në pushtet për të kultivuar frikën, për të hapur fushatat e "gjahut" njerëzor dhe për të siguruar skllëvër për sektorët më të vështirë të ekonomisë.

Të burgosurit e Spaçit ishin "gjahu" i shtetit komunist, më saktë i një partie të vetme që drejtonte tërë shtetin, ata ishin provokuar, shtytur në kurth dhe zënë nga shteti, ishin rrëmbyer, dhunuar, torturuar, dënuar dhe burgosur nga një shtet që vepronte me ligj, si një bandë kriminale kundër popullit të vet.

Në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789, pikërisht dy shekuj përpara sesa shqiptarët "të zgjidhnin" shtetin e diktaturës së proletarietit, renditen të drejtat natyrore dhe të patjetërsueshme të njeriut: liria, prona, siguria dhe rezistenca ndaj shtypjes.

Shqiptarëve u ishin hequr të tëra këto të drejta natyrore duke filluar nga viti 1944 e më tej, me një sërë masash e reformash ekonomike, megjithatë ata e konsideronin veten të lirë, sepse... ishin çliruar nga pushtuesi i huaj, konsideroheshin të lirë meqë nuk ishin brenda burgjeve?!

Në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789 përcaktohet se liria ka të

bëjë me lirinë për të bërë gjithçka që nuk dëmton askënd tjetër; prandaj ushtrimi i të drejtave natyrore të secilit njeri nuk ka kufij, përveç atyre që sigurojnë anëtarët e tjerë të shoqërisë, gëzimin e të drejtave të njëjta. Këto kufij mund të përcaktohen vetëm me ligj. Ky konceptim për lirinë i deklaruar që në shekullin XVIII ishte hequr me ligj në Shqipërinë e diktaturës së proletarietit dhe, në çdo rast, institucionet përkatëse shtetërore mund të ngrinin akuza "për agjitacion e propagandë kundër shtetit". Liria për të lëvizur lirshëm ishte zhdukur me kohë. Me pretekstin e rrethimit nga bota borgjeze, i gjithë vendi ishte i rrethuar me kufij të mbyllur me tela me gjemba dhe i ruajtur me roje të armatosura, gjë që dëshmonte kthimin e të Shqipërisë në një burg të përmasave gjigante.

Kushdo që dëshironte të shkonte në botën borgjeze, akt që nuk i shkaktonte dëm askujt tjetër veç vetes së vet, arrestohej për "tentativë arratisjeje". Edhe në këtë pikë, ligjet e shtetit të diktaturës së proletarietit bënin hapa mbrapa, duke rrëzuar Deklaratën e të Drejtave të Njeriut e të Qytetarit të shpallur në shekullin XVIII.

Edhe pse liritë ishin zhdukur njëra pas tjetrës - ishte hequr liria e shprehjes dhe e mendimit ndryshe, liria e lëvizjes së lirë - nën trysinë e propagandës dhe të frikës nga agresioni i huaj, shqiptarët kishin iluzionin se ishin të lirë. Kjo ishte drama e shqiptarëve. Pikërisht, në këtë atdhe "të lirë", me këta shqiptarë "të lirë", lulëzonte fenomeni i skllavërimit të njeriut nga shteti. Në fakt, të gjitha hallkat ishin qepur trashë, por gjithsesi, diktaturës i duhej një kuadër ligjor si justifikim, për farsën se po vendoste drejtësi.

Nga momenti që kundër dikujt ishte ngritur një akuzë, jeta e tij ishte shënjuar. Të burgosurit politikë ishin shpallur armiq: jeta e tyre nuk i interesonte më askujt, prandaj kalimi i portës së burgut i nxirrte ata nga dimensionet hapësinore-kohore të realitetit shoqëror. Shteti, në fakt, bëhej pronar i jetës dhe i vdekjes së tyre. Pavarësisht se dënimi mund të ishte edhe vetëm 5 vjet dhe me një akuzë qesharake, shteti sajonte pretekste për të dhënë ridënime të njëpasnjëshme dhe për të mos e lejuar më atë person të dilte i gjallë nga burgu, nuk e lejonte të fitonte lirinë pas kryerjes së dënimit, sikurse edhe mund ta asgjësonte pa dhënë llogari e pa mbajtur përgjegjësi askush, siç

kishte ndodhur në shumë burgje, mes tyre, edhe në Spaç.

Jo vetëm shfrytëzimi me punë të detyruar, në mënyrë çnjerëzore, por sidomos ndërprerja e çdo mundësie për rifitim të lirisë përmes dënimeve të njëpasnjëshme, përbëjnë karakteristikat themelore të skllavërimit të të burgosurve politikë në burgjet e diktaturës në Shqipëri.

Ajo që ishte e veçantë për Spaçin, lidhej me shfrytëzimin e gjahut njerëzor për punë të detyruar në miniera, një nga sektorët më të vështirë të ekonomisë, me përfitime shumë të mëdha, por me rrezikshmëri të lartë jete dhe, për këtë arsye, me mungesë të madhe të fuqisë punëtore. Të burgosurit në burgun-kamp pune të Spaçit ishin të detyruar të realizonin me çdo kusht normën, përndryshe jeta e tyre varej në një fill: që shteti, përmes dorës së rojës, ushtarit, oficerit, policit, operativit etj., mund ta këpuste pa asnjë problem, sepse jeta e një "armiku" nuk vlente.


Për të qartësuar sa të jetë e mundur, shfrytëzimin e të burgosurve në Spaç, nga qershori i vitit 1968 e deri në mars të vitit 1991, AIDSSH nisi një komunikim, bashkëpunim dhe partneritet me disa institucione shtetërore: me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me struktura vartësie të kësaj të fundit, si "Alb Bakër" sh.a, me Arkivin e Shtetit.

Pas këtyre komunikimeve, me disa prej institucioneve edhe në mënyrë të vazhdueshme, u krijua një tablo se çfarë ishte dhe çfarë solli dënimi me punë të detyruar brenda burgjeve të diktaturës, për qindra e mijëra shqiptarë, të cilët ishin gjykuar, shumica për arsye politike dhe për të cilët në gjykata ishte shqiptuar dhe shkruar vendimi, vetëm me heqjen e lirisë.

Gjatë 23 vite të ekzistencës së atij burgu famëkeq vuajtën dënimin më shumë se 2200 të dënuar. Në çdo vit, në burgun e Spaçit pati rreth 900 -1100 të burgosur, 20% e të cilëve ishin të moshës 18 deri në 25 vjeç; 75% ishin të moshës 25 deri në 60 vjeç dhe 5% ishin të moshave nën 18 vjeç, apo mbi 60 vjeç.

Të dhënat janë pasqyruar në grafikun djathtas sipër:

Grafiku 1




Siç shihet edhe nga grafiku, pjesën më të madhe, rreth 75%, e zënë moshën 25-60 vjeç, moshën më të fuqishme për punë të rëndë.

Për nga dënimet:

- Të dënuar deri në 5 vjet heqje lirie, ishin rreth 25% e të burgosurve.
- Të dënuar me nga 5 deri në 10 vjet heqje lirie, ishin rreth 38% e tyre.
- Të dënuar me 10 deri në 15 vjet heqje lirie, ishin rreth 15% e të dënuarve me burg.
- Të dënuar me mbi 15 vjet heqje lirie, ishin rreth 22% e tyre.

Të dhënat pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 2



Në burgun e Spaçit, gjatë gjithë viteve, rreth 55% e të burgosurve ishin përsëritës, kurse një pjesë e të burgosurve ishin edhe të ridënuar po aty, gjatë vuajtjes së dënimit.

Një e dhënë shumë e ndryshueshme ka qenë origjina e të burgosurve, që hedh dritë mbi një fenomen shumë radikal siç ishte zhvillimi i luftës së klasave, përmasat, shtrirja, thellësia, ashpërsia e së cilës, në shoqërinë shqiptare, ishte e tillë që, prej saj, nuk përjashtohej askush.

Lufta e klasave, që sipas orientimeve të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, herë ulej e herë ngrihej, po asnjëherë nuk shuhej, paraqitej si burim zhvillimi, ngjashëm me përfytyrimet e zjarrit heraklitian, që përshkonte gjithçka. Mbështjellë me këtë veshje filozofike antike dhe sidomos bazuar tek ideologjia marksiste, lufta e klasave u përdor si arma që spastroi shoqërinë shqiptare dhe ndryshoi thellësisht fizionominë shoqërore, ekonomike, kulturën, të drejtën, zakonet, traditat, moralin, mendësitë dhe përjetimet psikologjike brenda një kohe shumë të shkurtër. Koncepti mijërvjeçar për lirinë dhe përvoja njerëzore e lirisë erdhi dhe u rruhd në një përfytyrim mjeran lirie, megjithëse i "argumentuar shkencërisht" dhe në një përvojë "lirie" që identifikohet me të menduarit e të jetuarit siç thotë partia dhe me të jetuarit si në rrethim. Ndryshueshmëria aq e madhe e origjinës së të burgosurve dëshmon edhe faktin tjetër që të dhënat që përdoreshin nga prokuroria dhe gjykata, si fakte për të ndërtuar akuzën dhe për të vënë dënimin, ishin subjektive.

Statistikat tregojnë, gjithashtu, se numri më i madh i të burgosurve në raport me popullsinë, ka qenë nga zonat kufitare. Edhe pse kufiri shqiptar ishte një pjesë territori e rrethuar me tela me gjemba, me sinjalizues elektrikë, e ruajtur nga roje të armatosura që kishin të drejtë të vrisnin këdo që i afrohej dhe që ishin të mbështetur nga qentë e stërvitur të kufirit, të jetuarit pranë vijës kufitare bëri që tek ajo pjesë e popullit që banonte atje, më pranë pjesës tjetër të botës, të mbetej gjallë dhe të pulsonte vazhdimisht ndjenja e lirisë, ideja e lirisë dhe shpresa e shpëtimit nga ky shtet i vetërrethuar, që vetasgjësonte sistematikisht popullsinë e vet. Të dhënat e përgjithshme të realizimit të planit që përpiloheshin në çdo minierë, nxirreshin nga të dhënat e mbajtura në regjistra,

ku në kolona të veçanta shënohej realizimi i normës ditore nga çdo i burgosur, i rreshtuar si fuqi punëtore në minierë. Trajtimi i secilit prej tyre, varej nga realizimi ose mosrealizimi i normës. Shprehja "O normën, o shpirtin!" e pambështetur në ndonjë vendim gjykate, e pashkruar në muret e burgjeve, por e shqiptuar nga të gjithë policët dhe rojet e burgjeve, duke ia përplasur në fytyrë çdo të burgosuri që kryente punë me detyrim, nuk ndryshon aspak nga shprehja "Puna të çliron", e shkruar në hyrje të kampeve naziste të shfarosjeve në masë. Njëra shfaqej menjëherë dhe dukej që në hyrje, tjetra nuk dukej, por dëgjohej përditë, sa kohë kishe jetë në ato burgje-kampe pune, ndërsa pasojat e saj mbetën të fshehura e të panjohura për një kohë shumë të gjatë - mbi gjysmëshekullore.

Mosrealizimi i normës shoqërohej me dënime torturoese, deri në ridënime. Treguesit e realizimit të planit nga të burgosurit që punonin në miniera janë në rritje, me tejkalime çdo muaj e çdo vit. Përtej statistikës së thjeshtë dhe shifrave të ngurta, që gjithsesi, nuk tregojnë as kushtet teknike të minierave, as kushtet e punës së të burgosurve minatorë, as mjetet me të cilat punonin, as krimet e kryera mbi ta brenda minierave, kushdo mund të pyesë: Po ç'ishin këta të burgosur që punonin? Ç'ishin këta të burgosur që punonin dhe që dënoheshin për mosrealizimin e normës? Ç'ishin këta të burgosur që punonin, që dënoheshin dhe që torturoheshin për mosrealizimin e normës? Ç'ishin këta të burgosur që punonin, dënoheshin, torturoheshin dhe që vriteshin për mosrealizimin e normës? Ç'ishin këta të burgosur që punonin, dënoheshin, torturoheshin, vriteshin dhe që u zhdukej trupi pa gjurmë, maleve ose thellësive të minierave, për mosrealizim norme? Mbi bazë të cilit ligj, a të cilit vendim gjykate?

Në çdo vend të qytetëruar të botës, në të drejtën penale, që nga përcaktimi i veprave penale e deri te përcaktimi i dënimeve, llojet dhe masat e tyre, qëllimi është që të parandalohet kryerja e një veprë penale, të ndëshkohet personi që e kryen, duke iu hequr, apo kufizuar liria dhe disa të drejta të tjera, si edhe të edukohet me qëllim rehabilitimin në jetën shoqërore, pas kryerjes së dënimit. Mënyra sesi ishte ndërtuar e drejta penale, qëllimi, konceptimi i veprës penale dhe zgjerimi tej mase i saj, pastaj i gjithë sistemi i

institucioneve të përgjimit, zbulimit, ndjekjes, hetimit, gjykimit si edhe sistemi i institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgje-kampe pune si ai i Spaçit e të tjerë, na jep pamjen e një shteti bandit i interesuar të shtyjë në krim, të rrëmbejë dhe të kriminalizojë sa më shumë njerëz, të dënojë sa më rëndë e të krijojë pretekste për të ridënuar, me qëllim që i burgosuri të mos dilte më i gjallë nga burgju, na jep pamjen e një shteti që, të dënuarit në burgje nuk ishin atje për të vuajtur dënimin, ca më pak për t'u rehabilituar, por për t'u shfrytëzuar maksimalisht, si fuqi e gjallë e punës deri në vdekje, madje edhe për t'u asgjësuar.

Treguesit e dhimbshëm ekonomiko-financiarë

Në burgun-kamp pune të Spaçit norma e ditës së punës së një të burgosuri që përfshihej në fuqinë punëtore të minierës si punëtor i pakualifikuar, thjesht punëtor kazme dhe lopate, që mbushte e shtynte vagonët me mineral, ishte nxjerrja e 8 tonëve mineral bakri në një turn. Puna ishte e organizuar me tre turne, kurse paga ishte përcaktuar me ligj sa 10% e pagës së një punonjësi në gjendje të lirë, për të njëjtën punë të kryer.

Të burgosurit e Spaçit që u shfrytëzuan për punë të detyruar në nëntokën e Spaçit, në 23 vite kryen 88.388 (tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) metër linearë punime minerare. Çdo metër linear i ri në minierë është hapur vetëm nga të burgosurit. Ndër punët e tjera ishin mbushja e mineralit nëpër vagonë, shtyrja e vagonëve me mineral, nxjerrja në sipërfaqe etj. Të burgosurit nxorën nga nëntoka e Spaçit 2.8 milionë tonë mineral bakri¹ (llogaritur për periudhën 1968 - mars 1991, kohë kur ka funksionuar kampi) dhe rreth 1 milion ton mineral piriti.


Në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat zyrtare shtetërore, që sot i ka në zotërim Shoqëria aksionare "AlbBakër" sh.a. për prodhimin e mineralit të bakrit dhe të piritit në ish-minierën e bakrit, Spaç, në vite. Diferencat në sasinë e mineralit të nxjerrë në periudha të ndryshme, dëshmojnë edhe për shfrytëzimin që i është bërë punës së papaguar të të burgosurve, deri në vitin 1990.

Vitet	Mineral bakri (ton)	Mineral piriti (ton)
1966	13600	7355
1967	20403	30619
1968	28088	45069
1969	24947	30036
1970	30000	38237
1971	41443	37280
1972	60059	43580
1973	65613	35593
1974	76540	43869
1975	84795	43474
1976	95983	36098
1977	111516	47057
1978	139090	48281
1979	150659	54749
1980	156502	71532
1981	184134	70643
1982	172515	80219
1983	150794	92000
1984	184995	89001
1985	168986	92410
1986	168106	54012
1987	187815	54775
1988	183574	50958
1989	192338	48800
1990	126752	48750
1991	34729	22988
1992	35885	6551
1993	37867	7358
1994	34142	3309
1995	62737	2649
1996	53789	-
1997	7098	-
1998	18246	-
Totali	3103740	1337252

1. Të dhënat janë siguruar përmes shkresave-kërkesë të AIDSSH-së për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me nr. 482 prot., datë 06.03.2023; Kthim përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përmes "AlbBakër" Sh.A. me nr. 21/1 Prot., datë 10.03.2023, arkivuar nga AIDSSH me nr. 482/2 Prot., datë 13.03.2023.


Grafiku 3

Prodhimi mineralit të bakrit e pirit 1966-1998



Grafiku 4

Minerali Bakri (ton) Minerali Pirit (ton)



Në grafikun 3 paraqiten në mënyrë lineare, nxjerrja e mineralit të bakrit dhe të piritit, bazuar në të dhënat deri në vitin 1998.

Në grafikun 4 pasqyrohet prodhimi i mineralit të bakrit e të piritit krahasuar me njëri-tjetrin, çdo vit, deri më 1990.

Nga viti 1966 e deri në korrik të vitit 1968, në minierën e Spaçit punonin vetëm punëtorë miniere. Siç shihet edhe nga kurba e grafikut, sapo aty pranë u vendos burgu i Spaçit, prodhimi i bakrit dhe i piritit u shumëfishua. Gjithashtu, me mbylljen e burgut të Spaçit në vitin 1991, shihet qartë edhe nga grafiku, se çfarë ndodh me prodhimin e mineralit të bakrit dhe të piritit: nxjerrja e bakrit ra në nivele minimale, kurse nxjerrja e piritit u ndërpre krejtësisht.

Nga minerali i bakrit, përqindja bakër e të cilit ishte rreth 1.15%,² pas përpunimit u përfutur rreth 35 mijë tonë bakër, sasi kjo që në bursat e kohës, ku bakri kuotohej nga 1900 \$/ton deri në 3500 \$/ton, vlerësohej rreth 94 milionë e 500 mijë dollarë amerikanë ose krahasuar me bursën e sotme, pra viti 2023, ku bakri kuotohet rreth 8890 \$, vlera do të ishte 311 milionë e 150 mijë dollarë amerikanë.

2. Sipas të dhënave të marra me shkresat përgjigje nga "AlbBakër" sh.a., me nr. 21/3 Prot., datë 02.05.2023, për kërkesën e AIDSSH-së me nr. 482/7 prot., datë 26.04.2023, arkivuar nga AIDSSH me nr. 482/8, datë 03.05.2023, nxjerrja e mineralit të bakrit nga persona të dënuar është bërë në minierat Spaç, Gurth-Spaç nr.1 në rrethin Mirditë dhe në minierën Qafë-Bari në rrethin Pukë, por vetëm në minierën e Spaçit, kanë punuar të burgosurit politikë. Në këtë minierë, minerali i nxjerrë ka pasur një pastërti që nuk e ka kaluar në asnjë rast shifrën 1.15%. Në minierën Gurth-Spaç nr.1, ku kanë punuar të burgosur të zakonshëm, pastërtia e mineralit të bakrit ka qenë 1.5%-2.82%.

Produkti i mundit të punës së detyruar të të burgosurve i jepte frymëmarrje shumë sektorëve të ekonomisë. Sasi të mëdha të mineralit të bakrit shkonin në Uzinën e Telave në Shkodër, ku prodhoheshin produkte të rëndësishme për industrinë energjetike dhe mekanike.

Një sasi e konsiderueshme sidomos bakër elektrolitik, eksportohej, shitej në tregje, apo shkëmbehej me klering me shtete të ndryshme në Europën Lindore dhe në këmbim merreshin makineri bujqësore, pjesë këmbimi, artikuj të ndryshëm industrialë, etj.

Raportet financiare të këtyre transaksioneve është shumë e vështirë të gjenden, pasi në sistemin e diktaturës së proletarietit mungonte transparenca dhe çdo gjë zhvillohej e mbyllur dhe në fshehtësi. Edhe nëse mund të ekzistonte ndonjë dokument, p.sh., në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme është zhdukur gjatë ndryshimit të sistemit dhe largimit të qeverisë që lidhej me atë sistem.

Minerali i piritit i nxjerrë në minierën e Spaçit, në sasi të përgjithshme, prej 1.211 154 tonë³ kryesisht shkonte për eksport, ndërsa një pjesë përdorej në Uzinën e Superfosfatit, ku prodhoheshin plehrat kimike për bujqësinë, si edhe shërbente si lëndë e parë për prodhimin e acidit sulfurik (H₂SO₄), etj.

Shumë prej të burgosurve që kryenin punë të detyruar në miniera, të lodhur nga torturat dhe poshtërimet, në dëshpërim e sipër, hidheshin mbi telat me gjemba që rrethonin burgun-kamp pune të Spaçit, që s'mund të kapërceheshin e nga ku s'mund të arratisesh askush, megjithatë rojet qëllonin mbi ta dhe i vrisnin.

Shumë të tjerë vdiqën nga mundimi, torturat, sëmundjet e mushkërive dhe sëmundje të tjera që merrnin nëpër biruca dhe në dhomat e tejmbushura me të burgosur e pa kushte jetese, si edhe nga mungesa e sigurisë teknike në galeritë e minierave, apo nga dhuna e ushtruar prej rojeve edhe gjatë procesit të punës.

Pjesa më e madhe e të burgosurve morën ridënime, duke i kthyer dënimet e tyre fillestare

disavjeçare, në dënime thuajse të përgjeshme. Të mbijetuarit nga burgjet komuniste dëshmojnë se shteti i diktaturës së proletarietit i kryente torturat sipas manualeve që i kishin ardhur nga Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik apo Gjermania etj. Siç dëshmojnë të mbijetuarit, prifti katolik Pjetër Meshkalla kishte kundërshtuar përkthimin, nga gjuha gjermane, të manualeve me tortura çnjerëzore. Megjithatë, sistemi kishte në shërbim njerëz të specializuar në vendet komuniste për tortura, si edhe manuale që u përkthyen dhe aplikoheshin mbi të dënuarit.

Shfrytëzimi i të dënuarve për punë të detyruar në miniera, kushtet e vështira të punës, norma tepër e lartë dhe ndëshkimet e rënda për mosrealizimin e saj, mungesa e çdo mbrojtjeje teknike në punë, ushqimi shumë i pakët dhe jashtë standardeve shëndetësore, dhuna e vazhdueshme nga policia dhe punonjës të tjerë të shërbimit në burgje, ishin faktorët që shkaktuan shpërthimin e revoltës në 21 maj të vitit 1973 në Spaç, revoltë që zgjati tri ditë dhe tronditi nga themelet gjithë shtetin diktatorial.

Të mbijetuarit nga burgu i Spaçit dëshmojnë se jo vetëm që kërkesat e tyre të drejta nuk u morën parasysh, por shteti i diktaturës së proletarietit reagoi me egërsi për ta shtypur revoltën. Me urgjencë u mobilizuan korpuse të tëra dhe u zëvendësuan ushtarët me trupa policore. Kishte aq shumë trupa në rrethim, saqë policët rrinin ngjeshur sup më sup.

Që shfrytëzimi i këtyre skllëvërve të socializmit të vazhdonte i pandërprerë, shteti veproi me shpejtësi, duke arrestuar të gjithë pjesëmarrësit më të parë dhe më aktivët në revoltë.

Në Spaç u zhvilluan gjyqe farsë dhe u dhanë dënime me vdekje, për katër nga pjesëmarrësit në revoltë, të cilët, u masakruan dhe ndoshta, disa e dhanë frymën e fundit, përpara se ajo të mbyllej plotësisht dhe shumë më parë sesa të zhvilloheshin gjyqet për ta.

Tragjikisht, një pjesë e të burgosurve politikë të Spaçit edhe pas vdekjes mbajnë ende vulën e armikut për shkak se janë dënuar duke u cilësuar

3. Sipas të dhënave të marra me shkresat përgjigje nga "AlbBakër" sh.a., me nr. 21/3 prot., datë 02.05.2023, për kërkesë e AIDSSH-së me nr. 482/7 prot., datë 26.04.2023, arkivuar nga AIDSSH me nr. 482/8, datë 03.05.2023.

për "akte terroriste". Qindra të tjerë, e ndoshta më shumë, janë të dënuar pafundësisht të humbur e të pavarrë, sepse në mënyrën më mizore dhe në kundërshtim me çdo kod moral, që nga kohët më të lashta, trupat e tyre janë hedhur maleve dhe përrunjve gjysmë të groposur ose janë lënë në natyrë, që të shqyheshin nga egërsirat. Eshtrat e tyre s'dihet as ku ndodhen, as si të identifikohen. Diktatura e proletariatit s'kishte të ngopur me torturat ndaj trupave të të gjallëve dhe gjymtimet e trupave të të vdekurve, me zhbërjen e dinjitetit njerëzor, depersonalizimin, zhdukjen e varreve.

Ish-burgu i Spaçit ose burgu-kamp pune do të jetë përherë një vend i kimit komunist, krim që u krye në mënyrë masive dhe për gjysmë shekulli rresht, nga një sistem që, përmes propagandës, mashtrimit popullin me pamje të bukura të lirisë dhe të jetës së lumtur, ndërsa e rrethoi të gjithin me klone dhe tela me gjemba, për të mos lejuar askënd as të ëndërronte të largohej për diku tjetër, as të shprehte ndonjë dëshirë të tillë.

Kushdo që, qoftë në mënyrë naive, e shprehu një ëndërr të tillë, qoftë që guxoi të provonte të kapërcente telat me gjemba ose ra në kurth dhe nga frika u drejtua nga kufiri me tela me gjemba, u dënua nga shteti i diktaturës së proletariatit, jo thjesht me burgim, por iu nënshtrua një procesi të mohimit tërësor shoqëror, për së gjalli si të vdekur, kurse për së vdekuri, të humbur e pa asnjë shenjë.

Sot në Spaç ende kemi një krim të vazhduar. Janë të zhdukurit, rreth 50 ish-të dënuar të identifikuar gjer tani që presin t'u prehen eshtrat aty ku duhej të ishin, pranë të afërmeve të tyre, prej të cilëve u ndanë dhunshëm së gjalli. Çdo jetë vdes dhe jetë të lindura prej saj vazhdojnë, por vdekjet e Spaçit janë ndryshe, janë vdekje që jetojnë... Ndaj, Spaçi ka qenë një ferr dhe sot është një histori e rëndë edhe për t'u lexuar, një histori që i bën me turp shqiptarët dhe shtetin shqiptar, dhe detyron ndjesën ndaj të gjithë atyre njerëzve dhe familjeve të tyre, ndjesën ndaj brezave të rinj, për tronditjen që shkakton zbulimi i këtyre krimeve. Revolta e Spaçit do të mbetet në historinë e kombit tonë si një frymëmarrje shprese dhe besimi, nën dhunën e pandërprerë të diktaturës.

Jo rastësisht, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, në një rezolutë të veçantë, Rezoluta 1096, që në vitin 1996, theksonte se trashëgimia e regjimeve totalitare komuniste, nuk ishte një çështje e lehtë për t'u trajtuar: "*Në planin institucional, kjo trashëgimi përfshinte centralizimin, militarizimin e institucioneve civile, burokratizimin, monopolizimin...; në nivelin e shoqërisë, shkonte nga kolektivizmi dhe konformizmi në bindjen e verbër dhe në mënyra të tjera të mendimit totalitar. Në këto kushte është e vështirë të ringrihet një shtet i së drejtës i civilizuar dhe liberal - prandaj strukturat dhe mënyrat e të menduarit të së kaluarës duhet të çmontohen dhe të kapërcehen*".

Hapja e dosjeve të shërbimit sekret do të ishte një hap, krahas hapave të tjerë - rehabilitimit të të gjithë ish-të dënuarve, ruajtjes dhe kthimit në vende të kujtesës kolektive të burgjeve dhe të institucioneve të tjera ku janë kryer krime kundër jetës njerëzore dhe dinjitetit njerëzor - që përmes njohjes së të vërtetës, të zhduken iluzionet për sistemin komunist dhe brezat e rinj të orientohen drejt ndërtimit të perspektivave të tjera shoqërore ku jeta njerëzore, ashtu siç na mësojnë filozofët që nga thellësitë e kohës e siç e ripërsërit Kanti, të trajtohet si qëllim e jo si mjet. Ndërmarrja e këtyre hapave do të shërbejë për ngritjen e shtetit të së drejtës dhe mosdështimin e procesit të demokratizimit.

Ndryshe, siç theksohet në rezolutën 1096 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, "*do të shikojmë të instalohet oligarkia në vend të demokracisë, korrupsioni në vend të shtetit të së drejtës dhe kriminaliteti i organizuar në vend të të drejtave të njeriut. Në rastin më të keq, do të asistojmë në "restaurimin e mëndafshtë" të një regjimi totalitar, qoftë edhe të përmbysjes me forcë të demokracisë ende në lindje e sipër*".

Mblodhën dhe përpunuan të dhënat:

Luan Ismaili, Anton Dukagjini, Vojsava Delilaj⁴

4. Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi vetëm e autores dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë si pasqyrim i qëndrimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Dëshmi
nga ish
të dërr

mi
sh

Gëzim Çela
Urim Elezi
Nevrus Golka
Barjam Dervishaj
Nuri Stepa
Ndue Hoti
Nikoll Prenga
Shkëlqim Abazi
Ylber Merdani
Fatos Lubonja
Agron Hoxha
Hysen Haxhiaj
Iljas Kajo
Ylli Kanina
Edmond Halimi
Musa Hoxha
Ilir Malindi

nuarrit



Gëzim Çela

“Në Spaç edhe të qeshurën e kishim të ndaluar. Nuk më jepnin asnjë punë. Puna ishte mundësia për të jetuar...”

Gëzim Çela, i biri i Rozës dhe Mahmutit, lindur në vitin 1935, në Lushnjë. U arrestua për krimin e tradhtisë së atdheut përmes tentativës për arratisje, në 1 tetor 1957 dhe u dënua me 12 vjet heqje lirie.

Në vitin 1971 u dënua përsëri me 8 vjet heqje lirie, me akuzën për agjitacion e propaganda kundër pushtetit. U ridënua për herë të dytë, për pjesëmarrjen në revoltën e Spaçit, me 12 vjet heqje lirie⁵. Në burgun e Spaçit, hyri në vitin 1971 dhe doli në vitin 1984.

A keni aplikuar pranë AIDSSH-së, për të marrë dosjen tuaj?

Gëzim Çela: Po, kam qenë ndër të parët që e kam marrë.

Me çfarë u përballët, gjatë leximit të këtyre dokumenteve?

Gëzim Çela: I kam ditur ato që janë aty. Kam bërë 21 vjet burg.

A e keni kërkuar zbardhjen e bashkëpunëtorëve nga leximi i dosjes?

A i evidentuat bashkëpunëtorët që kanë raportuar për ju?

Gëzim Çela: As nuk më ka interesuar fare, ajo punë. Për çfarë më duhet? I njoh ata dëshmitarët që më kanë dalë për gjyqe dhe për hetuesira...

5. Fondi nr.1, hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2354. Vendim nga Gjykata Popullore e Rrethit Mirditë nr. 32 Regj.Them., nr. 34 i vendimit, datë 13.07.1973, Arkivi i AIDSSH-së.

“Kudo isha i ndjekur dhe i luftuar. Natyrshëm më shkoi mendja për të ikur.”

Tashmë që keni lexuar dosjen, a mendoni se raportet e atyre bashkëpunëtorëve kanë qenë finalizimi i arrestimit tuaj?

Gëzim Çela: Unë kam qenë me biografi të keqe, si quheshim atëherë, kështu që e dija, pritëshin këto të gjitha. Pasi mbarova shkollën fillore, më doli bursa pedagogjike për në Shkodër dhe pas tre-katër muajve më përjashtuan. E kam ende edhe dokumentin që ma treguan, pse më ndërpritej bursa. Një nëpunës i vjetër shkodran ma nxori atë, firmosur nga Karehman Ylli, ministri, e në të shkruhej: “Konviktorit Gëzim Çela i pritet bursa, për arsye se nuk i plotëson konditat që i duhen një konviktori.” Mbete poshtë e përpjetë, andej-këndej gjersa erdha këtu, në Durrës. Zura një dhomë, se nëna ime ishte mami në Durrës dhe mbarova gjimnazin, kurse për punë as bëhej fjalë. Desha të punoja si arsimtar në Lushnjë, por as atje nuk më pranuan. Kështu, m’u mbush mendja për të ikur.

Përpara sesa të niseshit për t’u arratisur, a kishit ndierë sikur ju ndiqnin?

Gëzim Çela: Nuk e di, por fakti që nuk më jepnin asnjë punë. Puna ishte mundësia për të jetuar. Ishte natyrshme që ne ishim të rrethuar nga lufta e klasave, se unë i përkisja asaj klase tek e cila këta kërkonin pretekstin më të vogël. Ata jetonin pikërisht me luftën e klasave edhe kështu

që kudo isha i ndjekur dhe i luftuar. Natyrshëm, më shkoi mendja për të ikur.

Kisha një shok nga Shkodra, që më kishte thënë se babai i tij e njihte mirë kufirin, se vinte e vinte andej, ngaqë merrej me punë tregtie. E takova dhe vendosëm. Një ditë prej ditësh, shkuam në Koplik, prej aty në Bajzë, ku na priste i ati i tij.

Atje iu nisëm malit përpjetë, drejt kufirit. Ishte natë dhe u hasëm me rojet. Na dëgjuan dhe bërtitën: “Ndal!” Ndërkaq babai i shokut tim, u tha atyre: “Jo, se jemi tanët”. Mirëpo kur ky tha “Jemi tanët”, i biri, Luigji, që ishte para rojeve iku me vrap. Edhe unë mbas tij. Kërciti automatiku. Qëlluan natën nëpër errësirë. Shpëtuam kot fare. Si duket, plumbat kapën babain e Luigjit. Ikëm e u fshehëm diku në një kodër dhe po prisnim, të gdhihej. Më pas e rrethuan vendin, na arrestuan dhe na dërguan në hetuesi, në Shkodër.

A morët vesh, çfarë ndodhi me babain e shokut, që e vranë në kufi?

Gëzim Çela: Ne nuk morëm vesh gjë, por nuk e pamë më atë. Më pas, morëm vesh që ushtarit i ishte bllokuar arma. Shyqyr që nuk i shkrepim më dhe u vra vetëm babai i shokut tim. Filluam burgun e parë me akuzën “tentativë për arratisje”.

Si e ka emrin shoku juaj?

Gëzim Çela: Ai ishte Luigji Shllaku nga Bajza e Shkodrës, diku lart, zonë kufitare. Kishim qenë ushtarë bashkë edhe ishim shumë shokë. Kam pasur një hallë në Lezhë. Edhe ai kishte njerëzit e tij atje dhe ishim takuar. Kishte rënë muhabeti që po të ishte puna keq andej-këtej, ai tha që e njihje mirë kufirin. Isha pa punë, pa shtëpi, me rrezikun e ndonjë internimi, kështu m'u mbush mendja dhe e takova Luigjin.

Pas arrestimit, ku ju dërguan?

Gëzim Çela: Pas arrestimit, filloi hetuesia në Shkodër dhe më dhanë dënimin.

Gjatë qëndrimit në hetuesi ishit vetëm?

Gëzim Çela: Jo, vetëm. Më pas edhe me të tjerë, madje kam qëlluar edhe me një tjetër.

Nga vendi ku ju arrestuan deri në Shkodër, a ju keqtrajtuat?

Gëzim Çela: Jo, jo. Ishte punë shpejt e shpejt, ishte komandë e ushtrisë. Nuk kishte filluar akoma policia. Na çuan në hetuesinë e Shkodrës.

Sa zgjati hetuesia?

Gëzim Çela: - Tetë muaj. Ishim para faktit të kryer. Ishim kapur në kufi "tentativë arratisjeje", por për fat, u bë amnistia dhe nga 14 vite u ul dënimi në 12.

Gjatë atyre muajve, a ju sollën dikë për t'ju spiunuar?

Gëzim Çela: Jo, jo... ne ishim para një fakti të kryer, ishim kapur në kufi, nuk kishim akuzë "agjitacion-propagandë", ku gjatë hetuesisë do t'u duhej të grumbullonin sa më tepër materiale për të dhënë dënimin. Ne ishim para faktit të kryer: "tentativë arratisjeje".

Gjatë hetuesisë a ju kërkuan që të bashkëpunoni?

Gëzim Çela: Jo, jo.

A ju keqtrajtuat? Si ishte sjellja e punëtorëve operativë ndaj jush?

Gëzim Çela: Presionet i kishin të zakonshme, por ndonjë gjë të jashtëzakonshme nuk kam provuar.

Si ishin kushtet e mjedisit ku qëndronit?

Gëzim Çela: Direkt në çimento edhe ato të zakonshmet... një copë bukë sa për të jetuar.

Gjatë marrjes në pyetje në hetuesi, sa vetë ishin të pranishëm? Sa zgjaste një seancë pyetjesh?

Gëzim Çela: Hetuesia e kishte shumë të thjeshtë me mua. Ishte vlarë një person në kufi. Ne ishim kapur në kufi dhe donin të na hiqnin qafe. Kishim akuzë për "tentativë arratisjeje" dhe do të dënoheshim.

A kishit avokat?

Gëzim Çela: Po, kisha dy avokatë, që i kishte marrë nëna ime, por njëri lejohej.

Avokatët i kishte marrë nëna juaj, nuk ua siguroi shteti?

Gëzim Çela: Jo, nëna ime i kishte marrë. Por vetëm njëri u lejua, jo të dy.

Gjatë gjyqit a ishte e pranishme nëna juaj?

Gëzim Çela: Po ishte. Unë nuk e shihja, por e di që ka qenë.

A ju doli dikush dëshmitar?

Gëzim Çela: Jo, ne ishim kapur në kufi. Madje, duke qenë se prej familjes isha në gjendje të mirë, kur u nisëm për t'u arratisur kisha marrë ca napolona floriri me vete. I kisha në xhep dhe i fsheha atje, 100 napolona flori.

Ku i fshehe?

Gëzim Çela: Atje ku ndenjëm, në kodër, gjer në mëngjes. Bëra një shenjë, i vura poshtë gurit. Më vonë, gjatë kohës së hetuesisë, kur ishte Ilmi Seiti, i thashë që më kanë mbetur edhe ca napolona atje.

Për flarinjtë treguat gjatë hetuesisë?

Gëzim Çela: Po, gjatë hetuesisë. Më shoqëruan mua, shkuam, u tregova vendin ku ishte dhe i morën ata flarinjtë. Kështu që, shkuan ato.

Çfarë ndodhi me nënën tuaj pas arrestimit edhe dënimit tuaj?

Gëzim Çela: Nëna ime ishte mami, në Lushnjë, e nderuar e respektuar, e njihnin si nënë Roza dhe atë e lanë atje, si mami. Kur mbarova hetuesinë, më çuan në Rinas.

Me çfarë ju transportuan dhe a ju kishin lidhur?

Gëzim Çela: Të lidhur me zinxhirë këmbë edhe duar më morën me GAZ-in e burgut dhe më dërguan në Rinas, në kamp. Aty na priti komanda e Rinasit. Meqë ishim më afër Tiranës, ndofta kanë qenë kushtet pak më të mira në krahasim me kampet e tjera që i kam provuar më vonë, por në Rinas nuk ishte fort keq. Aty ishte edhe Isuf Vrioni, nëse e keni dëgjuar. Punoja me çimento, me beton, me lopata, me vagonë. Kam bërë edhe disa piktura për të burgosurit, duke shtyrë vagonët. Në kamp u përballem me punë, por unë kam qenë fizikisht shumë i fortë dhe realizoja më tepër se një normë.

Aeroportin e Rinasit e kemi ndërtuar ne. Madje, mendoj që aty në Rinas duhet të jetë një pllakë përkujtimore që t'u kujtojë të gjithëve që kalojnë në pistë dhe hipin në aeroplan, se aty ku po shkelin është derdhur gjaku edhe djersa e të burgosurve politikë. Të gjithë pistën e kemi bërë ne, të burgosurit. Unë kam qenë edhe piktor, nga më të mirët që ka pasur Shqipëria.

Si ishte një ditë pune në kampin e Rinasit, nga mëngjesi deri në darkë?

Gëzim Çela: Si në të gjitha kampet e tjera. Por e vështirë ishte kohëzgjatja në punë dhe më e keqja e të këqijave ishte që nuk të lejonin të futeshe në kabanon, para orës gjashtë të darkës. Kishte shumë pleq aty. Ata vinin me jorgan e me batanije në kurriz dhe prisnin që të hapej dera për të hyrë në kabanon, se nuk na linin të hynim pa shkuar ora gjashtë. Imagjino, nëpër oborr gjithë ai i ftohtë.

Aty te fusha vendosëm të bënim një ndeshje futbollit, të rinjtë me veteranët. Më kërkuan të bëja një shpallje. U zhvillua ndeshja. Në mes të natës, më thërrasin të zbres poshtë. Kishin komentuar kundër nesh. Neve nuk na kishte shkuar mendja, por meqë unë e kisha bërë vizatimin e shpalljes, më thirrën dhe më futën në birucë, në çimento. Erdhi komandanti i kampit dhe më transferuan në Thumanë, në hapje kanali. Kam punuar nëpër kanale nja gjashtë-shtatë vjet, gjersa u bë amnistia dhe u lirova.

Mbaj mend që dëgjova lajmin për vrasjen e Kenedit. U emocionova, vërtet.

Kur erdhi për të më takuar, i thonë nënës time: *“Çuni yt, ka qarë për Kenedin, po burri në Amerikë, a ka qarë për Kenedin?”*

Kundërshtova, megjithatë më futën në birucë një muaj, vetëm pse qava.

A ushtronin dhunë në kampet e punës nëse dikush nuk e mbaronte normën?

Gëzim Çela: Unë kam qenë fizikisht shumë mirë, se isha i ri dhe bëja më tepër se norma, por ata që nuk e bënë normën, sigurisht, ndëshkoheshin me birucë.

Kur u liruat?

Gëzim Çela: Nga kampi i Rinasit shkova në Thumanë, ku bëra tetë vite, pastaj në Laç e që aty u lirova. Erdha në Tiranë ku kisha shtëpinë time, në mes të Tiranës, te rrugica “Ded Gjo Luli”. Duhet të bëja pasaportizimin, mirëpo nuk ma bënë. Një herë në muaj vinte polici, më merrte, më çonte te stacioni i trenit dhe më thoshte: “Ik nga Tirana. -E ku të shkoj?- i pyesja. - Shko ku të duash!” Unë shkoja prapë me kërkesë, pas katër a pesë ditësh. Kjo punë, gati një a dy vjet. Çështja ishte që një komshi, që punonte diku në ministri, ia kishte vënë syrin shtëpisë sonë dhe, më pas, për të na hequr qafe mua edhe nënës, na çuan në internim. Fillimisht, më çuan në minierë në Manëz, ku ishte drejtor Skënder Xhuglini, vëllai i Nexhmies. Kur shkova atje, pasi më pyetën e u thashë se isha piktor dhe dija t'i bija edhe kitarës, më quajtën “artist”. Më caktuan me bojëra dhe nisa duke lyer e zbukuruar me piktura dhe u bë

miniera e Manzës aq e bukur, saqë erdhën nga Tirana, ta nxirrnin në televizor. Një inxhinier italian që kishte ardhur në Sukth, e sollën për vizitë në minierë. Aq i bëri përshtypje, sa italiani shkroi një artikull ku thoshte se, atje ishte një mrekulli, bukuri edhe me pishinë për kalamajtë, me lodra fëmijësh që i kishin marrë te plazhi.

Cila ishte arsyeja që ju arrestuan, për herë të dytë ?

Gëzim Çela: Për herë të dytë u arrestova në vitin 1971, me akuzën “për agjitacion-propagandë”. Asnjë provë, asnjë gjë dëshmitarët. Gjatë kohës në minierën e Manzës, isha disi i privilegjuar si piktor. Vjen një Fejzi Alizoti, një djalë i ri, që e kisha ndihmuar kur ishte i internuar me gjithë të ëmën dhe më thotë të bëja kujdes, se e kishin sjellë kastile për mua, se donin të më fusnin në burg.

Pas disa kohësh arrestuan atë, sepse nuk u kishte treguar gjë. Më pas, me detyrim e nxorën si dëshmitar në gjyq ku tha që unë kisha thënë që këta që janë në pushtet, janë të luftës dhe bijtë e tyre ishalla kanë ndonjë mëshirë për ne. Atëherë edhe unë u thashë: - Shumë mirë, nuk e kam me ju. E kam me prindërit tuaj hesapin. Gjithashtu kundërshtova dëshmitarin, se ai ishte bërë spiun i Degës. Kështu me dëshmitarin e parë. Edhe dëshmitarët e tjerë, jo ka thënë kështu, jo ka thënë ashtu...

A kishit avokat, në hetuesinë e dytë?

Gëzim Çela: Gjatë kohës së hetuesisë së dytë nuk kisha më avokat. Por si dëshmitar sollën edhe një nga Korça, me të cilin kisha punuar duke lyer shtyllat e tensionit të lartë, kur dola nga burgu. Por ai më mbronte dhe përfundimisht tha që Gëzimi kishte një radio dore edhe dëgjonte lajmet italisht. Dëshmia e tij nuk i shërbente akuzës.

Trupi gjykues vendosi që të shtyhej gjykimi, se me ato fakte, njëherë për njëherë, nuk mund të jepte dënim. Më kthyen sërish në birucë. Aty kishin futur një ushtar duke menduar që mua do të më jepej dënimi atë ditë, mirëpo gjykata vendosi të shtyhej gjykimi. Ky ushtari që kishin sjellë në birucë, më thotë: “Ama ky gjyqi yt u bë si gjyqi i Hagës. Të kishe pranuar, do të të kishin dënuar me minimumin. S’ke pranuar, do të të dënojnë me maksimumin”.

“Aeroportin e Rinasit e kemi ndërtuar ne. Madje, mendoj që aty në Rinas duhet të jetë një pllakë përkujtimore që t’u kujtojë të gjithëve që kalojnë në pistë dhe hipin në aeroplan, se aty ku po shkelin është derdhur gjaku edhe djersa e të burgosurve politikë”

Në herën tjetër të gjykimit vjen një dëshmitar që e kishin mësuar të thoshte që ne donim të arratiseshim. Nga dhjetë vjet që kërkonte prokurori, m'i çuan tetë vjet, m'i falën dy vjet. Kështu më dënuan tetë vjet.

A ishte nëna jua, e pranishme në gjyq?

Gëzim Çela: Po, ishte dhe thoshte “Bir, mos bërtit!”, se unë ngrija zërin, kisha marrë një superxhiro dhe ulërija: “Poshtë dëshmitarët e sajuar”, se më kishin sajuar dëshmitarë e histori të paqena, një nga një. Për këtë arsye u prish seanca gjyqësore dhe trupi gjykues vendosi shtyrjen. Përfundimisht, më dënuan tetë vjet.

Ku ju dërguan pastaj?

Gëzim Çela: Në Spaç...

Kur shkuat atje si ishte ballafaqimi i parë me atë mjedis?

Gëzim Çela: Ambienti ishte malor. Ishte me të vërtetë tmerr, sepse burgu është në një grykë midis dy maleve, ku dielli duket një-dy orë dhe e kap mali tjetër. Kaq ishte dita. Puna ishte shumë e vështirë, por unë si i ri, fizikisht i fuqishëm, munda ta përballoja punën si minator.

Në minierë a kishit sigurim teknik dhe a zbatoheshin rregullat e sigurimit teknik?

Gëzim Çela: Unë, si minator, shkoja tok me dy punëtorë që kishin dy vagonë që unë me lopatë duhet t'i ngarkoja me mineral, 3 vagonë ose 4 vagonë. Nëse vagoni rrezohej, duhej ta ringarkoja. Ishte punë e vështirë, ishte vapë shto edhe të gjitha sikletet e minatorit. Megjithatë e përballoja mirë.

Po ushqimi si ishte? A ju dilte?

Gëzim Çela: Ushqimi ishte barishte dhe grosh. Kur kishte groshë, ishte festë e madhe, se më shumë kishin barishte...

Një natë shfaqej një film, se kishte një sallë ku bëheshin mbledhjet, shfaqeshin edhe filma. Filmi ishte komik dhe salla po qeshte. Dëgjuan ata të komandës që po qeshnin të burgosurit dhe vijnë shpejt e urdhërojnë të mbyllet televizori, se të

burgosurit nuk kanë të drejtë të qeshin?! Edhe e mbyllën televizorin. Domethënë edhe të qeshnin na ishte e ndaluar.

Si mendoni, cila ishte arsyeja që filloi revolta?

Gëzim Çela: Ne punonim në galeri gjatë gjithë javës, ditën e diel e kishim pushim, por si duket ndërmarra nga ku vareshim, nuk kishte realizuar planin, prandaj vendosën që të na nxirrnin në punë edhe ditën e diel. Ne vendosëm që ditën e diel të mos dilnim në punë. Kjo qe arsyeja e parë e revoltës.

A u mblodhët të gjithë bashkë dhe e diskutuat paraprakisht me njëri-tjetrin që nuk do të dilnit në punë? Si u organizuat?

Gëzim Çela: Shokët me njëri-tjetrin, duke bërë muhabet, kështu e vendosëm. Nuk do të dilnim në punë. Kishim disa ditë që e diskutonim, sepse shkonim edhe të dielën në punë. Ishte e tepërt. Kështu që vendosëm.

Atë ditë ishin rreshtuar një pjesë e të burgosurve. Pal Zefi e kishte plotësuar muajin e birucës dhe hap derën e birucës dhe doli. U turrën policët ta kapin. Ne të burgosurit, instinktivisht, u hymë në mes, filluam edhe me ndonjë grusht. Oficer roje ishte Fevzi Liço. Atij i ra kapela në tokë, madje iu shkel edhe ylli i kapelës. Në atë kohë po kthehej edhe turni i dytë. Disa të burgosur arritën të dalin nga biruca. Ushtari që ishte lart zuri të qëllonte me automatik. Ata të turnit të dytë, kur dëgjuan automatikun, menduan se diçka po ndodhte. Ikën pa u numëruar, pa u rreshtuar, hynë brenda në kamp. Atëherë edhe ne të burgosurit vendosëm që të mos lëmë në biruca ata që kishin mbetur atje, vrapuam t'i lirojmë dhe t'i hiqnin nga duart e policëve. Plasi rrëmuja. Atëherë e kuptoi edhe policia edhe komanda që nuk ishte më punë për ata. Situatën e kishin marrë në duar të burgosurit. Ikën e nuk erdhën më. Sollën policët e Rrëshenit. Ishin më të fuqishëm. Ushtria rrethoi të gjithë Spaçin. E gjithë kodra, majtas-djathtas, ishte me ushtarë me automatikë. Mbërriti edhe Feçor Shehu.

Midis parullave ishte edhe një parullë kundër punës në galeri. Këta mendonin se mos kishte

“Skënder Daja kishte hipur në tarracë, me kitarën që e kisha kujtim nga Vaçe Zela dhe më thoshte: “Gëzim, s’duhet të dorëzohemi, se do të na pushkatojnë të gjithëve...”

ndonjë arsye tjetër. Faktikisht, dolën probleme politike. Atë ditë u ngrit edhe flamuri, shyqyr, si monument kulture në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Bedri Çoku me gjithë një tjetër morën një shokun tim dhe ai me bojë këpucësh në një beze të kuqe, pikturoi shqiponjën dhe e ngritën flamurin pa yll. Vunë edhe roje atje. Ato tri ditë, kampi ka qenë i rrethuar. As bukë s’kishim, natyrisht na prenë edhe ujin dhe ne mbetëm pa asnjë gjë...

Tri ditë ishit pa bukë e pa ujë?

Gëzim Çela: Po, pa bukë, pa ujë komplet. Ishte e natyrshme se kampi ishte i rrethuar gjithandej. Prandaj u vendos që do të dorëzoheshim. Më kujtohet Skënder Daja, gjatë kohës së revoltës bërtiste: “Oh, nane, na keni lidhur me zinxhira”. Iu kthye ushtarëve: “O ushtarë, edhe unë si ju kam qenë. Edhe ju do të vini këtu, prandaj bëhuni me ne! Poshtë komunizmi! Na keni veshur nënat me të zeza!” Këto ishin parullat: “Poshtë komunizmi!”, “E duam Shqipërinë si gjithë Europa!” Këto

ulërinin dhe bërtisnin të burgosurit. Skënder Daja kishte hipur në tarracë, kishte marrë kitarën që unë e kisha kujtim nga Vaçe Zela dhe më thoshte: “Gëzim, s’duhet të dorëzohemi, se po të dorëzohemi, do të na pushkatojnë të gjithëve...”

Në ditën e tretë, me ndërhyrjen e policëve, na kapën. Kërciste huri me të burgosurit. Na lidhën e na vunë në rresht. Po lexonin emrat e të gjithë atyre që ishin rreshtuar dhe të atyre që do të riarrestoheshin. Kur dëgjova emrin tim, m’u kujtua ai gjesti i romakëve në ndeshjet me gladiatorë, që kur e kthenin gishtin e madh poshtë duhej vlarë. Më vunë hekurat, zinxhirët, na ngarkuan në kamionë edhe na dërguan në Tiranë, më futën në një birucë dhe filloi hetuesia tjetër.

Midis të burgosurve dikush bërtiste dhe kërkoi ministrin. Në atë kohë ministër ishte Kadri Hazbiu. Mirëpo siç duket ndonjëri ka kërkuar kryeministrin, se dëgjova hetuesit duke folur me njëri-tjetrin: “Budallenj këta duan kryeministrin. Të ishte ai atje,

**“E duam
Shqipërinë
si gjithë
Europa!”**

Një nga parullat e hedhura gjatë revoltës.

i kishte vrarë të gjithë”. Domethënë edhe ata vetë e kishin frikë kryeministrin.

Atë ditë që kishte filluar revolta, më datë 21 maj, nëna ime që ishte e moshuar, kishte ardhur të më takonte, por nuk e lanë. Unë kisha edhe katër vjet dënim dhe mendoja si t’i shtyja edhe këto katër vite dhe ishalla e gjeja gjallë.

Kur ndodhi revolta e Spaçit dhe u pushkatuan disa vetë, ajo e kishte marrë vesh edhe u nis e shkoi drejt e në Spaç, por Spaçi ishte rrethuar. E pyetën se ç’kërkonte atje dhe ajo pyeti për mua. I thanë që s’isha atje, por në Tiranë. Shkoi në Tiranë, pyeti, i thanë: “Jo, nuk është këtu. - Po ku është? - Në Rrëshen.” Nga Tirana shkoi në Rrëshen. Edhe aty i thanë: “Jo, nuk është këtu.” Ah, e shkreta zuri të ulërinte nëpër rrugët e Rrëshenit: “E paskan pushkatuar djalin!” Unë isha i lidhur në një birucë në Rrëshen edhe sikur e dëgjoj.

Dëgjova një zë që ulërinte, një zë gruaje rrugës edhe mu duk si zëri i nënës sime. I them një shokut tim atje, në birucë kështu, kështu kam dëgjuar një zë. “Jo, mo, jo. Nuk kam dëgjuar gjë - tha ai”. Instinktivisht dëgjova që dikush pyeste përgjegjësin e birucave dhe ai erdhi na pyeti: - Kush është Gëzim Çela, këtu? - Unë, - thashë menjëherë. - A, mirë, - tha ai.

Pas pak më solli një pako, ishte nga nëna. Kur ia pranuan pakon, atëherë ajo mendoi: “Qenka gjallë, paska shpëtuar!”

Pas revoltës së Spaçit, si ju gjykuan dhe ju dënuan, për së dyti?

Gëzim Çela: Operativët kishin gjetur disa dëshmitarë, ca spiunë që i përdornin për këto punë dhe kështu më dënuan katërbëdhjetë vjet, por u bë amnisti dhe m’u bënë dymbëdhjetë vjet. Në vitin 1984 dola.

Pasi ju ridënuan dhe u kthyet sërish në Spaç, si ishte jeta pas revoltës? A ishit më të mbikëqyrur? A u vështirësua më shumë jeta në kamp?

Gëzim Çela: Kur u kthyem në Spaç, ishte dyfishuar kontrolli i sigurisë dhe ndëshkimet. Edhe për gjënë më të vogël, të futnin në birucë. I kam provuar disa herë birucat. Jeta në kamp u vështirësua shumë.

A kishte mes jush njerëz që ju spiunonin?

Gëzim Çela: Po patjetër, por unë si natyrë nuk përzihem me njeri. Ishte e natyrshme që nuk duhet të kishe besim te njeri. Më kujtohet rasti kur sollën njërin, një piktor i mirë dhe njiheshim përmes Sali Shijakut. Një ditë, mes bisedash, më tha: “Gëzim, do të vras veten. Nuk mbrohem dot më.”

Përgjegjësin e zyrës teknike e njihja dhe iu luta atij nëse i gjente ndonjë vend pune këtij piktorit, meqë ishte në gjendje të rëndë e donte të vriste veten. E rregulluan të bënte parullat.

Më pas, për ca kohë, punuam të dy për të rregulluar fjetoret e ushtarëve. Një ditë, më thotë komandanti i kampit, një burrë i mirë, që ky piktori kishte bërë raporte kundër meje. Unë i shpëtova jetën, ai bënte raport kundër meje?! Prandaj në kamp, nuk duhet t’i besoje asnjë njeriu.

Pas revoltës së Spaçit a ju ndryshuan kushtet në dhoma?

Gëzim Çela: Nuk e mbaj mend mirë numrin, nja njëzet a tridhjetë vetë. Flija në katin e tretë dhe kur lëvizja për t’u ngritur, koka më prekte në tavan.

A keni vuajtur dënime të tjera, pas Spaçit?

Gëzim Çela: Jo. Në 1984 jam liruar dhe erdha në minierën e Manzës, se atje isha internuar. Më kishin dhënë një dhomë. Më liruan edhe një dhomë tjetër dhe mora edhe nënën.

Në minierë punoja. Ditën që vdiq diktatori, kam qenë në punë dhe dëgjova njërin aty që tha: “Vdiq Enver Hoxha”. O Zot, o perëndi! E pyesja veten: “Ka vdekur, vërtet?”

Si jeni ndier pasi fituat lirinë?

Gëzim Çela: Eh, më në fund. Isha bashkë me nënën. Isha në minierë, por kisha një si shtëpi domethënë një dhomë e kuzhinë, ku mblidhesha me nënën time. Punoja në minierë, te reparti i jashtëm, pastroja vagonët.

- A kishit mundësi integrimi në shoqëri, apo ndienit që ju shikonin me një sy tjetër, për shkak të të qenit ish-i burgosur?

Gëzim Çela: Unë kisha qenë edhe më parë aty, në minierën e Manzës, kisha njohje të vjetra. Unë po miq i kisha, por edhe ata e kishin njëfarë respekti për mua...

A ju ka kërkuar ndokush falje, për dënimet e padrejta që ju kanë bërë?

Gëzim Çela: E kush të kërkojë falje? Unë kam qenë edhe ndër themeluesit e Partisë Demokratike, në Durrës. Jam marrë me këto punë dhe di, që pak a shumë është folur edhe nëpër gazeta, kjo historia e faljeve, por nuk kërkon njeri falje.

Si ish-i dënuar a keni marrë shtesë pensioni, ndonjë pension të veçantë?

Gëzim Çela: Po, në fakt, kam marrë disa para, se unë kam bërë 21 vjet burg, që ishin pothuaj 120 milionë lekë, kështu që kam marrë një shtëpi të mirë. Babai më vdiq në Amerikë. Ai e kishte marrë vesh që më kishin futur në burg herën e parë dhe ishte mërzhitur shumë.

Me babain tuaj a shkëmbenit letra, i kishte treguar babait për dënimin me burg?

Gëzim Çela: Unë jo, mamaja po. Vetëm herën e parë e mori, se babai vdiq shpejt. Ka vdekur nga viti 1968, rreth moshës 70 vjeç.

Ju treguat që kishit një kitarë në burg, dhuratë nga Vaçe Zela. Atë kitarë e ruani edhe sot?

Gëzim Çela: Po...

Atë kitarë e përdornin të burgosurit?

Gëzim Çela: Po, ata që dinin t'i binin mblidheshim te dhoma e kulturës. Kishim një shok nga Fieri, që ishte me mandolinë dhe donte një kitarë. Kur vjen nëna në takim i kërkova të takonte shokët e mi e të më gjente një kitarë. Unë jam rritur në Lushnjë dhe kisha shumë miqësi me artistët, se kishte artistë shumë të mirë Lushnja. Një herë, dikush takoi Vaçe Zelën dhe kjo e pyeti për mua edhe i thanë që unë po kërkoja një kitarë. Atëherë, Vaça i kishte thënë se do më jepte kitarën e saj dhe ia kishte dhënë. Atë kohë, isha në kampin e Tiranës. Kështu që më erdhi kitara e këngëtares sonë Vaçe Zelës. Pastaj e mora edhe në Spaç, sigurisht fshehtas. Kjo është historia e kitarës që përmenda. Kur Vaça shkoi në Zvicër, më ka ftuar dhe i kam shkuar dy herë atje.

Çfarë politikash rehabilituese mendoni ju që duhet të ishin ndjekur për të gjithë ish-të përndjekurit, me qëllim që ju të integroheshit sa më lehtë me pjesën tjetër të shoqërisë?

Gëzim Çela: Është një pyetje pak e vështirë për të dhënë një përgjigje të arsyetuar. Unë jam më shumë artist sesa politikan...

Ju, sot, jetoni në Durrës?

Gëzim Çela: Po, jetoj në Durrës, vetëm me bashkëshorten. Nuk kam fëmijë.

A keni ndonjë mesazh lidhur me të gjithë këtë histori të dhimbshme, që përjetoi një pjesë e madhe e popullit tonë?

Gëzim Çela: Shohim se është pak e vështirë për ne shqiptarët të ndërtojmë një demokraci të vërtetë. Me gjithë përpjekjet që bëhen përditë, herë majtas, herë djathtas, kemi mbetur akoma te ai sistem i vjetër...

A ruani ndonjë gjë si kujtim nga burgu?

Gëzim Çela: Jo, i kam eliminuar letrat që më dërgonte nëna, kur isha në Spaç.

Çfarë mendoni se mund të bëhet që këto vuajtje dhe vendet ku kanë kryer dënimin të burgosurit politikë, si edhe këto ngjarje të kujtohen nga brezat që do të vijnë? Çfarë mendoni që mund të bëhet për burgun e Spaçit?

Gëzim Çela: E para e punës, unë nuk kuptoj përse Spaçin po e shkatërrojnë, që të mos i mbesin as gjurmë. Kam lexuar nëpër gazetat e huaja që edhe vende të tjera, si p.sh., në Gjermani, i kanë ruajtur si vende kujtese, këto kampe. Është në interesin e shtetit tonë që ta bazonim të shkuarën tonë në fakte, dokumente,

vende kujtese siç është Spaçi. Burgu i Spaçit është monument që do t'i shërbente historisë së njerëzimit, për të provuar gjithë krimet që kanë ndodhur atje. Më vjen shumë keq sesi po priset, po shkatërrohet.

Gjithë ajo shëtitore ku mblidheshin ne, nuk ekziston më. Kam shkuar disa herë në Spaç edhe më vjen shumë keq që nuk është më.

Monumentet e kulturës që i përkasin sistemit të vuajtjes së njerëzve në sistemin komunist, siç janë kampet e përqendrimit, burgjet, duhet të ruhen edhe të shërbejnë për të kujtuar atë që ka ngjarë.

Urim Elezi

“Më goditën në kokë,
sa më lëshuan sytë zjarr.
Mu bë sikur rashë në
galeri dhe do të kapja
trupat.”

Urim Elezi, i biri i Eminesë dhe Resultit, lindur më 18 tetor 1941, në Floq, Korçë. U arrestua më 26 tetor 1963 me akuzën për krimin e “tradhtisë ndaj atdheut”, duke tentuar të arratiset në një shtet të huaj. Gjykimi u zhvillua në shkurt të vitit 1964⁶ dhe iu dha dënimi me 18 vjet heqje lirie. Vuajti dënimin në Spaç, në periudhën 26 qershor 1969 - 10 shkurt 1989. Kur ishte në burg u ridënua “për agjitacion e propagandë”. Karriera e tij nisi si oficer në ushtri dhe përfundoi i verbuar në burgjet e diktaturës, ku vijonin ta dënonin edhe pse humbi shikimin si pasojë e dhunës...

Z. Urim, ju falënderojmë që keni pranuar të jepni intervistë, për të treguar vuajtjet e jetës suaj si ish-i dënuar në burgjet e kohës së komunizmit. A e keni parë dosjen, çfarë keni gjetur në të?

Urim Elezi: Ç’të të them unë. Lemer. Dilte, sikur unë të isha gjeneral... Kam kërkuar të takoj, një Gjergji Stefën. I thashë të vëllait të tij, po kishte frikë. “Nuk vij, - kishte thënë, - se më godet”. Kështu i tha të vëllait. Kaq. “Thuaj, more, se dua ta takoj, se dola nga burgju. - Jo, se më rreh”. Pa pikë logjike. Ai ka arrestuar shumë njerëz. Mua nuk donte njeri të më arrestonte, as nga të komandës. Kur dolëm në gjyq, se ma bënë gjyqin atje në repart, ata kishin dhënë opinion që si të krahasohet ky njeri me nja tre - katër policë. Edhe në hetuesi, ma kanë thënë që komanda ka dhënë opinion... Ky, Gjergji më tha: “Ti do të dënohesh 10 vjet, njëherë për njëherë, por kur të lirohesh, unë do të jem kryetar dege në Korçë dhe do të dënohesh prapë”. Jo vetëm këtë, por ka dashur të dënojë edhe dy vëllezërit e mi, Bilbilin dhe Festimin. Po shyqyr, nuk i futën dot.

6. Fondi nr.1, hetimor-gjyqësor, dosje nr. 9611. Vendim nga Gjykata Ushtarake Tiranë nr. 15 Akti, nr. 21 i vendimit, datë 27.02.1964. Arkivi i AIDSSH-së.

“S’ka natë të mos i shoh në
ëndërr! “Njézeta, njézeta! Hë
more, lëviz!” Lëviza kokën.
- Këq desha, - tha njëri nga
policët”. Ai më ka torturuar
më shumë nga të tërë.”

Kur ju arrestuan?

Urim Elezi: Jam arrestuar në 26 dhjetor 1963. Ditë e shtunë. Ora 10:00. Isha vetëm njëzet vjeç.

Keni qenë i vetëm, apo me të tjerë?

Urim Elezi: Tok me të tjerë, katër shokë: unë, Hekuran Shyti, Durim Shyti, Robert Morava. Me Durimin dhe Hekuranin jemi rritur bashkë. Unë isha nënoficer në Gjirokastrë. Hekurani ka qenë radist. Kam qenë edhe sekretar rinie. Nuk desha, por më thonin: “Pse s’do ti sekretar rinie?” Jo se kisha ndonjë bindje politike, po me ato mbledhjet, na neveritën... Ne kishim folur me njëri-tjetrin, por dikush na kishte përgjuar dhe na kishte denoncuar. Hekurani më njoftoi se Sigurimi ishte duke na ndjekur të katërve. Ç’të bënim? Do të na arrestonin të katërve, se ata të ndiqnin në çdo qoshe. Kështu që vendosëm të ikim, të paorganizuar fare. Lamë takim në fshat, te halla e Hekuranit. Ecëm në këmbë dhe ishte ditë me dëborë, 26 dhjetor.

Ju zunë trupat kufitare, apo ata po ju ndiqnin, ndërkohë?

Urim Elezi: Na ndiqnin... dyshoj se ka qenë ndonjë që na kishte spiunuar. Në kufi, në Nikolicë, na kapi një nga Kamenica. Besoj që i kanë thënë të na ndiqte, se ç’ne të ishte ai andej që me natë...E kupton? “Për tentativë arratisjeje” dënoheshe me vdekje, për dezertim nga ushtria, dënoheshe me vdekje, si kryetar grupi, dënoheshe me vdekje... Për fat të mirë, na ndihmoi shumë Mitat Kosova, me gradë kolonel, kryetar i gjykatës ushtarake, ai na shpëtoi jetën.

Ku ju çuan?

Urim Elezi: Fillimisht, në batalionin e mbrojtjes dhe që andej në Degën e Brendshme. Dhe ku e di unë sesi shpëtova gjallë, megjithëse me kocka të thyera, po mbase ngaqë isha me fizik të mirë. Që andej na çuan nëpër biruca. Aty ishin oficer Xhahil Dynjaja, major Agustini dhe Petro Tasallari, kapiten i parë. Ata të dy njoha, asnjë tjetër. Më morën zvarrë. Herë përmendesha, herë e humbisja... Më treguan shokët më pas, kur ishim në burg, që më kishin mbajtur një orë e ca atje e gjithë ç’më kishin bërë, edhe kur më futën zvarrë në birucë... Atje nuk e di sa ishte ora, kur dëgjoj derën dhe thirrjen “njézeta, njézeta”. Përmendem.

“Njëzeta, njëzeta!” këtë e kam të fiksuar edhe sot e kësaj dite. Edhe në mes të natës, edhe në varr këtë do të them. S’ka natë të mos i shoh në ëndërr! “Njëzeta, njëzeta! Lëviz! Hë more, lëviz!” Lëvizta një çikë kokën. - Kaq desha, - tha njëri nga policët”. Ai më ka torturuar më shumë nga të tërë.

A ju kanë torturuar në hetuesi?

Urim Elezi: Lufta psikologjike qe e tmerrshme. Ne ishim familje veteranësh lufte. Na e hoqën pllakën nga shtëpia, se gjoja ne e kishim ndihmuar luftën vetëm moralisht, por jo direkt... Babai im ishte bektashi, rritur dhe studiuar në Stamboll. La vilën atje e të tëra, për atdheun. Ka marrë pjesë në luftë. Por në vitin 1943, kur ndodhën problemet pas Marrëveshjes së Mukjes, babai i tha Safet Butkës, që do të tërhiqej dhe u tërhoq. Kur isha në hetuesi, ditën e parë a natën e parë, siç ma kanë treguar shokët, Roberti me Durimin, se ata ishin në këmbë, kurse unë shtrirë, vjen një, më kap prej mjekrës e ma tund: “Ç’ë ke Myzafer Elezin? - Vëlla e kam, - i them unë. - Hë, ç’ia zbardhe faqen, - tha. - As ia zbardha, as ia nxiva - i thashë.” Ai më hipi përsipër, por erdhi një nënkolonel a kolonel, dy metra burrë, e kapi për leckash, e hoqi edhe dha urdhër: “Merreni, çojeni në Degë!”. Në Degë m’i thyen të tëra dhëmbët. Këtë lart vetëm dy mbetën, poshtë asnjë... Filloi pastaj, druri. Një më kapte andej, një këtej. Gishtat e këmbës të thyer, brinjët thyer, kolonën mezi e mbaj dhe nuk eci dot në rrugë, as sot. Më vinte të thosha “Më vrisni!”, se tortura nuk durohej, Hekurani ulërinte në dhomën tjetër. Ai shtrirë dhe i binin me një thupër. Kur u thashë në hetuesi “Na vrisni! - Jo, - më thanë, - do të nxjerrim njëherë qumështin e nënës. Eee ... do të të bëjmë këtë, do të të bëjmë atë...”.

Më futën kokën në ujë. M’u dukën si dy vaska, por shokët më thanë që ishte vetëm një. Shkelma, grushte, hekura, varur për dere me duart të lidhura mbrapa... Të binte të fikët. Shoh në faqe, një këmbë... Nuk harrohet. “Fluturon gomari? - Pooo. - Ata kërcenin. - Do ta vëmë firmën? - Po, - u thashë. - Ne të bëjmë edhe ta...” Oh! Çfarë të bëja unë? Të mos i kafshoja? T’i godisja s’mundesha, se isha i lidhur.

Gjatë hetuesisë, a ju kanë sjellë në birucë, njerëz për provokime?

Urim Elezi: Mua dhe Hekuranit jo, Durimit dhe Robertit po.

Ku u zhvillua gjyqi dhe sa zgjati? A ju erdhi familja në gjyq?

Urim Elezi: Gjyqi u bë në Korçë në Gjykatën Ushtarake. Zgjati dy ditë, që nga mëngjesi deri në darkë dhe niste që në orën shtatë. Asnjë nga familja ime nuk ishte në gjyq. Dërguan një të afërm edhe një kushëri, Ilmi Elezin. Prindërit nuk erdhën se unë nuk isha mirë. M bathjet dhe të dyja këmishët ishin gjak... Ato i mbajti nëna, derisa jam liruar nga burgju.

Sa vjet u dënuat?

Urim Elezi: Prokurori kërkoi dënim kapital, por për mua ndërhyjnë shumë vëllezërit dhe shumë të tjerë, pati shumë ndërhyrje dhe e ndryshuan... Pastaj na çuan në burg në Korçë, një muaj e gjysmë gati dy muaj dhe që andej na çuan në Laç, për ndërtimin e Uzinës së Superfosfatit. Aty ndenja nja një vit e gjysmë. Më kujtohet kur vinte një oficer Rexhepi, na nxirrte jashtë të na godiste, se biruca qe shumë e ngushtë dhe nuk godiste dot: i prekte krahu në mur. Deri në fund të vitit 1965 kam ndenjur në Laç. Atje ishim unë, Lek Beja është gjallë, Barjam Dervishaj gjallë, Kujtimi s’është, Ibrahim s’është, Agroni s’është...

Njëherë, më morën mua të parin dhe më thanë: “Do të vish në komandë”. Ishte natë. Nga frika u thashë: “Nuk vij, më vrisni këtu. - Atë e dimë ne, - më thanë”. Pastaj ushtarë, policë...po ushtarë xhahila... Ç’punë kishin ushtarët me mua? Sesi shpëtuam nuk e di. Të tërëve na u futën me dru, atje ku ishte qymyri briket me të cilin gatuanin. Agron Kalanë e varën në tela. Mua erdhi një që m’i kapi duart, m’i tundi sa më ra të fikët... Çfarë të të them? Unë jam gjallë.

Mbas Laçit ku ju çuan?

Urim Elezi: Nga Laçi në Elbasan, nga Elbasani në Fushë-Krujë, nga Fushë-Kruja në Elbasan. Në Elbasan na vjen Nevzat Hasnedari. Na marrin 8 veta. Një nga një i merrte në zyrë ai... Që andej drejt e në Burrel të tetë. Tërë burgun atje e kam bërë, jo në kamp. Nga Burreli në Vlorë, nga Vlorë në Spaç, pastaj në Reps. Më 26 tetor të vitit 1969 më çuan në Spaç. Në 7 janar 1970 më çuan në Reps, më futën në birucë. Më kanë torturuar shumë: “S’ke për të dalë më që këtej!

Hë, do të shkoje te dajoja, në Amerikë?" Unë, që të ndalonin, pohoja: "Po". Mirëpo më kishin ngatërruar mua me një tjetër, dajoja i të cilit kishte hyrë si diversant. Atë tjetrin, vetë i tretë, e kishin futur brenda. Ishin diva, trima dhe burra të fortë. Edhe ngaqë më kishin ngatërruar, më kërkonin mua t'i ndihmoja që ta fusnin këtë dajon në kurth. "Po, si? - pyes unë. Ai është në Amerikë. - Do të të shpiem ne në Amerikë". E kështu, po mendoja ta firmos. U bëra si me krahë në veten time, në ndërgjegjen time. U fryva kështu e po thosha: "Hë, më çoni, më çoni, pa pastaj e di vetë unë..." I tregova vetëm Hekuran Shytit, që atyre u kisha thënë se do të firmosja që isha dakord, ta sillja unë nga Amerika e ta fusja në kurth... Mirëpo një shok, Rizai, më ndaloi: "Heeej, se mos bën ndonjë gomarllëk, se menjëherë, edhe Avdyli edhe Myzaferi, hanë plumbin, kurse jot ëmë internohet..."

Njëherë, se çfarë kishte ngjarë, dëgjuam zhurmë dyersh. Unë isha nga ana e veriut e thoja me vete: "Ç' është kështu? Mbani vesh!" Dëgjoja andej nga 8-ta, bam - bum... policë nga të Degës, vinin, hapnin sportelin se unë isha te dhoma 9, pyesnin: "9-ta kjo? - Po, 9-ta". Vazhdonin, hapnin e mbyllnin dyert: "Eeee, hajde, shpejt!" Na morën e na futën në birucë nja 10 a 15 vetë e na izoluan. S'dinim asgjë. Bënin si të tërbuar, aman, o Zot... Më thotë Pjetri: "Dëgjo, mos bëj gafë... Më duket, ka ndodhur diçka. Grusht shteti..." Edhe Simon Jubani, një priift - i shkreti priift, shkruante letra, i niste, po letra s'i vinte asnjëherë - edhe thotë: "Grusht shteti". Mirëpo e dëgjojnë policët e ia fusin me të rrahur. Bërtiti në kupë të qiellit, i shkreti. Sa herë është rrahur për vdekje ai! Një tjetër episod...

Kishin ardhur nga ministria dhe na vijnë nëpër biruca e na kontrollojnë. Unë s'dija gjë, por më vjen porosi nga një i njohur: "Mbyllni gojën, se s'kam çfarë të bëj!" Ishte natë. Na morën të tërëve në pyetje, në zyrën e policit: "Kë keni shokë atje?"... S'dinim si të përgjigjeshim. - Të tërë shokë i kam, - i them. - A janë në burg, me mua? Më kap Flamur Sinoimeri për krahësh, u thotë atyre: "E çoj unë." Më zgjidhi e më futi në birucë edhe më kthehet: "Shpëtuat mirë... shpëtuat mirë, se prisnim të na jepnin urdhër e të vinin me mitraloza. Na sollën listën dhe ju ishit të parët". Nuk e di sa na mbajtën në birucë, nja një muaj e gjysmë. Na nxirrin nga biruca nga një a nga dy dhe na jepnin ushqimet: "Ai që kishte, ai që s'kishte..." "Shpëtuat mirë, qenër, bij qenash,

se do ju hynim në mitraloz," bërtiste një polic. Këtë ia thoshte Simonit, Uran Kostrecit, Pjetër Arbnorit, Enver Shaqirit, Dullë Sallakut...Pastaj ai, Raqi Fica, eh, çfarë xhahili...

Po, saktë e keni, nuk po ngatërroheni. Ai ka qenë kryetar i Degës së Punëve të Brendshme në Dibër si edhe kryetar i seksionit për nr. 3 në Tiranë.

Urim Elezi: Puuuu... çfarë kriminel, sa i pashpirt! Vinte dhe thërriste: "Filani..., Haxhi Bena, Sami Dangëllia, Luan Burimi, Luan Koka, Hodo Pashai..." Allah, - thoja, - ç'bëhet kështu? O Zot, të jetë bërë grusht shteti siç më tha Simoni dhe Pjetri?

Si ndodhi, që ju humbët shikimin?

Urim Elezi: Ahhhh... isha në Burrel...më 8 dhjetor 1981. Është e shkruar në libër. Jo se nuk mund t'ua them, jo se s'e di, poo... jam i lodhur. Marrin Rrok Bitukun, të parin nga dhoma e tij, të dytin marrin Mersin Vlashin, e keni në libër dhe të tretin, më marrin mua. Për një letër që shkroi Rrok Bituku...Mersin Vlashi, shkroi një poezi... Më morën tre policë, Agim Kërtuku, Ramazan Lika dhe Mustafa Lika. I pashë me shkopinj. Terrorizohet njeriu. S'ka punë guximi aty. U hutova, se i pashë këta çfarë bënë, kur morën zvarrë shokët e mi. "Po mua, ç'do të më bëjnë?" mendova. Më futën në një dhomë. Aty pashë tetë policë. "Obobooo," thashë me vete. "Zhvishu, zhvishu të të kontrolloj," më thanë dhe nisën goditjet. Të parët që më ranë me shkopinj në kokë ishin Ramazan Lika dhe Agim Kërtuka. Të tjerët qëllonin me grushta dhe shkëlma, por jo si këta. Nuk di se kush po më mbante. Më goditën mu në kokë, sa më lëshuan sytë zjarr. Nuk di më pastaj...rashë...Njëri u bërtiste: "Boll, se e vdiqët fare"...

Atje më ikën sytë. Nuk e di, po këtë e kam fiksuar, mu bë sikur rashë në galeri, në Spaç dhe do të kapja trupat... Nuk e di. Sikur po bija poshtë. Trupa s'kishte, dheu ishte i zi, i lagur ujë. Atje kam bërtitur: "Ndihmëëë..."

Në birucë kisha Mersinin, kisha Rrokun e nja trekatër vetë, po që atëherë s'mbaja mend më, se sytë nuk më shikonin. Sytë më kishin ikur. Më pas, më paskësh ardhur vëllai, Bilbili, për takim. Urdhëroi polici Agimin të më nxirrte në takim. Më mori ky në krahë dhe më nxori në takim. Polici

“vët” ia futi me kamzhik. Takimi ishte në një sportel ja, kaq, sipas të thënave të shokëve, se unë nuk e di, nuk e mbaj mend. Më pa ashtu vëllai... Nja dy vjet a më shumë, sytë i kisha fare të ikur, të çakërritura, s’kisha ndjeshmëri. Pasi ndërroi sistemi, më bënë një trajtim me mjekime nga Kanadaja dhe ato m’i drejtuan disi sytë.

Edhe pse nuk shikonit, ju mbajtën në burg tetë vjet?

Urim Elezi: Jo vetëm tetë vjet, po mua më mbajtën dy vjet e tetë muaj në birucë, më kanë mbajtur, por më kanë rrahur, Tortura! Më kanë

vdekur jo një herë e dy, pyesni kë të doni. Çfarë të bëja unë? Na lexonin shkarravinat e atij e më linin mbyllur me urdhër të komandantit e të komisarit... Temperatura ishte minus dymbëdhjetë gradë. Bënin xhiro shokët nëpër biruca. Policët u bërtisnin: “Çojeni Urimin të lëvizë!” Po unë nuk lëvizja dot. Edhe sot, kur marr kthesën, më merren mendtë. Edhe sot që jam kurrar. Po u godita fare pak, e humbas dhe më tronditet koka. Atje flisja përçart, si në kllapi...

Dhe në cilin vit, dolët nga burgu?

Urim Elezi: Në 10 shkurt të vitit 1989.

1

2

3

4

5

6

Nevrus Golka

“Më dënuan dy herë.
Edhe herën e dytë për
tradhti ndaj Atdheut.”

Nevrus Golka, i biri i Hairijes dhe Isait, lindur më 25 mars 1945, në Mborje të Korçës, u arrestua mbrëmjen e 10 nëntorit 1963 në fshatin Dardhë, me akuzën se kishte tentuar të arratisëj, duke kryer krimin e tradhtisë ndaj atdheut⁷. Vuajti dënimin me 8 vjet burgim. Në shkurt të vitit 1973 tentoi përsëri arratisjen nga Pogradeci. U kap në kufi dhe u dënua me 10 vjet burg. Kreu dënimet në burgun e Spaçit, në vitet 1968 - 1982.

Faleminderit që keni pranuar të jepni një intervistë, për të na treguar realitetin e hidhur të burgut të Spaçit, si dhe të vuajtjeve e të dënimeve të padrejta që kanë rënduar mbi jetën tuaj. Fillimisht, a e keni parë dosjen tuaj?

Nevruz Golka: Po e kam parë dosjen. Gjeta shumë probleme të panjohura për mua. Aty gjeta me pseudonim edhe disa miq të ngushtë, përfshi edhe vëllain tim.

Si e keni përjetuar? Po vëllait tuaj a i thatë gjë?

Nevrus Golka: Më erdhi shumë rëndë. Nuk ia thashë dot atij, ia thashë të birit. Vëllai im është në

Greqi. Vinte nga Greqia e rrinte këtu, hante, pinte flinte... Sa e mori vesh, nuk erdhi më.

Vëllai juaj i kishte dhënë informacionet që u përdorën kundër jush, për t'ju arrestuar?

Nevrus Golka: Jo, por pas vitit 1983, kur dola nga burgu, familja nuk më pranoi në shtëpi. As babai, as vëllai, asnjëri, as njerka.

Sa zbrita në Degë të Brendshme u dërgova haber, por kundërshtuan: “Jo, jo, të mos vijë këtu! Të vejë ku të dojë, por këtu të mos vijë!” Pastaj Dega e Brendshme më nxori një fletë pune, për në minierë dhe, meqë kishte hotel beqarësh, filja aty.

Po përse se nuk ju pranuan në shtëpi?

Nevrus Golka: Nga frika, se do të provonin edhe ata internimin.

Çfarë punësh keni kryer, përpara se të burgoseshit?

Nevrus Golka: Isha tetëmbëdhjetë vjeç dhe s'kisha filluar ende punë.

7. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 9555. Vendim i Gjykatës Rrethi Gjyqësor Korçë nr. 3 Regjistri themelor, nr. i vendimit 3, data 29.01.1964. Arkivi i AIDSSH-së.

Si ju erdhi kjo ideja, për arratisje?

Nevrus Golka: Po ja, ishim një grup shokësh të një lagjeje. Thamë: “Do ikim?” E vendosëm.

Ishim shtatë vetë, vetëm tre prej nesh u dënuam, se katër të tjerët kishin lajmëruar Degën e Brendshme.

Ishin bashkëpunëtorë?

Nevrus Golka: S’dinim gjë. Ne shokë fëmijërie ishim, të një lagjeje. Madje, gjatë hetuesisë ishim të bindur se edhe ata ishin të arrestuar si ne. Vetëm kur na dolën në gjyq...

Mund të na tregoni si ju kanë arrestuar?

Nevrus Golka: U nisëm nga fshati ynë në drejtim të Dardhës, se është në kufi me Greqinë. Ishte e diel, mëngjes. Kur u nisëm, ishim shtatë vetë. Sigurimi ishte lajmëruar, ndaj na lanë deri aty ku deshën ata, deri në brezin e butë në kufi. Aty na arrestuan. Fotografuan edhe gjurmët tona, që të ishin si provë. Ne ishim të bindur, se na kishin arrestuar të gjithëve. Na nxorën në gjyq me kokë të qethur dhe ndërkohë, ata të katërt i kishin marrë nga shkolla, në pushimin e madh dhe i sollën si dëshmitarë. Kjo ishte goditja më e rëndë.

Që nga kufiri, si u kthyet?

Na morën nga Dardha, me ato makinat e mbuluara me mushama, hungareze më duket ishin e na sollën drejt e në Degën e Brendshme, ku na futën tek e tek, nëpër bucuca.

Ju sollën njeri tjetër në birucë, gjatë kohës së hetuesisë?

Nevrus Golka: Po, sollën një, i cili kishte punuar në minierë, atje ku karikoheshin llambat, domethënë ishte si baterist. Ma merr mendja se ka qenë bashkëpunëtor.

Si ju trajtuan gjatë hetuesisë?

Nevrus Golka: Na cilësuan si të pabindur dhe mua, në veçanti, më futën në birucën poshtë shkallëve. Ishte një pozicion i atillë që i gjithë uji i oborrit, nëpërmjet dritares së vogël hynte poshtë

në birucë. Kishte shumë lagështirë dhe aty kam kaluar nëntë muaj të jetës.

Nëntë muaj hetuesi? Po çfarë kërkonin nga ju?

Nevrus Golka: Fillimisht, na akuzuan sikur ne ishim takuar me një diversant të asaj kohe, që i thoshin “Kulino”. Në fakt, ne u ndeshëm me të, kur ai kaloj në fshat. Kishim ndezur një zjarr dhe po piqnim misra. Ai u afrua dhe pyeti: “Keni shkrepëse?” Ne i thamë: “Nuk kemi shkrepëse, po ja ku është zjarri, ndize.” Ai ishte i veshur ushtarak, si kapiten i parë. Mbante një automatik në qafë dhe kishte veshur çizme. Ne nuk e kishim idenë, vetëm kaq komunikuam me atë.

Ndezi cigaren dhe u largua. U habitëm me të, se ai nuk shkoj drejt në mal, por eci mbrapsht, duke kontrolluar rreth e qark. Ne e pranuan që e kishim takuar, por ne nuk biseduam asgjë me të. Na kërkoi thjesht, shkrepëse për të ndezur cigaren dhe asgjë tjetër. Ata na pyesnin: “Çfarë udhëzimi ju dha? Kë doni të vrisni ju? Si ju tha? - Po s’kemi thënë asgjë, - thamë ne, - as nuk e kemi idenë”. Ishte veshur si oficer, e respektuam prej rrobës. Ku dinim ne, se ai ishte diversant? Por, aty ngulmonin më shumë ata.

Jua përmendën në gjyq këto?

Nevrus Golka: Në hetuesi po, por në gjyq jo.

Gjatë kohës së hetuesisë, a u përpoqën t’ju bënë bashkëpunëtor ose ju bënë ndonjë ofertë?

Nevrus Golka: Ndoshta nuk e kemi kuptuar ne, por edhe mundet, por hapur, jo. Kështu, haptazi, nuk ndodh.

E mbani mend, se kur ju nxorën në gjyq dhe sa ditë zgjati gjyqi?

Nevrus Golka: Po, më 24 janar 1964 e kemi bërë gjyqin. Zgjati vetëm një ditë. Na e bënë gjyqin shembullor, në shkollën e fshatit. Ishim tre vetë që u dënuam, se katër shokë na dolën dëshmitarë, duke na fajësuar sikur ne ishim munduar t’u mbushnim atyre mendjen, për të ikur. Domethënë që të na rëndonin edhe një çikë më shumë.

“Aq shumë ishin të lyer me gjak në fytyrë sa nuk i dalloje dot se kush ishte njeri, apo kush ishte tjetri.”

Po familja erdhi në gjyq?

Nevrus Golka: Babai, eh... Kërkoj dënim me varje!

A e ke falur babain ?

Nevrus Golka: Po! Ditën që vdiq, i vajta në varrim. Ata që ishin atje, në ceremoninë e varrimit, kur më panë që vajta, të gjithë thoshin: “S’ka mundësi që të vijë djali madh! Thjesht, vajta në varreza, hodha dy grushte dhé, asgjë më tepër”.

Kur ju dhanë dënimin, në cilin burg ju çuan?

Nevrus Golka: Fillimisht në burgun e Korçës, ku ndenjëm pesëmbëdhjetë ditë, pastaj erdhi autoburgu, na mori dhe na çuan në Tiranë, në burgun 313. Rrugë e gjatë. Isha në gjendje shumë, shumë të rëndë, sikur kisha pësuar në trup tortura shumë të rënda, aq sa nuk isha në gjendje të zbrisja nga makina. Na hoqën zvarrë. Ishte tepër e rëndë.

Ishte edhe vapë shumë e madhe. Llamarina e autoburgut ishte shumë e nxehur. Ne ishim thjesht kufoma që nuk rrinim dot në këmbë. Dhjetë ditë

ndenjëm në “kaush”, pastaj na dërguan në Laç e, që andej, një vit në Elbasan, ku ndërtuam fabrikën e çimentos.

Më datën 7 maj 1968 kemi hipur në makina, bashkë me dyshekët dhe plaçkat që kishim. Mbi plaçka ishim ne, të burgosurit. Prit të arrinim në Spaç e s’ arrinim dot!

Kishim dhe një shok nga Vlora dhe thoshte ai: “Ore, si na thonë që Shqipëria është e vogël? Ne kemi gjithë ditën e s’po arrijmë dot në Spaç. Qenka shumë e madhe Shqipëria!” Donte thjesht të tregonte vuajtjen e asaj rruge. Udhëtuam rreth dymbëdhjetë orë.

Si e përjetuat mbërritjen në Spaç?

Nevrus Golka: Thjesht, ishte diçka e re. Ishte si grykë, ku fare pak qiell shikoje. Na shkarkuan atje, te ca kapononë prej pupuliti - një lloj tallashi i presuar, i bërë me kuadrate të mbërthyer në disa drunj. Hymë atje që natën e parë, por ishte e pamundur të flije, se kishte shumë tartabiqe, madje edhe akrepa, ishin të futur në pllakat që ishin të mbuluara me serë.

“Një pjesë, nuk u dorëzuan deri në fund. I katandisën aq keq, saqë pothuajse ishin të vdekur kur i nxorën që nga tarraca”

Si ju pritën të burgosurit e tjerë, në Spaç?

Nevrus Golka: Nëpër kampe krijohej një farë lokalizmi, kështu që dhe ne korçarët rrinim më vete. Fillimisht, na thirri drejtori i minierës, i cili na pyeti tek e tek, se çfarë punësh kishim bërë. Unë i thashë që kisha punuar hekurkthyes në ndërtim. Atëherë, të gjithë ne hekurkthyesit na caktuan të shtronim shina në galeri.

A ka patur raste që ju kanë dhunuar kur keni qenë në burg?

Nevrus Golka: Po, ka pasur, ka pasur shumë raste. Më cilësonin si njeri kokëderr, kështu i themi ne në Korçë, ose kokëmushkë. Kështu më kanë cilësuar, gjithmonë. Pjesën më të madhe të rrugës për në galeri e bënim të lidhur me hekura, jo të gjithë, por mua në veçanti, të lidhur me hekura. Mbaj mend një ngjarje me një polic, që nuk dua ta përmend, se është bërë për rahmet, ka vdekur. Para se të hynim në galeri, më lidhi me hekura. Lidhi edhe një tjetër nga Dibra. Ndërsa po ia lidhte hekurat, ai i lutet të mos ia shtrëngonte shumë, se i dhimbte. Polici ia shtrëngoi akoma. “Aman, - i thotë ai, - se po më dhembin shumë

duart.” E la atë e filloi po m’i shtrëngonte mua. Priste që t’i thoja “Mos m’i shtrëngo shumë”, po unë nuk i thashë. Dhe m’i shtrëngoi aq shumë, sa mua më ra të fikët. Dërgoi dikë të merrte ujë, ma hodhi e më tha: “Dëgjo, Golka. Unë inatin e kam me këtë, mirëpo atë nuk e shtrëngoj dot, se ai më çarmatos, kurse ti tregohesh kokëfortë. Unë nuk dua të ti shtrëngoj ty”. E megjithatë, mua më shtrëngoi tri herë dhe më ra tri herë të fikët, tri herë më hodhi ujë dhe pastaj, si duket u ngop edhe tha: “Boll!” dhe mori një tjetër. Psikologjia e policit ishte se kishte respekt për mua, për qëndrimin tim, mirëpo mua më shtrëngonte më shumë sesa atë tjetrin që ishte pak si spiun, ndërsa unë isha pak si kokëshkretë. Më thoshte: “Ty të dua më shumë, por ai më çarmatos, sepse më thotë “të lutem!”. Ndërsa unë nuk lutesha dot dhe gjithmonë kam ngrënë dajak, por ai dajak më ka bërë mirë ama, më ka mbajtur gjallë, se nuk kishte gjë më të keqe, sidomos pas asaj revoltës, të shikoje gjithë ata spiunë që hynë poshtë telave dhe u dorëzuan në komandë. Ishte gjë e ulët. Tani ti bën burg, pastaj kalon telat dhe... ka pasur edhe të tillë. Mua më dukej e ulët, të kaloja telin dhe të shkoja në komandë. Kam qenë gjithmonë në ballë.

A jeni ridënuar?

Nevrus Golka: Po, dënimi i dytë erdhi në muajin shkurt të 1973-it dhe u ridënova dhjetë vjet, edhe këtë herë për tradhti ndaj Atdheut.

Ke dashur të arratisesh përsëri? Si ndodhi?

Nevrus Golka: Kësaj radhe, isha vetëm. Nuk kisha më besim, se mund të krijonim grup. E kisha humbur besimin. Pas kryerjes së dënimit të parë, erdha këtu në Korçë, por nuk më lanë, se është zonë kufitare dhe më çuan në Elbasan. Fillova të punoja hekurkthyes, në Metalurgjik. Atje ishte kryetar dege, Nezat Haznedari. Ai më thirri një ditë të zakonshme në Degë dhe më tha që kishin nevojë për ndihmën time...

- Çfarë ndihme?- u çudita unë. - Po kemi nevojë për ndihmën tënde. Është gjynah, - më tha, -ti je shumë inteligjent, pse të punosh hekurkthyes? Do të të japim një punë më të mirë, të punosh magazinier e të shkosh në punë me kostum. - Po jam mirë atje,- i thashë unë. - Jo, jo, - tha ai, - që të shlyesh dëmin që i ke bërë atdheut me tradhti, duhet të punosh për atdheun, të punosh me ne.

- Çfarë pune tjetër, mund të bëj unë? Ja, po i bëj nga dy norma, çfarë doni tjetër?- i thashë. - Epo jo, nuk na duhet kjo punë. Ti e kupton shumë mirë, se... - Nuk po marr vesh,- thashë, - punë tjetër, s'di të bëj. - Jo,- tha. - do të punosh me ne. - Jo, - i thashë, - unë s'di të bëj punë tjetër. Të nesërmen, kur mbërrita në punë, më thërret shefi i kuadrit: - Hajde këtu! Nga ke ardhur ti? -Nga Korça. -S'po e gjej dot, atë fletën tënde të punës. Do të shkosh në Korçë, të marrësh një fletë tjetër. Në Korçë, takova shefin e kuadrit të komitetit dhe i thashë, se më kishin humbur fletën e punës, prandaj më kishin dërguar të merrja një tjetër.

Ai ma ktheu: - Po, po. T'i lëshonim fletët e punës kështu siç kërkon ti, të tërë diversantët do të merrnin fletë e do të hynin në punë dhe nuk do t'i gjenim dot ne. Ç'është kjo "më humbi"? Ik, ik, se ta kanë bërë me hile ata. Si humbi kjo fletë? U ktheva prapë në Elbasan, por shefi i kuadrit përsëri më tha: -Nuk e di. Unë nuk kam fletë pune, prandaj s'të pranoj.

Edhe në Elbasan, në hotelin e beqarëve flija. I

rashë lapsit..."Eh, ik, ore babë, se me këtë nuk merresh dot". Kështu që u nisa që nga Elbasani, me tren, deri në Pogradec. Aty takova një shok nga zona e kufirit, Arza.

- Hë, mo Golka, ku do të vesh? -Mbeta pa punë, - i thashë unë, - do të arratisem. -Po është një metër e gjysmë dëborë. Ku do të shkosh? Ishte shkurt. -S'kam nga t'ia mbaj. Nuk jetoj dot pa punë. - Jo, jo, andej mos u nis, se do të mbetesh për nam nëpër dëborë, - më tha, - nuk kalohet kufiri.

Unë që atje, mora bregun e liqenit dhe drejt e në kufi. Nuk kisha zgjidhje. Këtej u mbyll rruga. Kalova kufirin për mrekulli. Kisha një palë pinca me vete, e preva gardhin e me vrap e kalova, se atëherë kufiri, në fund fare ndahej nga një gardh.

E kalova dhe dëgjova ata që më ndiqnin nga mbrapa: "Lëre, lëre, kaloi! Mos e ndiqni më!" S'mund të më ndiqnin më tepër sesa kufiri. Kalova në Jugosllavi. Kur desha që të ecja sa më afër liqenit, atje ishte kufiri si me kthesa dhe kisha hyrë përsëri në Shqipëri. M'u sul qeni, po shyqyr që i kishin vendosur sitën në hundë dhe nuk më kafshonte dot. Kaq ishte! Në Pogradec, pothuajse nuk më bënë fare hetuesi, se çfarë do të më pyesnin? Unë s'kisha bashkëpunëtorë, isha tek-pullë. Më futën një spiun në birucë. Ai më pyeste nëse isha me Enver Hoxhën, apo me Mehmet Shehun. Kaq kërkonte.

Domethënë në shkurt të 1973-it u arrestova, në prill të po atij viti u dënova dhe shkova për herë të dytë në Spaç. Shumica nuk e dinin që unë u dënova për herë të dytë. Menduan se kisha qenë në spital meqë nuk më kishin parë dy vjet.

Sa vite ju dënuan këtë herë?

Nevrus Golka: Dhjetë vjet. Dy vite ndenja jashtë dhe u riktheva në prill. Në maj filloi revolta.

Si e mbani mend revoltën e Spaçit?

Nevrus Golka: Ishte një si tarracë në Spaç ku bëhej apeli para pune, aty na numëronin. Punën e kisha në turnin e tretë dhe isha në tarracë ku kishin rreshtuar ata që kishin radhën për turnin e parë. Mbjaj mend, si tani, qenin që iu sul një oficeri roje. E tërhoqi dhe i ra kapela.

Fondi nr.1, hetimor-
gjyqësor, dosje nr. 10142

I kujt ishte qeni?

Nevrus Golka: Ishte qeni jonë, e kishim rritur vetë që të vogël. Për çudi, edhe ai i afronte shumë të burgosurit. Po të vinte ndonjë i huaj, i sulej. Ishte bërë shumë shok me ne.

Revolta, ndodhi prej qenit apo diçka tjetër?

Nevrus Golka: Në birucë ishte Pal Zefi dhe nuk dilte në punë. Dy policë e morën me dhunë për ta dërguar në punë. Atje kanë qenë dy pallate dhe një urë në mes nëpër të cilën kalonin kapterët dhe oficerët. Në atë kohë që këta e sollën Pal Zefin për ta nxjerrë me dhunë në punë, qeni iu sul

oficerit të rojës dhe ky ishte fillimi. E morën pastaj Pal Zefin të lidhur, e çuan në rrugicën andej për ta nxjerrë në punë me dhunë.

Edhe mua më kanë nxjerrë në punë me dhunë. Kisha një miopi të theksuar nga sytë, me raport, kisha edhe syzet, dhe këta më futën në minierë. Më çonin në punë të lidhur me hekura dhe do të shkoja atje, detyrimisht, se s'kisha nga t'ia mbaja, kurse atë po e tërhiqnin zvarrë.

Pal Zefi nuk doli në punë?

Nevrus Golka: Pal Zefin e morën zvarrë. Kur do të fillonte turni i dytë, nuk doli njeri në punë

edhe u acarua drejtori i kampeve dhe i burgjeve, Sulejman Manoku. Ai erdhi aty në tarracë edhe tha: “Si e keni punën?” U ngrit dikush e parashtrio disa kërkesa: “Nuk duam të punojmë në minierë; nuk duam këtë lloj gjelle që na bëjnë, se na hidhnin një margarinë që, kur e kujtoj tani, them si e kemi ngrënë atë margarinë, se ishte shumë e rëndë.” Edhe disa pika të tjera.

Drejtori tha që do të shkonte në Tiranë, do t'i bisedonte me shefat e do të kthehej me përgjigje. Mirëpo ai nuk u kthye. Aty plasi një urrejtje dhe mosbesim. Ajo ishte tallje! Ti, drejtor i kampeve dhe i burgjeve jep fjalën që do të shkosh në Tiranë edhe do të kthehesh për t'i sqaruar, por nuk kthehesh më... Pastaj filluan britmat. Turni i dytë nuk doli për në punë. Kur u kthye turni i tretë, hyri me “urra” dhe revolta mori përmasa shumë të gjera.

Mbaj mend që të nesërmen në mëngjes erdhi Feçor Shehu me një makinë si zjarrfikëse. Në krye të kampit ku ishte toga e parë, vendi ishte shumë i thepisur. U mblodhën Kasëm Kaçi, Dhori Panariti, Aranit Çela dhe atje, në këmbë, e mori fjalën Feçori:

- E shikoni këtë makinë? Kjo është makinë me napalm. Po të jap urdhër, ju për dhjetë minuta jeni të djegur. Ju bëj shkumb! Ne ia kthyem: - Bëje, ne të vdekur jemi, që jemi. Ai vazhdoi: - Prandaj mblidheni mendjen. Rreshtohuni atje dhe dilni në punë! Ne: - Nuk dalim, që nuk dalim. Pastaj filluan thirrjet kundër qeverisë e mori rrjedhë njësoj si një rrëke prej shiut që bie. Është e vogël në fillim ajo, po pastaj, duke u mbledhur e duke u shtuar bëhet një përrua që përmyt çfarë gjën përpara. Ashtu ndodhi edhe me revoltën.

Kur ata vendosën që ta shtypnin revoltën, u krijua një situatë sa e rëndë aq edhe për të qeshur. Na morën, na lidhën me zinxhirë në seri, jo tek e tek, por kështu në seri. E kalonte zinxhirin nga këmbët nëpër duart, kalonte edhe këtu te goja, që të mos flisnim edhe këtu në kyçe. Të gjithë policët mbyllën kyçet. Ishte një kazan i madh i gjellës në Spaç. M'u aty i hodhën ato çelësat dhe u mbush ai kazani plot. Kur erdhi momenti e dhanë urdhër që të na lironin, ec ta gjeje çelësin mes të gjithë atyre çelësive. Duhet t'i provonte një njeri të gjithë, derisa të gjente atë çelës që hapte kyçin e

vetë. Kulmi! Ne kishim kaq kohë edhe pa ngrënë, kaq kohë edhe pa shkuar në banjë. Llogarite çfarë kishte pësuar trupi! Megjithatë qeshnim. Si ka mundësi që nuk u vunë numra atyre çelësive dhe të na zgjidhnin kollaj?

Nuk e ke idenë, atje ishte shkëmb dhe kur nxehej ai shkëmbi, ishte shumë, shumë vapë. Ne atje, të mbaruar, pa ngrënë, pa pirë, se edhe ujin na e ndaluan. Ylber Merdani ka qenë në skaldabanjë edhe i dhanë urdhër të mos i jepte ujë asnjë njeriu. Më pas kemi pirë ujë, po ujë të ngrohtë. Ishte torturë shumë e madhe.

Është vërtetë për të qeshur, po sikur të kisha një kamerë në atë kohë e ta filmoja, kush e di sa çmime “Oscar” do të kishte marrë ajo që do të filmoja. Një kazan i madh dhe tërë kyçet do t'i provonte një njeri. Kishte raste që dilte pas nja dhjetë herësh, por kishte raste që nuk dilte çelësi, se çdo kyç kishte çelësin e vet. Kur dolëm që atje, ishte tmerr.

Këtë detaj të çelësive nuk e kemi dëgjuar asnjëherë. Është e hera parë që e dëgjojmë.

Nevrus Golka: Ajo është thjesht e tmerrshme, por edhe për të qeshur. Pastaj, çuditërisht edhe për policët...I hoqën ata policët e përditshëm që kishim ne dhe sollën policë plot me thinja. Si ka mundësi? Ky, Kasëm Kaçi nga i gjeti, more? Po nga i mori të tërë ata me thinja?

Si shkoi më pas revolta?

Nevrus Golka: Ishte një pjesë që nuk u dorëzuan deri në fund. Mbetën lart në tarracë. Ishte shumë, shumë e rëndë kur ndërhyrë. Një kafshëri. I katandisën aq keq, saqë pothuajse ishin të vdekur kur i nxorën që nga tarraca. Nuk i dalloje dot se kush ishte njeri apo tjetri, aq ishin të lyer me gjak në fytyrë.

Gjyqi i parë u bë atje, në Spaç. Po çfarë gjyqi, ore? Unë mbaj mend një Luan Koka nga Vlora: absolutisht asnjë pjesë të trupit nuk e kishte më rroba, por vetëm të fashuar. Vetëm sytë i dukeshin, bile edhe gojën të zënë. Nuk i dallonim dot se kush ishte ky e kush ishte ai. Një torturë e tmerrshme. Edhe i pushkatuan atje, që tek seanca e parë. U dëgjua të qarkullonte njëherë lajmi nëpër Spaç,

se në çdo grup do të pushkatoheshin nga katër veta. Ishin dymbëdhjetë grupe, do të çonin për pushkatim 48 vetë. Madje thanë se, që atë ditë, Radio Londra kishte dhënë lajmin e saktë që në revoltën e Spaçit do të pushkatoheshin kaq persona, nga katër për çdo grup. Nuk pushkatuan më të tjerë. Ata të katër se nga i hodhën. Kishim një skuadër ordinerësh që merreshin me këtë punë. Këta që vdisnin, për shembull, nuk i varrosnin, por i shtinin në një vend dhe atje i linin.

Ku i linin trupat e tyre?

Nevrus Golka: Siç ishte Spaçi, merrnin kështu malin përpjetë dhe në një vend, siç thoshin, është një si lëndinë majë të malit, aty i linin.

E mbani mend atë vend?

Nevrus Golka: Unë jo, nuk e mbaj mend.

Po në qoftë se të çojmë në atë vend atje, a mund të orientohesh?

Nevrus Golka: Të burgosurit ordinerë e dinin.. Ata merreshin me mirëmbajtjen e rrethimit edhe me këta që vdisnin, kurse unë jo.

A dini gjë nëse është gjallë ndonjë prej tyre që mund të shërbejë si dëshmitar për mënyrën dhe vendin sesi i kanë varrosur ose braktisur trupat e të burgosurve?

Nevrus Golka: Unë njihja një pjesë nga ata. Bile është njëri, që ka qenë në Spaç, banon mbrapa shtëpisë sime. Dhe më ka thënë që vetëm i çonin në majë të malit. Aty ka një sheshpushim edhe është një vend me bar. "Aty i çonim, - më tha, - dhe iknim, nuk i varrosnim fare." Nuk e di nëse ka qenë apo jo në atë kohë, po ai aty ka shërbyer.

Pasi u mbyll revolta, vazhduat në Spaç apo ju çuan në Burrel?

Nevrus Golka: Jo, jo, në Spaç derisa u lirova.

Kur e fituat liruat?

Nevrus Golka: U lirova me amnistinë e vitit 1982, në nëntor, pas dy dënimesh, gjithsej pas tetëmbëdhjetë vitesh burg, m'u ulën nga dënimi

një muaj e njëzet ditë. Për një muaj e njëzet ditë unë e plotësoja krejt dënimin.

A ju kishte ardhur ndonjëherë familja në burg?

Nevrus Golka: Familja ime s'më kishte dhënë asnjë shenjë sa kohë kisha qenë në burg, përveçse gjyshes nga nëna. Ajo më erdhi njëherë në Laç dhe më solli një pllakë bukë dyzetëshe edhe një racion marmelatë sa një sapun. Kur e pyeta se ku e kishte blerë bukën, më tha që e kishte marrë në Elbasan te çupa, se kishte fjetur një natë atje dhe që andej erdhi në Laç. Ky ishte i vetmi rast i takimit me një familjar. Në tetë vite, vetëm njëherë më erdhi gjyshja. Pastaj në burgun e dytë, as letër, as telegram, asgjë prej gjëje. Gjyshja vdiq.

Nisur nga këto rrethana ku shkuat pas lirimat nga burgu?

Nevrus Golka: Na sollën në Korçë. Unë e dija që nuk do të më pranonte familja, se nuk kishte asnjë shenjë që të kishin shprehur ndonjë keqardhje apo diçka, absolutisht. E dija dhe nuk u paraqita në familje, por shkova në qendër të fshatit ku ishte një klub.

I thashë njërit prej djemve të fshatit që ishin aty, "Shko atje, te babai im dhe thuaji që është liruar Nevruzi. Unë po të pres këtu". Shkoi ai edhe u tha, mirëpo ia kthyen: - Jo vetëm që të mos vijë këtu, por a ka mundësi të zhduket nga faqja e dheut? Nuk e pranojmë ne!

U ktheva prapë dhe shkova në Degën e Brendshme. I thashë oficerit roje që familja nuk më pranoi. Ai më tha: - Mos ki merak se do të të pranojnë. Ja, do t'u themi ne. Ndërhyri ai te familja dhe më kanë futur në një kotec të vogël. Aty rrinte roja i magazinave të kooperativës. Rojën e çuan në një vend tjetër dhe më thanë mua: - Ja, këtu do të rrih. Vetëm një stol me dërrasa kishte!

Aty rrija, aty flija edhe shkoja në punë. Kur erdhi dita që do të merrja rrogën, nuk ma dhanë. E pyes brigadierin: - Përse? Kur ai më thotë: - Kanë ndryshuar normat dhe me ndryshimin e normave ty nuk të takon asnjë lek. - Po kur u ndryshua kjo norma? - Kur ishte ti në burg, - tha, - prandaj

jam i detyruar të ta mbaj tani rrogën. Shkova te Kryetari i Këshillit dhe i thashë të sqaronte përse brigadieri më mbajti rrogën për vitet e shkuara, ndërsa unë kam qenë në burg në Spaç. Sado që Kryetari i Këshillit i tha të mos ma mbante rrogën, brigadieri këmbëngulte që nuk ma jepte dot rrogën, se ashtu ishte ligji. Atëherë i kërkova të paktën të më krijonte mundësi që në mensën e fshatit të më jepnin për të ngrënë tre vakte. Lekë për cigare nuk kisha, por të paktën të kisha për të ngrënë bukë. Kryetari nuk mori përsipër ta zgjidhte këtë gjë. Shkova te mensa dhe shefja ishte një grua. Pasi i tregova problemin, më tha: "Hajde, hajde, po kur të mbarojnë të gjithë ata që janë të abonuar, se do të ketë mbetur ndonjë gjë edhe për ty".

Ajo më siguronte një vakt në ditë, kurse për cigare ishin ata shokët, moshatarët e mi. U vinte keq dhe më zgjasnin cigare. Meqë s'e përballoja dot jetën me rrogën e kooperativës, shkova në minierë. Edhe aty në hotelin e beqarëve të minierës. Aty u fejova dhe u martova me të motrën e Ylberit me të cilin njiheshim që në Spaç.

E motra kishte mbetur si mos më keq. Ylberi ishte në internim. U fejuam bashkë dhe shkova të banoj tek ajo. Rrogën që merrja në minierë s'kisha ku ta harxhoja, por blija ushqime. Na thirrën në Degë, se kishte ankesa... nuk donin që unë, ish-i dënuar, të banoja në atë lagje. Ua shpjegova se në bazë të ligjit, bëra fejesën, celebrimin e të tëra, prandaj banoj në një shtëpi me vajzën që e mora për bashkëshorte, se u bëmë një familje. Shefi i policisë ishte një fshatari im dhe më kërcënoi: - Të pashë që zbritë nga miniera për në Korçë, do të të arrestoj! - Po, mirë, - ia ktheva, - arrestomë. Unë nuk kam frikë nga arrestimet.

Na çuan në Degën e Brendshme ku ishte kryetar i saj ishte Bardhosh Lamçe, i cili pyeti se si ishte puna. Gruaja ime e përlotur qante dhe nuk përgjigjej për asgjë: -Si është puna? Pse të sollën këtu? - I plotfuqishmi më solli. Më thirrën në lagje, më treguan: - Ja, ku e ke emrin.

E vuri në rreth me të kuq, e bëri edhe me pikëpyetje, pastaj prapë me laps të kuq e më tha: - Je këtu? Prapë në Spaç do të të shpie, po më mirë ik. Shko rri andej nga miniera! - Pse, çfarë kam bërë? - i thashë kryetarit të Degës.

Gruaja është nga internimi, unë jam nga burgu, u morëm vesh me njeri-tjetrin, shqip flasim të dy, edhe çfarë kam bërë?

Mori bllokun dhe pa emrin tim me rreth të kuq. - Ç'është ky rreth? Aty ia ktheva unë: - Këta më kanë vënë në rreth të kuq si Emiljano Zapatën meqë ishte kryengritës. Atëherë kryetari i Degës më tha: - Ik, ore, ik. S'ke asnjë faj! Që atëherë u mbyll dhe nuk më thirrën më.

Sa kohë punove në minierë?

Nevrus Golka: Në minierë punova deri në vitin 1992, pastaj dola në pension të parakohshëm me 60% siç ishte ligji në atë kohë, meqë minierat po mbylleshin dhe shkova në Korçë. Pensioni më doli 48 mijë (lekë të vjetra), pensioni i pjesshëm, i parakohshëm, siç quhet. Mora katër herë pension dhe vajta tek disa shokë që kanë hotel turizmin.



I njihja se janë nga anët tona. U them atyre që s'më dilnin lekët e pensionit dhe ata më pranuan të punoja atje për të shpërndarë çelësat e dhomave kur vinin njerëz për të fjetur. Shumica nga këta ishin nga Shqipëria e Mesme, flinin një natë këtu, pastaj merrnin rrugën për në Greqi. Kështu fitova një pagë 100 mijë lekë, përveç lekëve të pensionit.

Pastaj, kur filloi reforma në polici, më erdhi në shtëpi Ferit Taja, një shok burgu nga Shkodra, i cili ishte me detyrë në Korçë. Pasi u takuam, fjeti në shtëpinë time.

Në mëngjes, u zgjua nga gjumi e më pyeti: - Po ti, s'vajte në punë? I thashë që kisha dalë në pension. - Po turp nuk ke?- tha. - Ne po kërkojmë njerëz për t'i veshur në polici, kurse ti më rri këtu pa punë. Bëje gati dosjen dhe ma jep! E mori ai dosjen, e firmosi në ministri dhe unë punova gjashtë vjet në Policinë e Shtetit, kryesisht në zjarrfikëse, se aty mund të bëja diçka.

A keni ndonjë mesazh për të rinjtë nga përvoja juaj?

Nevrus Golka: Rinisë së sotme i uroj që të mos pësojë zhgënjimet e kohës sonë.



Barjam Dervishaj

Përsëri në Spaç burg, birucë...

Barjam Dervishaj, i biri i Zenepes dhe Njaziut, lindur më 11 janar 1945, në Selckë të Tepelenës. U arrestua më 27 maj 1964 me akuzën “për arratisje dhe për agjitacion propagandë kundër pushtetit”. U dënua me 10 vjet heqje lirie⁸. Vuajti dënimin në Spaç, në vitet 1971- 1980. U arrestua sërish me akuzën për arratisje dhe u dënua nga gushti i vitit 1981 deri në vitin 1991. Kur doli nga burgu, mori vesh se nuk ekzistonte më në gjendjen civile: E kishin çregjistruar për së gjalli!

Zoti Barjam, si ish-vuajtës në burgun e Spaçit, a keni kërkuar që të njiheni me dosjen tuaj?

Barjam Dervishaj: Jo. S’kam interes, sepse i njoh dëshmitarët.

A mund të na tregoni sesi ndodhi arrestimi juaj?

Barjam Dervishaj: Kam rënë në burg 17 vjeç. As nuk kam ditur gjë fare nga këto mbikëqyrjet, as ç’ ishte komunizmi, as ç’ bëhej në Shqipëri. Më kanë arrestuar në 27 maj 1964, me akuzën tentativë për arratisje.

Ku ju arrestuan?

Barjam Dervishaj: Isha në shtëpi. Më mbante halla ime. Unë jam rritur jetim. Babai më ka vdekur dhe më ka lënë dy vjeç. Nënë e morën prindërit e saj dhe e martuan. Unë jam rritur tek halla ime, motra e babait. Kështu, erdhën e më morën aty. Më thanë të shkoja me ta dhe më futën në burg.

Nga doli ajo akuzë? A ishte e vërtetë?

Barjam Dervishaj: E vërteta ka qenë që unë mund të kem bërë ndonjë muhabet ose qyfyre. Nuk e kam pasur idenë e se ç’ ishte arrestimi. Më akuzuan “për tentativë arratisjeje” dhe më arrestuan në Përmet. Nga Përmeti më çuan në kalanë e Gjirokastrës. Më dënuan 10 vjet.

Si u zhvillua hetuesia? Sa kohë zgjati dhe a pati ushtrim dhune kundrejt jush?

Barjam Dervishaj: Hetuesia zgjati 6 muaj. Më kanë dhunuar fizikisht, që të pranoja akuzat që bënin kundër meje.

8. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 9645. Vendim nga Gjykata e Qarkut Gjirokastër, nr. 23 i Aktit, nr. 23 i vendimit, datë 31.07.1964. Arkivi i AIDSSH-së.

Çfarë pyetjesh ju kanë bërë?

Barjam Dervishaj: Pyetje të ndryshme. Vetëm këtë akuzë kisha. Unë kisha dashur të ikja, por atyre u thoja "jo".

A kanë tentuar t'ju bënin bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit?

Barjam Dervishaj: Po. Më thanë: "Do të të nxjerrim nga burgu, do të të lirojmë fare, po bashkëpunove me ne, se ti je i ri". Isha 17 vjeç. Nuk pranova se nuk kuptoja çfarë po bëhej.

Si u zhvillua gjyqi, a kishe ndonjë familjar gjatë seancës?

Barjam Dervishaj: Në kohën time, në vitet '64, unë kam qenë në kalanë e Gjirokastrës dhe po aty bëheshin gjyqet. Na nxirnin vetëm 5 minuta për ajrim. Në vitet '64 - '65 ishin ende avokatët mbrojtës, por këta ishin bashkëpunëtorë të shtetit. Shteti më vuri një avokat.

Më akuzuan se kisha dashur të arratisesha dhe se gjoja do të kthehesha për të zaptuar pushtetin popullor. Kështu më dënuan 18 vjet, por meqë isha i mitur, ma kthyen në 10 vjet. Pasi u dënova kam bredhur në të tëra burgjet dhe kampet.

Gjatë gjyqit më erdhën ata të hetuesisë dhe avokati. S'kishte të tjerë, se unë s'kisha as familje. Unë nuk e njihja nënën. Dija që kisha nënë, që kisha dajë, por nuk i njihja, se jam rritur tek motra e babait. Ajo kishte të shoqin, tri çupa, tre djem dhe unë bëheshim shtatë fëmijë. Kam vajtur që dy vjeç atje. Më ka çuar gjyshja ime, domethënë mamaja e hallës. Mbas 6 muajsh, ajo vdiq.

Në atë kohë nuk kuptoja dhe thoja që doja si baba burrin e hallës. Nënën e kam takuar në vitin 1980. Ishte në një fshat të Beratit. Gjithsej kam katër vëllezër dhe një motër me nënë dhe një motër me nënë e baba, të gjithë në Berat.

Kur më pa nëna, i ra të fikët. Në atë kohë isha burrë, 35 vjeç. Kisha bërë 17 vjet burg dhe sapo isha liruar nga Spaçi. Nëna dyshonte mos isha ndonjë provokator, i futur nga Sigurimi i Shtetit. Nga një anë qanin, nga ana tjetër kishin frikë. Vinte një njeri që kishte bërë 17 vite burg dhe shihej si armik!

Çfarë ndodhi pasi ju dënuan në Gjirokastër me 10 vjet burg?

Barjam Dervishaj: Nga kalaja e Gjirokastrës më çuan në burgun e Vlorës. Ky burg ishte për ata që dënoheshin nga jugu. Dhe ata që ishin pleq mbaheshin në burgun e Vlorës, ndërsa veriu mbahej në burgun e Shkodrës. Pas 6 muajsh shkova në burgun e Vlorës dhe aty gjeta rreth 250 burra, të sëmurë, pleq. Kush ishte i fuqishëm shfrytëzohej për punë si skllav. Kam ndenjur rreth tre javë atje, pastaj në nëntor të '64-s më morën tok me një 5-6 të dënuar të tjerë dhe më çuan aty ku po ndërtohej Uzina e Sodës Kaustike, po në Vlorë. Atje na zbritën nga autoburgu na kontrolluan dhe na futën në kamp. Aty pashë njerëz të burgosur: një 500 deri 900 burra. U futa midis tyre, u bëra pjesë e tyre dhe kaloja kohë me ata njerëz, sidomos ata që hynin e dilnin.

Kur dolët nga burgu?

Barjam Dervishaj: Përfundimisht, në vitin 1991. Por unë jam liruar në vitin 1980, mbasi i kisha bërë 17 vjet burg, kam ndenjur 7 muaj në jetën e lirë dhe jam arrestuar prapë. Më çuan në Spaç.

Në vitin 1965, mbasi u ndërtua Uzina e Sodës Kaustike, jo vetëm mua, por të gjithëve na çuan në Elbasan, në Fabrikën e Çimentos. Në vitin 1966, aty kam parë njerëz të vrarë e ndër ta edhe disa nga shokët e mi.

Në Elbasan më kanë dënuar tri herë. Po, po, mora 3 herë ridënime me nga 2 vjet, 6 vite për rrahje. Në burgun e Elbasanit nuk na thërrisnin në emër, na kishin vënë numra. Unë kisha numrin 305 dhe thoshin për shembull "numri 305 ka takim", për të tjerët kjo, se unë nuk kisha takime ose "numri x tek operativi". Këtë e kam parë vetëm në kampin e Elbasanit. Më pas më çuan në Laç, ku ndërtohej Uzina e Superfosfatit. Edhe aty kam parë ngjarje që nuk dua t'i kujtoj, njerëz të vrarë. Pastaj na transferuan si kamp në Fushë - Krujë, ku ngruhej Fabrika e Çimentos.

Më pas, nga Fushë - Krujë në Elbasan, në vitin 1967. Këtu mblodhën edhe nga Laçi, Rubiku dhe u bëmë rreth 2500 burra. Aty kishte shumë probleme. Ishin shumë të rinj që donin liri. Pati edhe tre-katër të vrarë. Nga viti 1967, kam bërë

Fondi nr.1, hetimor-
gjyqësor, dosje nr. 9645

4 vjet atje e më pas, në vitin 1971 më çuan në Spaç. Ndenja atje 4 muaj, pastaj për një rrahje me policët më çuan në burgun e Burrelit. Kështu, kam marrë disa dënime: 5 dënime. Një e mora në Burrel. E për çfarë? Se kundërshtoja policët. Po nuk durohej, ata na rrihnin.

Përse ju godisnin?

Barjam Dervishaj: Edhe pa bërë ne gjë, ata na goditnin, madje thonin që gjoja ishim ne që i kishim goditur e kështu na dënonin. Në burgun e Burrelit njerëzit trajtoheshin shumë keq.

Atje kishte dhunë sistematike: na lidhnin me zinxhirë këmbë e duar, në ato birucat ku na rrihnin barbarisht. Polici ma fuste këpucën me zor në gojë. Na rrihnin 7-8 policë. Ushqimi ishte shumë i keq.

Ju s'kishit askënd që t'ju ndihmonte me ushqim a veshmbathje. Si ia keni dalë?

Barjam Dervishaj: Ashtu është, por unë kam pasur shokë. Ata e ndanin çdo gjë me mua. Të gjithë atje vuanim, por të gjithë thonin si mund të më ndihmonin. Edhe pa e ditur unë, më fusnin ushqime poshtë jastëkut. Njerëzit vuanin shumë. Merrnim vetëm 500 gramë bukë, 2 herë në ditë, një gjellë ku s'e gjeje dot kokrrën e orizit a të fasules.

Fjetorja ishte e keqe. Në orën 8 të mbrëmjes na lajmëronin për gjumë e, në qoftë se nuk ishe shtrirë, të çonin në birucë. Në mëngjes, në orën 5 të mëngjesit, kur binte bilbili, duhej të kishë rregulluar shtratin me kashtë dhe dy batanijet. Na nxirrnin tri-katër herë në ditë për të kryer nevojat

personale. Kishim nga një qyp aty brenda. Dilnim për ajrim një orë paradite e një orë pasdite. Në rast se kokat e partisë bënin xhiro në Vlorë ose në Shkodër, komanda lajmërohej një muaj para dhe atë muaj nuk na nxirrnin fare as për ajër. Kur vinte koha të dilnim, sa shikonim dritën e diellit na dhembnin sytë. Gjatë kohës që kam ndenjur në burgun e Burrelit, tre miqtë e mi kanë varur veten nga uria. I kam parë me këta sy.

Ua mbani mend emrat?

Barjam Dervishaj: Posi jo. Mustafa Bajraktari nga Tropoja, 22 vjeç, Lefter Batovani nga fshatrat e minoritetit grek, Fadil Dushku nga Elbasani.

Për çfarë ishin dënuar?

Barjam Dervishaj: Njësoj si të gjithë ne. Unë nuk kam parë asnjërin nga të gjithë këta, që të kishte kryer vrasje ose krime. Në muret e burgut të Burrelit shkruhej "Këtu i thonë Burrel, ku hyn e më nuk del". Vetëm këtë të shikoje dhe imagjino si ndiheshe. Kam njohur miq dhe shokë në burgun e Burrelit, përpara të cilëve përkulesha me respekt. Burra që nuk jepeshin, por qëndronin në pozicion. Kam njohur aty Rexhep Hajdar Matën. I kishte këputur të dyja këmbët: - njërin kur e kishin kapur në kufi dhe tjetrën më pas. Ai qëndronte i fortë si një shkëmb. Na shërbente si shembull. Nuk mund t'i përshkruaj dhe ju nuk mund ta kuptoni, për shembull, pse unë edhe sot në gjumë, shoh në ëndërr sikur zihem me policët. Këto makthe janë nga tmerret që hoqëm.

Ato jetojnë me ne. Harrohen, thonë njerëzit. Jo, nuk harrohen. Harrohet një pëllëmbë, por nuk harrohen vuajtjet e tmerrshme. Ata tradhtarë na akuzonin neve si tradhtarë dhe nuk lanë poshtësi pa bërë mbi ne. Komunizmi ka qenë dhe mbetet në trurin tim si një sistem krimi, se ç'të të them. Ata patjetër duhet të kishin ardhur nga shpellat, ata nuk besonin në zot, në fe, në nder, në dinjitet. Ata na skllavëronin, ata vrisnin, ata prisnin, ata shkatërruan kombin. Do t'ju thosha juve, që në qoftë se Shqipëria është pushtuar, s'ka pas ndonjëherë pushtues më të rrezikshëm.

Pastaj, në vitin 1973, nga Burreli shkova në Ballsh, për Uzinën e Naftës. Edhe aty pashë shumë të vrarë. Prej andej më transferuan në Spaç, në vitin

1974. Kishte mbaruar revolta, por jo dhuna. Në Spaç kishte vetëm tortura. Nuk kishte fjalë tjetër, vetëm hu dhe birucë. Kërkonin "O normën, o shpirtin!". Dhe njerëzit shkonin në punë, dorë për dorë. Në qoftë se do të ikte njeri, do të vritej tjetri. Harrova të thosha se shokët e mi nuk i kanë jetuar këto gjëra. Në Spaç, na dridhej zemra në gjoks.

Në 1980-ën u lirova. Nuk kisha shtëpi. Shkova në Tepelenë, drejt e në gjendjen civile për pasaportë dhe nuk figuroja si i gjallë! Më drejtuan për te një zyrë e Komitetit Ekzekutiv. Aty ishte një djalë i ri. Më pyeti nga isha e nga s'isha e në vend të sqarohesha unë, u sqarua ai. E kuptoi që unë vija nga burgjet dhe prandaj, nuk po më gjente dot as certifikatën e lindjes. Kam lindur në fshatrat e Tepelenës dhe u sqarua për bukuri. Motrën e tij e kishte marrë për grua vëllai im. Këto janë rastësi të çuditshme!

Ku keni qëndruar sa të zgjidhej problemi i pasaportës?

Barjam Dervishaj: Punoja në minierë në Memaliaj dhe flija në kampet e minierës. Më nxorën një pasaportë të re. Shkova te nëna, në shtëpi. Vjen nëna duke qarë dhe më thotë: "Kë takove në Tepelenë?"

- S'takova njeri, - i them. Mirëpo hodha sytë dhe shoh dikë. Pyes nënën: - Po ky djali? - Më tha: - Është vëllai yt. Ai kishte çuar një letër dy faqe dhe i thoshte të motrës: - Armikun e keni në shtëpi. Ose ndahu me burrë, ose hajde në Dushk!", se nga Dushku i Lushnjës ishte. Dhe nuk vajta më as te nëna, pas kësaj.

Po në vitin 1981 çfarë ju ndodhi?

Barjam Dervishaj: Më kapën në malin Gramoz, në kufi dhe më dërguan në Spaç. Më dënuan 25 vjet. Hera e tetë. Ndenja shtatë vite, në Spaç.

Këtë radhë në ç' vend e kaluat procesin e hetuesisë?

Barjam Dervishaj: Në Ersekë, aty edhe më dënuan.

A ushtruan dhunë mbi ju?

Barjam Dervishaj: Jo! Këtë herë ishin të hapur, edhe ata e dinin që unë nuk i doja edhe unë e dija që nuk më donin.

Sa kohë zgjati hetuesia?

Barjam Dervishaj: Zgjati 4 muaj.

Po gjyqi ku u zhvillua dhe sa zgjati?

Barjam Dervishaj: Po në Ersekë. Zgjati 20 minuta. S'e kishin problem ata, vetë vulosnin... Kur dola nga burgu dhe më kërkonin dokumentet e burgut për dëmshpërblim, këto të Ersekës m'i kishin ngatërruar fare. Sekretarja e gjykatës nuk i kishte firmosur. Pa këtë dokument nuk më jepnin dëmshpërblimin. Shkova në Korçë dhe që nga gjykata e Korçës më ndihmuan për të marrë dokumentin e saktë.

Në Ersekë ju dënuan me 25 vite burg? Ku ju caktuan për ta kryer dënimin ?

Barjam Dervishaj: Përsëri në Spaç: burg, birucë, të gjitha masakrat që bënte komunizmi. Deri në vitin 1988 në Spaç, sepse në '88 bëhet një amnisti dhe lirohen ata që ishin dënuar 8 vite e poshtë, por jo përsëritësit. Kurse ne që ngelëm aty, na çuan në qendër.

Pjesën tjetër e kemi bërë në Qafë të Bardhës... Aty kishte hu...e çfarë nuk bëhej me shqiptarët. Po të ma shikosh kokën e kam gropa-gropa, se ma kanë çarë kokën. Nuk ka lënë gjë pa bërë komunizmi, prandaj të bindeni ju, se ne të bindur jemi, që komunizmi ka qenë e keqja e këtij kombi.

Në qoftë se shqiptarët kanë pasur pushtues, pushtuesit më të ndyrë dhe më të poshtër, janë këta dhe Enver Hoxha. Nuk i ka lënë gjë pa bërë, këtij populli: e plaçkitën, e vodhën, u ulën këmbëkryq dhe bënë çfarë deshën. E zhveshën këtë popull nga feja, nga nderi, nga dinjiteti. Më e keqja ishte kur të pështynin në fytyrë. Ne na kanë pështyrë. Ai mohonte Zotin...

Kur u liruat?

Barjam Dervishaj: Lirimi më erdhi kështu, siç u erdhi gjithë shqiptarëve. Nuk kisha shtëpi. Pasi dola nga burgu, shkova në Tepelenë, u sorollata rrugëve.

Ku keni fjetur? S'besoj se rrugëve?

Barjam Dervishaj: Po, rrugëve. Unë them rrugëve e ti nuk beson! Kur dola nga burgu, pata fatin e keq që nëna më kishte vdekur.

Po motrat e vëllezërit?

Barjam Dervishaj: Jo, s'i takova. Ika në Greqi. Edhe atje më futën në burg. "Emrin? - më pyeti polici atje. - Barjam Dervishaj, - u përgjigja". Vët, përsëri ma kërcitën me shkopinj. Shokët e tjerë thonin "Manol".

Kur e krijuat familjen?

Barjam Dervishaj: Eh, djalë i ri, 49 vjeç. Ku dija unë seç ishte familja, martesë? A besoja se do ta arrija këtë një ditë? Po Zoti është i madh. E falënderoj! Shtëpi s'kisha.

Qëndrova 4 vjet te vjehrra dhe aty i kam lindur fëmijët, djalë dhe çupë. Kur ka lindur djali, pickoja veten: "A është e vërtetë, apo jo?" Unë kisha punuar në minierë dhe dola para kohe në pension, me një 50-mijëlekësh të vjetër.

Në vitet e demokracisë a ju ka trajtuar shteti, duke ju dhënë shtëpi si i persekutuar politikë?


Barjam Dervishaj: Fillimisht, na dhanë shtëpi falas. Pastaj, meqë morëm një copë pension, na kërkuan të paguajmë 15 milionë (lekë të vjetra)

A mendoni se tashmë jeni integruar në shoqëri?

Barjam Dervishaj: Absolutisht që jo. Unë jam i persekutuar dhe kam shumë dëshirë të integrohem, por si? Me pensionet që na kanë lënë? A pi dot një kafe? Ja, ato kemi ne.

A keni ndonjë mesazh për të rinjtë?

Barjam Dervishaj: Unë u uroj suksese. Mirë a keq, janë në kushte të tjera. Shqipëria nuk është më ajo e Enver Hoxhës, e rrethuar me tela me gjemba, me burgje, me kampe, varre, varreza. Sot njerëzit janë të lirë. Se nga shkon njeri, se nga shkon tjetri, nuk regjistrohet askund.



Nuri Stepa

“Mijëra plumba gjuajtën për ta rrëzuar, asnjë vrimë nuk iu bë flamurit.”

“Jam një prej të dënuarve politikë dhe kam kryer 20 vjet burg, duke u dënuar për së dyti, kur isha në burg, për shkak të Revoltës së Spaçit. Unë u arratisa në Jugosllavi, por më kapën atje dhe pas katër muajsh, më kthyen përsëri në Shqipëri. Vuanin, jo vetëm ata në burgje, po detyrimisht, pasojat i kishte edhe familja.”

Nuri Stepa, i biri i Adiles dhe Memishit, lindur më 13 qershor 1947, Tiranë. U arratis në Jugosllavi në vitin 1965, por e kapën dhe e kthyen në Shqipëri ku pas katër-pesë muajsh në hetuesi e dënuan me 12 vite burg.⁹ Hyri në burgun e Spaçit në vitin 1966. Kur vuante dënimin aty, mori pjesë në revoltën e 21 majit 1973 dhe u akuzua “për agjitacion dhe propagandë”. U ridënuua me 13 vite heqje lirie. Doli nga Spaçi në vitin 1986.

Si ndodhi arratisja juaj për në Jugosllavi?

Nuri Stepa: Unë u arratisa dhe më kanë kthyer autoritetet jugosllave, që më dorëzuan te pala shqiptare dhe këta më futën në burgun e Pogradecit. Pas katër ditësh më kanë sjellë në Tiranë, në burgun e vjetër, në birucat e “Koçit”¹⁰ siç i quanin. Ato kanë qenë me penxhere sipër, jo në faqen e murit, por lart. Ishin biruca shumë të tmerrshme, shumë të vogla: dy vetë, me zor mund të rrinin atje. Edhe trajtimi ishte i keq, sigurisht. Ushqimi jepej përtokë, dy herë në ditë, në darkë

9. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2290. Vendim nga Gjykata e Rrethit Tiranë, nr. 26 Regj. Them., nr. 22 i vendimit, datë 31.5.1967. Arkivi i AIDSSH-së.

10. Janë quajtur kështu, sipas emrit të ministrit të brendshëm të viteve të pasluftës, Koçi Xoxe, i njohur për krimet e shumta, dhunën dhe torturat që ushtronte mbi personat e dyshuar.

një çaj pa sheqer. Bukë kishim 600 gramë. I kaluam ato 4 muaj edhe me rënie në peshë. Unë rashë në burg me një shok tjetër, Petrit Spahiu, i cili, tashmë është ndarë nga jeta.

A ju sillnin në birucë persona të tjerë për t'ju spiunuar?

Nuri Stepa: Gjatë hetuesisë ka pasur edhe njerëz që futeshin nga Sigurimi, sidomos pasi më çuan te birucat e burgut të vjetër, ka ardhur dikush në birucë. Ai bënte ca pyetje. Emrin nuk ia mësova, sepse dy orë ndenji.

Si janë sjellë me ju hetuesit? Sa zgjaste hetuesia?

Nuri Stepa: Kishte ulje-ngritje. Pyesin më shumë për njerëz të tjerë, me të cilët mund të kishe pasur lidhje për arratisje, për fyerje e sharje për udhëheqësit e shtetit. Këto pyeste hetuesia dhe prandaj zgjaste shumë, bënin presione gjatë gjithë kohës, të mbanin në tension.

A kanë ushtruar dhunë ndaj jush gjatë hetuesisë?

Nuri Stepa: Ka pasur edhe goditje, sa të duash. Atje karriget qenë të gozhuara. Të lidhnin, të gjuanin me shkelma turinjve, me grushte. Të ishe i zoti, të mbaje atë fjalë që kishe thënë në fillim pa u lëkundur, se ndryshe të gërryenin gjithë kohën...

Sa zgjati gjyqi dhe çfarë ndodhi me familjen tuaj, pasi u arrestuat edhe u dënuat?

Nuri Stepa: Gjyqi i parë ka zgjatur rreth tre ditë. U dha vendimi, 13 vite burg. Kam qenë rreth moshës 20 vjeç. Nuk kisha asnjë dëshmitar. Vetëm një vëlla erdhi në sallën e gjyqit. Unë dy vëllezër kisha dhe kur kishin ndonjë punë ose donin të ndërronin vendin e punës, u thoshin: "E ke vëllain në burg".

Pas marrjes së vendimit të formës së prerë, si u krye transporti për në burg?

Nuri Stepa: Fillimisht, na dërguan në "kaush", ato dhomat ku mblidheshin të burgosurit dhe pastaj transferoheshin me autoburgje. Ishte si dhomë transiti. Kishte edhe të tjerë që vinin edhe nga kampet e transferoheshin në një kamp tjetër.

Me autoburg shkuam nga Tirana deri në kampin e Elbasanit, ku punonim në Fabrikën e Çimentos.

Pas mbërritjes në vendin e vuajtjes së dënimit, me çfarë ndjesie u përballët?

Nuri Stepa: Në kamp, gjithmonë ishte vështirësi, sepse njeriu del në një ambient që nuk e njeh. Shumë njerëz që nuk i njeh, të afrohen. Ata pyesnin nga vije, nga ishe me origjinë, etj. Unë origjinën e kam Vlora dhe vlonjatët më kanë ndihmuar. Kapanonët ishin të mëdhenj, me pupulit, me 3 kate. Çfarë kishte jashtë, hynte brenda. Kur flinim ishte shumë ftohtë. Shtronim gazetata, pastaj hidhnim batanijet që të na mbanin ngrohtë. Për bukë ishte shumë keq. Filluan të na jepnin gati 150 gr. në ditë dhe mungesën përpiqeshin ta zëvendësonin me patate. U mbush oborri i kampit të Elbasanit me skodat që vinin dhe derdhnin patatet. Ne merrnim patate, i zienim, edhe i piqnim ndonjëherë. Në kamp kishte derra dhe atyre u hidhnim patate për ditë, por një ditë ne bëmë një grevë. Ata vunë këmbët te telat dhe ulërinin në drejtim të komandës.

Kur ju transferuan për në Spaç?

Nuri Stepa: Në Spaç jemi transferuar në prill të vitit 1968. Na ngarkuan nëpër makina me plaçka e me çfarë kishim me vete, rresht lidhur me tela njeri me tjetrin. Na nxorën në Rogozhinë, pastaj shkuam në Durrës e pastaj për në Spaç të Mirditës. Mbërritëm atje pasdite në darkë. Atje kishte kapanonë dërrase që ishin rresht. Atje ishte ndryshe, për ne që vinim nga ndërtimi, prandaj e ndjemë problemin e ushqimit dhe kishim uri të madhe. Puna ishte e vështirë dhe nuk e njihnim. Policët ishin mirditorë, por të marrë thjesht nga rruga. Pjesa më e madhe e tyre ishin shumë të këqij. Tek-tuk kishte edhe ndonjë që vinte nga familje e mirë, ndoshta...

Cila ishte arsyeja që filloi revolta në Spaç?

Nuri Stepa: Ishte mëngjes, 21 maj i vitit 1973. Unë kisha qenë turni i dytë dhe isha akoma i shtrirë në dhomë. Barakat u prishën dhe u ndërtuan nja dy godina. Ne i ndërtuam të gjitha, por prapë ishim shumë vetë nëpër dhoma.

Pal Zefi ishte një i burgosur, që i kishte mbushur

ditët në birucë dhe kërkoi të dilte, por polici nuk e nxori. I takonte të dilte, se tridhjetë ditë dënoheshe. E mbushi dënimin dhe duhej të dilte. I iku policit nga atje edhe u fut në kamp. Polici iu turr mbrapa. U sulën edhe policë të tjerë për ta kapur. Të burgosurit u nxeën. Ishte një nga shokët tanë. Pavllo Popa e Syrja Lame, të nxehur, u kapën me policët. Jo vetëm këta, po kishim edhe një qen të madh. Edhe ai u hodh mbi policët. I ka hedhur aty ku ishin hapur themelet e godinës. Ishte qen i tmerrshëm, aq sa e dënuan edhe qenin me vdekje.

Dëgjuam zhurmën edhe u çuam të gjithë. Doli gati pjesa më e madhe e kampit. Vjen operativi i burgut, Fevzi Liço. Turret ky e bëjnë fjalë me të. Syrja Lame ia futi me grusht. Kapela i fluturoi andej matanë. Shau Syrjain, mblodhi policët dhe u tërhoqën jashtë të gjithë. Kjo ishte nisja. Mbas nja një ore vjen Sulejman Manoku, drejtor i kampeve të burgjeve. Thonin që e kishin sjellë në kamp për punë fizike, se kështu i çonin atëherë. Ai bisedoi me të burgosurit. Mori përsipër që ta zgjidhte problemin dhe tha që nuk do të kishte pasoja. Kur erdhi nata dhe filloi të errej, atëherë plasi. U mblodhën të gjithë. Shanin sa mundeshin Enver Hoxhën, partinë, shtetin. U hodhën parullat “Duam Evropën e lirë!”, u shpërthyen edhe birucat, dolën edhe ata aty, në shesh.

Doli Skënder Daja, i cili u pushkatua. Dashnor Kazazi e ngriti në sup dhe ai u bënte thirrje ushtarëve të bashkoheshin me ne, se truprojat në atë kohë ishin të gjithë ushtarë. Nga komanda filluan të shtinin me armë në ajër. Ranë plumba edhe aty ku ishin ne. Kishin lajmëruar qeverinë. Prunë forca të reja, ndërruan ushtarët dhe kthyen disa policë në truproje, se filluan edhe të kishin frikë. Gjithë natën, kjo punë.

Kur u gdhi dita e nesërme, erdhi Feçor Shehu dhe u mbush i gjithë rrethimi i kampit. Kishin prurë dy korpuse, korpusin e Burrelit edhe korpusin e Shkodrës. E kishin rrethuar aq shumë rreth e qark kampin, sa ushtarët rrinin sup më sup. Sollën tanke, helikopterë, u bë e madhe. Mendonin mos kishim armë këtu, derisa guxonin t'i ngriheshin kundër një shteti diktatorial atje brenda.

Ishte një Kostandin Papa, nga Durrësi. Mblodhi të gjithë pleqësinë e kampit në mensë, që meqë



Gota me të cilën ka pirë çaj para pushkatimit Pal Zefi.

Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar

“Njerëzit nuk donin më të punonin, por të mos punoje në Spaç, të lidhnin pas shtyllës me tela me gjemba gjithë natën, pastaj të dërgonin në birucë, të mermin prapë dhe të çonin te shtylla.”

u bë kjo, çfarë do të kërkojmë, se duhej kërkuar diçka. Hartuam pesë-gjashtë pika në letër dhe i bëmë gati për t'ua dorëzuar. Në këtë kohë, Feçor Shehu, i dërguar nga shteti, qëndronte lart, te bregu sipër, i rrethuar me ushtarë.

A mbani mend, çfarë kërkuat në ato pikat që shkruat?

Nuri Stepa: Unë e kam dërguar edhe atë letër. Të gjitha pikat nuk i mbaj mend, po midis tyre ishin: të mos punonin më nëpër miniera dhe të liroheshim nga burgu. Thjesht këto, domethënë nuk kishte ndonjë gjë alarmante, gjëra të thjeshta për kushtet.

Kur erdhi Feçor Shehu, ne bërtisnim nga poshtë: "Hajde poshtë, të sqarohemi!". Ai na e ktheu që nuk vinte poshtë, por ne t'i dërgonim një përfaqësi. Atëherë, dola unë me gjithë Paulin Vatën, sot ka ndërruar jetë edhe ai. Më mbrapa edhe Hajri Pashaj... Unë hipa lart. Shokët që kishim mbrapa, si Bebi Konomi, Simon Hyka, më kapnin për duarsh që të mos dilja. Ishim të rinj në atë kohë. Dola lart, me atë letrën në dorë. Te porta më doli një polic. Nuk e mbaj mend kush ishte nga ata. Ia dhashë letrën dhe u ktheva atje ku ishte shoku im, Paulini kishte qenë oficer sigurimi në Degën e Shkodrës, në kohën kur kishte qenë kryetar dege Feçor Shehu. Ky e kishte nisur me mision në Jugosllavi Paulinin, që ishte me mua dhe kur Feçori pyeti se kush ishte, ai ia ktheu:

- Unë jam Paulin Vata. Më ke harruar?! Jam ai që e nise me mision në Jugosllavi. Më kapën jugosllavët dhe nuk tregova asgjë. Bëra 11 vjet burg atje. U lirova nga burgu dhe erdha këtu, por rashë në thesin tuaj. Më ke dënuar me 22 vjet burg...Tani, nuk e di kush jam?!... -Çfarë kërkonit? - I kemi shkruar në letër. Nuk po kërkojmë ndonjë gjë të madhe. - Ju keni bërë revoltë, prandaj duhet të dilni atje edhe t'u thoni njerëzve, se ata që duan të dalin në punë, të dalin në një krah, ata që nuk duan në punë, të dalin nga krahu tjetër. - Jo, - i thashë. - Atë nuk e bëjmë. Ejani brenda dhe sqarohuni me të gjithë.

Patëm ca debate me të, aty. Në këtë kohë futet, Hajriu edhe i thotë: - Unë jam Hajri Pashaj. - Aaaa, ti je i biri i Zenelit, që ka vvarë pleqtë edhe plakat e...? -Jo, jo, - ia ktheu ai, - Unë jam i biri i

Zenelit, që ti i mbaje frerin e kalit, të kujtohet? E ke harruar, siç duket. U thanë edhe ca fjalë që këtu nuk mund të thuheshin, sepse nuk kemi pse i themi". I thotë Hajriu: - Atëherë, nesër në mëngjes do të më shikosh! I them: - Hajde, Hajri, të ikim, se kjo punë nesër ka gjak!

Zbritëm poshtë. Erdhi darka. U ngritën, u organizuan, po unë nuk kam marrë pjesë në atë organizimin e flamurit. Atje ishin Bedri Çoku, Gjetë Kadeli, Mersin Vlasi, që ka vizatuar flamurin dhe që e kisha shok, se haja bukë me Mersinin. Ishin edhe të tjerë, por nuk i mbaj mend emrat. Nuk e di sa mijëra plumba janë gjuajtur gjithë natën për ta rrëzuar, si nuk e kapi një, as sa t'i bënte ndonjë vrimë flamurit. E ruanin dy vetë, një Shuaip Seiti, është ndarë nga jeta dhe Ndrec Çoku nga Mirdita. Ata ndenjen pranë flamurit të mos e hiqte njeri deri në mëngjes... Në mëngjes pastaj e morën, e palosën dhe e ruajtën. Nuk e di se kush e mori atë dhe ku përfundoi. Ndërkohë, nisi sulmi nga të katër anët. Erdhën forca speciale me GAZ lotsjellës. Kampi ishte i rrethuar i gjithi. S'kishim çfarë të bënim më. Ne kishim vetëm duart, nuk kishim gjë tjetër... U futën edhe merreni me mend se çfarë reprezaljeje kanë bërë...trup më trup, duke u hedhur mbi policinë. Ata ishin leva hekuri. Të fundit në tarracë mbetën Dashnor Kazazi, Jorgo Papa dhe Dervish Bejko që është pushkatuar edhe ai. Unë dyshoj për Dervishin, që e kanë nxjerrë të vdekur. Ai ishte i dënuar me dymbëdhjetë vjet. Mbaj mend që atë e kanë nxjerrë me barelë. Nuk jam shumë i sigurt më tej.

Na kapën, na lidhën duart prapa me hekurat e gjermanit, që fillimisht shtrëngoheshin me vida, më pas me tela. Unë isha lidhur me një shokun tim. Hajriu e kisha afër. Kisha marrë me vete ujë, një peshqir dhe cigare, nja pesë paketa. I dhashë Hajriut një paketë, një peshqir, i dhashë edhe një pagurë ujë, se nuk kishte marrë. Kur na rreshtuan të gjithëve aty sipër, te vendi që ata e quanin zona e ndaluar, futet Feçor Shehu. Ishte një prag kështu, si trotuar. Ai ishte në këmbë, ne të gjithë të ulur. Fjalët e para të tij: - Ku janë ata që më thanë "Hajde poshtë"? Arrestojini! Na kapën, por për mua nuk po gjenin çelësin. Një polic i shkurtër, më pyeti për vëllain dhe më tha që ishte komshiu im, por unë nuk e njihja. - Do t'ju rrahin keq! - tha. Si tani më kujtohet që u gjend çelësi im, por derisa u gjend çelësi ishte plotësuar

dymbëdhjetëshja edhe i kishin çuar atje. Paulinin, Hajriun, Dervish Bejkon, Sami Dangëllinë i morën kot, se nuk kishin bërë asgjë. Samiu ka bërë 45 vite burg. Varrin e ka në Tufinë. Gjithë burgun e kam kaluar bashkë me Samiun. Edhe Hodo Sokoli e Pal Zefi, që u dënuan.

Dymbëdhjetë vetë u dënuan me gjyq special, katër prej tyre u dënuan me pushkatim. Gjyqi u bë rrufe. Ne të tjerëve na hipën nëpër makina edhe na sollën në burgun e Tiranës. Në makinë na futën të lidhur, siç i kishim duart mbrapa edhe me litarë të lidhur me njëri-tjetrin, që të mos kishim ku të lëvizim.

Brenda ishin shtatë-tetë policë, të pajisur me bishta kazmash. Atë tendën nga mbrapa e lanë hapur. Po të ngrije pak kokën që të shikojë jashtë, e haje atë bishtin e kazmës me të rënë në kokë, e pa le kur vije në vete, mbas ndonjë gjysmë ore, apo nuk ishte edhe ajo rruga e Spaçit deri në Tiranë shumë e keqe. Kur arritëm në burg, na godisnin me shkelma dhe jemi ngatërruar me njëri-tjetrin, se ishim të gjithë të lidhur. Nuk e kam marrë vesh si jam ngjitur në kat të dytë. Nuk e di, me grushte, me shkelma, me shkopinj. Atje ishin mbledhur të gjithë shefat e hetuesisë së Republikës, të gjithë kryetarët e Degëve që të bënin hetuesin me ne. Hetuesia vazhdoi nja dymbëdhjetë-trembëdhjetë ditë, natë e ditë, por natën ishte e tmerrshme, se kërcisnin rrahjet nëpër korridor. Ishte pezulluar e gjithë hetuesia e Republikës. Atje ishin të gjithë.

Më morën që natën e parë dhe më çuan, si i thoshin ata, te dhoma me "kolltukë". Aty hetues kisha Medi Bushatin, kryetar dege i Lushnjës. Ishte edhe Muço Saliu, shef i Sigurimit të Shtetit. Na lidhën në karrige dhe nuk kam marr vesh gjë hiç, më mbrapa. Erdhi Muço Saliu dhe më tha: "Hë, mor ti, do të tregosh?" Më ishin bërë buzët gjithë gjak. Duart i kisha të vdekura.

Nuk flisja dot. Dhanë urdhër të më çonin te njëshi. Se çfarë ishte "njëshi", nuk e dija. Më çuan në birucë. Isha vetë i katërt. Të dytin, morën një nga Burrelit, burrë i mirë, plak i vjetër mbi gjashtëdhjetë vjeç. Kur erdhi i ziu, me duart në kokë. Oh, nëne... oh, nëne...! Merre me mend, torturën që kishte kaluar.

Çfarë formash dhune, përdorën?

Nuri Stepa: Teknika e tyre e dhunës ishte fiks si në ato filmat me mafie që torturojnë. Pasi mbaruam këtë hetuesinë në Tiranë, na futën të gjithëve nëpër biruca, na ndanë dhe po prisnim të zhvilloheshin gjyqet. Gjyqet bëheshin në Rrëshen. Ne ishim grupi që na quajtën si grupi i "Inteligjencës" dhe ishim gati pesëmbëdhjetë vetë. Ishim të parët që na çuan në Rrëshen.

Gjyqi zgjati gjashtë ditë. Ishim pa larë, me pantallona të grisura, pa këpucë, pa ngrënë. Hekurat na ishin futur nëpër duar, aq sa edhe sot e kësaj dite, më dhemb gishti kur punoj. Kryetar gjyqi ishte Filip Plaka. Dukej që nuk ishte burrë i keq. Prokuror ishte Zef Deda, prokuror i Rrëshenit, më i keqi. Ky, sapo hyri në sallë, ngriti supet edhe tha se nuk kishin çfarë të bënin dhe që do të na dënonin, domethënë kishin marrë urdhër. Dëshmitarët na i sillte operativi. I fuste aty dhe fillonin flisnin siç i mësonte ai. U dha vendimi, neni kaq e aq dhe na shkante gati 90 vjet burg, por e futën në një nen zbutës dhe dënimet, shkuan 12-15 vjet.

Gjatë kohës në hetuesi, ne ishim nja 7-8 vetë. Një ditë i rashë derës dhe u them këtyre çunave që na sillnin bukën çdo vakt, me një copë djathë, se desha të flisja me komandantin, nëse kishte mundësi, edhe i shkela syrin policit. Erdhi komandanti, kryetari i Degës atje. I thashë që kishim bërë shumë burg dhe ishim shumë të vuajtur e të rraskapitur. Iu luta të na sillte ndonjë lugë ujë, se nuk hahej dot buka, na kish ngecur në fyt. E pashë, se i erdhi keq. Më tha që ishte përpjekur për më mirë, se nuk kishin mensë, vetëm ta merrnin nga jashtë. Pas nja tre ditësh, na sollën gjellë restoranti.

E bëri kryetari punën e vet. Na shpëtoi të paktën, ato dy-tri ditë, pastaj na ndanë prej aty dhe një pjesë e çuan në burgun e Burrelit. Ishim shumë të dërrmuar. Mua më çuan në Spaç. Oh, nëne... oh, nëne... Spaçi ishte i tmerrshëm, në atë kohë. Ishte tmerr! Nuk lëvizte as edhe një mizë. Kampi ishte i dënuar dhe i dënuar keq. Nuk të pyesnin më, të sakatonin. Kishin bërë një gropë me ujë aty, një gropë gëlqereje e kishin mbushur me ujë dhe mbrapa kishin vendosur ca thasë me rërë dhe një dërrasë njëpondëshe me gozhdë. Në një dhomë aty ngjitur kishte vegla nga "mesjeta" dhe me ato të torturonin. Të nxirrnin atje lart, të fushnin në ujë sa të zhyteshe në të, nëse nuk doje të vinin

këtë dërrasën e të shkelnin me këmbë. Policët të bënin telef, deri sa duhet të vinin shokët të të merrnin, se ndryshe nuk lëvizje dot. Ky ishte terrori i kampit, në atë kohë...

Unë nuk pata fatin të rrija shumë aty. U konfliktova një herë me operativin e burgut dhe mbas një muaji më dërguan direkt në Burrel. Pas kësaj e kam kryer të gjithë burgun në Burrel, deri në 1986, pra nga viti 1973.

Sa vjet ju dënuan për revoltën e Spaçit?

Nuri Stepa: Trembëdhjetë vjet...

A kishe ndonjë informacion për ata që u pushkatuan?

Nuri Stepa: Jo, gjatë kohës që isha në hetuesi, nuk kam takuar njeri. Natën e parë, atë natë që na sakatuan që nuk e harroj kurrë, erdhi Kasëm Kaçi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me ca fotografi. Hyri brenda edhe na tha: "Ore, kam parë, nuk kam parë, trim djalë, si ai Skënder Daja. Deri në momentin e fundit që është shtrirë për tokë nga plumbat, vetëm duke sharë".

Edhe na tregoi fotografitë e të pushkatuarve. Nuk e di ku gjenden. I kanë zhdukur. Nuk i kanë gjetur. I kam parë fotot. Ka qenë zall lumi. I kam parë me sytë e mi, se m'i kanë treguar që të katërt, tek e tek, siç ishin të pushkatuar. I kam parë që natën e parë. Ua kanë treguar të gjithëve këtyre që vinin. Kjo bëhej për terror.

Kur i keni parë gjallë për herë të fundit?

Nuri Stepa: Për herë të fundit i kam parë atë ditë që i morën dhe i çuan në gjyq special. Na morën edhe neve nga kampi. S'i kam parë më. Shokët që kanë qenë në gjyqin special, siç më tregonte Paulini, edhe ata nuk kanë parë gjë, sepse edhe ata i kanë marrë me autoburg. Këta të katërt i kanë marrë me autoburg veç dhe tetë të tjerët me autoburg tjetër. Njërin palë e kanë dërguar për në Burrel, kurse ata për në Rrëshen edhe nuk dihet, as ku i kanë pushkatuar, ku i kanë vvarë...

Ma merr mendja se buzë Fanit. Mund t'i kenë varrosur aty ose mund t'i kenë copëtuar. Zoti e merr vesh!

Çfarë roli luajtën në revoltë, ata që u pushkatuan?

Nuri Stepa: Nuk është se kishin ndonjë rol, apo ndonjë gjë të ndarë. Skënder Daja doli dhe u bëri thirrje ushtarëve të dorëzoheshin, u thoshte: "Jemi vëllezërit tuaj". Pal Zefi, ishte ai i pari që doli nga birucat... Dervish Bejko, rezistoi dhe u përlesh me policinë, kur u lidhëm ne... Hajri Pashaj, po dihet, që u përball me Feçorrin, në atë moment. Ai ia mbajti inatin si duket ngaqë e kishte edhe nga fshati i vet e të gjitha të tjerat edhe kështu e pushkatuan edhe atë... Këto ishin. U përball keq me atë, i tha edhe ca llafe që tani nuk mund t'i themi. Hajriu ishte djalë shumë i mirë. Të katërt ishin djem shumë të mirë, të ndershëm,.. eh, por kështu ishte koha...Ajo ishte një revoltë që... t'i ngriheshe atij regjimi në atë kohë, ishte tmerr, ishte e paparë, në një terror të madh.

Ne kishim dhe një qen që e kishte rritur Fiqiri Muho, i cili është ndarë nga jeta. E kishte marrë këlysh të vogël, nga qentë e komandantit Çelo Arza, i cili mbante zagarë për gjueti.

Njërin prej tyre e mori Fiqoja, e rriti edhe u bë qeni i madh. Iu bë këmba, sa dora ime. Kur ngrihej mbi të dy këmbët, të rrëzonte. Ai i shoqëronte të burgosurit. Kur merrte turnin njëri grup, i çonte deri në një farë vendi lart, pastaj merrte tjetrin kur vinte poshtë. Këtë punë bënte ai. E ushqenim të gjithë. Sa e thërrisnim, vinte të jepte dorën si njeri. Meqë ai iu hodh policisë, e dënuan me vdekje edhe e kanë varur mu te porta e hekurit...

Po në lidhje me punën, normën shumë të lartë, kushtet e rënda të punës a paraqitët kërkesa gjatë protestës?

Nuri Stepa: Puna ishte shumë e rëndë. Nja dy herë, pati tentativa për t'u arratisur nga kampi. Njerëzit nuk donin më të punonin, por të mos punoje në Spaç, do të thoshte të të lidhnin pas shtyllës me tela me gjemba gjithë natën, pastaj të të dërgonin në birucë, të të merrnin prapë e të të çonin te shtylla. Kishte nga ata shokë, që u thoshin: "Mos puno, por të paktën rri këtu!", se lidhja pas shtyllës ishte torturë e madhe. Atje shkonte -20gradë. Në Spaç ishte i ftohtë i tmerrshëm.

Kur ktheheshim në kapononë, i kishim këmbët qull

brenda në çizme dhe gjithnjë vinte erë e qelbur... Jeta ishte shumë e vështirë, shumë, shumë e vështirë. Spaçi ka qenë tmerr, nuk e di, por si ato kampet e Mathauzenit, origjinal ashtu, por jo për një ditë, nuk ishte një vit, por ishte me vite.

Na tregoni pak, çfarë pune bënit në Spaç?

Nuri Stepa: Në fillim fare, një periudhë kam punuar në sallë të motorëve, motorët që fusnin ajër në minierë, meqë isha specialist. Edhe shofer kam qenë. Isha në zanat. Më pas, menduan dhe bënë kampin. Kishin ca makina të vjetra, ZIS dhe transportonin trupa nga njëra zonë në tjetrën, se ishte territor i madh. Kishte pjesë këmbimi dhe e ngritëm ofiçinën.

Ca kohë e mora unë ZIS-in dhe punoja nga një zonë në zonën tjetër. Se kush më raportoi dhe u kishte thënë që do të rrëzoja postbllokun, me atë ZIS-in. E çuan makinën në parkun e Rrëshenit, ku e mori një polic nga ata që ishte këtu tek ne. Sa kishte marrë patentën! U rrëzua me atë ZIS, lëmsh u bë... Më pas punova si minator. Krijoja hapësirat ku do të bëheshin birat me pistoletë elektrike, që shpërtheheshin dhe krijonin material për të punuar me vagonë.

Kush vinte për t'ju takuar, në Spaç?

Nuri Stepa: Nëna ime vinte edhe në kampin e Elbasanit, edhe në Spaç: një herë vinte me vëllanë, një herë me motrën. Në Burrel vinte shpesh e shkreta. Pastaj, nuk erdhi më dhe unë nuk e dija fare pse.

Pas tre vjetësh e kam marrë vesh hallin: i kishin gjuajtur kalamajtë me gurë dhe i kishin nxjerrë njërin sy dhe ashtu ka ngelur me atë sy. "Po shkon te armiku," i thoshin ata. Ashtu i kishin mësuar edhe kalamajtë...

Sa zgjaste takimi me nënën? A ishte i njëjti minutazh në Tiranë, në Spaç, në Burrel?

Nuri Stepa: Takimi aq ishte: një sportel i vogël pas derës, 5-10 minuta, fusnin ushqimet. Një periudhë ka qenë në Burrel një polic. Kishin një kazan, i hidhnin të gjitha ushqimet aty në atë kazan, i përziente të gjitha me dorë edhe ia jepte qenit t'i lëpinte. Pas kësaj të thoshte t'i merrje. Po

çfarë ushqimesh, të merrje aty? Ato ishin përzier të gjitha, si çorbë derrash. E kupton? Deri këtu kishin arritur. Burreli ka qenë më i tmerrshëm për këto...

Letrat që dërgonin familjarët, a ua jepnin?

Nuri Stepa: Po, m'i jepnin, por të kontrolluara. Edhe kur i shkruaje, t'i censuronin. Unë nuk shkruaja shumë. I bija shkurt, pyesja çfarë kisha për të pyetur. Kështu ka qenë, regjim i keq!...

Kur e përfunduat kryerjen e dënimit?

Nuri Stepa: Unë e kam përfunduar në Burrel. Atje kam bërë 15 vjet.

Në cilin vit u liruat?

Nuri Stepa: U lirova në vitin 1986. Në janar, ishte bërë amnistia unë kisha edhe pak, mund të kisha një muaj a një muaj e ca, për t'u liruar, edhe i vetmi që jam liruar nga burgu i Burrelit, isha unë në atë kohë...

Si jeni ndier pasi dolët nga dënimi? Po momentet e kthimit në familje?

Nuri Stepa: Ishte dimër. Kur dola, dëbora ishte deri në brez në Burrel. Më nxorën te porta, madje më ka shoqëruar komandanti i burgut deri te porta e jashtme. Kishin ardhur autobusët, e Tiranës. Na sollin e na la te "Zogu i Zi", pastaj mora rrugën në këmbë, deri te posta. Bëra një telegram dhe njoftova shokët. Shtëpinë time e kishin prishur dhe aty sot është *Torre-Drini*. Familjes i kishin dhënë shtëpi te "Nëntëkatëshet". Në shtëpi, gjeta nënën dhe babain. Kur u zgjova, natën e parë, nëna më thoshte: "Më dukesh si i huaj, more bir..!" Ishte tmerr!

Kur dolët nga burgu, a filluat punë?

Nuri Stepa: Po, fillova direkt punë. Në fakt, nuk rrija dot pa punë. E para punë që bëra, bleva një biçikletë, ta kisha njëherë, të lëvizja, të kisha kontakte me njerëz. Fillova punë në transport.

Pas rënies së sistemit, kur u shkatërruan, apo u privatizuan ndërmarrjet ekonomike, ku keni punuar, në privat apo në shtet?

Nuri Stepa: Në shtet, nuk e ndryshova, vazhdova deri në vitin 1997.

A merrni ndonjë shtesë pensioni, si ish-i dënuar?

Nuri Stepa: Unë marr shtesën, si minator. Vetëm atë na kanë dhënë, si minator.

Po banesë, a ju kanë dhënë?

Nuri Stepa: Po kam marrë një banesë, nga Shoqata e të Përndjekurve e kam marrë.

Ku jetoni sot dhe cila është përbërja e familjes suaj?

Nuri Stepa: Unë jetoj në "Kinostudio". Kam një djalë, kam dy në fakt, por njëri është i gruas që kam marrë, kurse tjetri është djali im.

A keni përfituar ndonjë rimbursim, për shkollimin e fëmijëve, nga shteti?

Nuri Stepa: Kur ishte Shoqata, nga shteti kam marrë një dy herë, në kohën që djali ishte në universitet, pastaj një vit e prenë dhe nuk e di pse.

Çfarë politikash rehabilituese mendoni se mund të përdoren më tej, për ju si ish-të dënuar politikë?

Nuri Stepa: Mendoj që duhet t'u rritet pensioni të burgosurve që kanë ngelur. Pensionet tona janë shumë të vogla. Sot ende ai që mua më ka rrahur me dru, merr 700 mijë lekë¹¹ rrogë, kurse ne që jemi rrahur nga dora e tyre, nuk marrim asgjë.

A ruani artefakte, kartolina, letra, fotografi nga jeta në burg?

Nuri Stepa: Po kam ca letra, ca relike të vogla, gjëra që i kam pasur ruajtur. Ca letra që ia kam pas dërguar nënës, ajo i kishte ruajtur të gjitha. Ato ia kam dhënë djalit të vëllait, se i ka qejf. I mbledh edhe do që të bëjë ndonjë gjë me to.

Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2290

A keni ndonjë mesazh për shqiptarët, për shtetin, brezat e rinj, lidhur me të gjithë përvojën tuaj në këtë histori?

Nuri Stepa: Mesazhi im është që rinia të mos ikë nga vendi. Mund të thotë dikush, që edhe ti, a nuk tentove? Ajo kohë ishte e keqe edhe të ikje, nuk bëje keq. Por sot, rinisë i them të mos lëvizë kurrë nga vendi, të rrijë këtu, në këtë vend!

Çfarë mendoni se mund të bëhet që kjo ngjarje dhe të tilla, si kjo e Spaçit, të kujtohen nga brezat që do të vijnë?

Nuri Stepa: Spaçi, patjetër duhet të bëhet muze që ta shikojnë të gjithë, por të bëhet diçka edhe këtu në Tiranë. Të bëhet një lulishte, ku të vendosen pesë apo dhjetë emra ose më shumë, ose të vendoset edhe ndonjë relike si ajo e Spaçit, siç bëri Fatos Lubonja, pranë godinës së ish-Komitetit Qendror. Është premtuar edhe për obelisk, por nuk u bë asgjë. Të paktën, të kujtohen ato dhjetë emra, nga ata që janë pushkatuar dhe të emërtohen rrugët.

11. Shuma e parave përmendet sipas gjuhës së popullit, me sistemin e vjetër. Me sistemin zyrtar, do të ishte 70 mijë lekë.

10

10

10

10

10

10



Ndue Hoti

“Më akuzuan për mosdenoncim të veprimtarisë armiqësore...”

Ndue Hoti, i biri i Dranes dhe Vatës, lindur më 1 janar 1942, në Mamurras. U arrestua më 12 tetor 1966 me akuzën “krim ndaj atdheut nëpërmjet tentativës për arratisje”. Periudha e qëndrimit në burgun e Spaçit është, nga viti 1967 deri në vitin 1971.

Zoti Ndue a keni aplikuar pranë AIDSSH, për të marrë dosjen tuaj?

Ndue Hoti: Jo, sepse unë e di kush më ka futur në burg. Nuk jam nga ata që i zmadhojnë gjërat. Në Tepelenë kemi qenë jo në qytet, por te kazemat ushtarake që janë përdorur që në kohën e pushtimit italian për ushtarët. Aty kemi ndenjur një muaj, se nuk kishte transport për të na shpënë në Tepelenë.

Për çfarë, ju çuan në Tepelenë?

Ndue Hoti: Babai ishte marrë me lëvizjen e Fan Nolit, bashkëpunëtor me Luigj Gurakuqin dhe në kohën e Zogut u detyrua të arratisë për në Itali. Babai ishte i fejuar në Grudë dhe për këtë arsye, nuk donin fillimisht ta merrnin me vete, mirëpo nga

një anë ishte kundërshtar i Zogut, nga ana tjetër ishte i dënuar nga serbët. Kështu që vendosën dhe e morën në Itali.

Ishin në Bari. Atje takoheshin, pinin kafe me Luigjin e me shokët e tjerë. Një mëngjes, ndërsa po shkonte për te vendi ku takoheshin gjithnjë, dëgjoi një krismë pistolete. Shpejtoi hapin dhe pa një djalë të ri që kaloi bulevardin për në krahun matanë. Kur u afrua, pa Luigjin të shtrirë. Ishte ende gjallë dhe e kapi për dore. Në frymën e fundit, Luigji i pati thënë: “Vëlla, ti kthehu në Shqipëri!” Edhe vdiq. Babai u kthye në Shqipëri, ndenji ca kohë i arratisur në një shpellë, pastaj me ndërhyrjen e një miku, u dorëzua me kusht edhe bëri 6 muaj burg, në kohën e Zogut. Pasi u martua u vendos në Mamurras, ku ndërtoi shtëpinë dhe kishte 25 dynmë, vetëm bahçe. Pak më lart është shtëpia e vjetër. Motra e babait ishte fejuar me Gjon Pironin, që është varur në Milot. Ishin dy vëllezër të arratisur këta: Mark Pironi dhe Gjon Pironi.

Në gusht të vitit 1949 na konfiskuan shtëpinë. Na futën njëherë te shtëpia e Mustafa Merlikës,

“Një dëshmitar që, për të shlyer një borxh dymijë e tetëqind lekë, më futi mua në burg.”

në Krujë. Poshtë, në katin e parë, në bodrum ishte bërë si burg. Tri javë na kanë mbajtur aty dhe mbas tre javëve, na kanë hipur në makinë të tipit “zis”. Dyzet vetë në një makinë të tillë deri në Tepelenë.

Si ndodhi arrestimi?

Ndue Hoti: Arrestimi im ndodhi në 12 tetor 1966, te lokali te sahati. Kamerieri vjen e më thotë që më kërkonte dikush. Kur dal unë, shoh zotërinë, Medi Bushatin. E kisha parë kur luante me Dinamon, por s’më shkoi mendja për momentin, që ishte aty për të më dënuar, kur ai më thotë mua: “Në emër të popullit, je i arrestuar!” E ndërkohë, më futi krahun. Lokali ishte afër shtëpisë dhe më njihnin nga të gjitha anët. Prej njerëzve, i thashë: “Nuk ka nevojë të më futësh krahun, o burrë!” Më morën e më futën brenda një makine, rrethuar tre vetë në një anë e tre të tjerë, në anën tjetër.

A e kishit ndjerë se po ju përgjonin dhe përndiqnin?

Ndue Hoti: Po, nja dy-tri javë përpara, ndërsa po pija në lokal, hyri një fotograf dhe më nxori në foto. Mua më dogji kjo punë, e kupton? Mendova ta shoh këtë punë, por nuk ishte fotografi që e njihja, se ma bëri fotografinë tinëz. Po ashtu, një mbrëmje, një shoku im nga Kosova, gjoja me shaka, më gjuajti në trup, por në fakt përpiqej të shihte nëse kisha armë apo jo. Ky preku diçka,

por nuk ishte armë, ishte thikë. Edhe në një rast tjetër, kur isha në ndërmarrje në Laprakë: hipa në autobus, për t’u kthyer në shtëpi. Dikush i ra xhamit. Unë ktheva kokën dhe ata më fotografuan. Pikërisht atë natë më arrestuan. Faktikisht, unë isha në shënjestër, se familja jonë ka qenë cilësuar armik i popullit. Vëllain e kisha në burg dhe shkoja nga Tirana ta takoja në burg.

Pandeli Përmeti, kolonel në atë kohë, kryehetues i Ministrisë së Brendshme, më thoshte mua: - Ç’ke dashur këtu... ç’ke dashur atje? Pse shkon në *Dajti* dhe pi dy mijë lekë fërnatin? Unë ia ktheja: - Pse, ça kanë të tjerët më shumë se unë, që të mos shkoj dhe unë?”

Sa kohë qëndruat në hetuesi?

Ndue Hoti: Më arrestuan në 12 tetor të vitit 1966 dhe u dënova më 23 tetor 1966 në Durrës.
Cila ishte akuza kundër jush?

Ndue Hoti: Akuza ishte neni 64/10/14 për mosdenoncim i veprimtarisë armiqësore dhe Pandeli Përmeti nuk kishte asnjë fjalë, asnjë send. Atëherë, nxorën dëshmitarë dy shokët e mi dhe ata i treguan të gjitha.

Gjatë kohës që keni qenë në hetuesi a ju kanë sjellë ndonjë njeri, për t’ju provokuar? A ju kanë kërkuar të bëheshit bashkëpunëtor?

Ndue Hoti: Jo, gjatë kohës së hetuesisë, jo. As gjatë kohës që kam qenë në burg nuk më kanë kërkuar. Mbasi më kanë liruar, më kanë kërkuar shprehimisht kështu: “Ndue, kemi nevojë për ty. - Për çfarë?” Edhe më thanë që, meqë unë kisha shokë filanin edhe filanin, se pata bërë ushtrinë me të dy, kërkonin të nxirrja ndonjë gjë prej tyre. U çudita, çfarë materiali duhej të nxirrja unë prej tyre. Se unë po ta shihja dikë të digjte fermën ose të dëmtonte oficinën, do ta ndaloja patjetër, se nuk më linte ndërjegjja. Por, se çfarë kishte ndërmend tjetri, si ta bëja këtë?

Gjatë kohës që keni qenë në hetuesi, a ju kanë dhunuar, keqtrajtuar?

Ndue Hoti: Më merrnin në hetuesi, rreth orës 11-12 të natës, asnjëherë ditën. Hetuesia zhvillohej te burgu i vjetër dhe fiks kur na kapte gjumi, atëherë vinin na merrnin në hetuesi. Më kanë marrë 3-4 herë në pyetje, por nuk më kanë prekur me dorë.

Gjatë kohës që ju merrnin në pyetje, a kishte persona të tjerë të pranishëm, përveç hetuesit?

Ndue Hoti: Asnjë tjetër.

Sa kohë ka zgjatur gjyqi?

Ndue Hoti: Gjyqi ka zgjatur dy ditë. Më morën nga Tirana, më çuan në Durrës dhe aty akuzën e mbushën siç ua kishin vënë disa durrsakëve, për mosdenoncim veprimtarie armiqësore. Brenda në hetuesi kam patur një Ylli Leka, inxhinier. E kisha të njohur që përpara unë, ishte me përbërje të mirë politike. Unë kam ndenjur me të dhe absolutisht, asnjë fjalë s'më ka dalë prej tij.

Familja juaj a ju erdhi gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor?

Ndue Hoti: Jo, jo asnjë prej vëllezërve, as babai nuk e dinin se ku isha. E dinin që më kishin arrestuar, por nuk e dinin që më kishin transferuar nga Tirana në Durrës. Atë kohë isha i martuar dhe as gruaja ime nuk e dinte se ku isha unë, ndërsa u bënë dy ditë gjyq.

Sa vjet ju dënuan?

Ndue Hoti: Dhjetë vjet.

A ndodhi gjë me familjarët dhe të afërmit, mbasi ju dënuan?

Ndue Hoti: Për fat, asgjë. Gruaja nuk kishte marrëdhënie pune në shtet, se ne ishim në burg të gjithë: babai në burg, vëllai në burg edhe unë në burg. S'kishin çfarë të bënin tjetër më, se i kishin marrë masat.

A mbani mend me detaje, kur ju kanë marrë për t'ju çuar për në Spaç?

Ndue Hoti: Fillimisht, isha në burg të Tiranës, pastaj më çuan në Elbasan. Aty kam gjetur vëllain. Kurse në Spaç kam shkuar në vitin 1971, se në vitin 1968 u shkri burgu i Elbasanit. Aty më ka bërë përshtypje një i burgosur, Ali Maliqi, “babai i burgut”, siç e thërrisnin të gjithë të burgosurit.

Aliu ishte arrestuar menjëherë pas çlirimit, nja dy-tre muaj, kur kishin dorëzuar batalionin në Dibër. Faktikisht, atij i erdhi lirimi, mirëpo pas liritimit e mbajtën edhe pesëmbëdhjetë ditë brenda, pa e nxjerrë as në punë. Ne punonim për ndërtimin e Fabrikës së Çimentos në Elbasan. Ai kërkonte të dilte në punë. Edhe një ditë doli. Mbaj mend që ishin armaturat e fabrikës dhe Aliu po hipte nëpër shkallë, për të vazhduar punën. Hipi ky, kur dikush me një shami në kokë dhe një hekur të madh tetëdhjetë e dy i gjatë, i bie dhe Aliu u rrëzua, ra poshtë nga katër metra lartësi. Aty sa kishte ardhur një skodë me tulla. E morën përnjëherë dhe e nisën për në Elbasan. I kam parë me sytë e mi, trutë që i kishin dalë. Vdiq. Ali Maliqi kishte ardhur në vitin 1945 dhe kishte bërë 22 vite burg. I kishte kryer ato vite dënimi dhe priste të lirohej. Mirëpo e vrau një bashkëpatrioti i vet për një konflikt që kish ndodhur mes tyre. Pavarësisht se familjarët sot thonë që e ka vrarë Sigurimi, unë di që e ka vra ky personi, se isha në një kaponon me të.

Çfarë keni ndier kur keni hyrë për herë të parë në burg?

Ndue Hoti: Ndjesia ime e parë, të them të vërtetën, shihja ku të gjeja mundësi ose të arratisesha, ose të vrisja veten. Ky ishte mendimi im i parë. Në Patos, gjeta një shok që e kishte pasur babai në burg, Ymer Naçi edhe, duke bërë muhabet me të, një shoku im e pyeti sesi ia kishte

dalë për gjithë ato vite burg. I thotë ky: “Shiko, ti, djalë, mos u mërzit! Deri në 16 vjet e 6 muaj e 24 ditë kalojnë, por pjesa tjetër nuk kalon. Aty kuptova unë sesa burg kishte bërë i shkreti dhe sesa kishte për të bërë.

Si ishin kushtet e dhomës në burg?

Ndue Hoti: Kapanon, si stallë bagëtish. Dy kate, rresht dyshekët, ngjitur me njëri-tjetrin.

Çfarë pune keni kryer në burg?

Ndue Hoti: Punëtor. Në Vlorë hapja kanale.

A kishte rregulla pune?

Ndue Hoti: Me thënë të vërtetën, kemi pasur një inxhinier që kishte studiuar në Poloni, që na thoshte vazhdimisht, në galeri “Kujdes, mos i hiqni kapelat!” Dhe vërtetë, një shokut tim, Kim Bashës, siç kishte hequr kapelën, i ra përsipër materiali, e goditi në kokë dhe vdiq.

Kurse në Spaç, për sa kohë punova unë, deri ditën që jam liruar, në 12 tetor 1976, një i burgosur është vrarë me mina. Janë plagosur Ali Bana, me dy shokë të tjerë, se u ka plasur lënda e eksplozivit, që kishte mbetur pa plasur në kohë. U vra edhe një teknik, Iliri. Më mbrapa, janë vrarë dhe dy-tre të tjerë. Ne punonim me tre turne, nga 8 orë. Ushqimi i burgut, të themi të drejtën, ishte vështirë të hahej, sepse uji kishte acid si uji që pinim, edhe ai që gatuanin ushqimin. Ndotëj nga galeritë, por ne shpëtonim me ushqimet nga familja.

Gjatë kohës së dënimit a ju kanë fyer, dhunuar, keqtrajtuar?

Ndue Hoti: Mbjaj mend një rast: isha në Vlorë, punoja brenda në një kanal që kishte 15 cm ujë. Ishte tokë kënetore me ujë. Ne hapnim kanalet për kriporen, se po rregullohej kriporja në atë kohë. Punonim me normë. Që të hapnim kanalën, ngrinim prita me llucë në të dy krahët, si pengesë

dhe me lopatë hiqim ujin. Vjen një kapter Murati, më sheh mua teksa punoja e më thotë: “Pse, rri?” Vjen oficeri, më kap, më lidh duart mbrapa me hekura e më thotë: “Dil aty!” Mirëpo atje ku thoshte ai, ishte piketa e rrethimit. Rreth tridhjetë-dyzet metra më tutje, kishte roje me mitraloz. Po të shkoje atje, ushtari kishte të drejtë të të gjuante. Unë e kundërshtova: Jo, nuk dal atje! Dha urdhër e më lidhën në argjinaturë. Argjinatura ishte e veshur me gurë. Në një anë ishte deti, në anën tjetër ishte kënetë. Ishte diell. Hekurat më kishin hyrë në duar.

Dikur u kujtua, erdhi e më zgjidhi. Kur m'i sheh duart, i thotë një shokut tim, të m'i fuste në ujë deti të kripur dhe t'u bënte masazh. Kjo ishte me leje të kapter Muratit dhe Sami Shehu e bëri këtë punë. Pastaj, më kanë futur në birucë. Në qoftë se nuk e realizoje normën 225% ishte minus. Vetëm kur e realizoje mbi 225 % ishte në rregull.

A mund të na tregoni ndonjë gjë që e mbani mend nga revolta në Spaç?

Ndue Hoti: Kur nisi revolta e Spaçit, kam qenë turni i dytë, duke u nisur për punë. Ishin dy vëllezër: Pal Zefi dhe Gjokë Zefi. Gjoka kishte një peshqir në qafë dhe i thotë kapteri hiqe. Ai nuk pranon dhe për kundërshtim e kthyen mbrapsht, dhe e futën në birucë. Pal Zefi ishte prej ditësh, në birucë. Shkon polici, i hap derën. Pali i thotë: “I kam mbushur tridhjetë ditë”. Ai i thotë: “Jo, nuk i ke mbushur”. Pal Zefi del nga biruca dhe vjen në oborr në kamp. Vijnë kapterët, e marrin me zor, ta kthenin në birucë që të plotësonte dënimin, se nuk e kishte mbaruar dhe i thanë: “E plotëson nesër”. Ky kundërshtoi dhe nisi përlëshjen. Njëri me emrin Syrja, zbriti vrap shkallëve dhe bërtiti: “Ecni, se do na mbysin në hu!” Atëherë kërcyen të gjithë njëherësh dhe plasi rrahja me policët.

Filloi përlëshja. Unë kisha gjurin të vrarë dhe ecja me patericë. Më thonë shokët: “Ndue, dil, se u bë nami”. Dola në katin e parë. Aty ishte operativi i Sigurimit. Dikush e goditi dhe operativit të Sigurimit i shkoi kapela rrotull. Vendi ishte me

pjerrësi në zbritje dhe duke zbritur të gjithë i binin me shkelm. Aty ishte edhe qeni. E kam parë me sytë e mi, që edhe qeni iu hodh kapterit në qafë. Kapte atë, jo të burgosurit. Pastaj ikën, u zhdukën, dikush nga porta e punës, dikush nga porta sipër. Pastaj plasi revolta: te pallati trekatësh, më tej te sheshi me magazinë, ku mbanin ushqimet...

Sollën roje dhe e rrethuan gjithë vendin. Në darkë, hidhnin ndriçuese për të parë. Erdhën makina ushtarake dhe u rrethua i gjithë vendi, rreth e rrotull.

Kohë më vonë një i njohur, brigadier, ish-komunist, vendali aty, na tregoi se kishte dëgjuar që kur Feçorr Shehu, shkoi direkt në Tiranë. Përfundimisht, prenë ujin dhe ushqimin. Kishim vetëm ushqimin tonë. Sesi u katandisëm ato ditë... Dikush kishte një fije uji. Kuzhina punonte me çfarë kishte brenda, konsumuam edhe ujin që ishte te çisterna. Skënder Daja që e kanë pushkatuar, më i vogli, më i riu, futi ca lopata brenda në dhomë. E pyeta, se çfarë po bënte. Po përgatiteshin për rezistencë. Të tjerët që nuk u bashkuan, u përpoqën të shpëtonin secili për vete. Gjon Milloshi shkoi mori një fuçi e ktheu sipër dhe u fut brenda në të. Met Kallashi, dentist, shkoi u fut në furrë dhe u fsheh atje. Por edhe atje shkuan, kërkuan dhe e gjetën.

Ditën e tretë ata hynë brenda. Erdhi shefi i policisë Kasëm Kaçi dhe na nxorën të tërëve dhe na mblodhën te fusha e volejbollit. Lart te tarraca, vendi ishte i rrethuar. Pastaj hynë edhe andej, i kanë marrë dhe i kanë nxjerrë. Neve na lidhën me hekura e zinxhirë dhe i hodhën çelësat.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Sulejman Manoku, i mori njerëzit në pyetje sesi ndodhi. Mori nja dy, i futi në birucë. Unë isha bashkë me Fadil Dushkun. U pushkatuan katër vetë: Hajri Pashaj, Skënder Daja, Pal Zefi dhe një i katërt, që ishte nga Pogradeci, por s'më kujtohet emri. Skënder Daja ka qenë shumë aktiv. Janë ridënuar 72 veta. Unë, jo.

Kur e keni përfunduar burgun?

Ndue Hoti: E kam përfunduar në mars të vitit 1977. Kur dola, shkova në Mamurras. Për ditën e lirimit, më prisnin shokët për darkë.

A i keni takuar ndonjëherë ata që ju kanë dalë dëshmitarë në gjyq?

Ndue Hoti: Atë që më doli dëshmitar e kam takuar te "Bar Sahati". Më pa dhe u ul aty. Më ftoi të pinim një gotë raki. Unë isha duke pirë birra, sepse sa isha liruar prej burgut dhe e pyeta çfarë po bënte, por nuk po më njihte. - A e ke njohur filanin? - e pyeta. - Po! - tha. Fliste gjysmë shqip e gjysmë serbisht se ishte malazez, por me origjinë shqiptare.

- Bëra denoncimin - tha, - se pata frikë, se do të më fusnin në burg. - Po për tironsin? - e pyeta. - Si është puna? - Tironsi, - tha, - pa faj. Faktikisht edhe në burg, s'ka bërë kurrë gjë! Më vjen keq për të. - Ai tironsi, jam unë! - i thashë. A të kujtohet që ke ardhur dëshmitar, me Ilmie Kajen? Ilmie Kajo ishte infermiere dhe me të, patëm udhëtuar deri në Korçë.


U pre. Tha që denoncimin e kishte bërë për 2800 lekë, se i kishte borxh. Kishte shkuar dëshmitar dhe kishte thënë se ne do të arratiseshim nga Pogradeci. Kjo është e vërtetë 100%, vetëm për të zhdukur borxhin 2800 lekë.

Keni krijuar familje?

Ndue Hoti: Kam tre djem edhe një vajzë. Dy djem i kam me gruan e parë, me të cilën jam divorcuar gjatë kohës së burgut. Një djalë dhe një vajzë i kam me gruan e dytë. Djalin e kam në Amerikë dhe vajza është duke vazhduar shkollën. Jam bërë gjysh.

Si i ish-i dënuar politik, a keni marrë dëmshpërblime?

Ndue Hoti: Po, i kam marrë.



Nikoll Prenga

“Duhet të pohohet njohja e krimeve të diktaturës”

Nikoll Prenga i biri i Marës dhe Zefit, lindur më 21 maj 1935, në Grykë-Orosh, Mirditë. U arrestua më 15 maj 1967¹² me akuzën “për tradhti ndaj atdheut mbetur në tentativë”. U dënua me 13 vjet burg. Kur ishte duke vuajtur dënimin, u dënua sërish. U lirua më 10 janar 1991, pas 23 vjet, 7 muaj e 26 ditësh.

Zoti Nikoll faleminderit për gatishmërinë tuaj, për të na treguar për fatin e jetës suaj si-ish i përndjekur politik dhe vuajtës në burgun e Spaçit. A jeni interesuar për të parë nëse ish-Sigurimi i Shtetit ka krijuar dokumente për ju¹³?

Nikoll Prenga: Më kanë thënë shokët e mi që t'i shihnim dokumentet, mirëpo edhe kohë s'kam pasur, por edhe larg jam, por tani jam i bindur se duhet ta bëj një përpjekje me qëllim që t'i njoh.

Thjesht që të di çfarë kanë bërë, se ne nuk kemi dalë me urrejtjen për hakmarrje, kur u liruam. Të them të drejtën, ne tëurvejuar ishim gjithëherë si familje, por qe një periudhë kohe që unë u largova nga vendlindja dhe me njerëz të njohur munda të gjeja një punë në ndërtim.

Ku jetoni sot dhe cila është përbërja e familjes suaj?

Nikoll Prenga: Fëmijët me gruan e parë janë të gjithë të martuar. Kërkuan të vijnë në Belgjikë dhe unë i pranova. Të gjithë janë në Belgjikë. Një nip dhe vajza e madhe janë në Australi.

Sa vite keni në Belgjikë?

Nikoll Prenga: Unë kam ardhur nga nëntori i vitit 1992. Kalova nga Kroacia në Itali dhe këtu. Por,

12. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr.9970. Vendim nga Gjykata Ushtarake Tiranë, nr. 105 i Aktit, nr. 98 i vendimit, datë 4.08.1967, Arkivi i AIDSSH-së.

13. Dëshmia është realizuar në Belgjikë nga. Ledja Canaj dhe Erion Kello

jo më pak se pesëqind shqiptarë kanë ardhur në banesën time ato vite, derisa u martova, se vetëm nuk jetohej.

Unë rrjedh prej një familjeje e persekutuar. Gjyshin e kam pasur në burg. Në kohën e luftës të gjithë meshkujt e familjes sime ishin me krahun nacionalist dhe kundër komunistëve me pushkë në dorë. Kur u vendos diktatura komuniste, gjyshin e arrestuan dhe e futën në burgun e Shkodrës, pastaj në vitet 1954-1956, në Tepelenë. Na cilësuan kulakë. Axha, vëllai i babait, kishte studiuar në Romë, në Itali dhe jepte mësim në shkollën e jezuitëve. Ai ka ardhur me vonesë në Shqipëri, pas lufte, në vitin 1947 dhe e kanë mbajtur për një vit të izoluar në Degën e Brendshme të Durrësit. Kishte sjellë dhurata, peshqeshe fetare, libra fetarë në gjuhën shqipe, megjithatë për 12 muaj e mbajtën nën survejim, në hetuesinë e Durrësit. Doli që ai nuk kishte ndonjë qëllim politik. Ishte vetëm për propagandë fetare, predikime për Krishtin, Zotin.

Atëherë e liruan dhe ai shkoi në Shkodër, te Kisha e Jezuitëve, pastaj për pak kohë në Tiranë dhe, për arsye të moshës, u kthye sërish në Shkodër. Nuk mundej të përballonte shumë shërbime fetare. Kryente vetëm ndonjë meshë të dielave, në katedralen e Shkodrës. Të gjitha këto ndikonin negativisht në biografinë e familjes sonë. Për arsye të biografisë, mua më kanë hequr nga puna në gjeologji dhe atëherë shkova u vendosa në Shkodër, ku ishte axha. Disa vjet ai shkoi në Orosh. E mori axha i vogël edhe aty ka ndenjur disa vjet. Për çdo të diel, në kishën e Oroshit, bënte meshë. Herën e parë ka ndenjur katër vjet, më pas edhe dy vjet të tjera.

Mirëpo erdhi koha që u hap lufta për të zhdukur të gjitha kishat dhe xhamitë. Unë isha në Shkodër. Të them të drejtën, aty isha pak si ilegal, se nuk e dinte shumëkush, se cili isha dhe i kujt isha, vetëm njerëzit më të afërt dhe më të ngushtë. Atje po punoja edhe në vitin 1967, kur nisi prishja masive e kishave dhe xhamive. Axha më kishte paralajmëruar që, ndoshta, do të na hiqnin nga arkiveshkuva ku kishin dhomat e veta, kryenin shërbesat fetare etj. Më kërkoi nëse mund ta shoqëroja dhe kur unë shkova, doli në pah se cili isha. Ndërsa priftërinjtë ishin atje, në befasi u shkoi kontrolli. Ndër punëtorët që punonin për

bastisjen, pjesa më e madhe ishin të Sigurimit vetë, që hiqeshin gjoja si punëtorë. Kur më panë mua, më pyetën se ç'punë kisha atje dhe pse merresha me priftin. U detyrova t'u tregoj që priftin e kisha axhë dhe kërkesa e tij e fundit, ishte që të vdiste e të varrosej në Orosh, te prindërit e vet, atje ku kishte lindur. U thashë që ai kishte shëtitur në tërë botën. Nga ajo kohë, më ndiqnin se ku punoja, ku banoja... Me anë të disa miqve munda të gjeja punë në Han të Hotit. Kur punoja aty, më akuzuan për agjitacion-propagandë dhe për përpjekje për arratisje, bashkë me një kushëri timin nga ana e nënës. Kur i prishën kishat dhe nxorën jashtë priftërinjtë ishte mars, por që më parë, në vitin 1965 më kishin larguar nga puna që bëja në ndërtim, në Shkodër. Kishin mbledhur të dhëna se kush isha, i kujt isha dhe biografia ime doli ashtu si doli. Njihej edhe një kushëri i babait, Prengë Shkurt Nikolla, i pushkatuar nga komunistët. Kështu që u dola njeri i dyshimtë.

Fillimisht, akuza ishte shumë e rëndë, sikur ne do të sulmonim. Mendonin që ne ishim shumë, por isha vetëm unë me kushëririn tim. Ai kishte një dashamir të vetin, Rexhepin që ishte nga kufiri, nga Dibra. Me të ishte njohur në shkollën e instruksionit, në Përrenjas. Rexhepin e kishin çuar te posta e brigjeve, te Hani i Hotit. Akuza ishte sikur ne kishim bashkëpunim për armatosje, për të sulmuar postën e kufirit dhe për arratisje. Kjo u doli huq, pastaj shtuan një *"agjitacion dhe propagandë"*. Jam ridënuar nëpër burgje, gjithsej njëzet e tre vjet.

Në Shkodër ka ndodhur arrestimi?

Nikoll Prenga: Unë në Shkodër kam jetuar, por më kanë ndjekur edhe te puna në Han të Hotit, për të parë mos kam pasur edhe shokë të tjerë. Vëllai im punonte në Vaun e Dejës. Një komshi i vëllait qëlloi të ishte spiun dhe ai u tregonte atyre, se kush isha unë. Ishte 13 maj i vitit 1967. Kisha qenë te vëllai atë natë, në Vaun e Dejës, dhe po kthehesha. Ishte duke u hapur rruga e malësisë, në atë kohë. Një mik dibran, që e njihte babain, ishte përgjegjës sektori te rruga që po ndërtohej. Kur kalova atje, të bëja disa dorëzime, më tha: "Nikollë, veç Zoti të shpëtoftë, se keq do ta kesh punën..." Atë ditë, më ndaluan dhe më thanë: "Nuk ke më të drejtë të punosh te Hani i Hotit. Je i arrestuar, në emër të popullit!" Edhe sollën një makinë ushtarake.

“Më akuzuan për agjitacion-propagandë dhe përpjekje për arratisje, bashkë me një kushëri nga ana e nënës.”

Kur ju ndaluan, ju ishit vetëm, apo me të tjerë?

Nikoll Prenga: Po, vetëm isha.

Sa kohë ju mbajtën në hetuesi, gjatë qëndrimit në birucë ishit vetëm apo me të tjerë?

Nikoll Prenga: Në hetuesi qëndrova nga maji, deri në shtator. Me mua ishte edhe një kushëri im, që kishte qenë në shërbimin ushtarak të detyrueshëm. Atë e dënuan 15 vjet. Në birucë nuk kam qenë vetëm. Sillnin provokatorë. Natën e parë erdhi një nga Malësia e Madhe. Ndenja vetëm dy ditë me të. E kuptova që ishte spiun, se kishte dyshekun, kishte djathin...

Pas tij, ju sollën ndonjë tjetër?

Nikoll Prenga: E kuptoi hetuesi, një Llambi Jegeni. Ai më ka qëlluar kur më kanë marrë në hetuesi. Aty më sollën një fotograf nga Shkodra. E njihja atë. Dhunë më është ushtruar nga vetë shefi i hetuesisë, Jegeni, që ditën e parë që më morën në pyetje. Më qëlluan sa më lanë pa ndjenja.

Sa zgjati gjyqi dhe për sa kohë ju dënuan?

Nikoll Prenga: Duke qenë se kushëri im ishte ushtarak, na ka dënuar gjykata ushtarake e Shkodrës. Gjyqi ka filluar paradite dhe ka përfunduar pasdite. U bë me dyer të mbyllura.

Ka pasur dëshmitarë, apo ballafaqime?

Nikoll Prenga: Kushëritim tim, Franit, kur i doli shoku i ngushtë, nuk besonte më asnjë, prandaj nuk mund ta quaj dëshmitar.

Sa vjet u dënuat?

Nikoll Prenga: Unë, trembëdhjetë vjet dhe Frani pesëmbëdhjetë vjet.

Pas dënimit, çfarë ndodhi me familjen tuaj?

Nikoll Prenga: Deri vonë nuk dija asgjë. Më kishte vdekur axha prift, kishin konfiskuar të gjithë pasurinë time personale, çfarë më takonte mua.

Pas marrjes së dënimit të formës së prerë, me çfarë mjete ju transferuan dhe në cilin burg?

Nikoll Prenga: Atëherë, ne në Shkodër ishim bërë shtatë-tetë vetë. Na transferuan me një autoburg. Ishte një makinë e mbyllur që kishte disa vrima sipër, për të marrë ajër. Na grumbulluan te burgu i Tiranës.

Kenë qenë të lidhur?

Nikoll Prenga: Po, i lidhur me pranga.

Sa vetë ishit, brenda tij?

Nikoll Prenga: Kishte dy lloje autoburgësh: ato që merrnin dymbëdhjetë vetë dhe ato me njëzet vetë. Ky yni ishte me 12 vetë. Mbyllnin derën, aty i kryenim edhe nevojat personale...

Sa ju zgjati rruga?

Nikoll Prenga: Aq sa zgjati rruga nga Tirana në Shkodër, dy-tri orë.

Kur hytë në burg, cilat ishin ndjesitë e para?

Nikoll Prenga: Na kontrolluan dhe na futën në "kaush". Thërrisnin me radhë listën e emrave dhe na i zhvishnin të gjitha rrobat, për të na kontrolluar.

Mund të na përshkruani një ditë burgu?

Nikoll Prenga: Një ditë ishte kështu: zgjoheshim në orën pesë. Deri në gjashtë, vrap për nxehje, rregullim krevati etj. Të të gjenin krevatin pa e rregulluar, të rrihnin dhe të dërgonin në birucë. Si ushqim duhej të haje atë supën me krimba vjeshte, silazh preshti, specja vjeshte të kribmura që i hidhnin në supë... Kjo ishte një ditë burgu.

Punonit atje?

Nikoll Prenga: Po, aty kishte edhe kampe pune. Neve na dërguan nga Tirana në Elbasan, te Fabrika e Çimentos. Ishim pesëmbëdhjetë vetë dhe punuam pesë muaj, po pastaj ra puna.

Sa orë në ditë punonit?

Nikoll Prenga: Dymbëdhjetë orë. Na ushqenin me patate.

Sa ishte norma?

Nikoll Prenga: Atje s'kishim normë pune, por

duhej të punonim dymbëdhjetë orë. Ishim rreth një mijë vetë.

Çfarë procesi pune kryenit?

Nikoll Prenga: Kam punuar në ndërtim.

A kishte rregulla të sigurisë teknike në punë?

Nikoll Prenga: Vetëm me fjalë. Kryetar dege ka qenë Nevzat Hasnedari, i cili i ka trajtuar shumë keq të burgosurit e burgut të Elbasanit. Disa kishin punuar për të hapur një tunel që të dilnin jashtë kampit. I kanë rrahur, aq sa tre vetë vdiqën. Ali Maliqin, ish-oficer i kohës së mbretërisë së Zogut, një muaj përpara se të lirohej, dikush e qëlloi me levë dhe vdiq. Nuk arriti të lirohej se nuk donte Sigurimi i Shtetit Shqiptar që ai të dilte i gjallë, pasi dinte shumë gjëra. Edhe një ballist e kanë vrarë padrejtësisht.

Edhe pse sistemi ka qenë i ashpër, gjithmonë ka pasur revolta, apo jo?

Nikoll Prenga: Po. Gjithmonë njerëzit kanë qenë të revoltuar, janë hedhur djem të rinjtë që duke kaluar telat kanë vdekur. Njëri ishte djalë i vetëm, mes disa motrash. U hodh në tela dhe e vrau roja...

Si mendoni, cila ishte arsyeja që filloi revolta në Spaç? A u ashpërsuan masat e ndëshkimit dhe sjellja e autoriteteve të burgjeve ndaj të burgosurve, pas revoltës së Spaçit?

Nikoll Prenga: Revolta e Spaçit shpërtheu pasi u akumuluan vuajtjet, torturat që u bëheshin. Në Spaç të burgosurit punonin në galeri, ku në zonën e piritit temperatura shkonte në 40. Punonin me këmishë ose vetëm me të mbathurat e komandës dhe duhej të realizohej supernorma, me 12 vagonë turni ose 15 vagonë turni. Por shpesh ishte e pamundur, se nuk kishte mineral, nxehtë ishte dhe temperatura mbi 40 , ndërsa kur dilje jashtë ishte i ftohtë akull. Ata që nuk kryenin normën, dënoheshin duke i lidhur pas shtyllës. Revolta e Spaçit pati rëndësi se sensibilizoi të gjithë kampet e burgjeve. Lajmi u mor vesh brenda dy-tri ditëve, se shkonin familjarët dhe u tregonin që diçka kishte ndodhur në Spaç. Një situatë e atillë për pak ndodhi edhe në Ballsh, ku pati një përplasje, por e shuan menjëherë, arrestuan shumë vetë

“Të hiqen titujt që edhe sot e kësaj dite i mbajnë ata që kanë bërë krime.”

dhe i izoluan nëpër biruca. Mes tyre kam qenë edhe unë i arrestuar, dhe i izoluar. Ndërtuan me shpejtësi një mikroburg pranë kampit edhe na izoluan atje, njëzet vetë nga ai kamp. Ishte i mbuluar me tela me gjemba. Ndenjëm atje deri kur na transferuan për në Burrel. Atje na lidhën dhe gjatë rrugës, na kullonte gjaku prej thonjsh, aq shumë m'i kishin shtrënguar hekurat. Hekurat gjermane ishin të tmerrshme.

Në cilat vite keni qenë në Spaç?

Nikoll Prenga: Në Spaç më çuan që nga Skrofotina e Vlorës, si i papërshtatshëm në atë kamp, që e quanin si rehabilitues. Kemi pasur një komisar, një Kiço Xhançi. Na izoluan nja njëzet vetë. Kishte ndërtuar një burg në bunker dhe na kishin izoluar. Në Spaç kam qenë nga viti 1971 deri në mars të vitit 1973. Pastaj, më vonë, më kanë sjellë prapë në Spaç. Nga Burreli më çuan në Zejmen, nga Zejmeni në Spaç, ku ndenja dy vjet e ca dhe në 1984-ën, më transferuan në Qafë-Bari.

Fillimisht jeni dënuar me trembëdhjetë vjet. Kur ua dhanë dënimin e dytë?

Nikoll Prenga: Dënimin e dytë e mora në vitin 1974.

Me çfarë akuze?

Nikoll Prenga: - Akuzat, gjithmonë, ishin për mosbindje dhe agjitacion kundër partisë dhe pushtetit.

Çfarë konkretisht keni bërë ju në burg, që ju dënuan sërish?

Nikoll Prenga: Me shokët e mi, të gjithë të burgosur, flisnim kundër sistemit. Ajo ishte liria

jonë, që na mbante gjallë...

Në sa burgje keni lëvizur, nëpër Shqipëri? Sa nga ato kanë qenë burgje të mbyllura dhe në sa prej tyre, duhej të punojë?

Nikoll Prenga: Në burgun e Skrofotinës në Vlorë, gjatë pjesës më të madhe të kohës kam ndenjur në izolim, një burg i aplikuar pranë kampit 1, në Vlorë. Në të njëjtën mënyrë, në izolim kam ndenjur edhe në Ballsh, që nga viti 1973, deri në vitin 1974. Edhe në Burrel, pesë vitet e para i kam bërë i izoluar. Pastaj kam qenë në kampin e Gjirokastrës, ku kemi punuar disa kohë në ndërtim. Nga Gjirokastra na kanë transferuar në Shën Vasil. Atje ishte kampi i ordinerëve. Pastaj kam qenë në Qafë-Bari, në vitin 1984. Edhe në Qafë-Bari ndodhi një revoltë, më 22 maj të vitit 1984, njëmbëdhjetë vite nga revolta e Spaçit. Pikërisht në maj, ndodhi edhe në Qafë-Bari. Na kanë hyrë në hu dhe prej aty, na çuan në Tiranë, pastaj në burg të Burrelit, ku kam ndenjur edhe dy vjet. Pastaj, më kanë sjellë në Zejmen, në kampin e Zejmenit. Disa prej nesh, na zgjodhën për të punuar te kompleksi “Dinamo”, në Tiranë. Atëherë kanë qenë vitet 1985-1986. Jam liruar më 10 janar 1991, pas njëzet e tre vjetësh, shtatë muaj e njëzet e gjashtë ditësh.

Cila ka qenë dita më e tmerrshme?

Nikoll Prenga: (Qesh) Të them të drejtën nuk e mbaj mend. Por, ditët më të këqija kanë qenë ditët e torturës. Ato janë ditët më të këqija. Të burgosurit, çdo ditë ishin në ankth se do të ndodhte ndonjë gjë, do ta rrihnin, do ta lidhnin. Kemi pasur një Tomor Allajbeu nga Berati, i cili ka bërë tre muaj në birucën e veshur me akull dhe më pas e kanë çuar në Burrel.

A kishit korrespondencë me familjarët?

Nikoll Prenga: Një herë në muaj kishim të drejtë t'i çonim letër familjes, nëse nuk ishim dënuar nga operativi i kampit ose i Burrelit. Kam pasur raste që edhe për dymbëdhjetë muaj nuk i kam parë njerëzit e mi, se nuk lejoheshin në burgun e Burrelit. E bëmë burgun dhe gjithsekush e di përse e ka bërë. Na mbante gjallë shpresa se një ditë, me ndihmën e Zotit, do të dilnim në liri. Kjo ishte forca me të cilën ne përballonim të keqen. Dhe disa kanë thënë se ka pasur të burgosur spiunë. Unë nuk i quaj dot të burgosurit "spiunë". Ata kanë qenë të ligështuar, nuk i kanë përballuar vuajtjet, kanë thënë atë që nuk duhej ta thonin, ka folur dikush i dobët nga ana morale, por burgun e ka bërë njësoj si unë. Unë nuk quaj asnjë të burgosur spiun.

Si e keni marrë vesh ju për vdekjen e Enver Hoxhës?

Nikoll Prenga: Vdekjen e Enver Hoxhës e kemi marrë vesh vetëm prej muzikës së altoparllantit. Ne e kemi përjetuar, se pas kësaj do të shpëtonin fëmijët. Nuk ishte vetëm halli ynë, që të dilnim prej burgut. Ishte mundësia që të çlirohej Shqipëria, mundësia që shqiptarët të merrnin frymë lirisht. Se çdo shqiptar, edhe ata që kanë qenë me të privilegjuarit, e kanë pasur policin te dera.

E ke ruajtur besimin në Zot?

Nikoll Prenga: Jo vetëm unë, po tek të gjithë të burgosurit ishte besimi te Zoti, pavarësisht se disa prej tyre janë hedhur në tela, kanë bërë vetëvrasje, me çarçaf kanë varur veten në kulmin e dëshpërimit ose kanë hyrë 18 vjeç e kanë dalë 50 vjeç, një tmerr i vërtetë.

Në burgje kanë qenë shumë priftërinj të burgosur. Çfarë ndikimi kanë pasur ata?

Nikoll Prenga: Kam njohur personalisht Patër Meshkallën. E kisha rrëfyesin tim para se të hyja në burg. Patër Meshkalla ishte një njeri i paarrtshëm. Kush donte ndonjë këshillë, merrte nga ai vetëm fjalë të mira, paqe, butësi. E morën për të përkthyer vepra policore nga Gjermania, për të përkthyer materiale hetuesie nga Gjermania, për instruktorët e shtetit shqiptar. Ai gjermanishten e kishte të vetën, por u ka thënë: "Nuk përkthej libra policeske, për të torturuar njerëz". Kështu që nuk ka pranuar.

Kur dolët nga burgu, para apo pas rënies së diktaturës? Si shkoj jeta juaj pas kryerjes së dënimit?

Nikoll Prenga: Kam dalë më 10 janar të vitit 1991. Isha në Shën Vasil, Përparim. Na morën nga tridhjetë veta dhe na çuan në Durrës. Unë isha tepër i sëmurë. Isha helmuar në Skrofotinë. U helmuan njëzet e pesë vetë nga uji, se ujërat nga tualetet e të burgosurve ordinerë ishin derdhur në depozitat e ujit të pijshëm të të burgosurve politikë. Aty më erdhi lirim.

Kur hytë në burg, ishit tridhjetë e tre vjeç. Sa vjeç keni dalë?

Nikoll Prenga: Dola kur isha pesëdhjetë e gjashtë vjeç. Nuk dinim të ecnim të lirë, nuk dinim ku ishte stacioni i trenit, autobuzat. Nuk e harroj kurrë atë lloj rinie që ishin studentë atëherë. Ngado që shkonim në Tiranë na shoqëronin ato zhelet që kishim veshur. Më ndihmuan ca studentë për t'u orientuar. Një tiranas, që sapo ishte liruar edhe ai, më ka çuar te shtëpia e Thanas Naçit, ku edhe kam fjetur. Tirana nuk kishte drita, nuk punonin makinat. Thanas Naçi më ka çuar te stacioni i trenit. Rruga nga Repsi në Orosh, shkon një orë e gjysmë. Janë habitur të gjithë që unë kam ecur në këmbë deri në shtëpinë e babait, pa u ndalur askund. Kishte njerëz që donin të më prisnin, po unë isha mpirë. Doja të takoja sa më shpejt babain dhe nënën.

Si shkoj takimi me ta?

Nikoll Prenga: Ata u përletën. Nëna më puthi, si gjithmonë. Unë e putha në ballë, ajo më puthi në dorë, me gjithë mallin e saj. Bënin çudi: "A është Nikolli, apo jo?" Unë isha si i dehur. Kisha dëshirë të shihja gjithçka: kopshtin, arrën, vendin... Por ende ecja poshtë e lart, si në burg, aq sa njerëzit e mi u trishtuan dhe menduan se mos kisha ndonjë gjë.

Si e gjetët familjen tuaj?

Nikoll Prenga: Pas njëzet e katër vitesh, nuk mund ta gjesh familjen ashtu si e ke lënë. Vitet janë të gjata. Dy herë në vit ua përmendnin emrin tim: ai është armik, kriminel, flet kundër shtetit... se ish-gruaja ishte ndarë me kohë prej prindërve të mi dhe kjo më rëndoi shumë, jashtëzakonisht. Fëmijët i gjeta të rritur. Vajzën e vogël, Florën, e lashë gjashtë muajshe dhe e gjeta gati njëzet

“Ngado që shkonim në Tiranë, na shoqëronin zhelet që kishim veshur...”

e pesë vjeç, Marien që e kisha lënë tetë vjeç, e gjeta me fëmijë, djalin e gjeta të sapo dalë nga burgu, kishte tentuar të arratisej për në Jugosllavi dhe e kishin kapur në Kosovë kishte bërë vetëm nëntë muaj burg, meqë ishte fundi i sistemit.

A ju kanë kërkuar falje ish-bashkëpunorët e Sigurimit që kishin raportuar për ju dhe që ju shkaktuan kaq vite dënim në burg?

Nikoll Prenga: Absolutisht jo, kurrkush nga ata dhe ky është mëkati më i madh. Për të jetuar, na kanë dhënë një pension minatori, fillimisht njëqind e njëzet mijë lekë, tani është rritur diku te dyqind e ca mijë lekë¹⁴.

Si e kanë llogaritur pensionin tuaj? A nuk jeni trajtuar me pension të posaçëm, si ish-i përndjekur politik?

Nikoll Prenga: Na thanë se kush kishte mbi pesëmbëdhjetë vjet e lart burg, do të merrte pension minatori. Por, për cilët minatorë bëhet fjalë, se minatorët marrin katërqind mijë, kurse unë marr njëqind e njëzet e mijë ose njëqind e pesëdhjetë mijë.

A ju kanë dhënë banesë për strehim, si i përndjekur politik ?

Nikoll Prenga: Po, kam marr një banesë në Rrëshen, Mirditë. Na thanë që do të na i

jepnin falas, por më vonë u detyrova të paguaja njëmbëdhjetë milion e dyqind mijë lekë të vjetra¹⁵.

Meqë ju keni vuajtur dhe e shihni që ka shumë mangësi puna në ndihmë të shtresës suaj, si mendoni, çfarë duhet ndryshuar në politikat rehabilituese, për më tutje?



Nikoll Prenga: Mendoj që njerëzve dhe sidomos brezave të rinj u duhet bërë e ditur çfarë ka qenë ai sistem, çfarë të këqijash i solli vendit tonë, sa i tmerrshëm ka qenë...Të bëhet mësim edhe në shkolla, duke nisur që nga klasa e pestë.

Çfarë mesazhi keni ju, sot, për të gjithë shqiptarët, bazuar në këtë përvojën tuaj, tepër të hidhur?

Nikoll Prenga: Duhet të pohohet njohja e krimeve të diktaturës. Të hiqen titujt që, edhe sot e kësaj dite, i mbajnë ata që kanë bërë krime. Kanë vrarë tërë Shqipërinë, një komb, atëherë si mundet t'i mbajnë këto tituj? Janë bërë gabime, se nuk u njoh prona: pronën time e ka tjetri... Unë u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve, pa dallim, të reflektojnë, ta duan kombin e vet, vendin e vet, vëllanë e vet, ta duan njeri-tjetrin, të mos ecin edhe sot me armiqësi e me luftë kundër njeri-tjetrit. Pasuria, nuk është asgjësend - sot e ke, nesër jo. Më kryesorja është t'i japim dorën njeri-tjetrit, të bëjmë ligje që t'i venë gjërat në vend.

14. Këtu folësi përdor njësitë monetare sipas gjuhës së popullit, me sistemin e vjetër. Shuma 120 mijë lekë të vjetra ose 200 mijë lekë të vjetra, me sistemin aktual zyrtar është 12 mijë dhe 20 mijë lekë.

15. Sërisht sasia e parave përmendet sipas të folurës popullore me sistemin e vjetër, domethënë me lekë të vjetra.



Shkëlqim Abazi

“Filloi si revoltë, por u kthye në kryengritje.”

“Unë ju falënderoj që erdhët të më merrni këtë intervistë, sepse kemi ngelur shumë pak nga ata që kanë qenë të pranishëm në revoltën e Spaçit. Edhe ata që janë ende gjallë kanë probleme moshe, probleme fizike dhe sëmundje të marra që nga burgu. Prandaj e ndiej që unë duhet t’ju falënderoj juve.”

Shkëlqim Abazi, i biri i Tabanes dhe Myslymit, lindur në 23 dhjetor 1951, në Berat. U arrestua në moshën 16-vjeçare, më 11 gusht 1968, me akuzat “për krimin e tradhtisë ndaj atdheut përmes tentativës për arratisje” dhe “agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”. U dënua me 5 vjet heqje lirie¹⁶. Vuajti dënimin në Spaç.

Meqë keni qenë vuajtës në burgjet e diktaturës, a jeni interesuar për të parë dokumentet e dosjes tuaj, që ruhen në arkivin e AIDSSH-së?

Shkëlqim Abazi: Jo.

Çfarë u bë shkak që t’ju arrestonin?

Shkëlqim Abazi: Nuk di të them nëse arrestimi im ka qenë apo jo i përgatitur. Ne ishim dy shokë që po bënim plazh në Himarë, në Spile.

Me çfarë akuze ju arrestuan?

Shkëlqim Abazi: Kam pasur dy akuza, njëren

16. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 13424. Vendim nga Gjykata Popullore Shkodër, nr. Regj. Them. 131, nr. i vendimit 126, datë 23.10.1968, Arkivi i AIDSSH-së.

“Ata që dilnin nga burgu, do të ktheheshin edhe një herë tjetër. Mjaft të thoshin dy a tre vetë, që foli, edhe të dënonin prapë.”

“për agjitacion-propagandë” dhe tjetrën, për “tentativë arratisjeje”. Të tentosh të arratisesh nga Spileja e Himarës, dhjetëra kilometra larg kufirit detar, këtë edhe zogu e ka të vështirë.

Po bënim plazh në bregdet. Nuk na arrestuan me bujë të madhe, zgjodhën një moment kur edhe plazhistët ishin futur brenda. Duhet të ketë qenë koha e drekës ose aty, rreth orës dy. Isha shtrirë në një shkëmb e po qetësohesha, shoku im po lahej, kur na erdhën dy civilë, dhe thanë: “Vishuni dhe do të vini pak me ne!” Pyetëm përse, por na thanë se ashtu ishte një problem. U veshëm dhe shkuam me ta. Pak më tej, rreth pesëqind a njëqind metra, ishte edhe një makinë jo e policisë, se në atë kohë nuk kishte makina policie. Mund të ketë qenë makinë ushtarë. Na hipën atje, na shoqëruan në një repart ushtarak dhe një ushtarak na tha që do të qëndronim atje.

- Për ku ishit nisur, ju? - na pyeti. - Në det, - i thamë. - Që ishit në det e pamë ne, po për ku tjetër ishit nisur? - vazhduan pyetjen.

Atë ditë e atë natë na mbajtën në repartin ushtarak. Nuk ushtruan as dhunë, as presion, asgjë prej gjëje. Na mbajtën si të izoluar, po të izoluar që

nuk ikje dot, se nga të gjitha anët ishim të rrethuar me ushtarë që bënë roje. Të nesërmen, na nisën për në Vlorë. Dyshova në momentin e parë, që diçka do të ishte. Ndoshta dikush do të kishte bërë ndonjë denoncim, se kot nuk na morën. Po kur na nisën për në Vlorë, të shoqëruar me policë, u binda plotësisht që dikush na kishte denoncuar dhe që këta na kanë pasur në ndjekje, se ndryshe nuk kishte mundësi: - Nuk ishim vetëm ne në plazh, ishin edhe qindra të tjerë. Na çuan në Vlorë dhe, me rrugën e asaj kohe, kuptohet që duheshin tre deri në katër orë, të mbërrije nga Himara në Vlorë. Na shoqëruan tre vetë, dy policë dhe një civil, mund të ketë pasur dhe të tjerë nuk e di, por një polic ishte ulur në mesin tonë që të mos komunikoni me njëri-tjetrin. Diku në Llogora, ndaluan për një pushim te një lokal, por ne ishim të zgjidhur. Nuk na kishin lidhur.

I kërkova njërit nga policët të shkoja në banjë. Ai pa njëherë, andej-këtej, pa që nuk ishte ai tjetri dhe më lejoi të shkoja. Ne u çuam të dy. I thashë atij shokut, që diçka ishte. Ai mendonte që na kishin zbuluar.

- Mbyll gojën, - i thashë. - Nuk ka pse të hyjmë në të thella...

Ky qe komunikimi i vetëm me njëri-tjetrin. Nuk patëm mundësi më tepër, se i kishim njërin andej, njërin këtej e njërin në mes. Në Vlorë, na futën në Degën e Brendshme dhe na ndanë. Nuk e pamë më njëri-tjetrin. Atje na torturuan, na lidhën. Mua, të paktën, më goditën dhe në atë kohë nuk i kisha mbushur as 17 vjeç, isha gjashtëmbëdhjetë vjeç e shtatë muajsh. Filluan presionet: çfarë ke bërë, me kë folur, çfarë ke thënë, jo andej, po këtej, siç ishin ato atëherë. Unë në atë mendjen time isha i vendosur që nuk do të flisja gjë, që nuk do të them asgjë. Faktikisht nuk kisha bërë gjë, mirëpo me këtë akuzë që u arrestova dhe u dënova me thënë të vërtetën, kisha folur me shokun tim, pa çka se nuk doja ta pranoja. Meqë e ndava mendjen dhe e ndamë fjalën tok me shokun tim, nuk do të pranoja dhe nuk pranova, mirëpo nuk e dija që shoku im jo në praninë time, por më vete, kishte folur dhe me dikë tjetër dhe i kishte treguar që ne e kishim ndarë mendjen të iknim ato ditë. Ai tjetri na kishte denoncuar, paçka se ne nuk na e nxorën atë. Unë këtë nuk e dija, sepse po ta dija, nuk do të kisha asnjë arsye që të rezistoj. E kam marrë vesh shumë, shumë më vonë, mbasi u dënuam, kur më tha ai: "Ore, e vërteta është që kam folur". Unë nuk dija gjë, që ai kishte pranuar, se po ta dija do t'u kisha shpëtuar shumë torturave, madje edhe këtij çyrykllëkut në kokë, që vuaj ende sot, por nuk e dija.

Sa kohë zgjati hetuesia?

Shkëlqim Abazi: Mendoj se zgjati tre muaj. Sa për torturat, sot ende e kam një shenjë të madhe. Ma kanë bërë në Shkodër, sepse nuk na mbajtën në Vlorë, por mua më çuan në Vaun e Dejës.

A e njihni personin që ua ka bërë këtë shenjë?

Shkëlqim Abazi: Ma kanë bërë tre veta, nga të cilët njëri më godiste, dy të tjerët e mbështetnin, kryehetuesi i Shkodrës, një Llambi Jegeni, prokurori Thoma Tutulani dhe Shyqyri Çoka që më ka bërë këtë shenjën.

Unë nuk e njihja aspak. Isha i ulur në një stol të betonuar, i lidhur sigurisht. Përballë kisha Llambin dhe Thoma Tutulani, që po talleshin me njëri-tjetrin. Thomai ishte beratas dhe njihej me familjen dhe me të gjithë njerëzit e mi, prandaj thoshte:

- E njeh këtë, ti? Ky është një kriminel. Ky është i biri i një ballisti të egër, që ka bërë namin në Berat...

Këto që thoshte për babain tim, ishin të pavërteta. Pastaj ngulte këmbë se përse unë nuk firmosja. Dhe unë nuk firmosja, jo se isha ndonjë trim, por kisha bindjen që kur nuk ke bërë gjë, nuk kishe përse të firmosje dhe madje, mendoja se as nuk të dënonin. Ku ta dija unë që ata e kishin prerë kostumin.

Thomai më thoshte: - Ore, firmos, të shpëtosh veten. Pse, do të të linim ne, të bëje ti ndonjë gjë? Kaq budallenj jemi ne? Pse, nuk e dinim ne kush ishe ti? Kësaj radhe do t'ia hedhësh, kodosh, me pesë vjet, se je i vogël, nuk i ke mbushur tetëmbëdhjetë vjet, por radhës tjetër ke dhjetë e përpjetë.

Unë ia ktheva: - Po çne, radhës tjetër? Pa bërë gjë më fute këtu, pale që më paske caktuar edhe radhën tjetër? -Hë, babuç, e para bie të dytën, - më tha, siç flasin beratasit.

Në këto momente Shyqyri Çobo, që unë as e kisha parë, se s'kishte punë fare me mua, thotë: - Po këtë ç'e kemi këtu? Çfarë ka vjedhur?

E kam të fiksuar sesi Llambi iu përgjigj: - Ky është më zi se ai, sepse është armik. - A, ta kisha unë, e kisha mbytur në vend, - tha Shyqyriu. - Pse e zgjasni kaq shumë, me këtë? Nuk i fusni një plumb? - Partia e ka barkun të madh, - tha Llambi. - Tani ia tregoj unë barkun këtij!

Afër derës ka qenë një hu a ndonjë këmbë karrigeje. Shikoja gjithmonë dhe një zorrë llastiku që e mbanin kastile. Më kishin bërë peshk. Por, Shyqyriu mori një hu e më goditi nga mbrapa. Më zuri në krah. Nuk pashë gjë. Ndjeva një dhimbje shumë të fortë, m'u errën sytë... Nuk ndjeva më asgjë. Mbas një ore a dy, erdha në vete dhe nisa të ndieja dhimbje. Isha çarë, në të djathtë, më ishin thyer tri a katër dhëmballë. S'pashë gjë. Gjuha më priste si xham...

Më kishin marrë e më kishin çuar te çezma e birucave përjashta. Atje, një polic më hidhte ujë. Ishte nga Berati dhe shërbente në Shkodër, bile që në kohën e Zogut kishte shërbyer në familjen

time, kështu që më njihje. Më kishte hedhur ujë, më kishte shpëlarë, po ç'të bënte? Dhe më shumë nuk bënte dot. Kur erdha në vete e ndjeva që kisha diçka, se nuk shikoja nga syri. Veshi m'u turit, gjuha binte te dhëmbët e thyera si xhama... - Lahu! - më tha.

Kur i hodha ujë fytyrës, atëherë e kuptova që më kishin bërë sallatë. Megjithëse nuk kisha çfarë të bëja, më lidhi një fasho dhe këndonte: - Çfarë të paskan bërë ty, o derman, etj.

U mjaftuan me mjekimin e policit dhe as më çuan te mjeku. Pas një jave a dhjetë ditësh më kullonte veshi qelb. Nga goditja ishte qelbëzuar brenda. Atëherë sollën një mjek ose infermier, nuk jam në gjendje ta them, por ishte me bluzë të bardhë. Në kushte biruce ma qepi dhe mjekoi plagën, por ajo ishte bërë shumë keq. Po ta kishte qepur në moment, mbase do të ishte zënë mirë.

Dëgjova që foli me dikë që ishte jashtë. I thoshte se duhesha çuar për mjekim në spital.

- Po lëre të vdesë. Një armik më pak!- i tha tjetri, siç e kishin këta, se nuk e kishin këtë vetëm me mua, po me të gjithë dhe kaq qe i vetmi mjekim i asaj kohe. Veshi më rrodhi për rreth dy a tri orë, pastaj u përtha vetë, jo se më bënë ndonjë një gjë këta, biles nuk mbaj mend më dhanë apo nuk më dhanë ilaçe përveç asaj që më bëri infermieri. Për këtë arsye më mbetën këto pasojat që kam sot. Syrin e kam humbur, se nuk shoh 60%, veshi me kalimin e kohës ka humbur shumë dëgjimin.

Në cilin vit, ju arrestuan?

Shkëlqim Abazi: Në vitin 1968.

A ju kanë sjellë njeri tjetër brenda në birucë, gjatë hetuesisë?

Shkëlqim Abazi: Në birucë, fillimisht kam qenë në Vlorë dhe aty isha vetëm, më pas në Shkodër. Atje pas dy javësh më sollën një person që kishte vjedhur dy llamba, dy portollamba dhe një prizë, siç thoshte vetë dhe ma kanë lënë dy a tri javë. Të them të drejtën, unë kam qenë i ri, por siç e gjykoj sot e mendoj që mund ta kishin sjellë për të folur, gjithsesi nuk kisha çfarë të flisja me të. Pas dy

javësh, më sollën një tjetër. Që ditën e parë erdhi i mbuluar me gjak, mirëpo gjak kishte, plagë jo. Mua më bëri shumë përshtypje kjo gjë. Ky i shante: "Të poshtër, kriminelë..." Më erdhi keq faktikisht dhe doja ta qetësoja, por nuk qetësohej. Ishte shkodran, por në respekt të fëmijëve të tij dhe të një origjine familjare shumë të mirë, unë nuk dua t'ia përmend emrin, sepse ishte një nga familjet më të mira, të paktën me aq sa mora vesh më vonë. Kjo më bëri shumë përshtypje, megjithatë kur ai u qetësua ose bëri sikur u qetësua, filloi të më pyeste: - Për çfarë të kanë marrë? Çfarë ke bërë? Mirë ua ke bërë, Janë qenër këta, Janë kështu, janë ashtu...

Po mendoja: "Ky njeri që flet kaq hapur, i gjakosur, por pa plagë, diçka duhet të ketë..." Aty nuk ishim vetëm unë dhe ai, ishin plot. Birucat në Shkodër rrinin plot rini, gjithmonë plot dhe mund të kenë qenë të dytat në Shqipëri, pas Tiranës, nga numri i të arrestuarve. Por nga të arrestuarit, asnjë nuk bënte si ai. Pas nja dy a tri ditëve, më thotë: - Fol, o burrë, çfarë ke bërë? Ti je i ri dhe nuk kanë çfarë të të bëjnë këta. Me mua fol, se jam njeri i besuar. I thashë që nuk kisha bërë gjë. Qëllimi i hetuesisë ishte që të merrnin vesh edhe për të tjerë, që të zmadhohej grupi sa më shumë e nga dy të bëheshin pesë e mundësisht dhjetë, që dënimet të ishin të bujshme, mirëpo unë me mendjen time thosha se s'më duhej me të tjerët. Edhe kështu shkoi kjo punë. Ata e panë që nuk fola dhe nuk më prunë më tjetër. Më pas, sollën njërin nga një fshat i Shkodrës. Edhe në pamje dukej që ishte qyqar. Me atë e shtyva për ca kohë, pastaj e mbyllën hetuesinë. Kaq ishte hetuesia ime, tre muaj e gjysmë - katër muaj. Na nxorën në gjyq dhe na dënuan.

A ju kujtohet dita e gjyqit?

Shkëlqim Abazi: Si datë nuk jam i sigurt, se mua çdo gjë në jetë më ka ndodhur afërsisht në datën 23 tetor. Ishte viti 1968, në Shkodër. Dita e gjyqit që të jem i sinqertë, nuk më është fiksuar mirë. Isha nën shokun e kësaj goditjeje dhe nuk zgjati pak ky shok, megjithëse mbaj mend që na thanë të visheshim se do të na çonin në gjyq. Unë nuk kisha çfarë të vishja. Shoku im ishte në një birucë tjetër dhe vetëm kur u futëm në makinë u takuam bashkë. S'kishim çfarë të vishnim. Familjet tona nuk dinin gjë ku ishim ne. Nuk u tregonin. Madje, në Berat ishte hapur fjala që "Shkëlqimi

është arratisur dhe ka marrë me vete nja tri-katër të përdala”, po familja ime nuk e besonte. E dinte që nuk isha i asaj natyre. Këto fjalë përhapeshin qëllimisht për të denigruar njerëzit.

Dolëm në gjyq me ato rroba që kishim veshur. Mund të them pa frikë që ato rroba nuk i kisha hequr për asnjë sekondë sa kohë që isha në birucë, në hetuesi, deri pas marrjes së dënimit.

As për të larë dhe shpëlarë s’bëhej fjalë, as për dush apo të laje sytë tamam. Ishte me rotacion çdo gjë: dy grushte ujë dhe me vrap, se erdhi tjetri.

Pas gjyqit, ku ju çuan ?

Shkëlqim Abazi: - Pas gjyqit na çuan në Degën e Brendshme, ku na mbajtën rreth një muaj, pastaj na bënë bashkë me të tjerë.

Sa vjet ju dënuan?

Shkëlqim Abazi: Na dënuan, nga 10 vjet.

Edhe ju që ishit nën moshë, a kishit avokat mbrojtës?

Shkëlqim Abazi: Mua nuk më zinte dënimi i plotë, se nuk i kisha mbushur 18 vjeç. Nuk kishte më avokat mbrojtës. Kishte një vit që ishte hequr. Ministria e Drejtësisë ishte pa rol. Drejtësinë e jepnin dhe e mbronin prokurorët. Ligjërisht unë nuk i dija, por edhe t’i dija nuk i kërkoja dot, se nuk t’i jepte njeri. Mua nuk më zinte ligji, prandaj për moshën që kisha duhet të kisha një avokat mbrojtës, por prokurori në hetuesi më tha: “Do të ma hedhësh me pesë vjet? Dhjetë vjet e ke. Ta kemi prerë kostumin, dhjetë vjet. Meqë ti je

nën moshën ligjore, do të bësh pesë kësaj radhe, pastaj do të bësh dhjetë ose një plumb”.

Kështu që na dënuan, pastaj, pas rreth një muaji, na hipën në makinë dhe na çuan në kamp, në Rreps të Mirditës, ku ishte një uzinë e përpunimit të bakrit në Rreps. Ka qenë 23 ose 24 nëntor 1968, kur na çuan atje. Dhe në Rreps kam ndenjur rreth dy vjet, nga viti 1968 deri në shtator 1970, pastaj më çuan në Spaç, në minierë, deri kur u lirova.

A morët ndonjë dënim të dytë?

Shkëlqim Abazi: Jam liruar në vitin 1973. Ishin shumë të rrallë ata që shpëtonin pa një dënim të dytë dhe unë qeshë një nga ata që shpëtova, se edhe rrethanat erdhën të tilla. E ndava mendjen të bëja sikur nuk dëgjoja. Përgjithësisht ata që dilnin nga burgu do të ktheheshin edhe një herë tjetër. Shokun tim për shembull, e lanë katër vjet dhe e dërguan sërish. Nuk foli fare i shkreti, por mjaftonte të thoshin dy a tre vetë që foli edhe të dënonin prapë. Me nenin “për agjitacion dhe propagandë” futeshin brenda të gjithë ata që shanin qeverinë deri te ata që lyejnë duart me gjak, për qeverinë. Unë njoh jo një, por me dhjetëra raste që dënoheshin pse kishin sharë qeverinë dhe vërtet e kishin sharë, ose të tjerë, pse për një moment kanë sharë Enver Hoxhën me fakte, jo me llafe. Edhe me emra t’i them.

Çfarë pune keni bërë në Spaç?

Shkëlqim Abazi: Në Spaç, nga dita e parë që kam filluar punë e deri ditën që u lirova, nuk kam dalë nga miniera. Mbi tre vjet, nuk pata çast të dilja një ditë jashtë miniere.

Na tregoni për revoltën e Spaçit, si ndodhi dhe çfarë ndodhi?

Shkëlqim Abazi: Revolta e Spaçit është një ngjarje e veçantë jo vetëm për Shqipërinë, por thuaj për të gjitha vendet komuniste. Gabimisht quhet revoltë dhe vërtet filloi si revoltë, por u kthye në kryengritje, të paktën në dijeninë time. Me sa kam dëgjuar, kam pyetur e kam lexuar, asnjë revoltë e kësaj natyre nuk ka ndodhur në burgjet e Europës Lindore.

Revolta e Spaçit, nuk lindi spontanisht, se kishte

30 vjet që vazhdonte dhuna e pandërprerë që herë ngrihej dhe herë ulej sipas ritmit të luftës së klasave. Revolta e Spaçit ndodhi në 21 maj, zyrtarisht filloi në datën 21, por spontanisht nisi që një ditë më parë.

Data 20 maj ishte e diel dhe nuk po na lejonin për të bërë pushim, që ishte i ligjshëm, se duhej të realizohej e të tejkalohet plani. Një pjesë e të burgosurve, nuk pranuan të dilnin në punë. Kjo bëri që të egërsohej komanda dhe na nxorën me gjysmë dhunë. Komisar kampi në atë kohë ka qenë një Shahin Zgura nga Mati, por ishte njeri tinzar dhe i pabesë. U fut brenda në kamp edhe na tha: “Do të dilni edhe sot në punë, sa për të çuar në vend fjalën tonë, pastaj nga e diela tjetër nuk do të dilni më”.

Të burgosurit u revoltuan dhe kundërshtuan. Ishte më shumë sesa revoltë. Erdhi e hëna, 21 maj. Në orën 5 në mëngjes, polici - roja i brendshëm shkante fillimisht në biruca, pastaj bëhej zgjimi për të tjerët, i zgjonin, u merrnin batanijet, ndërsa ata shkonin kryenin nevojat personale.

Mirëpo në birucë ishte i dënuar dhe një Pal Zefi nga fshatrat e Shijakut, zona e Ishmit. Pal Zefi dhe Gjokë Zefi ishin vëllezër. Njëri ishte dënuar 8 vjet dhe tjetri 10 vjet. I kanë prurë në Spaç nga fundi i vitit 1972, mbase nga fillimi i vitit 1973, nuk e kujtoj dot saktë. Ndoshta nga fundi, nëntor - dhjetor i vitit 1972. Gjokë Zefin e njihja, se punonim në një brigadë, ndërsa Pal Zefin jo. Dita kur do ta njihja për herë të parë ishte dhe dita e fundit që e pashë.

Mbaj mend se ka qenë shkurt i vitit 1973. Punohej njëzet e katër orë, me tre turne. Në Spaç turnet zëvendësoheshin. Unë kam qenë turni i parë me Gjokë Zefin, vëllai i Pal Zefit. Brigadat në Spaç ishin me afro shtatëqind apo tetëqind vetë, mbi dyqind vetë në turn. Kur kam qenë unë ishin tri zona: zona e parë dhe e tretë kishin bakër; zona e parë ishte më afër, e treta ishte larg; zona e dytë kishte pirit. Më pas janë bërë katër e më pas pesë zona. Unë flas për kohën e revoltës.

Atë ditë ishte shumë, shumë ftohtë. Një i ftohtë i hidhur që bënte në atë zonë, si askund. Ne nuk kemi pasur termometër, ta shihnim sa shkante temperatura, po sipas të dhënave zbriste deri në

minus pesëmbëdhjetë gradë. Në një të ftohtë të tillë, kur dolëm te porta për në punë, Gjokë Zefi kishte vënë një shall në qafë. Këtë e kam të fiksuar, se e pashë, ngaqë ishte dy a tre metra përpara. Kishte një shall nga e bija. Te porta, oficeri i rojës i thotë: - Ç'e ke këtë? -Shall - iu përgjigj ky. - Kush të ka thënë ty, që të vësh shall? Nuk lejohet! - Jam i sëmurë - i tha Gjoka.

E kështu, jo hiqe, jo nuk e heq, oficeri i rojës zgjat dorën dhe ia heq. Në atë kohë po kthehej turni i tretë, ndërsa ne ishim në të dalë. Takoheshim te dera: ne hynim në punë, ata dilnin dhe prisnin atje, se ishte vend i vogël. Me këta që u kthyen nga turni i tretë, ishte vëllai i Gjokës. Ky e pa që polici i hoqi shallin vëllait dhe erdhi e kapi për krahu policin, dhe i tha: - Është vëllai im.

Filloi një sherr që nuk zgjati as dy minuta, se erdhën katër-pesë policë të tjerë, që e kapën dhe e futën në birucë. Dënimi maksimal ishte 30 ditë, megjithatë kjo nuk e pengonte komandën që pas 30 ditëve të të jepte edhe 30 ditë të tjera e të tjera e të bëhej një vit, apo vite të tëra në birucë. Kështu kishte ndodhur me një shokun tim nga Berati, Tomor Allajbeu, që tashmë nuk jeton më. Hyri për tridhjetë ditë dhe bëri tre vjet, brenda në birucë. Pali bëri tridhjetë ditë. E nxorën një ditë dhe e urdhëruan për të shkuar në punë. Ai kundërshtoi. E dënuan edhe tridhjetë ditë të tjera. Bëri tre muaj në birucë. Kur hyri, ishte 18 shkurt dhe pas tre muajve i binte që të lirohej nga biruca, në 21 maj, mirëpo ata nuk e liruan. Një ditë më parë, e gënjyen dhe i thanë që do ta lironin të nesërmen. Ndërsa të nesërmen i shkoi polici që në orën pesë dhe e ngriti për nevojat personale. Pali i tha që ai, atë ditë duhej të lirohej. -E di ti, apo ne?- i thotë polici. - E kam kryer dënimin - i përgjigjet Pali. - Kam hyrë në filan datë e dal sot. Polici ia mbylli derën, por harroi të vendoste shulin dhe shkoi në birucën tjetër. Në atë kohë Pali e shtyu derën dhe erdhi në kamp. Policët i bërtasin: -Hej, ku vete?

Oficer roje, atë ditë qëllloi të jetë operativi i kampit, Petrit Liço nga Korça, njeri shumë i keq. Petrit Liçaj i thotë Palit: - Futu në birucë! -Nuk futem - ishte përgjigjja. -Të fusim ne - i thotë ai. Mori nja gjashtë policë, për ta kapur dhe për ta futur me zor në birucë Në atë kohë, godina trekatëshe ishte në ndërtim e sipër, ishte ndërtuar vetëm një

seksion i saj. Të tjerët ishin në themele dhe atje kishte material ndërtimi. Pali rrëmbeu një hekur në dorë dhe u kthye nga policët, duke i kërcënuar që kush guxonte t'i afrohej, do ta godiste në kokë me shufrën e hekurit dhe që ai nuk kthehej më në birucë, se e kishte plotësuar afatin e dënimit.

Policët e morën më tepër, për kërcënim. Kryetari i zyrës teknike, Bedri Noku, iu afrua, por Pali e goditi me hekur dhe e rrëzoi përdhe. Ai filloi ulërimat dhe policët u sulën. Ishte orari që të burgosurit ishin çuar dhe dilnin për të kryer nevojat personale në banjë. Pallati ku flinin ne ishte jo më shumë se 10 metra nga vendi ku ndodhi kjo. Kur dëgjuan ulërimat, shkuan me vrap për ta hequr nga duart e policisë bashkëvuajtësin e tyre.

Këto që po rrëfej i kam të dëgjua, nuk i kam parë me sy, se këto ndodhën që në orën pesë të mëngjesit, kur isha ende në gjumë, se punoja në turnin e dytë. Nga zhurma u zgjova edhe unë. Aty afër ishin Fiqiri Mujo dhe Ali Hoxha, kompozitor nga Tirana. Pyeta se çfarë kishte ndodhur dhe Fiqoja më tha: - Mbulo kokën ti, lëre çfarë ka ndodhur!

Dola në ballkon, se s'po më rrihej më. Muharrem Dyli, nga Kutallia e Beratit, goditi me pëllëmbë policin që mbante Palin. Ne kemi pasur edhe një qen, që e rriste Fiqiri Muho. Ia kishte venë emrin Tarti, Tartari. Ai na rrinte nëpër këmbë, ishte mësuar me ne. Mirëpo sa na donte ne, aq urrente policët, se i binin me shkelma. Prandaj Tarti iu lëshua policëve që po qëllonin Pal Zefin. Një shkodran që ishte aty pranë, kthehet e u thotë shokëve: - Na turpëroi Tarti. Ai po lufton me policët, ju rrii e bëni sehir. Këto ishin shkëndijat që ndezën zjarrin. Atëherë u çuan të gjithë, nja njëzet a tridhjetë a dyzet vetë. Sa ishin, nuk e di. Policët e gjetën veten shumë keq. U ranë kapelat nëpër themele, ikën me vrap...

Kështu zanafilla e revoltës ishte në orën pesë të mëngjesit. Largimi me vrap i policëve u dha zemër të burgosurve. Ishte momenti i zgjimit. Pak më vonë, jo të gjithë shkuan për në punë me turnin e parë. Ata që morën pjesë në rrëmujë mbetën brenda, të tjerët dolën në punë.

Në kamp kishte ardhur komisari Sait Gura dhe Sulejman Manoku, drejtori i Drejtorisë së Zbatimit

“Kur dolëm, pamë se poshtë në kamp ishte rrëmujë. Të burgosurit kishin shkruar parulla. Disa prej tyre kishin dalë në tarracë dhe mbanin fjalime.”

të Vendimeve. Se si u gjend ky në Spaç unë nuk e di. Ndonjëherë mendoj se mos ka qenë i parapërgatitur shpërthimi i revoltës. Këta nisën me fjalime: “Mos bëni kështu... dorëzoni shokët që morën pjesë në këtë rrëmujë... Filloni punë!...” Mirëpo hasën në rezistencë dhe nuk pranonte njeri të dorëzohej. Deri në atë moment, nuk mund të quhej revoltë.

Në krye ishin pesë-gjashtë vetë: Muharrem Dyli, Pavllo Popa, shkodran, Paulin Vata, Pal Zefi ishte kryesori natyrisht dhe një vlonjat, Syrja Lame. Drejtoria kërkonte me çdo kusht, t’i ndalonte këta. I vetmi që pranoi të dorëzohej, ishte vetë Pal Zefi që ishte nismëtari, por e bëri këtë akt me bindjen që po dorëzohej për të biseduar, jo që ta rifusnin në birucë, se ai e kishte përmbyshur dënimin. Ata nuk pyetën fare dhe e çuan sërish në birucë. Kjo sjellje i acaroi më shumë njerëzit dhe në këtë moment mund të thuhet që nisi një farë organizimi. Disa nga bashkëvuajtësit e mi, sot thonë që revolta ishte e organizuar. Unë mendoj që nuk ishte. Nga ana jonë, faktikisht, ajo ishte spontane. Ishte mbushur kupa, se kishte tridhjetë vite dhunë dhe urrejtja ishte e madhe, por që të

thuash se ishte e organizuar unë nuk e pranoj dot.

Në mos një ditë, një ditë tjetër do të shpërthente, por jo e organizuar. Nuk e pranoj dot që të ketë qenë e organizuar, se duhet të kishte një drejtues e të tjera. Deri në këtë orë, nuk kishte zhvillime, përveç mashtrimeve që bënin policët për të kapur me hilerë njerëzit që ata i kishin piketuar.

Me këto zhvillime na zuri ora dy e ditës dhe ne të turnit të dytë na nxorën për në punë, megjithëse jo të gjithë. Duke shkuar për në punë, po bisedoja me Astrit Delvinën që e kisha mik.

- Si do të shkojë kjo punë? - i thashë. – Të të thotë vëllai, një këshillë? Ti edhe tre muaj burg ke, prandaj shmangu sa të jetë e mundur, se këta të dënojnë. Këta i filmojnë të gjitha.

Dhe vërtet, Spaçi është në gropë dhe ata filmonin nga lart. Në atë kohë ishte më ndryshe, jo si është sot. Kisha rreth 3 vjet në Spaç, por asnjëherë nuk kishte ndodhur të na kthenin nga puna para se të mbyllej orari i turnit. Atë ditë rreth orës 8 e gjysmë, apo 9, brigadieri na tha se do të dilnim jashtë.

Ishte fundi i majit dhe jashtë ishte ende ditë. Punoja me një dibran, Mexhit Caka dhe me një nga Devolli. Na bëri shumë përshtypje që na nxorën jashtë orarit. Kushedi ç'kishte ndodhur andej! Një gjë duhet të kishte ndodhur, se nuk bënte vaki, të na nxirrnin pa e realizuar normën. Mexhiti me atë të folurën dibrançe, më tha: -

- Dëgjo, ta thotë Xhiti, hap sytë, se ti edhe tre muaj ke. Pa na shiko ne, unë kam 25 vjet, se këta të dënojnë prapë.

Kur dolëm jashtë, ishin vetëm dy policë, gjë që nuk kishte ndodhur ndonjëherë, se gjithmonë ishin dhjetë policë, dhe këta të dy pa kapele. Dy policët na pritën me sjelljen më korrekte që mund të ndodhte në Spaç. Hera e parë që na futën në kamp, pa na numëruar te dera, mirëpo kur dolëm, pamë se poshtë në kamp ishte rrëmujë. Të burgosurit kishin shkruar parulla. Disa prej tyre kishin dalë në tarracë dhe mbanin fjalime. Dallova dy nga të burgosurit moshatarë me mua, Skënder Daja dhe Dervish Bega, që i kisha shumë shokë. Asnjëherë nuk më kishte shkuar mendja që ishin aq të zotë në oratori.

Skënderi u bënte thirrje ushtarëve t'i hidhnin armët dhe të bashkoheshin me ne, se ne nuk po luftonim vetëm për vete, por edhe për ata, se vërtet ne ishim skllëvërit e tyre, por dhe ata ishin skllëvër të Enver Hoxhës. Me sa duket, duhet të vinte momenti i duhur që ata të shpalosnin karakterin.

Në këtë kohë, rreth orës 9 të mbrëmjes dhe ajo që kishte nisur në mëngjes, ishte kthyer vërtet në revoltë. Paradite deri nga ora 2, kur unë ika për në punë, ishte më tepër rrëmujë se revoltë, pas kësaj ore u kthye në revoltë dhe mbas orës 9 të mbrëmjes, kur po errej, u kthye në kryengritje, se u shqyen edhe birucat. Në birucë rrinin nëntë ose dhjetë vetë. Fillimisht, ishin tre biruca dhe më vonë u bënë pesë. Midis të mbyllurve në birucë, ishte edhe Tomor Allajbeu, nipi i Abaz Ermenjit, djali i motrës. E kisha shok, haja bukë me të. Tomori e kishte filluar me seri birucash, kishte tre muaj dhe bëri tre vjet birucë.

E dënuan për agjitacion e propagandë, po e vërteta është se atij i kërkuan të shkonte në Francë për të helmuar dajën e tij, Abaz Ermenji

dhe meqë kundërshtoi e futën në burg. Ishte i dënuar deri në vdekje, por me vdekje të ngadaltë. Këto i dimë vetëm ne që ishim shokë të afërt të tij. Në vitin 1970 i vdiq babai dhe ai nuk pranoi të punonte më. Shprehej hapur, ndoshta i vetmi në kampet dhe burgjet shqiptare, që ka thënë hapur "Nuk punoj unë që të hajë Nexhmija Mos më pandehni budalla! Jo, në asnjë mënyrë nuk punoj". Kështu që Tomori sa mbushte muajin dhe dilte sot, të nesërmen e futnin prapë në birucë. Tomori ishte ai që e bindi Pal Zefin që të mos punonte, se ishin bashkë në birucë.

Kur u ktheva nga puna, pashë Tomorin të ulur te krevati im. E pyeta si ishte dhe i thashë: - Ju paskan nxjerrë juve? Epo shyqyr, i paska ardhur mendja komandës. - Kujt? Komanda tha jo! Por më nxori Ulsi Pashollari. Ai na nxori.

Ulsiu ishte i burgosur politik nga fshatrat e Korçës. Dy ditë para se të fillonte revolta, po hapeshin kanale për të sjellë ujën e pijshëm. Kanalet e tubacioneve kalonin midis dy kapanonëve që ishin sipër, ndërsa birucat ishin mbi kapanonët e të burgosurve.

Hafiz Sabri Koçi ishte hidrauliku i kampit. Kishte hapur një kanal midis kapanonit dhe birucave për të sjellë tubat e ujit të pijshëm. Këtë kanal e shfrytëzoi Ulsiu për t'u futur në biruca. U fut se ishte dhe i pakët, i dobët dhe e nxinte kanali. I shqeu birucat me një levë.

Ushtari që ishte në postë roje mbi biruca e ka parë, po nuk ka dashur të qëllonte, se po të donte i vriste të gjithë, se katër-pesë metra larg ishte. Pyeta Tomorin sesi i gjeti çelësat Ulsiu, që i hapi birucat dhe ma ktheu: - Çfarë çelësash, ore. I hapi me levë. E ushtari bërtiti "Ndal! Ndal!", po për të qëlluar qëlloi sipër, se po të donte na kishte vvarë. Vërtet në atë distancë afro dhjetë metra, i grinte të gjithë e i shuante, po ushtarët atje nuk ishin aq të egër sa ishin policët, ishin më njerëzorë. Atë natë mund të jenë hedhur me qindra plumba dhe nuk u vra asnjë, nga kjo kuptohet që nuk kanë qenë plumba drejt trupave tanë, por në ajër. Jam i bindur që në 700 e ca veta që ishin atje, edhe kot fare po të qëllonte dikush, patjetër që do të kishte të vvarë, por nuk ndodhi asnjë vrasje. Birucat, nuk i hapi komanda. I hapi Ulsi Pashollari nga fshatrat e Korçës, që sot nuk jeton më. Por kam dëgjuar

që disa duan të marrin autorësinë e kësaj. Këto që them i kam nga burime të sigurta dhe një nga këta ka qenë vetë në birucë, Tomori. Pse do të thoshte ai, që e hapi Ulsiu? Mund të thoshte, që na lironi filani... Të njëjtën gjë ma kanë thënë edhe të tjerët dhe fakt është se, për këtë akt që kreu, Ulsi Pashollari u dënua edhe me 13 vjet të tjera.

Kështu, e gjeta Tomorin te krevati im dhe më pyeti nëse kisha ujë. - Kam pagurin plot - i thashë. - Jo, jo, duhet ujë, se do të zgjasë kjo punë. S'i njeh komunistët, ti. Do ta presin ujin, prandaj merr bidonë, bucela ça ke e ik mbushi.

Dhe vërtet, ashtu ndodhi. Shkova i mbusha në çezmë. Çezmat kanë qenë mbrapa banjave. Rrugës për në çezmë shikoj rreth e qark, përmasat e mëdha që mori kjo revoltë. Stendat e emulacionit i kishin thyer dhe kishin ndezur zjarr. U afrova atje. Afër zjarrit shikoj Fatmir Llaganin nga Tirana e i them: - O Fatmir, po ngrohesh?

Në fakt, ato tre ditë të revoltës së Spaçit, kanë qenë të nxehta, mirëpo atë moment ishte natë, ora 10 apo 11, apo më shumë. - Jo, jo, - tha, - nuk po ngrohem. Ndeza këto fotografitë e emulacionit socialist dhe librat e marksizëm-leninizmit, të bëjmë zjarr për shenjë, për t'i dhënë sinjal aviacionit anglo-amerikan që do të kalojnë këtej. Nuk e ndeza për t'u ngrohur, po për t'i dhënë sinjal aviacionit që ja, tek jemi, këtu.

Vërtet, njerëzit mendonin se do të vinin... Aty gjej një shokun tim nga Vlora, Xhemal Demiri. E kishte lidhur dorën dhe ishte me gjak gjithë andej.

- O Xhemo, të kanë plagosur? -Jo, - tha. - Nuk më ka plagosur njeri, por më çau një xham. Kur u binte xhamave me kazmë, një copë i kishte rënë në dorë. Aty ishte edhe Çaush Çoku.

U ktheva dhe e çova brenda ujin, po nuk më rrihej. Të gjithë më këshillonin të mos lëvizja, se edhe tre muaj kisha. Nuk e di, çfarë më hante nga brenda. Gjithë ato parulla, brohoritje, thirrje. Mendova se diçka kishte ndodhur, që po brohorisnin aq shumë. Dola. Takova dy vetë, Zef Pasho, shkodran dhe Xhelal Çenko, kolonjar. Zef Pasho nuk e arriti lirinë, vdiq në Spaç, në 1984-ën. Zef Pasho më tha:

- Shkëlqim, futu brenda, nuk është për ty kjo!

Kur u ngjita lart, në katin e tretë kishin ngritur flamurin me shkabë, pa yll. Bedri Çoku po recitonte himnin e flamurit. Mbaroi ai e filloi Gëzim Metolli, himnin dhe poezi nga tre-katër poetë të tjerë, si Asdreni, Gjergj Fishta, Fan Noli. Na ngrihet edhe Hodo Sokoli dhe reciton prapë himnin e flamurit... Kam qenë prezent.

Roje në nder të flamurit, në një krah ishte Ndrec Çoku nga Mirdita dhe në anë tjetër, Shuaip Ibrahim nga Shkodra. Ishin me qindra të tjerë, dyqind a treqind vetë që rrinin gatitu para flamurit. Sa mund të ketë qenë ora në momentin e ngritjes së flamurit nuk e di, se nuk kishim orë, por ka qenë mesnata e datës 21, duke u gdhirë 22 maj. Me saktësi nuk e jap orën, por sipas veprimeve që bënin ushtarakët, unë jam i bindur që ka qenë mesi i natës, kur u ngrit flamuri. Ishte një ngjarje vërtet emocionuese.

Kishte tridhjetë vjet që flamuri ishte me yll dhe arriti të ngrihet në burg, pa yll. U bëra kureshtar, kush e ngriti flamurin, cilët ishin ideatorët, mirëpo atë ditë nuk e merrnim dot vesh. Vetëm pas nja katër-pesë ditësh e mora vesh. Flamurin e ka ideuar Neim Pashaj nga Dorëzi i Tepelenës, që sot ka vdekur dhe Hajri Pashaj nga Hekali. Në ato rrëmuja, nuk mund të thuash që kishin drejtues, se nuk kishte një drejtues. Por pasi u zgjerua, filluan të marrin masa organizimi. U thirr një komitet shpëtimi me përfaqësues nga një burrë nga çdo krahinë. Meqë Shqipëria kishte dymbëdhjetë qarqe, i nxorën dymbëdhjetë veta. Revolta po mernte formë vërtet të organizuar. Flamurin e kanë ideuar një grup me katër-pesë vetë, të cilët u arrestuan pas pesë ditësh, jo që në datën 23 maj, me të parët që u dënuan menjëherë, sepse u zbuluan më pas dhe këta kanë qenë: Neim Pashaj, Feti Kumaraku, Nesim Dashi, Rexhep Lazri dhe një tjetër dhe kishte ndodhur kështu, që gjatë bisedave Neimi dhe Feti Kumaraku thonë të sulmonin postërojat e armatosura. Mirëpo do të vriteshin njerëz. Epo, në luftë vriten, po thoshin. Kurse Neimi hidhet e thotë:

- Si bëhet një luftë, pa flamur? - Flamurët janë me ye - ia preu Fetiu. - Kam unë jorganin e kuq, do ta shqep, po ai është me lule të bardha? Nuk bëhet. Mendonin se ku do të gjenin cohë për flamurin. Rexhep Lazri ishte dibran dhe flinte afër një dritareje, një kat mbi mua. Dritarja nuk kishte

perde dhe ai nuk flinte dot gjumë nga drita që i binte në sy. Rexhepi kishte hequr bezen e stendave të emulacionit, e kish mbledhur në një copë druri dhe e kishte vënë te dritarja. Kujtohet njëri nga këta, një Murat, nuk jeton më, kujtohet që Rexhepi kishte bezen dhe shkojnë ia marrin. Rexhepi që nuk mori pjesë fare në revoltë, vetëm se kishte bezen e kuqe, u dënua edhe me 11 vjet. Sepse bezja u bë flamur.

Po kush do t'ia bëjë shqiponjën? Piktori i kampit, Robert Morava, punonte në bibliotekë, në zyrë. Shkojnë i thonë, por nuk pranoi. Mersin Vlasi nuk ishte piktor, por amator. Kishte bërë 7-8 vjet burg dhe ishte dënuar për së dyti. Shkojnë i thonë Mersinit. Patjetër - tha, - por s'kam bojë.

Ndrec Çoku shkoi i mori bojën, piktorit Robert Morava. Boja ishte pak e trashë dhe nuk mjaftonte. Duhej holluar pak. Mori benzinë dhe e përzieu. Ata që ishin aty e ngacmonin Ndrec Çokun. – Jam tuj gatu hallvën për vdekjen e Enver Hoxhës - thoshte Ndreca. Që atëherë, Ndrecës i ngeli epiteti “Ndrec Flamuri”. Shqiponjën e bëri Mersini, në bazë të një kutie duhani që kishte një shok. E mori për model dhe e zmadhoi. Bezen ia morën Rexhep Lazrit. Ideja ishte nga Neim Pashai dhe piktura nga Mersin Vlasi. Duhej edhe shkopi i flamurit. Shkopin e bëri një mirditor, Gjetë Kadeli, që ishte burgosur për “tentativë arratisjeje”, pasi edhe i ati i ishte arratisur në Amerikë dhe kështu e ngritën në tarracën e katit të tretë. Beteja e flamurit u zhvillua të nesërmen në mëngjes, duke gdhirë data 22 maj, kur policët po godisnin flamurin dhe thoshin “Hiqeni atë sorrë, nga maja e pallatit”. Data 22 ka qenë e vetmja ditë që kampi ose burgu, ka qenë pa policë. Krejt komandën në kamp e kishin të burgosurit që urdhëruan që asnjë ushtarak, të mos shkelte brenda territorit me gjemba.

Jashtë ishin bërë tre rrethime. Ushtarët i hoqën se u hutuan, vetëm me policë. Prunë policë nga Rrësheni për të zëvendësuar ushtarët dhe shtuan rrethimet. Sollën ushtarë nga gjithë veriu dhe mobilizuan forcat vullnetare nga disa rrethe: Mirditë, Kukës, Dibër, Pukë, Lezhë, Mat.

Me forcat vullnetare dhe ushtarake u bë shtetrrëhim në të gjithë Mirditën. Revolta u kthye në kryengritje.



Kutia e duhanit që shërbeu si model për shqiponjën që u vizatua në flamurin e Revoltës së Spaçit.

Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar

Në 22 maj, rreth orës 9, një përfaqësi nga Ministria e Brendshme që e drejtonte Feçor Shehu, zëvendësministër, që nga tarraca e parë ku ishin kapanonët e ushtarëve, rreth 5-6 metra, apo 10 metra nga godina trekatëshe, me altoparant filluan të thërrisnin "Dorëzohuni!" dhe të ushtronin presion. Kërkuan një përfaqësi që t'u shpjegonte se çfarë kërkonin të burgosurit. Mirëpo nuk ishte e lehtë të nxirrje një përfaqësi, se kjo do të thoshte që të çojë disa nga shokët në gojë e ujkut, sepse ata patjetër ishin të eliminuar. Megjithatë, të gjithë të burgosurit pranuan të shkonin si përfaqësues. Pastaj u zgjodhën tre përfaqësues: Paulin Vata nga Malësia e Madhe, ish-oficer, i dënuar në Jugosllavi dymbëdhjetë vjet dhe këtu i dënuar njëzet e pesë vjet, Nuri Stepa ishte nga Vlora dhe Hajri Pashaj, nga Mallakastra. Paulinin e kisha shumë shok dhe Hajrinë e kisha nga ana ime. Hajrinë nuk e zgjodhi kush, por kërkoi meqë zëvendësministri ishte nga Hekali dhe ai donte të ballafaqohej me të. Dolën në takim, nga ora 10 paradite. Por takim nga larg: këta tanët poshtë, ata sipër. Për kushtet, foli Paulini dhe Nuriu. Kërkuan të hiqej puna në minierë, mos të punonin në minierë të burgosurit politikë, të riktheheshin amnistitë e një sërë kërkesash që, natyrisht, nuk morën përgjigje aty, por me demok që do i shikonin...Pasi mbaruan Nuriu dhe Paulini, hidhet Hajri Pashaj dhe këto i kam dëgjuar vetë. U thotë: - Nuk duam premtime boshe. Duam fjalë burrash, po ti nuk ke shumë burrëri, se të njoh mirë ty.

Ai bëhet kurioz dhe sheh nga lart poshtë, sepse tarracat kështu ishin, ne ishim poshtë, ata në krye. -Kush je ti që më akuzon mua për të pabesë?- tha. Ndonjë nga ata që kish aty, si duket i ka thënë që është filani dhe ai pyeti: - I biri i Zenel Pashait? - Po - u përgjigj Hajriu - i biri i tij jam. - Edhe ty - i tha zëvendësministri - do të ta bëjmë siç ia bëme Zenel Pashait, në Gjirokastër. Siç vdiq ai në burgun e Gjirokastrës në kala, në '48- ën edhe ti ashtu do të përfundosh, si ai kriminel.

- Po ku ka më kriminel se ty? - i tha Hajriu. - Ti je një sahanlëpirës, një maskara ordiner. Ti i lëpije çizmet Zenel Pashait. Kur ai zbriste nga kali, ti e ulje kurrizin që ai të vinte këmbën. Po ti je kriminel. Kjo ka qenë ndeshja e Hajriut, me zëvendësministrin. Jam dëshmitar vetë. Si përfundim, u ndanë me këtë gjuhë. Ata lanë si

afat që deri në pesë pasdite revolta të kishte marrë fund, të dorëzoheshim, në të kundërt do të përdornin të gjitha mjetet e dhunës. Pikërisht në këtë kohë, në kamp u ndërpre uji dhe ushqimi. Ishin tri ditët më të nxehta që kam parë unë në muajin maj: 21- 23 maj, ishte rast i jashtëzakonshëm për atë krahinë. Ca tensioni, ca ngjarjet dhe mosha e të burgosurve të vjetër, vuajtjet e gjata nga 20 e 25 vjet, i bënë shumë njerëz të dilnin nga vetja. Mungesat bënë punën e tyre. Ata që kishin siguruar ujë si unë, e ndanin me të tjerët. Kur shikoje tjetrin që i thahej buza për një pikë ujë, nuk mund të pije. Unë i ndava të dy bucelat që kisha për pleqtë, se aty kishte pleq nga 70-80 vjeç e me sëmundje. Vajti ora 5, kaloi 6, 7, 8, asgjë nuk ndodhi. Brenda, vrulli filloi të binte. Mungesa e ujit, ushqimit, sëmundjet, të moshuarit që po shfaqnin probleme, etj. Data 22 maj u mbyll me këto kushte, kurse data 23 do të sillte një ditë tjetër, një ditë dhune. Rreth orës 8 në mëngjes, Kasëm Kaçi, drejtor i përgjithshëm i policisë në atë kohë, doli me altoparant dhe kërkoi që të gjithë të burgosurit të mblidheshin te fusha - një shesh që mund të ishte e shumta 100 m. Në atë shesh mund të mblidheshin shtatëqind burra. Ne kishim dy ditë në liri të plotë, dy ditë pa policë. Më parë, vinin policët që na godisnin me shkopinj e me zor vinin rregull. Njerëzit ishin me sy të palarë e kishin etje. Mua, ky moment më gjeti në banje. Më thotë një shok: - Ore, ti, shko shpejt, se unë i kam njëzet e pesë vjet.

Unë jam duhanxhi dhe po kërkoja qesen e duhanit. Kthehem të shikoj në dhomë. Aty ishin Ali Hoxha, Fiqiri Muho, Tela Cako dhe Sulo Veshi. I pyes për qesen time të duhanit dhe Fiqua më thotë që e kisha mbi krevat. Unë, vrap drejt krevatit. Në këtë kohë, policët rrethuan fushën. Ca nga hutimi e ca nga shpejtësia, u godita te dërrasa e krevatit të sipërm. Aq fort e godita kokën, sa rashë mbi krevat dhe humba ndjenjat, nja dy a tre minuta. Vetëm ndjeva kur po më lëpinte qeni, Tarti. Më lëpinte nga duart dhe faqet dhe më solli në vete. Pastaj u kujtova unë të dilja në fushë. Kur shkova atje, afër gjysma apo më shumë ishin mbledhur, kështu që unë ngela në fund. Vjen një polic e më thotë: - Po ti, pse në fund? Kë sfidon? Ai ishte polici më i mirë. Nuk vuri dorë të paktën. Togat e policëve nisën të lidhnin dhe të shoqëronin të burgosurit. Mua më erdhi radha ndër të fundit dhe më kanë lidhur me një ish-oficer nga Kavaja, Nexhat Gjoci, pas meje ishte Gëzim Metolli.

Si u mbyll revolta?

Shkëlqim Abazi: Nga shtatëqind vetë që ishin në kamp, vetëm katër qëndruan dhe u përballën me forcat sambiste: Dashnor Kazazi, Skënder Daja, Jorgo Papa dhe Dervish Bejko. Këta u bënë rezistencë forcave sambiste. I kam parë vetë. Kur i nxorën nga kampi, kanë qenë katër barela dhe ka pikuar gjaku mbi këmbët e mia, se isha në rrugë. Ata të katër u dënuan. Pasi nxorën këta me barela, filluan që në çdo dhjetë emra njërin e merrnin. Atë ditë morën rreth shtatëdhjetë e ca, apo tetëdhjetë vetë. Thërrit emrin, lidh e hidh në makinë. Mbush makinat e nis për në Tiranë. Sa makina nisën nuk jam në gjendje ta them. I pari që morën nga ne që ishim ulur, ishte Hajri Pashaj. Para se ta merrnin, zëvendësministri doli mbi ledh edhe tha: - Atë karafilin e fshatit tim ku e kam?

- Këtu jam - iu përgjigj Hajriu. - Kemi punë, ne sot. Ti paske qenë i biri i babait - i tha zëvendësministri.

- Mua mund të më bësh atë që i bëre babait, po unë do të mbetem në historinë shqiptare, kurse ty shokët e tu, do të të shtrydhin si limon dhe do të të zhdukin si qen - ia ktheu Hajriu. Kjo fjalë e Hajri Pashait në 23 maj 1973, dhjetë vjet përpara sesa Feçor Shehut, t'i ndodhte pikërisht ashtu, ishte një profeci. Unë e kam dëgjuar me veshët e mi dhe si unë, edhe nja shtatëqind të burgosur të tjerë, madje dhe nja shtatëqind policë dhe ushtarë të tjerë. Ai e tha me zë të lartë, se ishte i bindur për atë që tha.

Pas dy minutash e morën të lidhur. Kemi dëgjuar vetëm ulërimat që vinin nga barakat e komandës dhe nuk kemi më dijeni tjetër për Hajrinë nëse e dënuan me vdekje.

Po atë ditë në darkë, katër veta u dënuan të vdekur dhe jo të gjallë. Përveç Pal Zefit, të cilin e kanë marrë nga biruca, tre të tjerët i kam parë vetë. Hajriut, nuk iu dëgjua më ulërima, pas dy minutash, Skënderin dhe Demir Bejkon, i kanë nxjerrë me barela që rridhnin gjak, të vdekur, në mos gati të vdekur. Të nesërmen i pushkatuan, na kanë treguar fotografitë. Ne nuk i pamë, ku i pushkatuan. Thoshin në Shënpal, po asnjë nuk di ndonjë shenjë nga eshtrat e atyre të katërtave. Në gjyqin special u dënuan dymbëdhjetë vetë: - Katër me vdekje që u ekzekutuan të nesërmen

dhe tetë, me nga njëzet e pesë vjet burg. Mund të them me bindje të plotë, se një pjesë e atyre tetë vetëve, nuk kanë qenë fare pjesëtarë në atë revoltë. Jam i sigurt për këtë, se i kam pas edhe miqtë e mi.

Sami Dangëllia nuk ka qenë fare, por u dënua me njëzet e pesë vjet në gjyqin special. Samiu ishte i burgosur që në 1944. Ka patur aq shumë eksperiencë, sa nuk futej në këto gjëra. Po ashtu Luan Koka, nuk futej kollaj në këto gjëra, ishte gjë e zgjuar. Hodo Sokoli ishte shumë inteligjent...

Sa vetë u dënuan atje?

Shkëlqim Abazi: Revolta e Spaçit mbaroi në datën 23 maj. U dënuan dymbëdhjetë vetë, katër me vdekje, tetë me nga njëzet e pesë vite burg. Të tjerët i dërguan në hetuesi speciale në Tiranë dhe i ndanë në katër grupe.


Në datën 23 kanë marrë rreth 80 vetë nga kampi, për t'i ridënuar. Nga këta, fare pak shpëtuan nga dënimi. Dënimet varionin 11 vjet, ishte i fundit që u dënua, Rexhep Lazri, pa marrë pjesë fare, vetëm se i morën bezen që u bë flamur.

Pas kësaj, unë mbaj mend që të kenë fituar pafajësi, vetëm një grup i vogël, nja shtatë a tetë, apo dhjetë vetë. Ndër ta ishte edhe Zef Ashta, se e kujtuan si Zef Pëllumbin, e kujtuan si prift, mirëpo prifti, për fat të mirë tri-katër ditë para revoltës, ishte transferuar në Ballsh. Zef Ashta ishte ngjitur me mua. Kur erdhi radha, u çua Zefi dhe ata menduan se ishte prift.

- Lere këtë, se do të predikojë. Mirëpo Zefi kishte studiuar për oficer në Itali, jo për prift. Kështu mbaroi Revolta e Spaçit.

Kur u liruat nga burgu, me se u morët? Po në demokraci?

Shkëlqim Abazi: Jam liruar në 27 korrik. Kisha bërë shkollën e mesme, por kjo shkolla e burgut ka qenë më e madhja, shkollë e vërtetë. U martova në vitin 1980. Në komunizëm, gjatë gjithë kohës, nuk m'u nda kasma. Pas vitit 1990 kam bërë shkollën e lartë. Desha të isha pjesë e shtetit, që të bëja diçka të mirë për shtetin. Mbarova dy shkolla të larta, Juridikun dhe Akademinë e Rendit, të dyja shkollat i kreu duke i ndjekur drejtpërdrejt.



Ylber Merdani

“E qëlluan flamurin, po s’e kapi asnjë plumb. Nuk e kapte plumbi!”

Ylber Merdani, i biri i Fatimes dhe Fuatit, lindur më 28 maj 1940, në Korçë. Në vitin 1965 u dënua nga gjykata e Librazhdit dhe u pushua nga puna si arsimtar, për shkak të një sërë shkrimesh të quajtura me natyrë pesimiste. Ai vijoi të shkruante atë që jetonte. Poema “Një lamtumirë e hënëzuar”, e shkruar në 1965-ën në Stravonjë, u pasua nga krijime të tjera të shkruara në kohën kur u internua në katundin Pulahë të Oparit, në vitin 1967. I detë e tij në shkrimet: “Të dënuarit”, “Monologu i një vetëvrasësi”, “Malet”, “Motrës dhe vëllait për ditëlindje”, etj., u bënë shkak për akuzën tjetër, “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”¹⁷. Pas internimit u arrestua më 9 qershor 1969 dhe me vendim të Gjykatës së Rrethit Korçë u dënua me tetë vite burg në Spaç ku u përfshi edhe në revoltën e vitit 1973.

Ju falënderojmë që jeni shprehur i gatshëm, të ndani disa nga kujtimet tuaja rreth Revoltës së Spaçit. Si nisi persekutimi juaj?

Ylber Merdani: Jam Ylber Merdani, pasardhës i një familjeje të vjetër qytetare, nga Korça. Prindërit kishin një firmë tregtare, “Magazia-Drejtësia” dhe

ishin tregtarët më në zë në qytet. Persekutimi i familjeve tona nisi që kur vuri këmbën thundra e hekurt e diktaturës, në fillim të vitit 1945. Familja iu nënshtrua shumë konfiskimeve, kurse kryefamiljarët, gjyshi, babai e të tjerë u burgosën me qëllim që të tregonin ku e kishin floririn e mbledhur nga tregtia.

Sipas të dhënave të publikuara në shtypin e shkruar, firmës “Merdani” i kanë marrë katër kuinalë e gjysmë flori. Në vitin 1951 na nxorën nga shtëpia. Babain e arrestuan, bashkë me dy tregtarë të tjerë, vëllezërit Ndreku dhe Xhovi Kajo. Ne na çuan në një shtëpi me mure të hapura dhe pa tavan. Më pas, na çuan te bodrumet e babait të Vaskë Miftës, ku vetëm ne fëmijët mund të rrinim në këmbë, aq të ulëta ishin. Dyshemeja ishte me kalldrëm. I zoti i shtëpive, kur e thirrën në Këshillin e lagjes, u tha: “Nëse doni t’ua lehtësoni dhimbjet sklleverve, hiqini nga unë! Dërgojini ku të doni, por një grua me katër fëmijë të vegjël unë s’mund ta mbaj aty. Nuk mund ta durojnë atë lagështirë”. Aty kemi banuar gjer më 1957-ën. Babai i ndjerë bëri 16 muaj në hetuesi, pastaj në burg. Doli nga burgu me një dorë gjysmë të paralizuar

17. Fondi nr. 1 hetimor- gjyqësor, dosje 10016-A. Vendim nga Gjykata Popullore e Rrethit Korçë, nr. 61 Akti, nr. 63 i Vendimit, data 26.08.1969. Arkivi i AIDSSH-së.

“Një popull që ruan në memorie të kaluarën, ka në dorën e tij çelësin e burgut, se nuk burgoset dot kurrë e nuk rikthehet më tek e kaluara.”

prej torturave. Për Xhovin, që u arrestua tok me babain, u hap lajmi sikur kishte gjetur një copë xhami dhe kishte prerë damarët... Në të vërtetë, siç na tregoi më pas babai, ua digjnin këmbët në mangall me prush. Xhovit iu dogjën aq shumë këmbët, sa vdiq. Ndërkohë, të dyja motrat e mia dolën mësuese. Edhe unë mbarova shkollën për mësues. Kemi vuajtur shumë në kohën e triskave. Ka qenë koha e vdekjes. Ata që punonin ishin të pajisur me triska dhe merrnin nga 400 gramë deri në 700-800 gramë bukë në ditë, kurse ne që s'kishim asnjë në punë, ne s'kishim as triska, as bukë. Gjyshi im, babai i nënës, ka qenë mësues. Si shumë të tjerë, ishte emigrant ekonomik në Amerikë dhe ai na ka mbajtur, që mbijetua. Thujse pjesa më e madhe e jugut të Shqipërisë, e ka bukën prej Amerikës.

Në vitet 1957-1966 apo 1967, për gati një dhjetëvjeçar, kur ndryshoi kursi dhe shkëputëm marrëdhëniet me rusët, një copë herë lufta e klasave nuk kishte më ashpërsinë e mëparshme,

pati njëfarë zbutjeje. Pastaj filluan kinezërit: ato fjalimet programatike, të vitit 1967...

Atëherë, nisën përsëri të shikonin nga familjet e “reaksionarëve”. Mua dhe motrën na pushuan nga puna, se Komiteti Ekzekutiv kishte marrë vendim për internim. Në mes të natës na vjen makina me policët dhe ne zgjohemi të llahtaritur e jo vetëm ne, por edhe tërë lagja nga trokitjet te dera e hekurit dhe nga thirrjet e policëve: “Shpejt, bëhuni gati! Është marrë vendim. Do të internoheni”. Ishim prindërit, unë, im vëlla - që atëherë ishte në vitin e tretë të gjimnazit - dhe motra ime mësuese. Nuk na lanë të merrnim asgjë me vete. Ishin ca romë që ngarkuan plaçkat. Unë dhe babai kundërshtuam, por ata e kapën babanë prej gryke: “Ti pse kundërshton?” Unë, si djalë njëzet e shtatë vjeç, nuk durova dot. Siç më kishin kapur dy policët, ngrita këmbët e godita njërin nga hamajtë që po merrnin plaçkat. Na morën dhe na dërguan të gjithëve në polici.

Kur ndodhi arrestimi juaj?

Ylber Merdani: - Më 9 qershor të vitit 1969. Më kishin spiunuar, për poezitë që shkruaja. Tani vonë, kur kërkova për të parë dosjen, gjeta që mua më kishte spiunuar miku im, P. B, bashkë me të shoqen. Ky ishte me pseudonimin "Numërotori". Po kishte edhe ca të tjerë, në dosje... Megjithëse atëherë, që gjatë hetuesisë, unë pothuajse e kuptova se cili më kishte spiunuar. Lëkura jonë ishte regjuri me persekutimin...

A ju kanë torturuar në hetuesi?

Ylber Merdani: Në fakt, disa herë hetuesi më ka goditur te kërcinjët. Hetuesin Safet Bari e kisha në lagje. Unë kërkova që të takoja kryetarin e Degës, Niko Ceta, meqë ky kishte pasur lidhje me babain. Mirëpo hetuesi ma preu: "Pse kërkon ta takosh?" Unë nuk u përgjigja më. Më pas, vazhdoi me presione psikologjike. Më thoshte, se ishte marrë vendim për nënën, që do ta internonin. Veç presioneve psikologjike, edhe më goditi nja dy herë.

Sa kohë ju mbajtën në hetuesi dhe a tentuan t'ju bënin bashkëpunëtor të Sigurimit të Shtetit?

Ylber Merdani: Hetuesia zgjati rreth tre muaj e ca, deri në shtator, por nuk tentuan të më tërhiqnin në bashkëpunim.

Si u zhvillua gjyqi? A ishin të pranishëm familjarët tuaj aty? Me çfarë akuze ju dënuan?

Ylber Merdani: Akuza ishte për agjitacion-propagandë dhe dënimi ishte tetë vjet burg. Të pranishëm gjatë gjyqit, ishin motra dhe të dy prindërit. Donin të dënonin edhe motrën, meqë nuk kishte bërë denoncim. Për të ulur personalitetin tim, në sallën e gjyqit më nxorën si dëshmitar një brigadier që tha për mua, se isha dembel. Ndërsa një veteriner tha se unë shaja kinezët.

Si ju çuan për në Spaç?

Ylber Merdani: Na lidhën dy e nga dy. Nja katër a pesë kishin qenë në Spaç, nuk di pse ishin në qytet dhe u kthyen prapë me ne. Kur hymë

brenda, pashë plot njerëz që i kisha njohur edhe jashtë, si: Armir Vula, Andon Vako boksieri, njëri kishte qenë mësues më parë edhe shumë të tjerë. Nga Korça njoha shumë, të cilët më njihnin më tepër nga familja ime.

A ju caktuan për punë në galeri?

Ylber Merdani: Hetuesi në burg quhej Medi Noka. Ishte nga Librazhdi. Kishim pirë nga një gotë me të kur unë isha mësues në ato anë. Ndërsa po na ndanin, ai i tha oficerit: "Ky ka qenë me syze qëkur ishte mësues. Garantoj unë për këtë." Kështu që prej syzeve dhe ngaqë ky tregoi që më njihnte dhe doli garant për mua, nuk më futën në galeri. Më caktuan të laja kapanonet dhe të bëja çdo gjë, si korrier i atij kapanoni, por në një kapanon ishin njëqind vetë.

Një ditë, hetuesi më thirri në zyrë dhe më pyeti: - Ku fjeti filani? - I përgjigjem: - Të thashë, o Medi, që nuk e bëj dot këtë punë. Unë ia thashë qëllimisht, që nuk bëhem spiun, edhe më hoqën. As dy muaj nuk më lanë dhe më hoqën. - Lëre, - thanë, se nuk është për atë punë. Më futën pastaj, tek "Investimet". Investime quheshin punët që bëheshin kur hapej ndonjë rrugë, sheshe, pra te brigada e mirëmbajtjes.

Ju keni qenë dëshmitar i revoltës së Spaçit. A mund të na tregoni sesi ndodhi, çfarë ndodhi? Si vepruat ju?

Ylber Merdani: Në atë periudhë më kishin caktuar që të kujdesesha për skaldabanjën: çoja qymyrin dhe drutë për ta ndezur. Ishin dy depozita, njëra me ujë të ftohtë dhe një tjetër që e ngrohta. Pastaj i kombinoja të dyja, sa të bëhej uji i ngrohtë për dushet. Kur shpërtheu revolta, ata më pleqtë më thanë të mos e hapja më ujin e dusheve, se kishin për të na lenë pa ujë. Kështu që e ruajta ujin. Ne po flinim te kapanoni pranë fushës së volejbollit, kur dëgjova zhurmë dhe u ngrita. Dola jashtë dhe pashë të pozicionuar Pal Zefin. Kishte vënë kurrizin te baraka ku ishte biblioteka, mbante një hekur në dorë e thoshte: - Të mos afrohet njeri, të bëjë hesapet mirë!

Policët lajmëruan punëtorin operativ, Fevzi Liço dhe ky erdhi. Ende nuk kishte filluar e madhja. - Ti do të hahesh me qeverinë? - i tha Fevzi Liço, Pal

Zefit. - I kam bërë hesapet, me kë do hahem, - ia ktheu Pali. Vjen edhe Medi Noku dhe Pal Zefi i thotë: - Medi, hamë bukë më një kazan. Nuk dua të të dëmtoj ty.

Kishin rreshtuar ata të Brigadës së Investimeve, pastaj dhe ata të armatorëve. Ne kishim një qen, që e quanim Tarti. Ai shoqëronte çdo grup të burgosurish kur shkante dhe kur kthehej nga puna: shoqëronte turnin e parë, deri te kthesa dhe kthehej me turnin e tretë, shoqëronte të tretin e kthehej me të dytin. Në kohën kur u radhitën të tërë dhe ende nuk kishte ndodhur përplasja, qeni iu hodh një polici. Ky iu shmang, por Tarti i zuri kapelën dhe ia rrëzoi. Atëherë iu hodhën policët. Tarti i zinte nga këmbët policët. Ai ishte qeni i të burgosurve, e kishim rritur ne, ishte më shumë se njeri. Po Tartin e dënuan si në mesjetë: ia prenë kokën me lopatë.

Në atë kohë u dëgjua Gjika, numërues te brigada e parë, që bërtiti: "Po na e marrin djalin në syrin tonë, po është turp". Kështu nisi përleshja. U sulën Met Pojani, Dashnor Kazazi e të tjerë. Këta që u sulën ishin të rinj që ishin marrë me mundje edhe u ranë policëve. Policët lanë kapelat dhe ikën.

Pjetër Gjoka hipi diku në një qoshe dhe, i lumturuar që po ndodhte kjo, bërtiste: "Pasha nderin, paska burra Shqipëria! Pasha Zotin, u ngjallën të vdekurit! Ndhimoi burrat e Shqipërisë, o i shenjti Shna Ndou!"

Kam qenë aty. Kur i kujtoj më vjen për të qarë: ishin momente të jashtëzakonshme. Një burrë plak i entuziazmuar, që kishte bërë 20 e ca vite burg, i lutej Zotit. Kur e kujtoj, më rrëqethet mishi. Policët dolën jashtë rrethimit të parë dhe biseduan sesi do t'ia bënin. Filluan po i thërrisnin njëri pas tjetrit, që të dorëzoheshin.

Nisën debate të mëdha. Sulejman Manoku debatonte me Syrja Lamën dhe Njazi Bylykbashin. U ngrit problemi i ujit me acid, u ngrit problemi i margarinës dhe i ushqimit të pakët dhe të keq, i bukës që mbante era naftë. Pastaj, problemi që policët na zgjonin kur ne sapo na kishte zënë gjumi, p.sh., ne ishim turni i dytë dhe ndërsa ishim duke fjetur, ata vinin që të zgjonin turnin e parë. I binin bilbilin mu në mes të kaponit, gjoja që

të vinin njëfarë rregulli. Ne flinim ndërsa ata na zgjonin me bilbil. Kishte edhe shumë gjëra të tjera...Pastaj, unë me Rasim Pashollarin ngjitëm traktet e krahut nacionalist që kërkonim Amerikën. Një tjetër, Ferit Lopa, bërtiste: "Këta do na vrasin. O burra, të shpërthejmë mapon dhe të ngopim barkun me petulla dhe arra!" Atje në oborr ishte dhe një si tabelë e emulacionit socialist. Unë, siç e kisha tipin, i them Emin Gjokës: "A e djegim?" Nuk e zgjatëm, ia vumë zjarrin dhe e dogjëm. Kështu, me të tëra gjërat që ndodhën, u bë e madhe.

Erdhi drejtor Shehu dhe filloi po bërtiste që andej nga lart: "Ç'është kjo kryengritje? Kryengritja bëhet me armë. Ju jeni të vdekur aty!"

Dolën edhe ata të birucave. Birucat ishin në zonën e ndaluar, po edhe ata i zbërthyen dyert e birucave dhe erdhën. Ushtarët qëlluan, por Zoti i shpëtoi pjesëmarrësit e revoltës, se ushtarët qëlluan tamam. Vetëm njëri mbeti në birucë. Mbas revoltës, kur ne e pyetëm se përse nuk doli si të tjerët, na tregoi se i kishin mbetur vetëm 2-3 muaj burg dhe pastaj lirohej. Po të dilte nga biruca dhe të bashkohej me të tjerët, do ta ridënonin.

Skënder Daja u bëri thirrje ushtarëve: "Edhe unë para 3 vitesh, ushtar kam qenë! Ne jemi vëllezërit tuaj, jemi baballarët tuaj këtu! Mos na qëlloni ne, por qëlloni oficerët që ju gënjejnë!"

Përfundimisht, ne e pamë që po shtoheshin dritat rreth e qark: makinat s'kishin të numëruar. Dhe zjarr rreth e rrotull. I tërë korpusi i Burrelit, erdhi aty. Natën e parë, u ngrit dhe flamuri. Ndrec Çoku e ngriti flamurin. Unë, kur e shikoja atë, e ngushëlloja se ishte më i dobët se unë. Aq i dobët, por sa zemër të madhe kishte! Në katin e tretë e ngriti flamurin dhe ne të gjithë i thoshim "Ndrec flamuri". Unë di që flamuri u bë nga faqja e jorganit të Naim Pashait dhe i ndjeri, me Gëzim Laçin, e pikturoi. I them Ali Hoxhës, trompist: - Hajde të ekzekutojmë himnin e flamurit me trompë! Më thotë: - Ylber, unë dhe nja dy vite kam dhe lirohem.

Nejse, nuk ka më rëndësi ajo...E qëlluan flamurin të nesërmen, po s'e kapi asnjë plumb. Nuk e kapte plumbi! Në kat të tretë ishte flamuri. Nuk e kapi asnjë plumb. Pastaj, na e prenë ujin.

Kur ua ndërprejnë ujin, a e kishit ujin e rezervuarëve?

Ylber Merdani: Po, po, prandaj më mësuan mua. Bedri Blloshmi, në romanin e tij për Spaçin, më përmend edhe mua. Ndodhi siç tregohet për kohën e Skënderbeut, në rrethim, kur turqit i prenë ujin. Asnjërit nuk i vajti mendja që të përfitonte nga kjo rrëmujë dhe të ikte ose të arratisesh. Kishte diçka aty... Secila krahinë kishte nga një plak, për shembull ne kishim Ahmet Mullahun.

Ditën e tretë ata kishin sjellë edhe shefin e lëndëve kimike. Donin të hidhnin lëndë kimike. Përfundimisht, ditën e tretë, me shtimin e forcave, na zunë të tërëve, na lidhën dhe na kaluan në zonën e ndaluar. Nja pesëmbëdhjetë vetë kishin gjetur ndonjë dru, ca hekura edhe ca tulla dhe rezistuan më gjatë, por e pësuan më keq. I nxorën me barela, gjysmë të vdekur. Morën dymbëdhjetë kryesorët. Ndërmjet tyre Sami Dangëllia, burrë plak, Foto Sokoli, burrë plak shkodran, dhe i çuan mbrapa rrethimit të dytë. I futën në një dhomë dhe nisën t'i rrihnin me bishtat e kazmave. Që të mos dëgjoreshin ulërimat dhe rënkimet e atyre fatkeqve, policët nisën të këndonin: "Ne përpara po marshojmë, me Enverin fitimtar."

Donin të pushkatonin gjashtë veta, por pushkatuan katër. U ridënuan 82 vetë. Dervish Bejko u pushkatua. E njihja që jashtë burgut. Këta e futën brenda dhe nuk e lanë më të ikte! Mbas revoltës çfarë nuk hoqëm: policët kishin leje të të rrihnin e të bënin si të donin. Ca që s'kishin marrë pjesë në revoltë, i lironin, disa të tjerë vinin i arrestonin. Nuk kishte më as pako nga shtëpia, as takime. Kampi u vu në gjendje hetuesie...

Mua më morën, më vunë një dërrasë me perona në kurriz edhe hipnin e shkelnin mbi dërrasë. Trupi m'u bë gjak e m'u hapën dy vrima.

A ju ridënuan?

Ylber Merdani: Jo, nuk më ridënuan. Bëra vetëm ato tetë vjet. Kishin marrë vendim, si duket, të më internonin në Mavrovë të Vlorës. Familjen ma kishin internuar për herë të dytë, në Shtyllë të Vithkuqit, prandaj kur më pyetën se ku do të banoja, unë u thashë "te familja". Kështu që më internuan aty dhe ndenja në internim, gjer në vitin

1990. Ika nga Korça, në 1967-ën. Gjithsej, njëzet e katër vjet burgje dhe internime.

A ishit i martuar përpara burgosjes, apo kjo ndodhi më pas dhe mund të na thoni diçka për këtë ngjarje të jetës suaj?


Ylber Merdani: Me gruan kemi qenë njohur si familje, që më parë. Të motrën e kisha në klasë dhe këtë e trajtoja si motër të vogël. Kur unë u burgosa, ajo ishte mësuese në Librazhd. Por edhe atë e internuan në 1969-ën, bashkë me familjen, se babai i saj ka qenë dënuar në 1947-ën me "Grupin e deputetëve", si grupi i Devollit edhe ka qenë dënuar me pushkatim. Kur ato ishin në internim, e ëma i thotë që po e kërkonte filanë. Atëherë, ajo i tregon mamasë dhe motrës që kishte një fjalë me Ylberin dhe u thotë, se do të priste deri kur të dilja nga burgu. Në mars 1977 u lirova, në prill erdhëm këtu dhe bëmë celebrimin. Rastësisht, takova një shok nga burgu, Andon Vako dhe atë e ftova si dëshmitar në celebrim. Kështu më erdhi dëshmitar shoku nga burgu.

Fatmirësisht, keni krijuar familje. Sa fëmijë keni?

Ylber Merdani: Tani jam tetëdhjetë e tre vjeç. Zoti më dha dy fëmijë. I rrita, e bëra detyrën dhe nuk ka kënaqësi më të madhe sesa kur vijnë dy mbesat dhe nipi. Nuk ka melodi më të ëmbël për mua sesa kur më thërresin "gjyshi". Edhe gruaja ime është e persekutuar, prej katër brezash. Të dy prindërit i vdiqën në Shtyllë, edhe gjyshja në Shtyllë. Vetë, bashkëshortja ime ka kryer njëzet e një vite internim. Të dy fëmijët na lindën në internim. Tok me gruan i mbyllëm internimet në vitet '90.

Keni ndonjë porosi për brezin e ri lidhur me vuajtjen që kaloi ky popull, sidomos ju, familjarët tuaj, shokët tuaj të burgut?

Ylber Merdani: Një popull që ruan në memorien e tij të kaluarën, ka në dorën e tij çelësin e burgut, se nuk burgoset dot kurrë e nuk rikthehet më tek e kaluara. Mbi të gjitha, doja të thoja që nuk ka forcë në botë, të kthejë atë destinacion që ka caktuar i madhi Zot, për secilin nga ne, prandaj fluturoni me shqiponjat. Qëndroni të ndershëm dhe mos u përzieni me sorrat dhe me minjtë!



Fatos Lubonja

“Nëse duam të
çlirohemi nga kjo
vuajtje, nëse nuk e
duam këtë lloj jete
që po bëjmë, një
nga instrumentet e
çlirimit është njohja
e së kaluarës.”

Fatos Lubonja, i biri i Liries dhe Todit, lindur më 27 prill 1951, Tiranë. U arrestua më 15 janar 1974, me akuzën “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”¹⁸ dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie. Në vitin 1979, u ridënua me 16 vjet heqje lirie. Kreu dënimin në Spaç, nga viti 1974 deri në mars 1990.

Kur ju kanë arrestuar?

Fatos Lubonja: Unë jam arrestuar më 25 korrik 1974.

A e keni ndier veten tëurvejuar përpara arrestimit?

Fatos Lubonja: Po, sigurisht. Kisha një ndjesi që me siguri do të ndodhte diçka, sepse një vit më parë, në 1973-in, u dënua babai im që e shpallën “armik i popullit”. Ne kishim dëgjuar për këto teknikat e sigurimit që të ndjekin, por ishim të rinj dhe njeriu priret të besojë që s’do t’i vijë e keqja.

Një herë mbaj mend që na ishte prishur çelësi i derës. Isha i martuar atëherë, kisha edhe një fëmijë. Banonim në një apartament. Babanë e kishin shpërngulur në Lezhë. Kanë tentuar të na hynin në shtëpi dhe mbaj mend që e kemi diskutuar atë punën e derës: Kush na e hapi, si e hapën? Pastaj na erdhi një njeri i afërt për të fjetur te ne në shtëpi. Ne thoshim: “Çudi, si erdhi ky për të fjetur këtu? Çudi e madhe!” Ky i afërm erdhi në një mënyrë që dukej sikur ndenji me zor për të fjetur. Këto ishin shenjat ku ne kapeshim dhe dyshonim, ashtu siç lindnin dyshime edhe për shokët e shkollës. Ne u arrestuam si grup. Xhaja im kishte një të dashur, që kishte një të afërm a nuk e di çfarë e kishte, i cili ishte në Sigurim. Ajo i thotë këtij të Sigurimit që Llazi, pra xhaja im, kishte fshehur në shtëpi ca gjëra. Kur babai u transferua, çoi atje edhe ca armë, dhe ca gjëra, që i kishte që nga lufta, jo se donte të bënte ndonjë revolucion. Kishe edhe ca libra, dhe shkrime të miat. Dhe ajo ia tregoi atij. Kështu Sigurimi i vendosi përgjues xhajës. Pastaj ata bënë kontroll dhe i gjetën të fshehura në tavan: librat, shkrimet e mia dhe çfarë kishim na i morën. Arrestuan edhe Vasilin, burrin e hallës, se edhe ky kishte një kobure që ia kishte dhënë xhaja.

Po juve ku ju kanë arrestuar dhe si?

Fatos Lubonja: Mbarova vitin e pestë të universitetit dhe megjithëse babain e kishin arrestuar, mua nuk më përjashtuan direkt nga universiteti. Madje edhe babain nuk e arrestuan që në Plenium, por në 1974-ën, pasi kaloi një vit. Unë po bëja zborin ushtarak universitar në Karpen të Kavajës dhe sa kishte mbaruar kampionati botëror. Ishte verë. Gjatë kohës që isha në zbor, më kishte lindur vajza e dytë, Tetis. Po kthehesha në Lezhë, ku kishin çuar familjen time. Nëna më kishte njoftuar me telegram, se Zana kishte lindur një vajzë të bukur si Ana, vajza e madhe. Doja të merrja leje, mirëpo mezi më dhanë dy ditë leje.

Shkova, e pashë vajzën aty, në ballkon, te materniteti i Lezhës dhe u ktheva në zbor e me të mbaruar zbori, përsëri u ktheva në shtëpi. As dy javë ose nja dhjetë ditë më pas, trokasim në derë që në orën pesë të mëngjesit. Ne jetonim me idenë që diçka do të ndodhte, por prapë njeriu s’e di çfarë mund të ndodhë. Dinim që babai ishte shënjestra kryesore. Kur trokiti dera, doli nëna. Unë isha në dhomë me gruan dhe dy gocat, njëra e sapolindur njëmuajshe dhe tjetra një vjeç e gjysmë. I thanë nënës që më kërkoni mua. Gruaja u tmerrua, reagoi e frikësuar.

U çova, u veshja disi. Në fakt nuk më thanë “Je i arrestuar”, por “Do të të çojmë në Tiranë. Nuk e dimë as ne pse të kërkoni”. Nuk njihja asnjë nga ata që më morën. Makina GAZ ishte aty. Brenda mund të ishte ndonjë operativ i universitetit, por s’i njihja. Për të kuptuar arsyen pse po më merrnin, gjatë rrugës bëja ndonjë pyetje, si “Ore, mos më kanë vjedhur shtëpinë?” Ata hiç. Në orën gjashtë, mbërritëm në Tiranë. Akoma nuk ishin hapur zyrat. Më çuan te drejtorja e Sigurimit. Doja të shkoja në banjë, se për momentin e quaja veten të lirë, por kur u nisa, vjen polici nga pas meje. Aty mendova që ishte diçka serioze, sepse nuk isha mësuar që edhe për në banjë shoqërohesh, duke u mbajtur nën survejim për rrezik ikjeje. Pastaj erdhën shefat. Më çojnë lart në zyrë, te Koço Josifi, i famshmi, dikur ka qenë drejtor i hetuesisë dhe Kapal Çako, nëndrejtor i Sigurimit të Shtetit.

Më pyesin se cilat ishin bindjet e mia politike. U

18. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 10686. Vendim nga Gjykata e Rrethit Tiranë, nr.Regj. Them. 539, nr vendimit 531, datë 17.12.1974. Arkivi i AIDSSH-së.

“Të burgosurit e rinj ishin “mishi” që hynte në burg.”

përgjigjem: - Po më vjen si bombë, kjo pyetje. Kur ma prenë: - Si bombë të të bjerë. Unë vazhdova: - Si të gjithë shokët e mi.

Puna ishte që unë nuk vajta t'u shaja Enver Hoxhën. Edhe më thanë: - Si të gjithë shokëve të tu, ë? Hapi sirtarin, nxori letrat. Sa e pashë kuptova që kishin gjetur letrat. Nuk dija gjë që ishte arrestuar xhaja dhe burri hallës. Babai, jo, akoma. Nxori tekstin dhe lexoi: - Të urdhërojnë idiotët, këta palo idiotër, etj. Filluan të lexonin shënimet në ditarin tim qysh në Laç. Sa s'më ra pika. Ia nisi hetuesi: - Kush janë këta idiotër, more? Edhe ke thënë jo vetëm këta këtu në Laç, por edhe atje në Tiranë.

Ishin në ditar të shkruara. Kur i kisha shkruar, isha 19 vjeç. Kisha shkruar në Laç, për riedukim, se vodhëm tezat e provimit. Na përjashtuan nga rinia dhe na çuan për riedukim në klasën punëtore. Aty fillova duke shkruar. Ishte edhe një roman, aty... Ata vazhduan: - Pse i ke ruajtur? Apo të duhen, për kur të rrëzohet regjimi? Unë justifikohesha: - Nuk i kam fshehur, por i kam çuar për t'i ruajtur te xhaja. Kështu, më morën në GAZ, më çuan në burg te 313-ta, mbrapa Arkivit të Shtetit.

Sa kohë qëndruat në hetuesi?

Fatos Lubonja: Shtatë muaj.

A keni qenë vetëm, apo me të tjerë?

Fatos Lubonja: Edhe vetëm, por edhe me të tjerë, kam pasur edhe një ...

Provokator?

Fatos Lubonja: Po, po. Ishte e tmerrshme. Më futën në fillim me një tjetër, pastaj me një tjetër. Ruhesha, se m'u duk si njeri i dyshimtë, por as nuk e imagjinoja dot që të fusnin dikë që të rrinte me të burgosurin për muaj të tërë. Mendoja që marrin dikë nga jashtë, e mbajnë këtu dy-tre ditë dhe kaq, por që të fusnin një njeri të burgosur dhe që të rekrutonin të burgosur që të qëndronin me muaj, as nuk të shkonte mendja. Mbaj mend një Ridvan, nga Vërdova e Pogradecit. M'u duk si njeri naiv dhe u bë si vëlla për mua. Kështu që i kam treguar, nga këto gjëra atij dhe mora veten në qafë. P.sh., një revolver të babait ia kisha dhënë një shokut tim dhe këtë ia tregova. Kur e morën atë shokun, I. K. Dyshoj shumë që kanë dalë prej këtij, që ma sollën në birucë. Më pyetën hetuesit, se çfarë lidhje kisha me këtë, I. K., etj. Unë u justifikova, duke u thënë që i kisha kërkuar ta hidhte revolen, jo ta mbante, se në fakt, revolja ishte e babait. Babai kishte tre të tilla, por në vende të ndryshme. Ai më kërkoi t'i hidhja, por unë ia dhashë njëren shokut tim, meqë ma kërkoi. Hetuesit synonin te versioni i arratisjes. Pyesnin të zbulonin a kisha dashur të arratisem. Në fakt, s'kisha pasur ndonjëherë dëshirë të arratisesha, por ata aty e rrihnin muhabetin. Kur dola në “kaush”, pyeta për Ridvanin, se e kisha bërë si vëlla. Aty, ma pret njeri: - A, more Fatos, po çfarë Ridvani, thua ti. Kushedi kush ka qenë ai...

A ju kanë dhunuar?

Fatos Lubonja: Në hetuesi, po.

Më kapën një letër të babait, që ma kishte shkruar për Enver Hoxhën, ku e përmendte me fjalën “dajre”. E kisha këtë letrën, në xhep të

pantallonave. Dy ditë pasi morën babain, më arrestuan edhe mua e në xhep gjetën këtë letrën ku shkruhej "I dashur Fatos...", etj., etj., dhe këtë letër e kisha unë. Dyshoja, se ka qenë periudha kur kishin vendosur edhe përgjues. Enver Hoxha ishte sëmurë dhe në dhjetor pësoi infarkt miokardi. Ne e morëm vesh që ishte sëmurë dhe ishte në rrezik vdekjeje. Me shokët ishim lezetuar duke qeshur për lajmin, ne, që ishim si kundërshtarë. Unë mendova t'ia çoja lajmin babait që "dajre" ishte sëmurë dhe këtë fjalë e përdorja për Enverin. Mirëpo neve na kishin vënë përgjues edhe në Lezhë. Edhe babai më çon mua këtë letrën, ku e cilësonte "ky maniak, ky mizerabël", ky kështu, ky ashtu... Nuk kishte lënë gjë pa thënë, për të. Kur më nxorën letrën dhe më pyetën "Kush është ky?", ishte e tmerrshme. Njëherë u thashë "Fadili", njëherë filani, kot më kot, por ata e kishin kuptuar, se dukej letra. Babai u kishte thënë hetuesve që fjala ishte "dajo", kurse mua nuk më shkoi ndër mend kurrë ta thoja sikur ishte "dajo". Mirëpo në letër kuptohej...

Babai, më me shumë eksperiencë, ishte munduar t'i ngatërronte hetuesit. Pastaj më pyesnin: "Çfarë ke thënë, kur ke qenë përballë Hotel Dajtit?" Mirëpo ne e shanim gjithmonë... Ka pas vëzhgues që na vëzhgonin, si Shyqyri Toska. Më sollën dy shokë të mi, Maks Dajçi dhe Besnik Sinani, si dëshmitarë. Këta treguan që kur kishte kaluar çuni i Enver Hoxhës, unë e shava.

A ka qenë babai juaj komunist?

Fatos Lubonja: Po. Ka qenë sekretar partie.

A ishte i bindur për gjërat që bënte?

Fatos Lubonja: Kjo është histori më vete. Babai ka qenë komunist, sigurisht. E përdorte atë shprehjen "për ideal të partisë", derisa u prishën me Bashkimin Sovjetik. Atëherë pësoi zhgënjim, por njeriun e mban edhe pushteti.

A kishte dijeni babai juaj sesa vriteshin, sa shkonin në kampe? Ju në familje a i njihnit këto pjesë të errëta të diktaturës, pjesë e së cilës ishte edhe babai juaj?

Fatos Lubonja: Fare pak.

Le të kthehemi te gjyqi juaj.

Fatos Lubonja: Po gjyqi, eh...Prit, se s'mbaruam me hetuesit. Koço Josifi me Elham Gjickën kanë qenë dy hetuesit më të tmerrshëm. Besniku, ky shoku im, ishte zbërthyer fare. Edhe u thotë se unë i kisha treguar që Enver Hoxha, kur kishte qenë me një franceze, kishte dashur të bënte seks anal. Unë instinktivisht u tmerrrova, se të shajë Enver Hoxhën ishte gjëja më e rëndë. Nisa të bërtisja se shoku im kishte luajtur mendsh. Kur hetuesi thotë: "Hë, more, se nuk po ta shënojmë këtë" dhe përfundimisht nuk e shënuan. Si duket s'kanë dashur t'i qarkullojnë në letrat e gjyqit këto detaje për Enver Hoxhën. Mua mu duk sikur ata më lehtësuan, por ata kanë pasur qëllimin dhe hallin e tyre. Në hetuesi babai s'kishte pranuar asgjë nga akuzat. Atij ia bënë gjyqin me dyer të mbyllura, ndërsa ne me dyer të hapura. Mua, xhajën dhe burrin e hallës na dënuan në grup të treve, me akuzën "agjitacion-propagandë" dhe na dënuan me nga shtatë vjet.

A mori pjesë familja në gjyqin tuaj?

Fatos Lubonja: Jo, jo, sepse ishin në internim. Familja ime ishte e dëbuar dhe nuk e mbaj mend të ketë qenë në gjyq.

Çfarë ndodhi pas kësaj me familjen tuaj?

Fatos Lubonja: Unë vetë kisha krijuar familjen time, kisha gruan dhe fëmijët, kurse nëna ishte me babain në Lezhë, bashkë me vëllain. Mbas dënimit edhe gruan time e çuan në Lezhë, e dëbuan. U vendos te lagjja sipër spitalit të Lezhës, kurse më vonë i kanë internuar, duke i çuar në Fishtë dhe në Torovicë. Nga "kaushi", me autoburg, më çuan në Spaç. Autoburgu ishte, praktikisht, një dhomë hekuri, me një hapësirë të vogël si vrimë lart, e mbyllur dhe ajo, por ishte si për ajrim e mbuluar siç janë oxhakët. Isha i lidhur dorë për dorë. S'e mbaj mend me kë, por di që ishin disa nga veriu. Njëri i gjatë, me sa mbaj mend. Udhëtonim nga pesë-gjashtë a tetë vetë, jo më shumë. E kam përkthyer në librin që kam shkruar.

Sa zgjati udhëtimi?

Fatos Lubonja: Udhëtimi për në Spaç, zgjati rreth katër orë.

Përshtypja e parë nga Spaçi?

Fatos Lubonja: - Përshtypjet i kam përshkruar pikërisht te ky libri i fundit. Aty i gjen shumë më bukur sesa t'ua them tani. Zakonisht, gjatë rrugës me autoburg disa villnin, disa nuk villnin. Unë zakonisht, nuk kam vjellë, vetëm në një udhëtim. Ka qenë edhe një tas për të vjellat. Në autoburg ishte errësirë. Ishte një derë e ngushtë nga hymë dhe prej aty, hynte pak dritë sa për të dalluar turbullt, se ne ishim të ulur dhe nuk dalloheshim mirë. Arritëm më në fund, pas gjithë atij udhëtimit nëpër errësirë, se nuk e dinim as ku po shkonim. Dhe një nga arsyet e të vjellave, ishte pikërisht kjo që kur je në një makinë të hapur, shikon larg, nuk të përzihet, ndërsa kur je aty, në vend dhe silllesh me veten vërdallë, trupit i krijohet një situatë shumë e vështirë.

Ishte janar, a shkurt. Kishte dëborë dhe autoburgu ndaloj larg, në një zonë që ishte ndërmjet komandës dhe burgut ku ndalonte autoburgu. Aty pikërisht, ishin birucat. Gjëja e parë që mbaj mend ishte se, pasi na nxorën që na zbritën njëri pas tjetrit, na bënë kontroll për të parë çfarë kishim. Që aty nga lart dukej pamja e asaj që e quanin fusha e volejbollit, por asnjëherë s'kemi luajtur volejbol aty. Të burgosurit me atë veshjen me kapota të murrme, ca ngjyrë më të hapur e ca më ashtu, me ato kapelat që i bënin vetë, me një vesh të mbuluar e një vesh të zbuluar, si çmendinë m'u duk. Këta, të burgosurit, ndaluan të gjithë duke parë kë po sillnin. Cili ishte "mishi", se kështu quheshin të burgosurit e rinj që vinin.

Kur hyra për herë të parë në birucë, ato dy-tri ditë isha i tronditur për vdekje. U çova dhe eca parambrapa. Më dukej vetja si pjesë e një dokumentari që e kisha parë ca ditë para se të hyja në burg. Dokumentari tregonte se edhe te kafshët mbyllja në parqe zoologjike u shkaktonte sëmundje psikike. Madje edhe gjatë transportit nga Afrika në Europë, gjirafat kishte raste që ngordhnin gjatë udhëtimit, nuk duronin dot mbylljen në kafaze. Më kujtohet ujku në atë kafazin e vogël sillej kështu, poshtë-lart, vërdallë. Në natyrë, ujku bën 200 km në ditë lëvizje dhe kur e fusin në kopshtin zoologjik, sado që tani i bëjnë më të mëdhenj e me kushte më të përmirësuar, e kupton që është në "një burg" dhe sërish bën të njëjtën gjë, vjen vërdallë poshtë e lart. Aty në birucë, isha si ai ujku brenda kafazit të vogël, që shkon para-pas...

Sa vetë mund të keni parë, në momentin që sapo mbërritët në burg?

Fatos Lubonja: Aty te fusha ishin pak, se mund të ndodheshin në punë, por gjithsej në kamp kanë qenë rreth 400-500. Më pas, u bënë 1000 e ca të burgosur. Mbaj mend që na futën aty dhe na dhanë ato rrobat ngjyrë kafe...

Mandej ku ju dërguan, si ju prezantuan te dhomat me të burgosurit e tjerë?

Fatos Lubonja: - Na dhanë veshjen, na treguan dushin, na përcaktuan vendin e fjetjes. Kaq. Pastaj, shkoje vetë të takoje shokët, pra bashkëvuajtësit.

A kishit ndonjë të njohur midis bashkëvuajtësve?

Fatos Lubonja: - S'i mbaj mend mirë, por mes tyre ishte Vasili, burri i hallës, që e kishin çuar atje përpara meje. Të tjerë të njohur nuk kisha, por ishte Nuri Sollaku, që njihje familjen dhe m'u afrua. Edhe çunat e rinj nga Tirana më kanë pritur.

A mund të përshkruani një ditë në Spaç?

Fatos Lubonja: Shiko, ishin katër lloje ditësh, sepse atje kishte disa kategori të burgosurish. Ishte dita e atyre që quheshin të papunë, po edhe ditët e atyre me tre turne.

Papunësia quhej "gjashtë qindëshja", sepse merrnin racionin e bukës 650 gramë, dy pjata gjellë dhe një tas çaj. Kaq ishte ushqimi i papunësisë. Kur them dy pjata gjellë, ishte një supë në drekë e një supë në darkë. Ajo supë bëhej një ditë me një grusht oriz, një ditë me një grusht makarona, një ditë me një grusht groshë, tjetër ishte në mbrëmje, në supën me bishta qepe, spinaq, lakër. Gjithsej ishin 7 ml vaj në ditë, racioni i papunësisë, këto dy supat, tasi i çajit dhe 650 gramë bukë. Dita e papunësisë ishte ndryshe nga dita e të burgosurve. Zgjjimi ishte në orën pesë, pastaj pas zgjjimit ishte higjiena vetjake, pas këtyre shkoje të haje mëngjesin që ishte çaj dhe supë, në drekë e në darkë. Pasi ishte ngrënë mëngjesi, pritej të bëhej apeli rreth orës 9, se duhet të mblidheshin edhe turni i tretë dhe i dyti, që ndërkaq ishte zgjuar e kishte ngrënë mëngjes. Të gjithë bashkë numëroheshin në tarracë. Të papunët bënin lexim

“Duhet parë në mënyrë kritike historia, kultura që ndërtoi liderin autoritar absolut.”

të detyrueshëm dy orë në ditë veprat e Enver Hoxhës, nga ora 9-11 e mëngjesit. Pasi mbaronin leximin, të papunët ishin pushim, mund të luanin ndonjë lojë e kështu. Kurse turni i dytë nisej për punë pasi kishte ngrënë drekën, aty nga ora dy shkëmbehej me turnin e parë që ishte duke zbritur, punonin deri nga ora 10 e mbrëmjes dhe kthehej. Aty nga ora 11 zbriste, hante darkën dhe flinte gjumë. Aktivitetin e jetës, apo të kohës së lirë si ta quajmë, e kishte në mëngjes, pasi çohej, afërsisht nga ora tetë, bënte apelin, kishte orën e leximit, mbi gjysmë dhe dilte në punë.

Pse një pjesë e të burgosurve quheshin të papunë? Këta refuzonin punën, apo kishte ndonjë kriter, ndarja e tyre mënjanë?

Fatos Lubonja: Jo, refuzimi kishte histori tjetër, kurse të papunët ishin të moshuar e të sëmurë.

Ju, zoti Lubonja, në cilën kategori bënit pjesë, te kjo e papunësisë, apo te ata që punonin?

Fatos Lubonja: Jo, unë kam punuar në minierë derisa u dënova, sepse refuzova punën dhe pastaj bëra katër muaj birucë. Të papunët fizikisht ishin më rehat, vetëm se nuk kishin për të ngrënë dhe kishin uri. Pas dreke, nga ora katër afërsisht, bëhej apeli i pasdites. Kishte ardhur turni i parë, turni i dytë ishte nisur për punë, turni i tretë zgjohej nga gjumi. Pasi bëhej apeli, të papunët

bashkë me turnin e parë hynin në sallë për lexim gjysmë ore, të gazetës “Zëri i popullit”.

Pas leximit ishte kohë e lirë, lojëra etj., deri nga ora shtatë e gjysmë, kur hahej darka. Në orën 21:00, ishte orari i gjumit për të papunët. Kur isha në punë, pasi bëhej zgjimi në orën pesë, nevojat e para, ngrënia e mëngjesit, bëhej rreshtimi në tarracë për apelin ditë dhe nisja për punë, nga ora 5:30-6:30. Te dera bëhej kontrolli nga policia, për të parë nëse kishe marrë me vete ndonjë gjë që mund të shërbente për t’u arratisur. Pastaj vazhdonte ngjitja e monopazit deri te një pikë që quhej “pika e karbitit”. Kishte një turn që punonte nën tokë dhe një në sipërfaqe. Kur ishe me turnin që punonte nën tokë, të jepnin karbitin. Ata që punonin në sipërfaqe, nuk ndalonin tek karbiti, se s’kishin nevojë, ata të nëntokës merrnin një copë edhe shkonin merrnin kandilat te barakat. Kandili funksiononte kështu: kishte dy pjesë, te pjesa poshtë futej karbiti që ishte me copë si gur. Te pjesa e sipërme futej ujë. Midis është një kunjë, që shkon lart e poshtë. Kur e ngrije kunjin, futej pak ujë poshtë që bashkëpunonte me karbitin, ky nxirrte gaz, kalonte për te pipëza që e ndiznim. Ky kandil mbahej në dorë ose vihej te vagoni, kur ishe duke punuar e bënte dritë dhe ndriçonte të burgosurit. Mbasi merrej copa e karbitit, shkoje te banaku merrej kandili. E hapje, e përplasje diku për të derdhur hirin e vjetër, fusje copën e re të karbitit, e mbushje me ujë dhe niseshe për në frontin e punës nën tokë ose shtyje vagonin.

Karbiti ka veti që bashkëpunon me ujin dhe nxjerr gaz me erë të keqe.

Çfarë pune keni bërë ju, mbushje apo shtyrjen e vagonëve?

Fatos Lubonja: I kam bërë të dyja, por më shumë kam shtyrë vagonë. Kishte më shumë lodhje, por kishte mundësi të marrjes së ajrit të pastër. Punëtorët quheshin nivelistë. Vagonët ishin dy llojesh: me dhe edhe me bakër. Unë shtyja vagonët me dhé, isha nivelist i dheut. Kam punuar me të dy llojet e vagonëve. Në galeri ishte një si pus, që quhej furnelë. Vinte si i ndarë në dysh: gjysma e pusit ishte me shkallën ku ngjiteshe deri te galeria, ku punohej dhe nxirrej materiali, gjysma tjetër e pusit ishte hapësira ku hidhnin materialin ata që punonin në galeri dhe që aty, duhej të nxirrej jashtë. Ky ishte furneli. Ata që punonin në galeri hidhnin material, ti e merrje, ngarkohe vagonin dhe e nxirre jashtë. Kishte shumë lodhje, por të paktën dilje një moment jashtë, merrje ajër të pastër. Minatori bënte vrimat. Vagonisti punonte me lopatë dhe mbushte vagonin me material.

Çfarë materiali, bakër apo pirit?

Fatos Lubonja: - Në Spaç ishin të dyja llojet. Nëpërmjet shpimeve gjeologjike identifikoheshin zonat, cilat ishin më të pasura me mineral, që quheshin "trupi" dhe zonat që nuk ishin me mineral. Për të shkuar te zonat e pasura me bakër ose mineral tjetër, duhej përparuar duke hapur galeri. Unë kam punuar si vagonist dhe nivelist dheu, që shkonte deri te trupi, po kur arrinte te trupi bëhej një punë tjetër. Aty bëheshin vrima shumë të thella dhe bëhej një shembje gjigante. Gjatë shembjes krijoheshin hapësira boshe. Aty merrej bakri, te trupi e hidhej në furnelë, nga e nxirrin nivelistët e bakrit. Këta ishin me normë dhe paguheshin më shumë. Ne ishim punëtorë të thjeshtë, ndihmës për punën. Me këtë punë merrej 600 lekë, kurse këta të bakrit e kalonin këtë shumë, por edhe ishin më të fortë, më të vjetër në punën në minierë.

Si ishte sigurimi teknik në punë?

Fatos Lubonja: Nuk kishim asnjë lloj instruksioni. As më të thjeshtin që të na thonin se kapela nuk duhet hequr. Nuk mbaj mend të kishim dikë që të na numëronte rregullat. Në ditët

e para të vinin të punoje në një grup. Unë isha me një që quhej Sherif Mejdati, një tjetër Llesh, një burrë i fuqishëm dhe një tjetër që nuk ia mbaj mend emrin edhe duhet të shikoja si punonin këta dhe këta nga përvoja e tyre, do të më thonin çfarë duhej të bëja ose jo. Lleshi mbushi një vagon. Djabatas po hapej një galeri e re dhe për ta nxjerrë vagonin, duhej ta fusje në një vend që ishte si i rrumbullakët. Këta më thanë mua ta nxirra vagonin edhe unë u thashë mirë, por ai po vinte me shumë shpejtësi. Unë shikoja dy drita, dëgjoja që bërtisnin, po nuk dija ku ta kapja vagonin, që ta ndaloja. Si përfundim, vagonët u përplasën.

Po nëse nuk e realizonit normën, çfarë ndodhte?

Fatos Lubonja: Në mëngjes, brigadieri tok me policin na caktonin se çfarë lloj pune do të bënim: material, trupa apo bira. Në qoftë se nuk realizohej norma dhe kjo ishte e përsëritur, të dërgonin në birucë ose të lidhnin me zinxhir, ndërsa kur ndodhte vetëm një herë varej nga polici. Puna që bëhej nga të burgosurit ka qenë e paparë. Njëherë u futëm dhe si në garë. Po kjo kishte një problem, se gara ishte me njëri-tjetrin, kush t'ia bënte me hile tjetrit dhe po të mos bëheshin plasjet, nuk kishe material për të mbushur vagonët...Dhe unë u futa njëherë, aty te zona katër. Arrita të merrja 2000 lekë, me të cilat i bleva një kukull gocës. Ishte një përparim i paparë, me nga 16 vagonë. Po hapnim traverbankun dhe punonim shpejt që të mos na bënin hile të tjerët. Punë e paparë. Po kishte edhe ca që rrinin gjithë ditën, me dy vagonë. Bënin ndonjë gjermim për studim, as unë s'e di sesi. Mbase bënin punime për gjeologjinë. Ne te të papunët ishim vetëm të burgosur politikë. Kampi kishte vetëm të burgosur ordinerë. Përballë nesh ishin ca baraka që lidheshin me një urë. Pastaj na ndërruan, sollën ordinerët te kampi edhe shkuam ne te barakat. Pas vitit 1982, kur ngelëm pak, të burgosurit ordinerë bënin punët që nuk i bënim dot ne.

Gjatë kohës së dënimit a ka pasur raste që kanë ushtruar dhunë?

Fatos Lubonja: Po, ka pasur raste dënimi në birucë, zakonisht. Unë bëra katër vjet në minierë, pastaj u ridënova. Gjatë kësaj kohe, mbaj mend që më kanë futur njëherë në birucë dhe më kanë

lidhur disa herë. Kur të kapnin duke ndenjur jashtë minierës, të lidhnin, p.sh. unë kisha mbaruar punë dhe dola të ngrohesh në diell ose po të mos bëje punën. Më kanë lidhur disa herë. Dhunën më të egër që kam provuar, ishte kur nuk pranova të punoja. Atëherë edhe më ridënuan. Unë kam jetuar atmosferën pas revoltës. Kur shkova, i gjeta ridënimet. Duhet të ishte shumë i kujdesshëm, që të mos merrje ridënim. Mbjaj mend që Sherif Merdanin e ridënuan.

Ndërsa historia ime në burg, përkoi me kohën kur ishin edhe Fadil Kokomani, Vangjel Lezho, Xhelal Komprenccka. Në vitin 1978, Shqipëria ndërpreu marrëdhëniet me Kinën. Këta kishin bërë nga 16 vite burg afërsisht, unë nja katër a pesë vjet. Me Vangjel Lezhon kisha një lloj miqësie pak më të veçantë, se ky kishte qenë në burgun e Burrelit, me babain tim edhe kështu që kishim muhabet. Shpesh, ai thoshte "Mbaruan!". Ishte gjithmonë shpresa. Kur ndodhi prishja me Kinën, e shtoi Vangjeli këtë. Në atë situatë Vangjeli edhe Fadili shkruan një letër kundër Enver Hoxhës, duke e akuzuar dhe duke kërkuar ndryshimin e vijës politike. Ata ishin me vijën Hrushovit, që dënonte kultin e Stalinit dhe kundër burgjeve politike, pra ishin grupi prosovjetik. Edhe më herët në 1962 i ishin drejtuar me një letër Komitetit Qendror të PK-së në Bashkimin Sovjetik, letër që doli përmes atasheut të ambasadës sovjetike dhe u shfaq edhe në Kongresin e 22-të. Pas kësaj ngjarjeje, sigurimi i kishte vënë në përgjim edhe kështu i kapën. Kur i kapën, ishin katër vetë që u dënuan me vdekje. Por, Fadilit dhe Vangjelit ua falën jetën, ndërsa për dy të tjerët, Trifon Xhagjika dhe Thoma Rafaeli u ekzekutua dënimi me vdekje. Këta mbetën në burg dhe pas 16 vjetësh, shkruan letër kundër Enver Hoxhës. Xhelali ishte grup tjetër, proamerikan. Një ditë të bukur, duke u kthyer nga puna e turnit të parë, po zbrisnim. Turni dytë ngjitej dhe aty ku këmbeshin turnet vijnë dhe arrestojnë Fadilin dhe Vangjelin. Aty u mor vesh që këta kishin bërë një letër e kështu, kështu.

Ishte gjë e frikshme në atë kohë të bëje letër kundër Enver Hoxhës. Ishte rrezik jete. Nuk kaloi shumë dhe arrestuan edhe Xhelalin. Ishim mbledhur aty lart te fushat, kur erdhën policët dhe morën Xhelalin. Edhe mua ma kishin hapur dosjen që në 1977-ën të më fusnin brenda prapë. Erdhën policët, më kaluan mbrapa. "Oh, ikën,"

mendova. Shpëtova. Xhelali ishte i shkurtër dhe e pashë që e kishin marrë, kur po ngjtnin shkallët. Më pas më morën edhe mua dhe ca të tjerë. Na nisën me një kamion, ku ishin afërsisht 15-20 vetë. Donin të na akuzonin se kishim krijuar organizatë kundër pushtetit. Me akuzën "agjitacion e propagandë" dënimi ishte 3-10 vjet. Atëherë, për të dënuar me vdekje Fadilin dhe Vangjelin, dhe për të na ndëshkuar edhe neve, u përpoqën të na paraqisnin sikur ishim një organizatë antisocialiste, për të organizuar krime kështu që dënimet shkonin nga 10-25 vjet, deri edhe me vdekje. Filloi gjyqi i Xhelalit dhe i të tjerëve, si: Irfan Vrioni, Ernest Çobo etj., dhe zgjati nja tri ditë. Isha gjithë kohës në vigjilencë, të merrja vesh çfarë ndodhte. Kur u dha pretenca. Më vjen lajmi mua: i pari me vdekje, i dyti me vdekje, i treti me vdekje... Ishte shumë e tmerrshme dhe po prisja çfarë do të më gjente mua. Xhelali e kishte bërë letrën, bashkë me një Veiz dhe ky u lirua. Ka ngelur si enigmë kjo puna këtij, që s'u dënua fare. Nuk e morëm vesh fare pse nuk u dënua.

Mua më dënuan edhe me gjashtëmbëdhjetë vjet të tjera. Kisha bërë pesë, do të bëja edhe gjashtëmbëdhjetë. Më kthyen sërish në Spaç. Mbase, ngaqë kisha babën në Burrel dhe këta kishin politika që nuk fusnin dy vetë të një familjeje në një burg, që të mos kryenin ndonjë akt, a nuk e di sesi. Kur u ktheva në Spaç, me disa të tjerë nga grupi ynë, nuk pranova më të punoja. Kështu bëra katër muaj birucë. Hyra një ditë në grevë urie. Më sollën prokurorin edhe i thashë atij: "Këta më thonë që jam i dënuar me vdekje. Unë nuk jam i dënuar me vdekje. Pse më thonë që po nuk dola në punë, do të vdes? Unë nuk kam vendim gjykate, si i dënuar me punë të detyruar. Këta, ta quanin privilegj që po të jepnin punë, por nuk ishte privilegj. Kështu ndjenja në birucë. Muajin e tretë, zuri i ftohti. Ata kur të fusnin në burg, të zhvishnin. Lejoheshin vetëm një palë pantallona, një triko, një kanotierë dhe një xhakëtë doku, fare e hollë. Një kanotierë dhe një triko i kisha veshur tepër. Më thotë kontrolli: - Zhvishu. - Jo, jo - i thashë. - Ku e ke në rregullore, që duhet të dalësh me këto? Rregullorja nuk thotë gjë. Më mori e më çoi te Pjetër Koka, që më urdhëroi të zhvishesha. Unë e kundërshtova. Pastaj solli tre policë. Unë si dordolec para tyre. Tak më hoqën xhakëtën, pastaj trikon. Deri këtu isha në rregull unë edhe mendova se do ta shpëtoja atë kanotierën me mëngë. Tak e ngriti këmishën ai. "Uaa, paska

kanotiere me mëngë, - tha". S'durova dhe fillova një përleshje. Më rrasën poshtë. Unë nga inati bërtisja "Kriminelë!". Fap, peshqiri në gojë. Më zhveshën e më futën atje ku më futën. Iku muaji i tretë në acar, në të ftohtë, pa rroba.


Ta jepnin batanijen nga ora 9 e darkës dhe ta merrnin që në orën pesë. Polici shikonte edhe poshtë dërrasës, se mos dikush e fshihte atje. Kontrollonin edhe në trup, në kurriz, se njeriu për të mbijetuar e fshihte edhe aty. Minus 18 shkonte temperatura në dimër në Spaç. Muajin e katërt, çfarë s'më kanë bërë. Më mori një i famshëm dhe më binte me shkop gome. U ngrita në një vend, po aty ishte më keq se më binin goditjet në të gjithë trupin. Kalon një Prenk Rrapë aty edhe unë i thashë: - Nderimet tona, Prenk Rrapë! Kthehet ky, më fut në një birucë edhe bamb me grusht: - Me kë tallesh ti, mizerje...Por goditjet në kokë ishin të tmerrshme. U ndjeva në alarm edhe mendova se tani vdiqa. Pastaj nja dy grushte m'i futi edhe Gjergj Topalli. Ndenja në birucë shtatë ditë, si i ngordhur. Nuk po haja. Më ushqente Bardhok Gega, vëllai i Frrok Gegës. Duhej të mbijetoja dhe të hiqesha si i çmendur. U kërkova letër dhe kur e prunë, shkruajta emrat e gocave: - Ana, Beti. Bëra edhe një mbledhje aritmetike 3+4, vura edhe një shifër kot, 15.

E morën letrën policët, po as e çanë kokën fare, mor burrë. Erdhi një person nga Ministria e Brendshme edhe më tha që kishte urdhër nga ministri që po të mos dilja në punë, do më linin të vdisja në birucë. Ishte shumë e rëndë, aq sa mendova të hidhesha në tela. Sado që nuk kisha fuqi, u çova. Më vonë më transferuan në Ballsh.

Keni mundur të njihni nga ata që kanë tentuar të vetëvriten, duke u hedhur nëpër tela?

Fatos Lubonja: Posi jo. Të paktën nja tre-katër. Ka qenë një Refik Beqo, që u hodh në tela. Francezi i thonim, se kishte qenë në Francë. Ishte futur në burg, kishte dalë dhe e futën prapë... Një tjetër nga Korça, në prag të Vitit të Ri.

Ka qenë Azem Luzi që u hodh, por ushtari nuk e vrau dhe ai mbeti i gjymtuar, dhe një nga Berati. Kur hidheshe në tela, supozohej se do të arratiseshe dhe prandaj të gjuante ushtari.



Kandil me karbit që përdorej nga të dënuarit në minierë.

*Objekt nga arkivi i ish-të dënuarit politik,
Fatos Lubonja*

A kishit mundësi për kontakte me familjen në Spaç?

Fatos Lubonja: Kontakte mbaja përmes letrave. I kam të gjitha letrat, përveç letrave të pesë viteve të para, që m'i dogjën pas kësaj aventure që kisha bërë, kur më çuan në Ballsh. Operativi më tha se letrat i digjinin, përveç fotografive, prandaj mund të mbaja fotografitë. Letrat e tjera, m'i morën që në Spaç, letrat e babait, fotografitë që më çonte nëna...

A vinin në Spaç nëna dhe vajzat për t'ju takuar?

Fatos Lubonja: Po, vinin. I kishin çuar në Fishtë dhe që andej, shkonin në Lezhë, deri tek Ura e Zogut. Aty gjenin ndonjë kamion që shkonte për në Kukës, se andej ishte rruga për në Spaç. Nga Ura e Zogut shkonin drejt Rrëshenit, deri në Shën Pal, që ishte pa shkuar në Kukës. Nga Shën Pali zbrisnin për në Rreps.

Aty ndalonin te një urë, për të marrë ndonjë kamion që shkonte në minierë. Po shpeshherë e bënë me këmbë. Nga Rrepsi deri aty ishte 5 km. Takimi zgjaste vetëm 10 minuta. E gjithë kjo rrugë bëhej për 10 minuta takim! Ishte porta e madhe për automjetet dhe porta e vogël që ishte për këmbësorët. Aty ishte një sportel, hapej, i shikonin si ishin veshur dhe takimi bëhej në këmbë dhjetë minuta. Ushqimet i kishin marrë ata për t'i kontrolluar dhe t'i sillnin më pas. Ky ishte takimi, në vitet '70. Pas vitit 1983, lejonin një takim gjysmë ore, me familjen. Kanë qenë ca baraka, që tani janë shembur dhe aty ishte një dhomë takimi special.

Në burg ishte edhe një si kuzhinë, ku të burgosurit gatuanin diçka. A ju ndihmonin, me ushqime? A kishte bashkëpunim, mes të burgosurve?

Fatos Lubonja: Varej nga shoqëria. Kishte plot, që ndanin ushqime. Ca kohë, unë kam ngrënë bukë me Hadon dhe Ali Osekun. Ata i kishin familjet në Tiranë. Aliu kishte nja pesë vëllezër dhe i vinin muaj për muaj. Familja ime ishte në internim, nuk kishte mundësi. Punonin në fushë. Ka pasur bashkëpunim, por dhe egërsi. Burgu ishte shumë i përzier.

Si i keni kaluar kohët e fundit të dënimit?

Fatos Lubonja: Detajin e liritimit e kam të hidhur shumë. Kalova nga Spaçi në Ballsh, 3 vjet, 3 muaj në Qafë-Bari dhe nga aty u ktheva në Spaç, deri në 1987-ën, pastaj në Burrel. Ishte periudha e fundit, kur filloi rënia e sistemit. Në vitet 1990, këta filluan lirimet dhe transferimet, sepse u hap fjala që Arshi Pipa i kishte shkruar Perez de Kuelarit për burgjet dhe ky do të vinte, të shihte vetë burgun e Burrelit. Këta nuk e kishin mendjen të na lironin, por ashtu erdhi puna.

Në 1990-ën na transferuan në Kosovë të Madhe. Aty ishte grupi i ashtuquajtur i revizionistëve, armiq të partisë. Këta të dënuar konsideroheshin të rrezikshëm, se kishte folur shumë Enver Hoxha për ta. Në grupet armiqësore ishin Fadil Paçrami, Tanush Taraku, Sadik Bekteshi, Nesti Nase, djali i Mehmet Shehut, Anton Sheti, grupi ushtarak. Nuk ishim shumë, ndoshta 10 a 15. Ishte edhe një grup lart që ishin si të fortë që kishin bërë edhe krime ordinere dhe ishin të përzierë me të dënuar politikë. Aty u bënë disa lirime. Më në fund doli dekreti që do të liroheshim. Ne kishim mbetur 17 vetë, të dënuar politikë. Ishte dekreti i faljes, data 17 mars.

Në 31 mars ishin zgjedhjet. Këta të grupit ordiner, kur morën vesh që për ne doli dekret faljeje, erdhën na mbyllën brenda edhe nuk donin të na lëshonin pa marrë takim me përfaqësuesit e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Arben Puto, Ylli Popa etj., që të ndikonin për t'i liruar edhe ata. Ishte një ditë e bukur për të shkuar te familjet, mirëpo mbetëm peng, të mbyllur deri në orën 7 të mbrëmjes, kur mbërriti Arben Puto. Atëherë u hap dera.. Dola, bashkë me Fadilin. Unë shkova për në shtëpi dhe mbërrita nga ora nëntë të darkës. Gjeta të mbledhur, një pjesë njerëzish. Kishte ardhur edhe një lord anglez, i shoqëruar nga Brikena Çabej që dëshironte të shihte një të burgosur politik, i cili sapo kishte dalë nga burgu.

A ju ka kërkuar dikush të falur, për gjithë ato dënime të padrejta që ju kanë bërë?

Fatos Lubonja: Kam një episod. Më del një e më prezantohet, që quhej M.R. Atëherë e kuptova. Më tregoi sesi kishte firmosur një dënim me vdekje, por më shumë sesa të kishte pendesë, në tregimin e tij

kishte përpjekje për t'u shfajësuar, se gjoja kishte qenë i shtrënguar. Nuk ishte falje, justifikim. Unë nuk do t'i bëja gjyqin aty, atë moment.

Keni ndonjë mesazh për rininë e sotme, lidhur me gjithë këtë histori të dhimbshme tuajën e të gjithë ish-të dënuarve politikë?

Fatos Lubonja: Unë jam kundër atij vështrimi për historinë, që siç thoshte Niçe, e trajton historinë si antikuar. Unë jam për një këndvështrim tjetër të historisë: vështrimi kritik i historisë, që nisët nga e tashmja.

Një nga arsyt pse kemi interes për historinë është se ne vuajmë në të tashmen, vuajmë nga fantazmat e Enver Hoxhës, që dalin në pushtet

njeri pas tjetrit, nga dhunimi i njeriut prej njeriut. Nëse duam të çlirohemi nga kjo vuajtje, nëse nuk e duam këtë lloj jete që po bëjmë, atëherë një nga instrumentet e çlirimit është njohja e së kaluarës, se shumë probleme na vijnë nga e kaluara.

Duhet parë në mënyrë kritike historia, kultura që ndërtoi liderin autoritar absolut, se Enver Hoxha nuk ishte thjesht një individ, por veprimtaria e tij lidhej me mendësi të caktuara dhe ai, nga ana tjetër, krijoi mendësi të caktuara.

Historia nuk duhet parë si antikuar, si diçka që ka ndodhur dhe që për këtë duhet ta njohim, por duhet parë në funksion të çlirimit të vetes sonë, që edhe rinia të kuptojë se nga i vjen e keqja, që të çlirohet prej saj sot.

Agron Hoxha

“Si kishte mundësi që ky shtet të merrej me mua kur unë nuk kisha bërë asgjë?”

Agron Hoxha¹⁹, i biri i Hafizes dhe Ibrahimit, lindur më 13 janar 1956, në Ballsh dhe banues në Levan. Në moshën 19-vjeçare u arrestua më 7 janar 1975 me akuzën “për tentativë arratisjeje” dhe “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”²⁰. U dënua me 22 vjet heqje lirie. Hyri në Spaç, në korrik të vitit 1975 dhe doli më 11 korrik 1990.

Zoti Agron, fillimisht, a keni aplikuar pranë AIDSSH, për të parë dosjen tuaj?

Agron Hoxha: Unë e kam marrë dosjen time dhe kisha vetëm dosjen e hetuesisë. Duke qenë se vetë unë kam dy vite që punoj pranë AIDSSH-së, di edhe të shpjegoj përse s’kam dosje tjetër, që quhet dosje formulare. Unë tentova të arratisem dhe arrestimi u bë në shkelje të kufirit. Nuk vija nga ndonjë familje e përndjekur dhe nuk kisha pasur

probleme të mëparshme me policinë. Mendoj se këto janë arsyet që nuk ka patur një dosje ndjekjeje që më parë. Domethënë nuk kam qenë i survejuar, sepse isha si të gjithë të tjerët: nuk e kisha origjinën nga ndonjë klasë e përmbysur dhe si familje nuk kemi qenë kundër shtetit. Isha një njeri i zakonshëm, që kisha pakënaqësi, por duke parë televizorin e huaj, sidomos stacionet italiane, jetën që bëhej në perëndim, thura ëndrra dhe prandaj tentova për t’u arratisur.

Kam qenë i përfshirë dhe i spiunuar në dosje të shokëve të mi, domethënë përmendem në informacionet që kanë dhënë bashkëpunëtorët e sigurimit kur raportoni për shokët e mi. Duke mos pasur dosje formulare, nuk ka pasur bashkëpunëtorë të caktuar direkt për mua, por edhe sikur të kishte të tillë, sot nuk më interesojnë. Më kanë dënuar në vitin 1975 me akuzën “për

19. Z. Agron Hoxha ka ndryshuar emrin për shkak të emigrimit në Greqi dhe sot në dokumente mban emrin Nikollaq Kristo.

20. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2477. Vendim nga Gjykata e Rrethit Fier, nr. 96 Regj. Them., nr.108 i vendimit, datë 21.05.1975. Arkivi i AIDSSH-së.

agjitacion-propagandë” dhe “tentativë arratisjeje” sipas Kodit Penal të atëhershëm. Hetuesia zgjati 7 muaj, në rrethin e Fierit. Që nga 7 janari i vitit 1975 deri në korrik ndenja në birucë. Kur hyra brenda, isha djalë 19 vjeç. Kushtet aty m'u dukën si në një ëndërr të keqe. Ne keq ishim edhe jashtë, se unë prandaj doja të ikja, por kur u përballa me ato kushte të birucave dhe të njerëzve që jetonin aty, u shokova. Kam ndenjur ulur për orë të tëra, se s'po e mblidhja dot veten se ku isha. Në këtë gjendje më gjeti nisja e procesit nga hetuesia, me ato mënyrat e tyre. Në datën 5 maj, dolëm në gjyq. Nga gjyqi shkova në “kaush” të Tiranës, ku u bë edhe shpërndarja sipas aftësisë, moshës.

Gjatë hetuesisë ishit vetëm apo edhe me të tjerë?

Agron Hoxha: Në hetuesi kam gjetur një njeri që e kishin vënë për të më zberthyer mua. Ai priste që unë vetë t'i hapësja, mirëpo unë kisha frikë se të flisje kundër shtetit ishte e frikshme. Edhe nuk iu hapa fare, nuk bëra kurrë muhabet për këtë punë.

A kërkuan nga ju që të bëheshit bashkëpunëtor?

Agron Hoxha: Gjatë hetuesisë, jo. Ne i dolëm përpara ingranazhit shtetëror dhe morëm dënimin që ata na dhanë.

Si ishte sjellja e punëtorit operativ?

Agron Hoxha: Detyrimisht ata do të nxirrnin atë që kishin bërë në plan. Ne duhet të prananim gjithçka që ata na thoshin p.sh., kur të pyesnin se pse u arratisje, duhet të rendisje të tëra arsyet, përse, që kishin të bënin me të tëra pakënaqësitë ndaj atij pushteti e kështu bëhej më i plotë “hetimi” i çështjes. Prandaj, nga ata kishte dhunë, edhe dhunë fizike, por më shumë psikologjike.

A mund të na tregoni diçka më konkret, për teknikat e dhunës që përdornin?

Agron Hoxha: Bënin presion të vazhdueshëm psikologjik, duke të thënë “me krimet që ti ke konsumuar, të ikën dhe koka”. Të trembnin, sikur veprimi yt dënohej me pushkatim. Të mermin orë e pa orë, p.sh., në orën 1 të natës, të ngrinin nga gjumi.

Sa mund të zgjaste një seancë në hetuesi dhe kush ishte i pranishëm, gjatë marrjes në pyetje?

Agron Hoxha: Një orë, dy orë... I pranishëm ishte hetuesi, operativi që kishte bërë arrestimin, por shpesh edhe disa njerëz me pushtet që ishin kuriozë, sepse nga ai vend nga ishim ne kishte fare pak të burgosur politikë. Ne pothuajse akuzën e kishim të ngritur dhe ishte pothuajse faktike, se ne po përgatiteshim për të ikur edhe na kapën në momentin që po niseshim për arratisjen. Kurse për pjesën e agjitacionit, merreshin në llogari arsyet për të cilat kishte vendosur të ikësh. Detyrimisht që ne nuk mund të thonim, se ju duam shumë dhe prandaj po ikim. Patjetër që do të pohonim, se nuk i deshëm. Jeta nuk na pëlqente, se ishte plot shtrëngime deri te jeta private, kështu që lindi pakënaqësia dhe deshëm të ikim.

Sa kohë zgjati gjyqi juaj dhe sa u dënuat?

Agron Hoxha: Hetuesia zgjati afërsisht 7 muaj edhe gjyqi 4 ditë rresht. Si duket, kishin interes ta zmadhonin, për të frikësuar të tjerët. Gjyqi u transmetua me altoparlantë, sikur kushedi çfarë kishte ndodhur.

A nxorën dëshmitarë?

Agron Hoxha: Jo, nuk nxorën dëshmitarë, se ata konsideronin që ne e kishim konsumuar vetë veprën penale.

Familja juaj a mori pjesë në gjyq?

Agron Hoxha: Familja ime nuk ishte, nuk mori pjesë, sepse si me thënë, iu vinte zor nga banorët e Levanit dhe e mësuan nëpërmjet të tjerëve. Mbasi u dënova dhe erdha në këtë kamp, mora vesh që familja ime nuk kishte pësuar ndonjë pasojë nga unë. Im atë ishte ndihmësmjek dhe i kishte shërbyer gjithë asaj zone, prandaj kishin respekt për të. Kur rashë në burg, isha 19 vjeç, një moshë shumë e re. Këto ndikuan që familja nuk pati ndonjë pasojë nga veprimi im.

Pas gjyqit dhe shpalljes së dënimit të formës prerë, si u krye transporti për në burg?

Agron Hoxha: - Nga Fieri kemi ardhur me autoburg deri në “kaush” të Tiranës, te burgu

“Kur të pyesnin se pse u arratisë, duhet të rendisje të tëra arsyet, që kishin të bënin me të tëra pakënaqësitë ndaj pushtetit.”

313. Autoburgu ishte me kushte të tilla, që nuk mund të tentoje për asgjë, komplet i rrethuar me llamarinë, kishte vetëm ca dritare me hekura, nuk kishte rrezik. Rruga nuk ishte shumë e gjatë. Ne ishim tetë vetë. Midis nesh ishin tre të dënuar politikë dhe pesë të tjerë ordinerë.

Çfarë keni përjetuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit?

Agron Hoxha: Mbas shtatë muajve izolim, kur shkova në Spaç, m'u duk vetja sikur diçka ndryshoi dhe lindi vërtet. M'u duk çlirim kur dola në natyrë, në ajër të pastër pas periudhës së birucës dhe mbylljes në “kaush”. Isha komplet në një gjendje tjetër. E dija që isha në burg, por m'u duk vetja i lirë. Më në fund isha i zgjidhur, mund të ecja vetë, pa më detyruar njeri. Në këtë kuptim të fjalës, u ndjeva pak më mirë.

Kush ju priti kur erdhët këtu?

Agron Hoxha: Kur mbërritëm, lart ishte komandanti i repartit, operativi, komisari, komandanti e me radhë çfarë ishin. Si të them, vetë prania e tyre të bënte presion, ajo arroganca në lëvizje, mënyra sesi të shikonin, sikur të thonin “Ëhë, çfarë do të heqësh ti!”. Sa zbritëm nga autoburgu, ishin disa veprime standarde. Të merrnin dhe të çonin te magazina për të marrë teshat e burgut, që ishin ngjyrë kafe dhe dyshekun prej kashte. Na caktuan dhomën.

Dhoma ishte e madhe dhe afërsisht pesëdhjetë vetë, rrinin aty. Vumë dyshekun gati edhe batanijet, edhe u qetësuam.

Si ishte ushqimi?

Agron Hoxha: Ushqimi... Për hatër të së vërtetës, miniera i ka pasur disa rregulla. Për minierën kishin një ushqim të paracaktuar, kishin normë ushqimore që të kishe fuqi të punoje. Se na morën për skllëvër, nuk ishim për qejf. Që të punoje, duhet të haje. Jo se ishim në kushte me ushqim të mirë, por kishte ushqim. Në mëngjes, kishim një gjellë dhe një pilaf, edhe një gotë qumësht. Për drekë, gjithashtu gjellë, pilaf ose makarona dhe në darkë, djathë, çaj dhe marmelatë.

A mund të na përshkruani një ditë në kamp?

Agron Hoxha: Dita ishte rutinë. Bëhej zgjimi në orën 5:30. Prej aty, shkoje në tualet dhe pastaj lart, ku ishte dhe mensa. Aty rreshtoheshim me të gjitha brigadat. Kur ishim turni i parë, ishin katër brigada, se ishin katër zona, kështu që sipas brigadave rreshtoheshim, plotësohej e gjithë brigada dhe pjesëtarët e brigadës do të futeshin një për një në mensë, për të ngrënë bukë. Higjiena? Gatuhej për 200 veta.

E çfarë mund të thuash për cilësinë dhe higjienën? Futu aty, prit patate, të qëruara e të paqëruara, të ziera e të paziera.

“Edhe tani që duhet të jem i lirë, duhet të më dalë përpara ish-hetuesi im?”

A ju treguan sesi duhet të punonit dhe çfarë rregullash kishte puna e minatorit?

Agron Hoxha: Unë isha ndër ata të rinj që sa kam zbritur te zyra teknike, më caktuan minator. Edhe pse isha 19 vjeç. Edhe kur erdha nga biruca mund të isha 50 kg, ma do mendja, edhe më caktuan minator, se unë nuk kisha bashkëpunuar në hetuesi me Sigurimin e Shtetit. Kisha mbajtur qëndrim. Unë e mbajta qëndrimin për të vetmen arsye se mendoja që si kishte mundësi që ky shtet të merrej me mua kur unë nuk kisha bërë asgjë. Këta më morën, më izoluan, më keqtrajtuuan sikur unë të isha kriminel, ndërkohë që unë nuk kisha bërë asgjë! Nuk i shikoja dot me sy!

A ekzistonin rregullat e sigurimit teknik gjatë punës?

Agron Hoxha: Në letër gjithçka e kishin bukur këta, ishte edhe sigurimi teknik, ishte edhe ushqimi, të gjitha. Por në fakt, asgjë nuk kishin. Unë kam qenë minator dhe si përgjegjës i grupit që isha, duhet të merrja përgjegjësi për gjithçka. Në qoftë se unë nuk do ta realizoja dot ciklin, siç quhej, mua më fusnin në birucë. Edhe për këtë arsye, kam bërë shumë biruca. Kjo ishte puna e sigurimit teknik. Në momentin që unë shikoja rrezik që edhe mund të dilja, edhe nuk mund të dilja nga galeria, atëherë nuk punoja, nuk i bëja birat dhe i drejtohesha birucës. Sepse rregulli ishte që do të shkoje me trupa të mbrojtur deri te balli, afërsisht 1 metër e gjysmë deri te balli, duke bërë me pistoletë, birat. Kur nuk e kisha të

sigurt, nuk i bëja birat dhe i drejtohesha birucës. Mendoja: “Më mirë të jetoj. Le të rri në të ftohtë, atje, por do të jem gjallë”.

A ka pasur persona që kanë ushtruar dhunë ndaj jush, apo ndaj të tjerëve?

Agron Hoxha: Zakonisht në kamp, njerëzit që nuk realizonin detyrat, këta i lidhnin dhe i torturonin duke i lidhur fort me hekura edhe i fusnin në birucë.

Kjo ishte tortura më e madhe, kurse fizikisht ishin raste speciale që të rrihnin. Unë me thënë të drejtën, në këtë lloj kampi kam punuar, sepse kisha edhe nevojën ekonomike që punoja. Këtyre nuk u duhej të më rrihnin, se unë punoja vet.

A i keni ndier pasojat e revoltës së vitit 1973, megjithëse ju shkuat atje në vitin 1975?

Agron Hoxha: Nuk kishe të drejtë për asgjë. Vetëm duhet të haje, që të ishe gati për punë. Të drejta të tjera siç kishte më parë, nuk kishte. Më parë, për shembull, ishte një si tip barake aty, mbrapa, ku shkonin luanin shah. Kishte edhe që i binin kitarave dhe këndonin, pra diçka e tillë. Pas revoltës së Spaçit u prenë të gjitha, kishte vetëm rregull dhe disiplinë, p.sh., krevati duhet të ishte i rregulluar katror në mënyrë perfekte, peshqiri të palosej trekëndësh dhe nëse këto nuk do t'i kishe, roja i brendshëm pasi i verifikonte të thoshte: “Pse e ke lenë peshqirin kështu? Pse s'e ke vënë këtë, drejt? Pse e ke çuar shtrembër? Në

birucël!" Kishte penalitete të kësaj natyre, për të të mërzhitur.

A kishit aq kohë të lirë për argëtim?

Agron Hoxha: Nuk bëhej fjalë për argëtim, bëhej fjalë për t'u çlodhur sado pak, se ishe i lodhur gjatë gjithë kohës. Puna ishte aq e rëndë, sa unë që isha i ri e përballoja, por pjesa më e madhe që ishte edhe në moshë, e kishin të vështirë. Argëtimi ynë ishte të rrinim shtrirë në krevat, aq të lodhur sa ishim. Ndonjëherë, luanim ndonjë lojë shah. Pastaj lanim ndonjë rrobë andej nga banjat. Ja, ky ishte argëtim. Çfarë argëtimi...

Kur e përfunduat kryerjen e dënimit?

Agron Hoxha: Unë isha dënuar maksimalisht nga gjykata e Fierit edhe vetëm në vitet 1990, pasi u ndryshua sistemi, m'u dha rasti të dilja, se me atë lloj sistemi unë nuk dilja dot. Deshi Zoti dhe fati që unë dola nga burgu. U ndryshua sistemi në lindje, detyrimisht edhe këtu në Shqipëri. Se thonë këta këtu që e ndërjuan, por jo, nuk ka lidhje me këta.

Si u ndjetë pasi fituat lirinë?

Agron Hoxha: Unë kam dalë nga Qafa e Barit, se na transferuan atje. Ishte një lirim i papritur. Nuk e prisja, se ne kishim një vit e ca që nuk dilnim në punë, e kishim refuzuar daljen në punë. Ishte viti 1990. Filluan t'i nxirrnin të burgosurit grupe-grupe. Ndoshta ishte llogaritur nga ana e tyre që të mos krijonin konfuzion, po të të dilnin të tërë së bashku, të mos frikësonin kënd. Prandaj na nxirrnin nga dhjetë e nga pesëmbëdhjetë.

Mua më ka ardhur lrimi nga një shoku im, nga Berati. Quhej Adriatik Mustafaraj dhe kishte bërë 2 vite burg. Kur erdhi në Spaç, unë e ndihmova se ishte i vjetër. Atij i thanë të bëhej gati, se do ta lironin. E kundërshtoi lirim dhe u tha:

- Nëse më keni dhënë mua lirim, ju lutem t'ia jepni shokut tim, që ka bërë shumë burg. E pyeti roja: - Seriozisht e ke? Ma thuaj emrin. Edhe ky i tha: - Agronin, se ka bërë shumë burg. - Mirë, shko lajmëroje - i tha roja dhe ndërroi emrat. Shoku im, ndenji në burg. Edhe pse ne e dinim se do të dilnim, unë atë lirim të parakohshëm e mora nga shoku im, nga Adriatiku. Unë isha shtrirë në

dhomë. Vjen shefi i policisë, më kap te këmbët e më thotë: - Hajde, se të dua pak. Unë ia preva: - Ne kemi mbaruar punë me ju e nuk kemi më punë me ju. - Të dua për të mirë, jo për të keq - më tha. Ky shef policie ishte i ri në Qafë-Bari, jo ai Ludovik Çali, krimineli më i madh që kanë njohur kampet dhe burgjet. Më nxori në korridor edhe më tha:

- Po sikur të them, një gjë të bukur? - Çfarë do të më thuash? Çfarë të bukure, të pres nga ty? - i thashë. - Jo, do të të them vërtet diçka të bukur. Me mua s'je takuar ndonjëherë - tha. - Përderisa mban kapelën, je si të gjithë të tjerët. - Jo, s'jam si të gjithë të tjerët. Hajde, bëhu gati, se do të ikësh te prindërit.

Të them të drejtën, nuk e di sesi më erdhi kështu, si e ftohtë. Shkova te dhoma ku isha me shokët e u jap lajmin: - Më tha, se do të lirohem. - Oh, shyqyr - thanë, se ata e dinin që unë kisha bërë më shumë burg se ata. Kurse ky shoku që më nxori, më kishte bërë gati edhe rrobat te magazina për t'u larë dhe po më priste atje. Unë nuk e dija, çfarë kishte bërë ai. Nejse, u lava, u shpëlava, u vasha me rroba civile. Kur shkova të merrja fletën e lirit, isha bashkë me këtë shokun. Ai që kishte fletën e lirit më pyeti: - Çfarë e ke këtë? - Shok. - Quaje shok, se ky është shok tamam. Nga ky, po del ti. E pashë shokun tim. Unë vetëm të mira prisja nga ai, nuk prisja të këqija.

Dola. Kur kalova portën e dola jashtë, më merreshin këmbët. Sesi liria, më dehu kështu! Sa kalova portën! Aty ishte një vend i bukur, me pisha. Dola kështu e po i shikoja të burgosurit. Të gjithë atje. M'u duk një skenë e tmerrshme. Aty kuptova, se çfarë kisha hequr unë atje brenda. Ata rrinin të shkretët para telit dhe shikonin. Me zor u shkëputa nga ajo pamje. Kështu. Sa dola në kthesë, erdhi një makinë e ngarkuar me pirit. Shoferi e dinte që ishim të burgosur. Na mori lart mbi pirit deri në Fushë-Arrëz.

Po ndieja vërtet liri. Vetëm se ecja. Kisha liri, të ecja! Ka ndodhur që kam bërë një muaj birucë, në të ftohtë. Në një vend dy metra me një metër e gjysmë kam ndenjur. Vetëm bëja xhiro. Mund të flija vetëm dy orë, se ishte ftohtë. Tmerret e birucave! Kurse aty kisha rrugë, shikoja pamje, mund të ecja sa të doja, nuk doja as makinë të ecja.

Kur zbrita, më morën një grup gjeologësh që punonin këtej, në veri, inxhinierë. Unë jam liruar në datën 11 korrik, pasi kishin ndodhur ngjarjet me ambasadat. Kur hipa në automjetin e tyre, ata e panë që isha i qethur dhe e kuptuan se nga po vijja.

- Do të na thuash ndonjë gjë? Mundesh, të na thuash ndonjë gjë? - më thanë. - Unë jo vetëm do t'ju them, por nuk kam frikë. Kam sharë gjithmonë. Gjithë kohës që kam qenë në burg, pesëmbëdhjetë vjet, kam sharë çdo ditë. Me të gjithë shokët që kishim në burg, me të gjitha ato që hiqnim ne, vetëm shanim këta. U tregoja disa gjëra kështu dhe ata i ndienin, po ashtu siç i ndieja unë, vetëm se regjimi të detyronte të mbyllje gojën për hatër të familjes, për hatër të shumë gjërave. Më thanë: - Nuk do të vish në Tiranë, sepse aty policia ka bërë postbllok, që në Fushë-Krujë. Sa të vish në Tiranë, po ta marrin vesh që je i burgosur, do të të fusin në birucë.

Unë e dija, çfarë kishte ndodhur në Tiranë, por kisha aq mall për familjen, sa që thashë me vete: - Më mirë po gjej një rast tjetër, për të shkuar atje, se unë do të shkoja. Do të shkoj të takoj njëherë nënën, të paktën. Ajo që kishte vuajtur dhe vëllezërit që pas kaq vitesh, nuk më harruan.

Edhe vendosa: u ktheva në Fier. Kur shkova afër shtëpisë, për t'i përgatitur se mos i gjente gjë, nënën të paktën, çova dikë tjetër për të njoftuar. T'u thoshte që kishte dëgjuar, se isha liruar... Kur shkoi ky në shtëpi, nëna ime nuk ishte. Kishte shkuar te një komshi. Aty gjeti një mbesën time të vogël nja 7-8 vjeçe, ma do mendja, edhe harroi ky se çfarë i thashë unë, por i tha: - Shko thuaji nënës, se ka ardhur Agroni. Shkon mbesa. Nëna po pinte kafënë, me komshien. - Nëno, çohu, se ka ardhur Agroni. - Çfarë? - pyeti nëna. - Çohu, se ka ardhur! Dhe nëna erdhi me vrap. Ashtu e mbaj mend. Kishte varur në qafë një çelës të dollapit ku mbante ato gjërat e veta, si nëna për fëmijët, që mund t'i përdorte për çdonjërin prej fëmijëve. Unë po prisja në fund të shkallëve, sa të përgatitej. Ndërkohë, ajo ishte futur para meje në shtëpi. Unë po ecja ngadalë, me një valixhe të vogël. Hyra te dera. Mamaja, sa më pa, i ra të fikët. Kunata, e cila ishte në shtëpi, unë nuk e njihja, i hodhi ujë, e përmendi. Kur u përmend, mbaj mend që më merrte erë, si puna e asaj kafshës së mirë që i merr erë birit të vet, krijesës së vet. Ajo nuk e besonte, që unë isha aty me të. Dhe gjatë gjithë kohës, nuk mbaj mend sesa,

më mbante të përçafuar, a thua se unë do të ikja përsëri. Ky ishte lirimi im!

Si jeni trajtuar si ish-i dënuar?

Agron Hoxha: Kur dola unë, gjithçka kishte mbaruar edhe të gjithë këta që ishin dikur në pushtet vinin dhe na afroreshin, na tregonin që nuk kishin faj, se fajin e kishte pasur qeveria e jo ata, se ata s'kishin në dorë gjë për ne. Nuk kisha ndonjë trajtim të keq, na u dha mundësia për t'u ingranuar, por ishte shumë e pamundur, ishte varfëri e madhe.

Atje ku jetonim ne, në Levan, ishte e pamundur të jetoje. Megjithatë, për dënimin që m'u bë dhe vuajtjet e mia, për ato që kishte vuajtur edhe im atë, të cilin nuk e gjeta gjallë, se vdiq në vitin 1986, për hatër të nënës sime u betova që deri sa të jetë gjallë nëna, nuk do të largohesha.

A ju është kërkuar falje për dënimin dhe vuajtjet e padrejta ose ndonjë nga bashkëpunëtorët e sigurimit, a ka ndierë pendesë?

Agron Hoxha: Falje në këtë vend nuk na ka kërkuar askush. Në vitin 1992, duhet të ikja në Greqi dhe bëra disa dokumente. Këto dokumente do t'i bënim pranë gjykatës. Kur shkoj aty, në një zyrë avokatie, gjej ish-hetuesin tim, që ishte avokat. I thashë vetëm kaq: - Prapë më dole përpara? Edhe kur duhet të jem i lirë, duhet të të kem ty përpara? Ai donte që të më jepte ndihmën e tij, por unë ika dhe nuk u mora me të...

A morët ndonjë shtesë pensioni si ish-i dënuar?

Agron Hoxha: Unë nuk kam dalë akoma në pension. Për pension të veçantë, nuk bëhet fjalë me sa shoh unë. Përveç që, më duket hipokrizi. Unë nuk do ta pranoja kurrë një pension të veçantë. Qeveria duhet të merrte masa që të gjithë të burgosurve t'u krijonte një pension të denjë për të jetuar, por jo një pension që të jetë mbi të tjerët. Por, gjendja është kjo që është dhe për këtë duhet të jemi të ndërgjegjshëm. Shteti më dha njëqind milionë lekë, si kompensim për vitet e burgut. Ç'i dua njëqind milionë lekë? Unë dua një trajtim dinjitoz për sa të jem gjallë.

Po për fëmijët keni kërkuar rimbursim shkollë?

Agron Hoxha: Mbasi dola nga burgu, fatmirësisht u martova. Kam tri vajza, të tria i kam jashtë shtetit, i kam shkolluar, por doja të dilja pak aty te shkolla e fëmijëve. Meqë u martova dhe bëra ato tre fëmijë, e ndjeva detyrë që unë t'u dilja zot. Kam tentuar të arratisem tre herë në jetën time, një herë për liri, dy herë kur isha në kohën e regjimit. Arratisja e parë më dështoi, kur doja të iknim me një anije greke, bashkë me një mikun tim. Ai hipi në anije. Mua më zuri dikush nga këmba dhe jam kthyer. Nuk pata pasojë, se ai nuk tregoi për mua. Edhe ai u dënua për këtë akt, por nuk më nxori ai. Herën e dytë ishte tentativa nga Gjirokastra dhe herën e tretë e kam bërë arratisjen në liri, kur shkova në Itali, me fuçi, vetëm për hatër të fëmijëve. Kur na kthyen nga Italia, shkova në Greqi, ku jetova dymbëdhjetë vjet, në Athinë. Lekët që më dhanë për vitet e burgut i shpenzova vetëm për shkollat e fëmijëve. Fëmijët i kam shkolluar në shkolla private edhe me studime jashtë shtetit, në Londër.

A keni mundur të ruani objekte të ndryshme, apo letra e kartolina nga korrespondenca me familjen tuaj, nga koha e burgut?

Agron Hoxha: Po, kam letra që i dërgoja dhe më dërgonin.

Çfarë politikash mendoni se duhet të zhvillohen, për të rritur vëmendjen e shtetit ndaj shtresës së ish-të burgosurve politikë, që ata të integrohen plotësisht në jetën e vendit?

Agron Hoxha: Mendoj se politikat e rehabilitimit duhet të ishin bërë që në fillimet e demokracisë. Këtu u munduan dhe bënë aq sa bënë. Ligji nr. 9831 që ishte për rehabilitimin dhe dhënien e pafajësisë gjithë ish-të dënuarve, ishte ndihma e parë. Përmes këtij ligji u ndanë letrat me vlerë, mirëpo kush pati mundësi, arriti të përfitojë duke i futur në punë, ndërsa pjesa më e madhe nuk mundi dhe nuk përfitoi asgjë prej tyre. Ndaj ky

hap i parë i qeverisë ishte i dështuar, sepse nuk na shërbeu neve. Shumë vonë, në vitet 2007-2009 doli ligji për dëmshtëpërlimin në monedhë të ish-të dënuarve politikë. Pavarësisht nga shuma që na dhanë, ajo që binte në kontradiktë për të burgosurit ishte që na e mbajtën vlerën e shtëpive, që na dhanë fillimisht. Sipas statusit që na dha qeveria, na takonte shtëpi, punësim dhe arsimim, gjë që me pjesën më të madhe, nuk ndodhi. Me ligji na u dhanë. Në praktikë, nga dëmshtëpërlimi që u vendos në vitet 2007-2009, hoqën ata që morën shtëpitë që në fillim dhe, ç'ishte më e keqja, ua hoqën me çmimin e tregut, domethënë nëse e kishte marrë shtëpinë me 200 mijë lekë²¹, ajo shtëpi me vlerën e tregut të këtyre viteve u konsiderua 18 milionë lekë²². Letrat me vlerë që morëm nga Ministria e Financave, u hoqën nga Ministria e Drejtësisë. Si përfundim, u katandis kokoshi një thellë.

A keni ndonjë mesazh për brezat e rinj, lidhur me gjithë atë periudhë të egër diktature, që u shkatërroi jetën dhe u solli aq vuajtje, dhjetëra-mijëra njerëzve?

Agron Hoxha: Do të thosha që është e nevojshme t'i bëhet e ditur brezit të ri, gjithë vuajtja që ra mbi atë pjesë të shoqërisë që u mbyll burgjeve, me qëllim që të mos biem përsëri atje ku ishim, në diktaturë.


Duke qenë se këtë intervistë po e realizojmë këtu, në Spaç, ku ju keni vuajtur një pjesë të dënimit, a mund të na tregoni si ndiheni, kur ktheheni në këtë vend?

Agron Hoxha: Herën e parë që kam ardhur këtu, të them të drejtën, sikur vetë shpirti kishte nevojë ta kujtonte atë të keqe. Ndodh si me njeriun, që kur qan, lehtësohet. Kështu edhe puna jonë sa herë vijmë këtu, te kjo pamje që më ka shoqëruar për trembëdhjetë vjet, m'u duk sikur isha në katin e tretë të dhoma ku flija, m'u duk sikur sa dola nga dhoma dhe do të bëja veprimet e radhës...

Ndihem shumë i prekur sa herë vij këtu. Kujtoj shumë gjëra që na kanë ndodhur...

21. Këtu vlera e lekëve është sipas të folurës së popullit, me sistemin e vjetër të këmbimit të lekëve. Në sistemin zyrtar, kjo vlerë është 20 mijë lekë.

22. Edhe këtu vlera jepet sipas të folurës me sistemin e vjetër të lekut. Në sistemin zyrtar, kjo vlerë është një milionë e tetëqind mijë lekë.



Hysen Haxhiaj

“Pasi kisha kryer 5 vjet dënim, më dënuan edhe 10 vjet të tjera, prapë ‘për agjitacion e propagandë’.”

Hysen Haxhiaj, i biri i Hysnies dhe Ismailit, lindur më 1 mars 1942 në Çorrush, të Mallakastrës. U arrestua më 12 dhjetor 1976 me akuzën “për agjitacion e propagandë”²³. Qëndroi 4 muaj në hetuesi. U gjykua në vitin 1977 dhe hyri në burg fillimisht në Spaç, pastaj në Qafë-Bari dhe në Durrës. Doli nga burgu më 13 tetor 1990.

- Përshëndetje, zoti Hysen. Ne dëshirojmë, të na tregoni historinë e të gjithë kalvarit të vuajtjeve tuaja, nëpër burgjet e komunizmit.

Hysen Haxhiaj: Gjatë kohës së luftës, për 3 vjet familja ndihmoi të gjithë ata që luftonin kundër fashizmit, duke vënë në shërbim të tyre gjithçka: 2000 dele, 3000 dhi e 200 lopë. Bukë, dreqën, darkën dhe çdo gjë në shtëpinë time, e gjithë djersa shekullore e njerëzve të mi u sakrifikuara për

luftën. Në vitin 1945, ndodhën ca grindje fshatarake. Si përfundim, më burgosën babain për një vrasje që s’e kishte kryer. Më vonë doli e vërteta, por e mbyllën, siç i kanë mbyllur edhe shumë të tjera deri më sot. Në vitin 1947 e arrestuan prapë. Çfarë ndodhi?

Sigurimi i dha një letër dajës së babait dhe ai ia solli babait. Im atë e lexoi: “Hajde, andej nga Tepelena, se kemi një mbledhje. Do të bëhemi kundër komunizmit, në një revoltë”. Babai e grisi, e hodhi në zjarr në sy të tij dhe ia ktheu: “Ik, se kam shtatë fëmijë për të mbajtur. Të lutem, largohu!” Duke qenë se ky person ishte daja i vet, nuk mund ta denonconte.

Megjithatë ia gjetën pretekstin dhe prapë e arrestuan, këtë herë për mosdenoncim dhe e dënuan me 25 vjet heqje lirie.

23. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 11394. Vendim nga Gjykata e Rrethit Durrës, nr. Regj. Themelor, nr. vendimit, data 15.04.1977. Arkivi i AIDSSH-së.

A e keni marrë dosjen tuaj pranë AIDSSH-së? Çfarë keni gjetur në të?

Hysen Haxhiaj: Po, e kam marrë dosjen, por nuk përputhet fare me realitetin. Aty ishin 12 vetë me pseudonim: "Aktivisti", "Shqiponja", "Profesori"... Ndër ta, nja 4-5 vetë unë i njoh cilët ishin. Po të ishte për hakmarrje, do të kisha vrarë të paktën një, por ne nuk jemi të tillë. Ne nuk kemi pështyrë një njeri. Kujtoj njëfarë Spiro, që e kam pasur hetues në Durrës, më ka hequr një dhëmballë me pinca, përveç edhe torturave të tjera.

Me një fjalë, në dosjen tuaj ishin të gjithë me pseudonim. Ju nuk e dini, se cilët ishin ata?

Hysen Haxhiaj: Nuk e mora vesh se kush është ky e kush është ai.

Në dosjen që keni lexuar, a mendoni se ajo çfarë shkruhet aty, përputhet me shkaqet për të cilat ju arrestuan dhe me rrjedhën e ngjarjeve?

Hysen Haxhiaj: Aty s'ka të dhëna as për burgun, as për hetuesinë. Ka procesverbale që i kanë bërë më pas dhe që nuk kanë të bëjnë fare me hetuesinë dhe as me torturat, që kanë qenë të jashtëzakonshme, si në kohën e mesjetës. Kanë qenë vezët e ziera nën sjetull, morrat në kokë, ta rruanin një pjesë të kokës dhe aty të lëshonin morrat që i nxirrin nga një filxhan. Ulërije si bishë, derisa të pranoje ose deri sa të të binte të fikët. Pastaj, thoshin: "Lëreni, se është i çmendur." Të rrihnin dhe të torturonin sa të të binte të fikët dhe ti vetëm mund të shaje. Për ca fjalë të merrnin jetën.

Për ju, zoti Hysen, arrestimi ishte diçka e papritur, apo e kishit kuptuar që po vëzhgoheshit dhe ndiqeshit për një kohë, nga sigurimi i shtetit?

Hysen Haxhiaj: Më kanë survejuar familjarisht, se babai bëri burg. Edhe familja kaloi 33 vjet në kampe dhe në internim. Dy vëllezërit, Haxhiu dhe Enveri, kanë qenë heronjtë e shtëpisë sonë, që mundën të qëndronin pa u përlulur dhe pa u degraduar si familje. Jemi krenarë për këtë. Unë kam ardhur në Durrës, që në moshën 7-vjeçare.

Klasën e parë, e kam bërë në shkollën "10 Korriku". Aty bëra filloren dhe 7-vjeçaren, kurse gjimnazin, në shkollë "16 Shtatori". Kur mbarova gjimnazin, nuk më dhanë të drejtë studimi, meqë vëllanë ma kishin futur në burg, se i sajuan sikur i gjetën deficit në punë. E bëri kush e bëri, e hëngri vëllai im! Unë rrija te nusja e vëllait dhe flinim te bodrumet e Halil Grudës, në Kala. Aty poshtë ishte një dhomë e një korridor. Për të dalë jashtë, duhet të ngjisje nja 10 shkallë deri sa të arrije sipërfaqen e tokës.

Mbaj mend që kur isha 14 vjeç, sa kisha filluar gjimnazin, më erdhi një letër ku thuhej se "Hysen Haxhiaj, nuk i lejohet të banojë në lagjen nr. 1, prandaj të largohet". E ku të shkoja? Ishte një kryetar Reiz Xhelili nga Mallakastra.

Shkova, me një qarje prej 14-vjeçari dhe iu luta. Isha i shkurtër dhe i vogël. "Ashtu? - u çudit ai. - Po pse, me kalamaj do të merremi?" Dha menjëherë urdhër që të më bëhej pasaportizimi. Nusja dhe vëllai bënë pasaportizimin për mua dhe kështu mbarova gjimnazin, por s'më dhanë të drejtën e studimit. Më morën ushtar. Pas ushtrisë, një profesor i letërsisë, në gjimnaz, Mustafa Grasaliu, më tha: "Shko arsimtar, të rrih sa të rrih, se ty s'të japin të drejtë studimi, ngaqë ke biografi të keqe". Kështu shkova tre vjet arsimtar. Ai më nxiti edhe të kërkoja që të shkoja në Institutin e Shkodrës, për matematikë-fizikë, meqë isha mirë në këto lëndë. Ashtu bëra, por në vitin e dytë, një fshatar, nga ata që kanë marrë kripë në shtëpinë ime në shekuj, lëshoi deklaratë që unë isha bir kulaku, me babain dhe me vëllanë në burg. O Zot i madh!

Më thirri drejtori, Mihal Prifti, i cili kishte qenë ambasador në Moskë dhe në Pekin, dhe më tha: "E ke nga vëllai yt. Ne të kishim student të rregullt. Edhe unë të kam respektuar, se ke zhvilluar aktivitete këtu." Kështu që më përjashtuan nga Instituti.

U ktheva në Durrës dhe u futa në një shkollë nate, mekanike. Mora kategorinë e gjashtë, se të dytën e kisha nga gjimnazi. Meqë kishte edhe inxhinieri elektrike u regjistrova edhe aty. Mendova që të mbaroja një shkollë. Mirëpo, erdhi vëllai i Mehmet Shehut, Nexhipi dhe i tha drejtorit: "Është djalë kulaku. Si e mban këtu ti?" Më thirri drejtori dhe

“Ne ramë në burg, se s’donim një parti, jo se s’donim atdheun tonë, jo se s’donim Shqipërinë edhe popullin.”

më përjashtoi nga shkolla e natës. Në vit të dytë! M'u pre shpresa se do të mbaroja ndonjë shkollë. Fillova punë si mekanik i kategorisë së shtatë. Pastaj, gjeta një vajzë që ishte arsimitare. Një shoku im, më tha: “Merre, se është vajzë e mirë dhe familje e mirë”. Ndërhyra me vëllezër, por familja e saj nuk pranonte. Pastaj ndërhyri daja im, që në atë kohë ishte kolonel, dhe atij ia dhanë. U martova në vitin 1971, ndërsa në vitin 1973 u bëra me vajzë. E quajta, Belina. Kur ajo ishte dy vjeç, më 12 dhjetor, ndërsa isha në shtëpinë e vjehrrit në Golem, më arrestuan. Kisha dy javë që e kisha çuar vajzën që të rrinte atje, që të çlodheshim pak, se ne shkonim në punë.

Çfarë ndodhi që ju arrestuan? A ju mbajtën gjatë në hetuesi?

Hysen Haxhijaj: Në hetuesi kam qëndruar katër muaj, me hetues Spiron. Ai të vandalizonte saqë të binte të fikët e të tërhiqnin zvarrë, nga kati i tretë deri në katin e parë. Akoma sot më dhembin këmbët. Nuk kam as gjumë, as jetë. Them që po jetoj kot. Si përfundim, më arrestuan dhe më dënuan në grup: grupi i art-kulturës.

Gjatë periudhës së hetuesisë ishit vetëm apo edhe me të tjerë në dhomë?

Hysen Haxhijaj: Fillimisht vetëm, pastaj erdhi një që kishte një si saçme në vetull. Ishte nga Lezha. Ma sollën sikur gjoja kishte vrarë gruan, se e gjeti me një tjetër dhe gjoja e kishin dënuar 25 vjet. S'ishte e vërtetë. Ai ishte provokator. Ma prunë ashtu, gjithë gjak. I bënin qëllimisht këto veprimet barbare, se vetvetiu më erdhi keq. I dhashë për të ngrënë e për të pirë. Por njëherë, më tha diçka që më dogji. - Më mirë të tregosh, sesa të mos tregosh, se do të dënohesh keq, - tha. - Hë, për këtë të kanë futur këtu? - i kthehem unë. - More, qen bir qeni! Ti më the që ke vrarë gruan, bashkë me dashnorin.

Kisha një pagurë atje, ku mbanim ujë dhe e godita me të në kokë. Pastaj atë e hoqën, kurse mua më lidhën nga majat e këmbëve për pesë ditë e pesë net. Ajo ishte tortura më e tmerrshme. Si përfundim, kështu vazhdoi derisa mbaroi hetuesia.

A ju kërkuan gjatë hetuesisë që të bëheshit bashkëpunëtor?

Fondi nr.1 hetimor-
gjyqësor, dosje nr. 12459

Hysen Haxhiaj: Patjetër. Gjithë puna ishte që të bëhesha bashkëpunëtor edhe kundër shokëve të mi, se ishim shtatë vetë në atë grupin e art-kulturës të portit detar. Gjyqi u bë te kinemaja dhe me altoparlant. Kot, vetëm llafe. Na dënuan. Mua më dhanë 10 vjet, por si duket, ky hetuesi duhet të ketë bërë ndonjë shënim në kartelë, që të dënohesha dhe për së dyti. Prandaj, në vitin 1981, pasi kisha kryer 5 vjet dënim, më dënuan edhe 10 vjet të tjera, prapë “për agjitacion e propagandë”.

Në hetuesi, a ju kërkuan që ta pranoni akuzën?

Hysen Haxhiaj: Patjetër. Po të firmosje atë, nuk të ngacmonte më njeri, të linte aty të rrije si zotni, ama të firmosje. Unë nuk firmosja dot, se kisha

edhe këshillën e babait: “Kujdes, mos ma lësho në qafë!” Më kërkuan për babën, për vëllezërit, më kërkuan për miq e njerëz të dashur, më kërkuan për gocën... Unë s'mund t'i dorëzoja ata! Kisha biseduar me ta, shumë gjëra të moshës dhe që ishin preokupime për jetën.

A kishte ndonjë rregull se sa duhet të zgjaste një seancë pyetjesh?

Hysen Haxhiaj: Pesë minuta ose edhe një minutë. Të pyeste e s'i përgjigjeshe, merrje një prapa kokës që bije pa ndjenja. Të linin dhe të merrnin prapë, pas dy-tri ditëve.

A ishte e përcaktuar koha kur ju merrnin në pyetje?

Hysen Haxhiaj: Jo. Edhe në një të natës për Vitin e Ri më kanë marrë në pyetje.

Sa persona ishin të pranishëm kur ju merrnin në pyetje?

Hysen Haxhiaj: Vetëm hetuesi.

Po gjyqi juaj sa kohë zgjati dhe për çfarë ju dënuan?

Hysen Haxhiaj: Tri ditë. Më dënuan për agjitacion e propagandë, kurse njërin nga ne e dënuan edhe për dështim.

A zhvilluat debate gjatë ballafaqimit me dëshmitarët?

Hysen Haxhiaj: Jo. Unë e dija që ata u thyen dhe e kam pasur si parim që, me një njeri që thyhet e nuk duron dot, s'ke çfarë flet. Çfarë t'i thuash atij? As emrat e tyre, s'dua t'i përmend. Besoj, nja dy veta ishin këtu, nga Durrësi. Më kryesori, ishte piktor edhe skulptor, rrinte te varrezat, punonte pllakat e varreve. Ai dëshmoi. U kishte thënë këtyre të tjerëve: "E kam shok filanin", meqë kishim qenë në Institut bashkë. Kur më përjashtuan nga Instituti, ai më shoqëroi deri tek autobusi, kështu që vetvetiu i dhashë shoqëri. Edhe dajën, atje e dënuan 10 vjet, vëllain 3 vjet, Astrit Qorrin e dënuan 10 vjet edhe shumë e shumë të tjerë. Pas gjyqit më erdhën në takim nipa, motra e vëllezërit e më thanë se "po të mbajnë në gojë të gjithë në Durrës, për qëndrimin njerëzor e burrëror që ke mbajtur".

Familja juaj mori pjesë në gjyq?

Hysen Haxhiaj: Motra ime, po. Një moment, kur prokurori po lexonte biografinë e pastaj pretencën, u çua një nga salla dhe bërtiti: "Të pushkatohet, armiku i poshtër!" Motra ime, ia ktheu menjëherë: - "I marrsh të keqen!" E morën policët motrën, e nxorën jashtë dhe pastaj vazhdoi gjyqi. Asaj motre, kudo në kampe dhe në burgje, i thonë "Heroinë".

Sa vjet ju dënuan?

Hysen Haxhiaj: Më dënuan 10 vjet "për agjitacion e propagandë dhe për minimin, dobësimin dhe përmbysjen e pushtetit popullor". Akuza ishte me të vërtetë e rëndë. Kush e dëgjonte, tmerrohej.

Babai kishte bërë 12 vjet nëpër burgje e nëpër kampe, më pas. Më tregonte për Bedenin. Atje i lidhnin djemtë e rinj, me kokë poshtë në llucën e kanalit, edhe i linin ashtu derisa të vdisnin. Ose intelektualë të mirëfilltë, në kënetën e Maliqit. Një kapter nga Mallakastra, Haxhi, i vinte në radhë që të kalonte mbi ata në anën tjetër të kanalit dhe i shkelte, i mbyste aty tre – katër vetë, sa t'i tekej. Janë veprime çnjerëzore! Ose aty ku ishim ne, në galeri, kemi pasur dy - tre raste që i kanë hedhur mbi bunker e kanë dalë trupat copa - copa poshtë. Pas një viti në burg, njëherë, u bëra të vras veten, se pashë edhe ordererë atje.

Po me familjarët tuaj çfarë ndodhi? Ku i çuan?

Hysen Haxhiaj: - I çuan në vendlindje të gjithë, në fshat. Punonin në kanale. Pas një viti, më erdhi kjo motra edhe nuk m'u nda. Ajo më mbajti gjallë, gjer më sot që po jetoj.

Ku ma merrte mendja mua, që unë të arrija gjer 80 vjeç! Vajzën ma rriti gruaja. I thashë që përpara se të arrestohesha, se e nuhata ngaqë po më vinin vërdallë. "Të lutem, më rrit vajzën. Po deshe, po gjete ndonjë njeri që e do për shok jete, ma ço vajzën te prindërit e mi, se ndryshe nuk ta fal." Ajo, vërtet e mbajti vajzën. I thashë: "Do të bësh ndarjen me mua e do t'u thuash që s'e kam dashur kurrë. Bëje ndarjen!"

Pa dalë unë në gjyq e bëri ndarjen. Nuk e hoqën nga arsimit, se dy vëllezër i kishte komunistë, anëtarë partie. Mbeti në arsim, sa këtu dhe sa atje, brenda në Durrës. Më priti. Kur erdha, gjeta një strehë, një dyshek e një jorgan ku të fusja kokën.

E kishit dëgjuar fjalën Spaç?

Hysen Haxhiaj: E kisha dëgjuar. Edhe revoltën që u bë atje, edhe se Gjermania e ka dhënë njoftimin brenda 24 orëve.

Ju shkuat në burgun e Spaçit saktësisht 4 vjet pas revoltës, apo jo?

Hysen Haxhiaj: Po. Në Spaç, për një shikim që i hidhje kapterit, ai menjëherë thoshte: "Pse më shikon? Dil lart!" Dhe kur dilje lart, të lidhte dhe të fuste në birucë. Birucat e Spaçit ishin çnjerëzore.

Si jeni ndier kur sapo mbërritët në Spaç?

Hysen Haxhiaj: Njeriu, kur shkon në një burg politik, mendon se aty ka njerëz që janë më të mirët e vendit dhe që mendojnë për vendin e për atdheun. Këtë bindje kisha unë. Mirëpo aty, fatkeqësisht, pashë që gjysmë për gjysmë ishin ordinerë, se mbas vitit 1973, që ndodhi revolta, kanë futur shumë ordinerë tek të dënuarit për politikë, që t'ua nxinin më keq jetën, se ordineri të vidhte edhe bukën, të ngacmonte dhe të provokonte.

A kishte solidaritet mes të dënuarve politikë?

Hysen Haxhiaj: Kishte edhe burra të mrekullueshëm duke nisur nga Xhelal Koprencka, Fadil Kokomani, Vangjel Lezho, gazetarë këta dhe, çudi e madhe, vdiqën komunistë?! Thonë se kishin shkruar një letër për Komitetin Qendror, ku kërkonin: "Ju lutemi, hiqeni Nastradinin dhe vini një tjetër." Kishin guxim!

Për këtë u dhanë plumbin në vitin 1979. Kur e arrestuan Xhelal Koprenckën dhe i thanë: "Në emër të popullit, je i arrestuar!", ai ju kthye atyre: "Dëgjoni! Thoni në emër të armiqve të popullit, jo në emër të popullit!" E ngritën përpjetë, sa unë vetëm këmbët i pashë. Unë i shkreti isha te shkallët, ku e ngritën dhe e çuan atje, ku e pushkatuan. Për katër-pesë ditë ua bënë gjyqin. 15 djem dhe 4 të tjerë, i dënuan me nga 25 vjet. Aty s'kishte fjalë. Fjala ishte: "O vdekje, o burgim i përjetshëm!"

Kushtet e dhomës si i kujtoni tani?

Hysen Haxhiaj: Një dhomë me 54 të burgosur brenda, që flinin në me tri kate. Unë isha në katin e tretë. Hapja kapakun e dritares aty dhe merrja ajër natën. Kishim dyshekë kashte për secilin, por rrinin ngjitur - ngjitur dyshekët.

Po ushqimi?

Hysen Haxhiaj: Ushqimi bëhej në kazan: presh të zier, lakra të ziera, specat të ziera. Kishte edhe

ndonjë copë mish, por nuk arrinte deri tek ne... Për ata që ishin në punë në darkë, marmelatë me një çaj, ndërsa ata që s'punonin, vetëm një çaj.

Mund të na përshkruani një ditë në Spaç, nga zgjimi e gjersa shkonit sërish për të fjetur?

Hysen Haxhiaj: Në dimër temperatura shkonte -17 gradë, kurse në behar shkonte 38-40 gradë. Zgjoheshe në orën pesë. Haje bukë, në orën gjashtë. Në gjashtë e gjysmë niseshe për galeri, dorë për dorë. Galerinë e kishim 20 minuta larg kampit. Ishin tri zona: zona e dytë dhe e tretë, nga njëzet minuta larg. Unë isha te bakri, pastaj shkova në nxjerrjen e piritit. Atje më dënuan për së dyti. Në pirit futeshim gjer në 2500 metra nën tokë dhe galeria kullonte acid me ujë, kurse temperatura shkonte 43 gradë. Edhe duhej të mbushje shtatë vagonë, t'i nxirrje. Se përndryshe, ktheheshe me tezgë. Atë e ngrinin katër shokë, deri te dera. Pastaj të çonin në infermieri, që të të mjekonin çfarë kishe.

Pas punës shkonit në mensë, për drekën?

Hysen Haxhiaj: Po, hanim drekën. Nëse s'doje, të rrinte polici te koka dhe të thoshte: "S'të pëlqen gjella e Enver Hoxhës?" dhe të fuste një muaj në birucë, prandaj do ta haje se s'bën.

A ju mjaftonte ushqimi, apo kishit edhe ushqime nga familja?

Hysen Haxhiaj: Ushqimi nga familja, më ka nxjerrë gjallë nga burgu, se shumë kanë vdekur...

Çfarë pune ju caktuan të bënit?

Hysen Haxhiaj: Në galeri qysh ditën e tretë. Në nxjerrjen e vagonëve të bakrit: çfarë hidhte shoku, do t'i nxirrja unë. Vagoni i bakrit ishte një ton dhe i piritit ishte një ton e gjysmë. Kishte vende ku minerali të binte dhe do ta ngrije e do të haje dynjanë, se ishte një ton e gjysmë. Ndodhte që nuk bënim normën e përfundoje në birucë, deri në tre muaj dhe dilje i shkatërruar, herë-herë merrje tuberkuloz.

A ka pasur persona që kanë ushtruar dhunë ndaj jush? A ju kanë torturuar? A keni dëgjuar për të tjerë, që t'u jenë nënshtruar torturave?

Hysen Haxhiaj: Ka pasur dhunë fizike. Kur s'kishte shkopinj plastikë, me bishta lopate e bishta kazme, barbarisht. Nuk e ke idenë: as llogariste, se ku të kapte. Një kafshëri që nuk mund të imagjinohet. Kampet e punës, sidomos, kanë qenë tmerr i vërtetë, sepse donin që ne të bënim normën. Me normën tonë kanë nxjerrë edhe flori. Në Rubik vinte GAZ-i 59-sh dhe e merrte floririn çdo javë. Kështu e di unë.

Si jeni ndier pasi dolët? Po kur u kthyet në familje?

Hysen Haxhiaj: Oh, si në ëndërr! Një ëndërr që nuk e beson se është realitet.

Në këto vite të demokracisë, a ju është kërkuar falje nga pushteti për dënimin e padrejtë që ju është bërë

Hysen Haxhiaj: Kjo është më dramatikja. Mirë na bënë, ç'na bënë, po një falje s'kërkohej? Festohen përvjetorë ngjarjesh të ndryshme dhe nuk pyet askush përse ramë ne në burg? Ne u burgosëm se nuk donim një parti, jo se nuk donim atdheun tonë, jo se nuk donim Shqipërinë edhe popullin tonë. Këto i duam. Nuk e kanë fisnikërinë që të thonë: "Urdhëro, zoti Hysen Haxhiaj. Eja këtu në Ballsh ose në Mallakastër, ose në Tiranë se është 28 Nëntori, festa e Atdheut!" Por, po ma hiqni edhe këtë të drejtë?! Mirë që më hoqën vendlindjen, me ligjin nr. 7501, një ligj kriminal, por po më hiqni fare edhe Atdheun!

A keni takuar ndonjë prej atyre që dolën dëshmitarë kundër jush?

Hysen Haxhiaj: Kam një rast. Vajta në Berat dhe takova ushtar Çobën. Më tha: - Hysen, e di që unë kam bërë deklaratë për ty? Ma mbështolli ai hetuesi... Kështu tha e filloi të qajë. - Do të më vriste, unë

nënshkrova deklaratën për ty. Atë çast mendova se, cili nga ato 12 pseudonimet mund të ishte i tij. - Po mirë, more, - i thashë unë, - lëre, të hamë bukë!

Më erdhi keq, kur më tha që do ta vrisnin. Mendova: - "Ja, edhe pse u dënova unë për së dyti, s'u bë kiameti. Prapë jam gjallë." Këta që janë tani, kanë parë edhe botën... Djemtë tanë janë, s'kemi të tjerë. Këta jemi. Ne që jemi të duam njëri-tjetrin, se po s'e deshëm njëri-tjetrin, ka marrë fund.

Si jeni ndier gjatë këtyre viteve të demokracisë, lidhur me qëndrimin e shoqërisë ndaj jush, si ish-vuajtës për shkaqe politike gjatë diktaturës?

Hysen Haxhiaj: Në vitin 1994 shkova në Amerikë. Mendova një herë të rrija atje, por doja këto gurë dhe ferra. Akoma e kam dashurinë në vete. Edhe për nënën, që e ka varrin në fshat. T'i çoj një tufë me lule. Edhe atij vëllai, që e ka varrin në Ballsh, te dëshmorët, t'i çoj një tufë lule. Edhe atij që s'i ka çuar asnjëri, deri më sot.

A merrni pension si ish-i dënuar?

Hysen Haxhiaj: Tani vonë e kanë shtuar, ka shkuar te 300²⁴.

Bëhet fjalë për pension të veçantë?

Hysen Haxhiaj: Jo, pension të veçantë jo. I bëra dokumentet dhe i çova në Kryeministri. E aprovuan të gjitha shoqatat këtu në Durrës, por atje nuk e dhanë.

Cila është përbërja juaj familjare, me kë jetoni? A keni përfituar banesë, si ish-i dënuar?

Hysen Haxhiaj: Unë kam gruan edhe vajzën, po kam marrë banesë si ish-i dënuar, por duhet të bëhet më shumë për ish-të dënuarit, në emër të dinjitetit të tyre.

24. Edhe këtu, për vlerën e lekëve përdoret referimi popullor me sistemin e vjetër 300 mijë lekë të vjetra, që janë 30 mijë lekë.

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

26

27

28

29

30

31

32

33

34

35

36

37

38

39

40

41

42

43

44

45

46

47

48

49

50

51

52

53

54

55

56

57

58

59

60

61

62

63

64

65

66

67

68

69

70

71

72

73

74

75

76

77

78

79

80

81

82

83

84

85

86

87

88

89

90

91

92

93

94

95

96

97

98

99

100

101

102

103

104

105

106

107

108

109

110

111

112

113

114

115

116

117

118

119

120

121

122

123

124

125

126

127

128

129

130

131

132

133

134

135

136

137

138

139

140

141

142

143

144

145

146

147

148

149

150

151

152

153

154

155

156

157

158

159

160

161

162

163

164

165

166

167

168

169

170

171

172

173

174

175

176

177

178

179

Iljas Kajo

“Nuk bëra dot birat në shkëmb. Më lidhën mbas shtyllës dhe më vunë në duar atë rrotën e vagonit të hekurat dhe me tela me gjemba.”

Iljas Kajo, i biri i Zarës dhe Hakiut, lindur më 4 mars 1948, në Lapardha, Berat. U arrestua me akuzën “për agjitacion e propagandë” më 27 janar 1977. Qëndroi në hetuesi për gjashtë muaj. U gjykua më 20 maj 1977. Vuajti dënimin në burgun e Spaçit. U lirua më 30 maj 1985.

Zoti Iljas, ju falënderojmë shumë që keni pranuar të ndani me ne dhe lexuesit kujtimet tuaja mbi burgun e Spaçit dhe veçanërisht për revoltën e Spaçit.

Iljas Kajo: Vij nga një familje nacionaliste. Gjyshi komandonte një grup me 300 ushtarë. Për këtë fakt u arrestua gjyshi e me radhë u arrestua gjyshja, babai, vëllai dhe më pas unë...

Gjyshi është arrestuar në '45-ën e tok me të edhe Luftar Kajo dhe Dervish Kajo. Luftari u dënua dhe vdiq në Maliq të Korçës, gjyshi vdiq në Berat.

Babain e arrestuan në vitin 1971 me gjithë vëllanë tim. Kur e arrestuan vëllain, e zbritën nga makina, i hodhën një batanije mbi kokë dhe e mbajtën të fshehur nja 12 a 20 ditë.

Pas kësaj, edhe unë e kam ndjerë veten të mbikëqyrur. Gjatë vitit 1972 më kanë ndjekur.

Si e zbuluat që ju ndiqnin?

Iljas Kajo: Shefi i Sigurimit vinte te brigada nr.1 ku punoja unë. Njëherë më thirri në zyrë dhe më pyeti sa shkollë kisha. 7-vjeçare, - iu përgjigja unë. - Ku punon? - Në brigadë. Edhe filloi të ma sillte fjalën, por unë ia preva: - Dëgjo këtu! Mos më pyet mua! Mos më thirr më në këtë zyrë! Këtu, mos më thirr më!

Në cilin vit ju arrestuan?

Iljas Kajo: Më arrestuan në 24 janar të vitit 1977

“...Eh, babai në burg, vëllai në burg, miqësia e tërë në burg.”

në Lapardha. Isha 25 vjeç dhe punoja. Më morën, më futën brenda në birucë në hetuesi. Aty iu luta perëndisë të më nderonte që të mos bëhesha spiun. Aty ka qenë një kapter Zaimi. - Hë, biri i armikut, u ktheve nga Baba Tomori? - Po, - iu përgjigja. - S'do mend, Baba Tomorin kemi ne. Gjashtë ditë kam pritur pa hetuesi, se dosja ishte në Ministrinë e Brendshme.

Në krye të gjashtë ditëve erdhi dosja. Arrestimin tim e kishte firmosur sekretarja e parë, kryetari i Degës dhe prokurori. Në një shkurt filloi hetuesia. Atje ku bëhej hetuesia dhoma kishte një karrige betoni, ku të lidhnin e të vinin dorë.

Kur thoni “të vinin dorë” e keni fjalën që juve ju kanë rrahur?

Iljas Kajo: Të rrahur që s'e ke idenë. Nga të rrahurit syri i djathtë u bë aq keq sa për 3 muaj nuk shikoja me të. Hetues ka qenë Bujar Himçi. Hetuesi dhe dhunë.

Më pyesnin për njerëz që unë i njihja, por atyre u thosha: “Nuk i njoh”. Më merrnin edhe në 12 të natës. Më kërkonin llogari për miqtë e mi dhe dru natë për natë. Në gjashtë muaj një ditë nuk kam shpëtuar pa ngrënë dru.

Sa zgjati hetuesia?

Iljas Kajo: Përafërsisht 6 muaj.

A ju kanë futur provokatorë për t'ju bërë bashkëpunëtor?

Iljas Kajo: Po. Sollën një, por ai doli njeri besnik.

I mashtroi ata. Kur ky më pyeti përse më kishin dënuar, unë i thashë që kisha vrarë gruan. Më kishte porositur nëna që nëse sillnin ndonjë provokator, të hiqesha sikur kisha vrarë dikë: gruan, a vëllain ose ndonjë tjetër.

Ashtu bëra edhe ndava birucën me të: deri këtu e kam kufirin unë e deri atje e ke ti. Bëra kujdes edhe të mos shaja, se e dija që vinin përgjues. Pasi u dënova unë, ai vetë më tregoi që e kishin futur kastile për të më zbërthyer.

Pas 6 muaj hetuesie ju nxorën në gjyq? A u paraqitën dëshmitarë kundër jush dhe sa ju dënuan?

Iljas Kajo: Po, atëherë dola në gjyq. Me dyer të mbyllura. Më dënuan 10 vite burg edhe 5 vite elektorale. Dëshmitarë dolën 6 vetë.

Çfarë dëshmuan ata kundër jush?

Iljas Kajo: - Dëshmuan sikur kisha thënë që unë nuk pyes për këtë pushtet, as për ata të Tiranës, sikur kisha sharë “mua Enver Hoxha të më hajë m...”, etj.

Këtu e kapa mat hetuesin. -Për këtë më akuzoni? Po ti e njeh familjen time? - i thashë. -E njoh, - tha ai. - A ma lejon edukata e familjes sime, që unë të shprehem kështu?- i thashë. - Shkruaj aty çfarë të duash. I firmos të tëra unë, por këtë nuk ta pranoj!

A ju ka kërkuar ndonjëri prej dëshmitarëve të falur?

Iljas Kajo: - Vetëm njëri më ka kërkuar falje. Po

shkoja me plakun në klub për kafe dhe na doli përpara. U ul në gjunjë.

Sa vjet ju dënuan?

Iljas Kajo: Jam dënuar 10 vjet dhe kam kryer 8 vjet.

Pas gjyqit ku ju dërguan?

Iljas Kajo: Atëherë vinte autoburgu. Ka qenë i mbyllur dhe lart kishte një rretë. Erdhi në Berat. Prej aty në "kaush" në Tiranë. Nga Tirana në Spaç me autoburg. Ishim rreth nja 20 veta që po shkonim në Spaç.

Si shkuat deri në burg? Sa zgjati rruga?

Iljas Kajo: Zgjati nja tri orë e gjysmë a katër orë. Rruga ishte shumë e keqe.

A njohët njeri kur mbërritët në Spaç?

Iljas Kajo: Unë? Po unë në Spaç i njihja të tërë "armiqtë". Miq e shokë atje i kisha unë, s'kisha jashtë. Atje më doli burri i motrës, pastaj më doli Besniku, Qazim Torua, Barjam Dervishaj, kisha edhe ca fshatarët e mi, që ishin para meje të përndjekur politikë...Eh, babai në burg, vëllai në burg, miqësia e tërë në burg.

A ju sillte ndokush ndihma, ushqime?

Iljas Kajo: Te babai shkonte vëllai i madh muaj për muaj. Tek unë vinte vëllai i dytë, edhe vëllai i vogël edhe motra që kishte burrin në burg. Pastaj në burg të vinin beratasit e të pyesnin. Vinte Bajram Dervishaj e më thoshte: - Ke lenë gjë mbrapa? - Jo, jo, - i thosha unë. - Mbahu këtu, mos u bëj spiun,- thoshte Barjami. Më mësonte ai, se ishte "ujk i vjetër", ndërsa unë i sapovajtur. Unë isha pa shkollë, por atje kishte njerëz që ishin intelektualë, si: Fadil Kokomani, Vangjel Lezho, një Ndue nga Shkodra. Më thonin: "Bëhu shurdh, bëj punën që të takon. Nuk ke punë me policinë".

A mund të përshkruani një ditë në burg?

Iljas Kajo: Ngrihesha në orën 5 të mëngjesit kur binte çanga. Dilja jashtë, laja sytë, vishesha. Merrja tasin e lugën dhe shkoja në mensë. Pasi

haja bukën, çoja tasat në vend. Pastaj në rresht. Bëhej apeli dhe na nxirrnin në punë. Në orën 6:30 dilnim nga kampi, se puna kishte ritëm dhe duhet të ecnim edhe rreth 1 orë e gjysmë larg për në galeri. Kur na fusnin në galeri na thonin shokët: "Mirë dalç!", se futeshe dhe nuk e dije nëse do të dilje më i gjallë.

Unë me duart e mia kam nxjerrë njerëz të vrarë, futeshe 10 km drejt në tunel brenda, në këmbë dhe duhet të plotësohej 10-vagonshi, 5-vagonshi ose 20 vagonë që të shpëtoje nga druri dhe hekurat. Njëherë, ishte ora 3-4 e mëngjesit dhe po punonim në turnin e tretë. Vjen polici dhe më thotë: "Hajde, Laze, hajde se ka zënë galeria Kol Manen dhe Martin Pjetrin nga Shkodra". Shkoj atje dhe shoh Martinin që ishte deri te buza me mineral. Piriti është si gurë.

Morëm një dërrasë, e vumë të bllokonte mineralin që të mos binte më. Më pas, ne hidhnim kova uji mbi mineral, se kur dikë e zinte minerali nën të, uji hidhej për ajër, se nga nxehtësia qarkullonte ajri. E nxorëm Martin Pjetrin. Ankohej i ziu: "avash, se më këputët këmbën!" aq shumë e vriste minerali. E kështu e nxorëm dhe ata e plasën andej matanë, kurse Kola kishte vdekur.

Nëse nuk e realizoje normën të lidhnin. Hysen quhej polici që më lidhi. Binte dëborë kur më lidhi herën e parë. Nuk bëra dot birat në shkëmb. Më lidhën mbas shtyllës dhe më vunë në duar atë rrotën e vagonit te hekurat dhe me tela me gjemba.

Kam ndenjur 8 orë i lidhur. Hyseni rrinte në dritare dhe më ruante mua. Unë isha i burgosur i ri, sa kisha vajtur. Pas 8 orësh, më mori dhe më futi në zyrë. Aty ishte soba e ndezur. Kur do të më hiqnin hekurat nga duart, nuk dilnin. M'i futën duart në ujë të ngrohtë, se nuk dilnin hekurat nga mishi. Buhavitej dora. Pastaj më çuan në birucë.

Sa mbërrije atje, të vinte polici tjetër, jo ai i punës, por polici i birucës, që të rrihte pse nuk kishe realizuar normën. 30 ditë në birucë, vetëm me një batanije. Kaq! Kam qenë në birucë 1 muaj me Feritin nga Shkodra. Djalë i mirë ai, djalë besnik. Ngaqë nuk kishim çfarë të bënim, ai më tha që të vidhnim një batanije. E mbështolli tek cepi i murit.

**“Kur na fusnin
në galeri, shokët
na thonin: “Mirë
dalç”, se futeshe
dhe nuk e dije
nëse do të dilje
më i gjallë.”**

Por kur erdhi kapteri, Pjetër Koka e pa. -Kush e vuri batanijen këtu?- tha. -E vura unë - iu përgjigja. Mirëpo dola bluf, se ai e dinte që e kishte vënë Feriti. - Përse, përse?- dhe më gjuante -Po qysh e durove, more?- më tha Feriti. - Epo, ai do të të rrihte ty. Ti dje u zure me të, dje të rrahu. A do t'i mbrojmë shokët? Ka qenë edhe një, Cuf Taja, dhe...më ka kapur njëherë më ka rrahur atje në birucë.

Kur keni dalë nga burgu?

Iljas Kajo: Unë kam dalë nga burgu në 30 prill të vitit 1985.

Si jeni ndier pasi u kthyet në shtëpi? Çfarë pune keni bërë?

Iljas Kajo: Atë ditë që jam liruar unë, shefi operativ ishte oficer roje. Atë e kisha nga fshati ngjitur me fshatin tonë, por s'e njihja. Ama ai më njihje dhe kur dola, më dha të njohur: "Nuk më njohe? Unë jam çuni i filanit. Ne do të shkojmë në Shkodër".

Kështu që hipa në makinë gjer në Milot. Aty prita. Kaloi një autobot i madh dhe unë e njoha shoferin. I tregova që po vija nga burgu i Spaçit. Ishte ora 2:00 e natës kur mbërrita në Berat, në Lapardha. Zbrita në fshat. Me rrobat në krahë shkova drejt e në shtëpi. Nga xhadeja deri te shtëpia ishte 2 km. Aty më priste plaka e plakun. Kur hyra, i ra të fikët plakës.

Atë natë nuk fjeta fare, se u llafosa me plakun. Kisha 16 vjet pa e parë me sy, se edhe ai kishte qenë në burg, në Ballsh. Kur më arrestuan isha 25-26 vjeç. Dola nga burgu 37 vjeç, pa i mbushur tamam. Kisha punuar në galeri, minator. Nga burgu, fillimisht u paraqita në Degë dhe atje dorëzova zarfin. Për punë më çuan në brigadë në bujqësi, punë me kazmë në Lapardha.

Kur e keni krijuar familjen?

Iljas Kajo: Jam martuar në 1989, se nuk të qaste njeri. Thoshin: "Si ta japim çupën te burgaxhiu?" Djalin e madh e kam 33-vjeç, është i fejuar, punon në Tiranë. Djali tjetër është i martuar.

Çfarë kujton ndonjë gjë të veçant, nga vuajtjet tuaja?


Iljas Kajo: Ka shumë gjëra...Kujtoj vuajtjet, rrahjet, shokët e mi që ngelën në galeri, se kam nxjerrë me duart e mia 5 vetë të vdekur nga galeria. Dhe kur kujtoj atë Kolë Vanin nga Shkodra, më *dridhet mishi*. *Qenë edhe dy nga Pogradeci, nuk më kujtohen emrat. S'i harroj dot ata djem të rinj*. Unë kujtoj edhe takimin e parë me nënën.

Aty s'e kam mbajtur dot veten. Dhe aty jam zënë me policin saqë më tha: - Pusho, bir! - dhe zuri të qante. - Mos qaj,- i thashë - se unë do të vij, se jam i ri. Jam i lumtur që s'jam martuar, fëmijë s'kam lënë t'ua bëja barrë juve. Mos u mundoni më për në takim, se unë jam mirë këtu.

Ja, kështu i thashë. Çfarë t'i thosha unë? Ushqimi ishte tërë krimba dhe do ta haje nga e keqja: fillonte me domate, mbaronte domatja, fillonin specat, mbaronte speci, fillonte preshi i njomë, mbaronte preshi i njomë, fillonte preshi i thatë...

Kujtimet tuaja janë të shumta e të dhimbshme. A keni ndonjë porosi të veçantë, për brezin e ri?

Iljas Kajo: Porosia ime për të rinjtë është që të punojnë e të nderojnë veten e tyre, të punojnë për kombin, të shkollohen, të kthehen drejt perëndimit, të mos presin nga partitë politike.



Ylli Kanina

“Aty s’të linin të flisje që të mbroheshë.”

Ylli Kanina, i biri i Nekies dhe Islamit, lindur më 20 maj 1957, në Braçanj, Bilisht. U arrestua në 27 qershor 1977, me akuzën “për agjitacion e propagandë” dhe u dënua me nëntë vjet heqje lirie²⁵. Hyri në burgun e Spaçit në vitin 1977 dhe doli prej aty, në prill 1988. Ndërsa vuante dënimin u ridënua me gjashtëmbëdhjetë vjet e shtatë muaj, sërish me akuzën “për agjitacion e propagandë”. Banon në vendlindjen e tij.

Zoti Ylli, ju falënderojmë që keni pranuar të jepni intervistë për ngjarjet e jetës suaj gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Spaçit. Cili ishte shkaku i arrestimit tuaj?

Ylli Kanina: Nga familja, nuk kisha ndonjë problem, prandaj mendoj se këto ishin teka të operativëve, që donin të ngriheshin në detyrë. Unë isha një ushtar 18 vjeç dhe u dënova për prishjen e fotografisë së Enver Hoxhës, gjë që s’e pranoj as sot. Ishin trillime të Sigurimit të Shtetit që i sajuan vetëm për të krijuar një grup që duhej dënuar edhe na dënuan ne të katërve. Zanafilla ishte më shumë për të goditur ish-komandantin e

batalionit. Nuk kishin si t’ia bënin, për ta dënuar komandantin e batalionit dhe na goditën ne. Imagjino, çfarë dënimi!

Kisha një shok të ngushtë, Frederikun, i persekutuar, se e kishte të atin në burg me një grup armiqësor. Atëherë, në shtator u arrestuan shumë vetë. Që ta bënin sa më të besueshme në popull këtë ngjarje, arrestuan edhe të birin, Frederikun. Në këtë kohë, goditën edhe familjen time. Babai im ishte kundër regjimit dhe për t’ia mbyllur gojën atij, më arrestuan mua.

Kur është prishur portreti i Enver Hoxhës, unë nuk kam qenë fare në repart. Isha në shtëpi me leje të rregullt, madje mbaj mend se, kur shkova në repart, portreti ishte i prishur. Vetëm për këtë gjë më kanë arrestuar. Unë isha teknik për qendrat e zjarrit. Më thanë se në Zaroshkë po montoheshin qendra zjarri dhe duhet të nisesha për atje e të qëndroja disa ditë.

U nisëm në këmbë. Një xhip priste mbrapa një kodre. Sa u afuam ne, nga xhipi zbritën katër vetë

25. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 11100, Vendim nga Gjykata Popullore e Rrethit Korçë, Kolegji Ushtarak, nr.30 Akti, nr.30 vendimi, datë 13.09.1977, Arkivi i AIDSSH-së.

“Mbylle gojën, armik! - Po ç’ armik jam unë? - Armik je!”

e më thanë: “Në emër të popullit, je i arrestuar!” Më arrestuan dhe më çuan drejt e në Degë. Më futën atje dhe më kanë bërë një të rrahur që... nuk di ç’të them. Më pyesnin: - Çfarë ke bërë? - Asgjë, s’kam bërë. - Jo, ke bërë. Ke prishur portretin e Enver Hoxhës, bashkë me filanin. U thashë që s’dija gjë, se kisha qenë me leje dhe atë ditë, kur isha kthyer në repart, portreti kishte qenë i prishur. -Jo! - më thanë dhe më rihnin.

Sa zgjati hetuesia?

Ylli Kanina: Hetuesia zgjati katër muaj.

A mund të na e përshkruani birucën ku ju mbajtën gjatë hetimit?

Ylli Kanina: Biruca ishte si mos më keq. Mbjaj mend si tani, se kam qenë te biruca numër 8. Edhe dritaren e kishte të vogël. Te dera kishte një katrore të vogël për të ndezur cigaren. Kaq shikonim ne. Në Korçë nuk na jepnin fare kuverta. Edhe ujin e hollë e bënim në një shishe, që na e linin brenda. Skëterrë ishte! Na rihnin, na bënin të vdekur kot. Vinte një Nexhat, një gardian burgu. Sa na rrihte ai! Pastaj na fusnin ca spiunë të na provokonin. Nuk mund të thuash, çfarë gjërash të poshtra na kanë bërë, se i kemi vuajtur mbi kurriz e na vjen zor t’i kujtojmë përsëri.

E mbani mend, daljen në gjyq?

Ylli Kanina: Po si nuk e mbaj mend! Gjyqin e kemi bërë te reparti i kufirit. Andej nga parku ka qenë. Na morën atje dhe, deshe apo nuk deshe ti, ai s’e kishte problem ta pranoje, apo të mos e pranoje ti. Për gjyqin, mund të thuash gjyq prej

karagjozi, se nuk ishte gjyq. Çdo gjë mund t’i thoje, por gjyq jo. Aty s’të linin të flisje që të mbrohesh. Vetëm “Mbylle gojën!” Një prokuror fals, një gjykatës fals. Vendimi i shkruajtur që më parë, që kaq do të dënohet dhe mbaroi. Edhe në hetuesi, ai vendim ishte, i përcaktuar që më parë, sipas shkollës, sipas armiqësisë. Mua më dënuan 9 vjet.

Kishit ndonjë dëshmitar tjetër, përveç grupit?

Ylli Kanina: Kishte. Shiko çfarë dëshmie kishin ata: “Kanë mbajtur një radio; kishte flokë të gjata; kishte qejf të vishte pantallona të gjera”. Për këto u dënuam. Ta dinte bota për çfarë jemi dënuar ne, do të na ngrinte lapidar. Ishin gjyqe kot, sa për të na dënuar dhe poshtëruar ne ose fisin tonë.

Duke qenë se ishit në një moshë aq të re, a ju ofroi shteti ndonjë avokat?

Ylli Kanina: Ku kishte avokatë, atëherë? Avokati nuk ekzistonte. Po ta zinte njeri në gojë, të persekutonin më keq.

A erdhi ndonjë nga familja për të ndjekur zhvillimin e gjyqit tuaj?

Ylli Kanina: Jo, se nuk i lajmëruan. Nuk ishte asnjë nga të afërmit e mi, asnjë. Salla ishte plot, por ishte me ushtarë dhe oficerë.

Sa ishte dënimi që kërkoi prokurori dhe sa ju dha gjykatësi?

Ylli Kanina: Aq sa tha prokurori, aq ngeli. Ishte e vendosur që në Degën e Brendshme, se sa do të dënoheshe.

Mbas dënimit tuaj, a i ndodhi gjë familjes?

Ylli Kanina: Jo, nuk pësuan gjë.

Me çfarë ju transportuan për në Tiranë?

Ylli Kanina: Mjeti ishte si bot²⁶, i mbyllur nga të katër anët. Më fal për shprehjen, por vill njëri e vill tjetri... Binin njëri mbi tjetrin. Ishte tmerr...

Sa kohë qëndruat në “kaush” në Tiranë dhe kur ju nisën për në Spaç?

Ylli Kanina: Në “kaush” të Tiranës kemi ndenjur 25 ditë, se prisnin sa të bëheshin 27-30 vetë. Me 5 veta s'të çonin. Pastaj na çuan në Spaç. Në mos gaboj, ishte nëntor kur shkuam atje.

Gjetët ndonjë të njohur në burg? Si jeni ndier kur mbërritët në Spaç?

Ylli Kanina: Ishin nja dy fshatarë, por nuk më njihnin mua. Ata ishin dënuar nga 25 vjet burg dhe atë kohë kishin bërë 15 vjet, prandaj nuk më njihnin fare. Kur ata kanë rënë në burg, unë kam qenë 2 vjeç, por nga mbiemri erdhën të më pyesnin, nga je dhe nga s'je. Dolën e më pritën si fshatarë e në këtë kuptim, ata ndiheshin mirë, që të prisnin një prej fshatit të tyre, pavarësisht se ne ishim në fatkeqësi, ishte rasti që të merrnin vesh për bashkëmoshatarët e vet e për të tjera gjëra. Aty kishte njerëz të panjohur dhe presion nga policia, presion nga frika... Ishin të gjitha, derisa u mësova me ambientin.

Na përshkruani një ditë pune të zakonshme në Spaç.

Ylli Kanina: Në Spaç filluam një punë që nuk e kishim bërë ndonjëherë, në minierë. Nuk e mbaj mend mirë, por na çuan gjasme si për të mësuar rregullat e sigurisë në punë e pastaj, na vunë minatorë. Në një ditë pune, ishte kjo rrjedhë: dilje në mëngjes, haje bukë, viheshim në rresht, kontroll fizik, kur ishim turni i parë dhe shkonim në minierë, se kontrolli bëhej edhe kur hyje edhe kur dilje. Kur mbërrinim, merrje veglat, lopatën, kazmën, mbushje kandilat me karbit edhe drejt e atje. Duhet të mbushje 10 vagonë, t'i nxirje dhe duhet të fillon të bëje birat, për t'ia lënë turnit tjetër. Tetë orë punë dhe më zbrisje prapë në kamp, haje bukë, shkoje me detyrim në lexim

shtypi: lexohej gazeta. Pastaj bëhej apeli dy herë; në mëngjes dhe në darkë. Por në darkë s'e ndjenim, se binim për të fjetur dhe na numëronin duke fjetur. Kurse në mëngjes na mblidhnin tërë kampin dhe bëhej apeli, një më një. Rrinin policët dhe oficerët roje e na numëronin të tërëve.

Në çfarë ore e hanit darkën?

Ylli Kanina: Saktësisht, nuk e mbaj mend unë, por rreth orës 7:00-8:00. Hante turni i 3-të, pastaj i dyti dhe kur të vinte radha, do të haje.

Çfarë orari kishte turni i dytë?

Ylli Kanina: Niste puna në orën 1 e gjysmë ose 2, s'e mbaj mend mirë, diçka e tillë edhe ktheheshim në orën 10 të darkës.

Po turni i tretë?

Ylli Kanina: Turni i tretë niseshim në orën 9:30 të darkës, në orën 10 hynim në minierë e dilnim nga ora 6 e mëngjesit nga miniera, por për ne njëlloj ishte, si turni i tretë, si i dyti, se atje natë ishte.

Po rregulla të sigurimit teknik dhe masa të tjera mbrojtëse në punë, a kishit?

Ylli Kanina: Rregulla nuk kishim fare. Formalisht kishte, po kush të pyeste. Ata nuk donin t'ia dinin. Ata donin vagonët. Se je i sëmurë, s'je i sëmurë, të ra armatura... se ishin 7-8 vagonë e të tjera, se nuk e mbaj mend fiks, ngaqë u bënë 35 vjet, ata s'donin t'ia dinin, duhej të realizohej norma.

Nëse nuk plotësohej kjo normë, çfarë ndodhte?

Ylli Kanina: Na priste o dru, o birucë. Kjo ishte. Mua nuk më kanë rrahur, se unë isha djalë i ri dhe e bëja normën, por të tjerët i kanë rrahur, i kam parë vetë.

A kanë ndodhur aksidente në minierë?

Ylli Kanina: Aksidente ka pasur. Mbjaj mend Napoleon Kolecin, të cilin e nxorëm të gjallë, që vetëm mustaqet i dukeshin. E kam parë me këta sy. Edhe Mondin, Mond Cekën...

26. “Bot” është shkurtim i fjalës autobot. Varianti i shkurtër përdoret në të folmen e përditshme.

Çfarë keni dëgjuar për revoltën e Spaçit?

Ylli Kanina: Unë kam shkuar në vitin 1977, ndërsa revolta është bërë në vitin 1973. Po nuk e ke jetuar vet, kot është. Pasojat e revoltës, unë nuk i kam ndjerë shumë, se kishin kaluar gati 5 vjet dhe ishin zbutur, por kisha edhe shokë që kanë vuajtur shumë. Kur arrestuan Koprenckën, Fadil Kokomanin, Vangjel Lezhon, pas arrestimit të tyre, na thirrën edhe neve dhe e pësova edhe unë, që më arrestuan për së dyti. Në atë kohë, prisja një takim me babain. Megjithatë gjithnjë isha si i përgatitur, se më kishin thënë: “Do të ta tregojmë ne!” Kështu që merrja diçka me vete, ndopak duhan dhe vishesha. Atë ditë sikur ma hoqi. Më thirrën: “Kanina, të vijë lart”. Epo, mendova se ishte takim. Atje më prisnin dy hetues dhe kryetari i Degës, Barjam Pela. Shkova dhe po shikoja se ku do ishte familja ime, kur më thanë: “Në emër të popullit, je i arrestuar!” Më vunë prangat dhe më çuan në hetuesi. Pesë muaj hetuesi.

Mbas dënimit të dytë me 10 vjet, në cilin kamp ju çuan?

Ylli Kanina: Pastaj na çuan në Qafë-Bari. Atje po, atje isha në revoltë unë.

Ju dolët sepse ra sistemi, apo ngaqë e përfunduat dënimin?

Ylli Kanina: Jo, dola më shpejt, që në 1988. Atëherë kishin filluar të lironin nga 10 -15 vetë. Ne e ndienim, se diç po ndryshonte.

Kur dolët nga burgu, si u ndietë?

Ylli Kanina: Të të them që isha i gëzuar kur dola, të gënjej. Kam qenë në Tiranë, punonim te njëri prej stadimeve, se ishim bërë ustallarë ne. Tre muaj ndenja atje dhe na thanë që ishim liruar. U lirova me dekret. Na premtoi ish-zëvendësministri atëherë, që kur të mbaronim punimet do të vinte vetë Ramiz Alia, për ta përruar dhe do na lironte tërë grupin e ustallarëve. Dhe vërtet, të tërë siç ishim ne të gjashtë, na lironi për një ditë. Një polic që ishte nga Vithkuqi, më shpuri te stacioni i trenit, se unë nuk dija nga të ikja dhe më përcollti. Hipa në tren. As lekë s'kisha, më duket vetëm nja 200 lekë. Përballë ishin dy studentë, që shkonin për në Durrës. Më panë me ato rroba e

me kokë të qethur ata dhe filluan të llafoseshin dhe të shanin qeverinë. Mendova që këta dikush i paskësh futur për mua edhe doja të ikja. -Jo, jo, rri, - thanë. - Përse të rri, - i pyeta. - Rri, se ne e dimë ku ke qenë. Atëherë u tremba më keq unë e po mendoja, po të paktën të mundesha të takoja njëherë babain, të takoja pleqtë në shtëpi.

-Po rri, - më tha, - se s'jemi nga ata, jemi studentë. Kjo qeveri ka marrë fund, po ti s'e ke marrë vesh përse të kanë liruar ty. - Jo, - u thashë unë. - Hape gojën, - tha - se nuk të gjen gjë, jemi studentë. Mbaroi! Mbaroi, prandaj je liruar. Unë prapë kisha frikë, ku ma mbante mua! Gjer në Durrës ku kthehej lokomotiva, njëri rrinte me mua. Unë kisha prapë frikë. Njëri iku me vrap, mori një qese me ca gjëra e ma solli mua. Unë e mora qesen. Po përse ma dha?

-Ore, ik e të të prijë e mbara. Burgu për burra është, po mos çaj kokë fare. Ditë të mira do të vijnë! Ik, mos çaj kokë. Edhe fol me kë të duash, - më thanë dhe më takuan. Ika tërë merak rrugës. Në Korçë ishte një e ftohtë që të priste. Mbërrita vonë rreth orës 11 e ca. Një operativ nga Progridi, më pyeti se ku kisha qenë dhe unë i tregova se kisha qenë në burg. -Po fletën e liritit, e ke? - Po, po, e kam, - iu përgjigja. Ai më ftoi të thyenim ca dërrasa për zjarr, po unë s'pranova. I theu vetë edhe ndezi zjarr, kurse unë u largova. Kisha frikë se do të mbërrinte ndonjë polic e do të më merrte prapë. Si më pa që u largova, ai më tha se e kuptonte përse unë nuk po afrohesha te zjarri dhe sërish më ftoi të ngrohesh. Kaloi ca dhe kur e pamë që nuk kishte makina u nisëm për në këmbë, deri te parku. Atje na arriti një skodë. Operativi hyri përpara, ne të tjerët sipër, se ishim nja katër vetë. Në Zëmlak, ishte postblloku. E ndaluan makinën dhe na kërkuan dokumentet. Unë nuk kisha, prandaj më thanë të zbrisja poshtë. “Boboboo” – mendova. - Ti do të kthehesh mbrapsht. Ke qenë në burg. - E pastaj? Unë kam kartën, - ua ktheva. Operativi zbriti prej makine dhe i pyeti përse më mbanin.

- Ka qenë në burg. - Edhe pastaj? Ka qenë në burg e çfarë? Ai ka dokument, nuk ua mbush syrin? Pa ma jep telefonin, se do të flas unë me Degën, se ata e dinë kush jam unë. Kështu u tha. Ai zbriti në Progër dhe i porositi, të mos më merrnin lekë për makinën. Unë do të zbrisja në Bilisht. Kështu më ndihmoi. Erdha për në shtëpi. Takova nja dy vetë

rrugës, që më shikonin me habi e s'më flisnin. Ishin të fshatit tim. Mbërrita te shtëpia e po rrija te porta, se kisha hallin mos i binte të fikët nënës, kurse babait jo. Nëna ime, ishte te radha e qumështit. Më sheh një nga gratë e fshatit dhe shkon e i thotë: - Të ka ardhur djali. Kur u kthye nga radha e qumështit, kaloi mu te këmbët e mia dhe, nuk më njohu. Unë te porta, u bëra edhe më keq. Ajo e kishte humbur fare. As nuk më pa fare që isha te dera dhe hyri brenda dhe i tha babait: - Çfarë bën këtu ti, se ka ardhur djali? - Ç'djalë, moj, më thua? - Çuditet babai dhe i ra sqepari nga dora. Dolën ashtu si ishin, të zhveshur se ishte mëngjes e më takuan atje. Ndenja 3-4 ditë atje, kur më thonë që të shkoja në punë. S'të linin ata. - Po ku do të vete, bre? - Do të shkosh në brigadë.

Edhe shkova të prashitja panxharë. Të tërë bënëin nga 5-6 sëra, unë 2 dhe ato s'm'i merrnin në dorëzim. - Këta kanë bërë nga gjashtë dhe i kanë bërë mirë, ti s'i ke bërë mirë. E kështu me fjalë gjersa më hoqën nga atje më çuan në brigadën e ndërtimit, se ne ishim ustallarë. Atje ishin ca shokë të mirë. Gati gjysmat ishin dora jonë dhe me ata punuam gati një vit, sa u prish fare.

Kur dolët nga burgu dhe u kthyet në fshat, si ishte atmosfera që ju rrethonte? A u treguan dashamirës ndaj jush, apo e ndjetë se ju mbanin larg?

Ylli Kanina: Kur dola, pyesja veten: "Pse do të dal?" Mendoja që do të më persekutonin. E ndieja veten inferior ndaj të tjerëve, se nuk të shikonin si gjithë të tjerët, se ishe një shkallë më keq, një fëmijë i të persekutuarve. Ata kishin mësuar, ishin rritur ato 11 vite. Fëmijët që kisha lënë unë 10 vjeç ishin bërë 20 dhe nuk më njihnin, më shikonin si derr, jo si njeri.

A ju kanë kërkuar falje? A e ndieni veten të vlerësuar në shoqëri?

Ylli Kanina: Jo, nuk ndihem mirë, se këta e kanë kollaj të thonë: "Hë mo, ti, sikur ç'të bënë!" Si ore, çfarë më bënë? Më morën rininë.

Me ardhjen e demokracisë a fituat mbështetje ekonomike, punë, strehim, dëmshpërblim për vitet e burgut e të tjera?

Ylli Kanina: Jo, jo, asgjë. Na dhanë ca letra me vlerë, por që u zhvlerësuan dhe ne nuk dinim as ku t'i shitnim e i shitëm ashtu kot, pa vlerë fare. Edhe shtëpinë e kam bërë vet, si qeni e kam bërë, kam punuar me thonj... Më kanë ndihmuar ish-shokët e mi.

Shumë më pas, në vitet 2007-2009 u bë një dëmshpërblim me lekë dhe atëherë i kemi marrë. Kurse kur erdhi puna e pensionit, çova dokumentet që nxora edhe tek Autoriteti i Dosjeve, vërtetimin e viteve të burgut në Spaç dhe në Qafë-Bari. Kur shkova në Korçë, më thanë që nuk e njohim dokumentin, se nuk shkruhet që kam punuar në minierë. "Ore, - u thashë - atje nuk ka qenë kooperativë, minierë ka qenë". Mirëpo, më thanë që nuk e njihnin. Nuk kam lënë vend pa vajtur edhe më kanë nxjerrë sikur isha prapë i persekutuar, jo siç më takonin. Më kanë dëbuar tamam si qëmoti!

A keni ruajtur ndonjë letër nga burgu?

Ylli Kanina: Jo, ne i digjnim letrat.

Çfarë dëshironi, t'i thoni brezit të ri?

Ylli Kanina: Nuk kam çfarë t'u them unë të rinjve. Ajo kohë mos u ktheftë më! Atë sistem mos e paftë më njeri dhe ato vuajtje që kemi hequr ne, s'dua që t'i shikojnë. Edhe im bir, kur ia tregoj si ngjarje, nuk beson. Vërtet nuk e thotë me gojë, por e shikoj unë që ai mendon: "Ky, babai im, që thotë këto, është çmendur", e kështu nuk ia tregoj, se edhe ai nuk do që t'i besojë. Nuk i beson.

Sot, unë kërkoj të më trajtojnë si njeri. Unë kam vuajtur si qeni dhe ai tjetri që më ka dalë dëshmitar e më ka futur në burg, merr pension 400 mijë, ndërsa unë marr 200 mijë. Unë kam vuajtur, i kam këmbët copë nga të rrahurat në hetuesi. Dhe unë e di si e ka emrin hetuesi që më ka rrahur.

Burgu i Spaçit duhet të rregullohet, që ta dinë brezat që do të vijnë mbas nesh, se atje kanë vuajtur të parët tanë, por me sa shoh nuk ka vullnet për atë punë, se po të kishte, nuk do të ishte prishur ai. Po të kishte vullnet të rregullohej, do të shkonin ta shikonin edhe djali im, edhe nipi im, që atje ka vuajtur babai dhe gjyshi.

138

139

140

141

142

143

144

145

146

147

148

149

150

151

152

153

154

155

156

157

158

159

160

161

162

163

164

165

166

167

168

169

170

171

172

173

174

175

176

177

178

179

180

181

182

183

184

185

186

187

188

189

190

191

192

193

194

195

196

197

198

199

200

201

202

203

204

205

206

207

208

209

210

211

212

213

214

215

216

217

218

219

220

221

Edmond Halimi

“Duke na ndjekur, ata na detyronin të merrnim rrugën për në kufi...”

Edmond Halimi, i biri i Muazezit dhe Memsurit, lindur më 14 nëntor 1952, në Korçë. U arrestua me akuzën “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”²⁷ **në 24 prill 1978** dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie. Në vitin 1981 u ridënua me 13 vjet të tjera²⁸. Hyri në burgun e Spaçit në vitin 1979 dhe doli më 10 janar 1991.

Ju falënderojmë që keni pranuar të ndani me ne ngjarjet që kanë karakterizuar jetën tuaj gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në burgun e Spaçit. A keni kërkuar të njiheni me dosjen tuaj dhe të zbardhen, cilët ishin bashkëpunëtorët e Sigurimit, që ju kanë

ndjekur dhe përgjuar?

Edmond Halimi: Pres të njihem me dosjen dhe pastaj do të kërkoj edhe të zbardhen emrat e personave që më kanë ndjekur.

Përpara arrestimit, a dinit gjë se po ju ndiqnin?

Edmond Halimi: Po, më kanë survejuar rreth një vit e gjysmë. Një nga bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit, në ndjekjen që bënte, la një gjurmë. Ne dyshuam pak dhe i kishim lënë adresën e vendit ku punonim, për të na takuar.

27. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje 10892. Vendim nga Gjykata e Rrethit Tiranës, nr. 296 Aktit, nr. 307 i vendimit, datë 24.07.1978, Arkivi i AIDSSH-së.

28. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje 12465. Vendim nga Gjykata e Rrethit Mirditë, nr. 40 Akti, nr.32 vendimi, datë 02.07.1981, Arkivi i AIDSSH-së.

Ai bëri edhe gabimin e dytë. Na erdhi në shtëpi dhe la adresën e shtëpisë, të shkruar në një letër. Sa e pashë adresën e shkruar, mendova: “Ku e gjeti këtë adresë?” Ia them këtë gjë edhe shokut tim, me të cilin, madje, ishim nën mbikëqyrje së bashku: - Ore, është dikush që po na ndjek. Ka ardhur filan person dhe na ka lënë një letër. - Ma ka lënë edhe mua, - tha ai. - Po ne nuk i dhamë adresë shtëpie, - i thashë, - ai na ka ardhur me adresën e shtëpisë. - Do ta ketë marrë te zyra e adresave, - më tha shoku im. - Unë di që pa qenë kryefamiljar, nuk del adresa në zyrën e adresave, - i thashë. Nga ai moment, ne kuptuam se po na ndiqnin: shteti na kishte futur njerëz nga prapa. Meqë shoku im ishte prapë spektik, e marr dhe shkuam te zyra e adresave ku i kërkoj sportelistes nëse mundej të na ndihmonte për të gjetur një adresë. I dhamë emrin dhe mbiemrin tim, si gjoja personi për të cilin interesoheshim t'i gjenim adresën. E mori dhe u mundua, por nuk e gjeti dot. Atëherë i kërkuam mbase na gjente adresën e një personi tjetër dhe i shkruajtëm emrin e shokut tim. As atë nuk e gjeti dot. Punonjësja na sqaroi se nëse personi që kërkonim nuk ishte kryefamiljar, adresa nuk kishte si të gjendej. Atëherë u bind edhe shoku im, që neve na kishin vënë njerëz nga pas. Është e bezdisur, të të ndjekë njeri mbrapa: kupton që nuk je i lirë. Ndiheh i kontrolluar. Është shumë e rëndë. Ndodhte që edhe i dallonim se cili ishte duke na ndjekur, po ç't'i bënim? Nganjëherë bënim nja dy kthesa që t'u largoheshim. Kur e shihnim që nuk na gjenin dot, ktheheshim dhe për gallatë i përshëndesnim: - Si kaluat? Jeni mirë? Mund t'ju duket e pabesueshme, por unë kisha identifikuar katër persona që më ndiqnin. Kaq shumë më ka peshuar ndjekja e tyre, sa që në momentin e arrestimit thashë: “Shpëtova. Fitova lirinë!” Qe shumë masakruese.

Sa kohë, zgjati ndjekja?

Edmond Halimi: Një vit e gjysmë. Jam rritur në Kombinatin²⁹ dhe në atë kohë, punoja në Kombinatin e Tekstileve. Kur shkoja për të hipur në autobus, ngaqë e dija që më ndiqnin, për të parë cili person ishte, e lija autobusin të fillonte të nisej, pastaj shkoja shpejt sikur do të hipja.

Ai që më ndiqte, turrej me vrap. Unë tërhiqesha, nuk hipja që ai të mbetej brenda. Njëherë, pasi kisha hipur në Kombinatin, bëra sikur do të zbrisja te stacioni tjetër, te “Misto Mame”³⁰. Dola te dera. Ai që më ndiqte, doli te dera tjetër. Qe autobus fizarmonikë. Kur u hap dera, bëra sikur po zbrisja, por ndalova. Ai zbriti. “Epo, e lashë, - mendova, - Çfarë do të vuajë! Sa të dojë, të vijë me vrap. Le të më ndjekë!” Dhe po kënaqesha me veten. Kur zbres te Banka³¹, më bëri përshtypje se personi që e hoqa qafe kur zbriti te “Misto Mame”, kishte mbërritur përpara meje te Banka. Vrisja mendjen: “Si kishte mundësi?” Se e pashë që ai zbriti, kurse unë ndenja në autobus. Kuptohet që ai ishte ndjekësi. Kuptova edhe që ata kishin në dispozicion edhe mjete të tjera, makina apo biçikleta që ndiqnin autobusin.

Si ju arrestuan?

Edmond Halimi: Më thirrën për zbor, por në fletëthirrje ma kishin ndërruar emrin e repartit ku unë bëja zborin. Mendova se ndoshta meqë kisha mbaruar për kundërajror, edhe tani po më çonin atje. Kisha veshur një xhup ushtarak, se isha një çikë merakli për t'u veshur. Më dukej si më “modern” për kohën. Nëna më kishte vënë dy rriska bukë me gjalpë, që për fat i kishte, se jemi rritur jo fort mirë, për shkak të financave.

Po ngjisja kodrën e Zall-Herrit, se atje ishte reparti kundërajror. Duke u ngjitur kisha harruar që më ndiqnin. Isha i gëzuar. Para një jave kishim fejuar edhe motrën. Bile fletën e zborit ma solli një djalë i ri që më pyeti se ku banonte Edmond Halimi. I thashë të vinte me mua, se do ta çoja unë atje. Dhe e çova te shtëpia ime. E ftova të hynte brenda, se aty ishte shtëpia e Edmond Halimit, e ftova edhe të pinte një gotë raki, meqë kishim sebeb dhe aty i thashë: - Unë jam Edmond Halimi. Më dha fletën e zborit, por nuk ndenji.

Po ngjisja kodrën kur pashë një GAZ “BÇ kinez” i lyer si i ri, pa targa. Më bëri përshtypje, se nuk kishte makina pa targa. Mendova që sapo duhet të kishte dalë nga rimonti. Dukej e sapo lyer dhe prandaj mundej që s'ia kishin vënë ende targën. Kur u afrova tre-katër metra, u hap dera dhe, kur

29. “Kombinat” quhej lagjja e Tiranës ku ishte ndërtuar Kombinati i Tekstileve.

30. Vendi njihet kështu sipas emrit të ndërmarrjes së prodhimeve të drurit që ka qenë dikur.

31. Banka e Shtetit Shqiptar, godina e saj ndodhet në qendër të Tiranës.

“Në njëfarë mënyre, isha i përgatitur për jetën në burg. Vetëm ato uniformat e shkalafitura dhe ato palltot e gërryera nga konsumi, nuk i imagjinoja dot. Veshja e të gjithëve njëloj, ashtu të dobësuar e të bardhë...”

prej andej zbriti dikush, vetëtimthi mendova: “A po më arrestojnë?” S’kisha ku të lëvizja, s’kisha ç’të thosha, absolutisht asnjë lloj gjëje. “Kemi një sqarim të vogël”, më thanë. S’kishte nevojë të thoshin asgjë fare, se dihej çfarë donin. Më futën thesin në kokë deri te gjunjët dhe kur ma hoqën thesin, e pashë veten në një dhomë me derën të mbushur me pambuk a me lesh. Më vonë e kuptova se ishte për të penguar zhurmat, që kur torturonin dikë, zëri të mos dëgjohej jashtë e të ishin të sigurt. Tek ajo dhomë, pashë se kisha pesë vetë te koka.

Cila ishte akuza?

Edmond Halimi: Agjitacion e propagandë dhe tentativë për arratisje.

A ke ndonjë ide se kush mund t’ju ketë spiunuar?

Edmond Halimi: Zakonisht, me shokun tim, Musain, bisedonim për gjërat që s’na pëlqenin: Ç’është kjo luftë klasash? Ç’është kjo propagandë? Në një moment, kur po na ndiqnin, nga frika se do të na ndodhte ndonjë gjë, kishim bërë edhe një bisedë për arratisje.

Në fakt, me ato që ndodhën sidomos pas ’73-it, u ngacmuan të gjithë për të arsytuar më shumë për politikën, se pati disa ngjarje...Edhe brenda tyre, ata po hanin njëri-tjetrin. Filloi me Koço Theodhosin e me të tjerët, më pas. Kështu edhe ne bisedonim, thonim ndonjë fjalë...

Duke na ndjekur, ata bënin çmos, të na detyronin të merrnim rrugën për në kufi. Madje, shumë vetë që e kanë dëgjuar si na ka ndodhur, na thonë që ata kanë dashur të na vrasin.

Për shtetin, kur kapte dikë në kufi, kishte një fakt, një akt të materializuar. Ndërsa nëse dikush fliste kundër, dënimi i tij për agjitacion kishte efekt negativ në popull, se në ndërgjegjen e njerëzve mbisundonte mendimi që po e dënonin kot. Ndryshe ishte efekti, kur e kapnin dikë në tentativë për arratisje. Prandaj ishin më të interesuar të të dënonin për arratisje.

A keni menduar se cili mund të ketë qenë personi që ju ka spiunuar?

Edmond Halimi: Mua më kanë ndjekur edhe më parë, por për pamundësi provash janë tërhequr. Të jem i sinqertë, mendoj se ka qenë dikush nga radhët tona. Ne ishim dy shokë, por në biseda kishte edhe të tjerë. Kur krijonim përshtypjen, që ishin njerëz të mirë, edhe kemi shprehur pakënaqësitë me ta. Por arratisjen tonë nuk e ka ditur njeri tjetër, se nuk kishim biseduar për t'u arratisur. Ne kishim thënë që në rast nevojë mund të arratiseshim, por po ne vetë kishim hequr dorë nga kjo rrugë, që përpara se të na arrestonin. Edhe në hetuesi, ata kanë qenë të bindur që ne nuk donim të arratiseshim, se na kanë pyetur, por jo me atë presion që ushtronin kur ishin të bindur, se vërtet do të arratiseshë. Ne ishim dy shokë, si fillim. U bëmë tre, se ky shoku im kishte një shok në Elbasan dhe kishim thënë që po të vinte puna, kishim edhe filanin. E kishte emrin Ali. Domethënë, po të rrezikoheshim për të na futur në burg, mund të iknim. Me këto fjalë nuk provohej që ne kishim marrë ndonjë vendim për arratisje. Dyshoj se ka qenë një jurist, djali i një të dënuari me grupin ushtarak, që na u fut për të na nxitur e për të na shtyrë më tutje. Ai del si bashkëpunëtori që mblidhte materialin që duhej për të na dënuar.

Gjatë hetuesisë, a ju sollën ndonjë person që t'ju provokonte?

Edmond Halimi: Më kanë sjellë një bashkëpunëtor në birucë, që donte të dinte përse hetohesha, ç'kisha folur. Ishte një i dënuar

ordiner, mjeran. E dija që ishte spiun, po s'e ndërroja dot. Është e vështirë të jetosh në burg me dikë që e sjellin aty të të bëjë përsëri një të keqe. Në njëfarë mënyre, duhet të punosh me veten që ta përballosh atë periudhë me qetësi, të bësh sikur s'kupton gjë, s'di gjë, t'i japësh edhe ndonjë cigare nga të tuat, përveç paketës që ia jepte hetuesi andej mbrapa.

Sa zgjati hetuesia?

Edmond Halimi: Katër muaj e gjysmë.

Ju i pranuat, apo i kundërshtuat akuzat?

Edmond Halimi: I ramë shkurt, thamë ato që duheshin thënë e dolëm për katër muaj e gjysmë, se mund të dilnim edhe për dhjetë.

A ju sollën për ballafaqime dëshmitarë nga njerëzit me të cilët kishit folur më parë?

Edmond Halimi: Po, më kanë sjellë një për ballafaqim. Vëllai i tij punonte si bashkëpunëtor, nga këta ndjekësit e fshehur, njerëz që merrnin dy rroga... Mua donte të më fuste në burg, se do të hante një tas më shumë me makarona! Unë i njoh një pjesë nga këta dhe po pres të marr dosjen, se tani e kam bërë kërkesën, por i njoh që më parë.

Gjatë hetuesisë, a u përpoqën që edhe vetë juve t'ju bënin bashkëpunëtor?

Edmond Halimi: Joo. Mendoj se ata të shikonin. Po të kuptonin se ti ishe penduar, mund të të bënin bashkëpunëtor, ndërsa kur merrnin vesh edhe në rrugë të tërthortë, që ti i kishte të patundura idetë për lirinë, për demokracinë, për të drejtën, nuk qenë aq naivë sa të të kërkonin të bëheshe bashkëpunëtor. Kanë provuar të bënin bashkëpunëtorë edhe me dhunë, por në këto raste, ka ndodhur që kur kanë dalë në kamp, ata nuk kanë bashkëpunuar.

Sa kohë që ju ishit në hetuesi, a kanë përdorur dhunë ndaj jush?

Edmond Halimi: Po, por jo të më diktonin me dhunë çfarë duhej të pranoja. Unë vetë nuk

kisha folur me të tjerë, vetëm me këta dy shokë. Është absurde ta mendosh. Njeriu, në fund të fundit, është i tillë, atë që ndjen dhe mendon, do ta thotë. Nëse ti nuk flet dot, nuk e thua atë që mendon, nuk je më i lirë. Atëherë këto grimcat e të drejtës ne i gëzonim në rrethe të kufizuara, aty ku mendonim që ky është njeri i mirë, që me këtë mund të diskutosh dhe reciprokisht shkëmbejmë mendime. Kur mora dënimin e parë, më vinte keq në shpirt për shokun tim, Musain, ngaqë unë ia hapa bisedat i pari, edhe për arratisje e për të tjera. Thoja që po mos të kisha folur me të, s'do të ishte në burg me mua. Në njëfarë mënyre i kam kërkuar falje. Po të mos fliste me mua, të mos ishte shoqëruar me mua, s'do të ishte në burg. Por ja që, donim s'donim, e solli momenti, u bëmë "grup".

Kur dolët në gjyq, a ju erdhi njeri nga familja, apo nga të afërmit tuaj?

Edmond Halimi: Familja nuk më është ndarë. Më erdhën edhe në gjyq, madje motra dhe i fejuari, edhe pse unë u dënova, nuk e ndau motrën. Në fillim, më dënuan 7 vite.

Pas dënimit tuaj, pati pasoja për familjen?

Edmond Halimi: Nënë time e hoqën nga puna, si edukatore në çerdhe dhe e çuan pastruese, jo se pastruese nuk ishte punë, se shumë njerëz e bënin këtë punë, por më shumë ishte për ta poshtëruar.

Pasi morët dënimin, si u krye transporti për në vendin ku do të kryeje dënimin?

Edmond Halimi: Me një autoburg, që më mirë ta quajmë termus-burg, se s'kishte as oksigjen. Imagjino që për nevoja personale, s'bëhej fjalë. Nga Tirana deri në Spaç, rruga zgjaste nja gjashtë orë, në mos gaboj. Nëse kishe nevoja personale, i zgjidhje aty... Lëre, ç'të flas! Mos më pyet më shumë! I thashë të gjitha, kur thashë se ishte një termus. Hipje në Tiranë. Mbyllur komplet...Një frëngji e vogël, që nuk bënte punë...

Si e përjetuat mbërritjen në burg? A njihnit dikë atje?

Edmond Halimi: Jo, nuk kam njohur njeri kur shkova, por në njëfarë mënyre, kam qenë i përgatitur për jetën në burg. Vetëm ato uniformat e shkalafitura dhe ato palltot e gërryera nga konsumi, nuk i imagjinoja dot. Veshja e të gjithëve njëlloj, ashtu të dobësuar e të bardhë... Kur i pashë, i thashë: - "O Zot na ruaj! Si ka mundësi kështu?" I kisha imagjinuar njerëzit sikur ishin jashtë, por të izoluar. Aty i pashë të qethur, të tharë nga mungesa e ushqimit, se aq ishte ushqimi, të lodhur, të rraskapitur. Kjo më bëri përshtypje. Në burg kishte solidaritet me atë që sapo mbërrinte. Të afroheshin, mundoheshin të të ndihmonin, të të këshillonin për mirë, të të jepnin kurajë. Kishte njerëz që, kur i analizoje edhe sot, them se kanë qenë heronj, kanë qenë njerëz që s'donin t'ia dinin se ç'do të ndodhte me ta. Donin të të ruanin, të të mbronin e të ndërtonin të mirën pa të njohur fare.

A mund të na përshkruani kushtet e dhomës, ushqimin, pastërtinë, rregullin, disiplinën në burg?

Edmond Halimi: Besoj, se e keni dëgjuar nga shumë të tjerë, por ishte fakt që rreth e qark krevatet të gjithë ishin me tre kate. Kur rrije ulur, mbetej dy gisht mbi kokë gjer te dërrasa, se s'kishte vend. Do të thotë që kishte super popullim. Dritaret i kishim pa xhama, jo thjesht se ju dhimbsej xhami atyre, por mirë që s'ishin, se po të qenë me xhama s'do të kishim oksigjen. Ne kemi qenë, ka pas raste, edhe 90 vetë në një dhomë. Ta llogaris kështu: - 60 cm ishte i gjerë një dyshek, pra, në 60 cm gjatësi në mur, rrinin tre persona. Në rast se dhoma qe 5 me 7 metra, nga ana e 7 metrave i binte të ishin 11 krevate, shumëzuar për 3 kate, i bie 33 vetë. Edhe nga krahu 6-metërsh të themi 3 radhë krevatesh, nga 33 vetë rreth 100 vetë në një dhomë. Skandal! Pa xhama, pa gjë!

Po për ushqimin, ç'mund të na thoni?

Edmond Halimi: Për ushqimin, po flas pak më shumë në detaje. Ndahej kush merrte 600 gr. bukë, e kush merrte 800 gr. bukë. Unë nuk e mbaj mend mirë, po më duket se kishim 20 gr. mish. Po të heqim ato që mbase i hanin ata të kuzhinës dhe operativët, ç'mbetej ishte për ata që punonin në galeri me tre turne. Të mos harrojmë që punonim me tre turne në galeri, ku ka qenë

edhe temperatura 43 - 44 gradë, përveç gazrave acide, se ne kemi qenë në miniera me depozita piriti. Piriti në kontakt me ujin zëbërthehet dhe çliron avujt sulfurikë, që të shkatërrojnë. Kështu që ai ushqim që i pallogaritshëm...

Të vjen keq kur kujton edhe ç'kanë sakrifikuar familjet tona, se atë gjysmë kile djathë që merrnin e hiqnin të na e sillnin neve. Po kur vinte preshi i staxhionuar aq sa nuk e pinte dot ujin, sado që ta zieje? Po kur në supë gjenim insekte pa masë? Dhe i thonim policit, edhe për gallatë se nuk na i ndërronte dot: "O komandant, ka gjëra të gjalla kjo supa, që nuk janë pjesë e mishit? Ai thoshte: - S'të kemi sjellë për burrë të mirë këtu, po haje atje e rri mirë!" Edhe një gjë tjetër. Një kuksian që nuk ia mbaj mend emrin, se kanë kaluar vite, ishte me temperaturë 41, i shkreti. I ndenjëm te koka gjithë natën. Bie çanga, në orën pesë. Policët rrinin te dera dhe sapo binte çanga, po të mos lëvizje me vrap, sikur e kishin kënaqësi të të godisnin pa mëshirë dhe kënaqeshin. Vjen një polic, shkon drejt e atje e thotë: - Nuk e di si dhe pse nuk është çuar ky, qen bir qeni. Çohu, more! - tha dhe e gjuajti. Ky i shkreti u ngrit. - Komandant, po vdes - i tha, - nuk jam mirë, po vdes. - Të vdesësh, more, qen bir qeni, po të vdesësh sipas rregullores, - i tha.

A mund të na përshkruani, një ditë në burg?

Edmond Halimi: Në një moment, arriti që në Spaç, të ishin 1350 vetë në një godinë. Rutinë e zakonit, ishte që duhej t'i bënim gjërat me vrap. Nja dy orë e gjysmë na i hante leximi i veprave të partisë, që gjynah, ata të mjerë më kollaj do t'i kishin kuptuar po t'ua hidhje në supë e t'ua zieje në kazan, sesa duke ua lexuar. Na merrnin kohën kot. Binte çanga që në pesë të mëngjesit. Me vrap. Ku të shkonim më përpara? Një gjysmë ore kohë kishe. Shkonim në mensë, hanim ça na binin, pastaj në punë, në minierë, tetë orë fiks. Kur dilnim nga puna, rreshtoheshim. Na merrte një gjysmë ore vajtja e gjysmë ore kthimi. Pastaj, hanim bukën, kur ktheheshim. Sa hanim bukën, binte çanga e fillonte leximi dhe dëgjonim ato pallavrat e Enver Hoxhës. Dy orë e kishim lexim e s'mbetej gjë për pasdite. Sa bënim ndonjë xhiro e flisnim me njëri-tjetrin. Në orën nëntë binte çanga për gjumë. Tetorëshi ishte gjumë.

Juve në çfarë lloj pune, ju kishin caktuar?

Edmond Halimi: Në fillim kam punuar minator.

Si ishin kushtet teknike në minierën e Spaçit? A kishte respekt për jetën tuaj? A kishin marrë masa për ruajtjen e jetës suaj?

Edmond Halimi: Ne ishim të detyruar t'i ndiqnim vetë rregullat teknike, në njëfarë mënyre, po për të kontrolluar nëse zbatoheshin apo jo, nuk vinte njeri të na kontrollonte. Ne na kontrollonin vetëm për sasinë e bakrit ose të piritit që nxirrim dhe po të mos e nxirrim sa duhej, na lidhnin e na çonin në birucë. Po të flisje, të preknin edhe me dorë...

Për normën që s'realizohej, ndodhi revolta e Qafë-Barit. Një vagon pirit u bë sebeb. Akumulimi i revoltës ndaj pushtetit ishte tjetër, të mos e ngatërrojmë. Shkëndija që e ndezi atë revoltë qe Tom Ndoja, që s'kishte mbushur me lopatë 14 ton pirit në vagonë, po kishte mbushur 12 ton. Një vagon peshonte dy ton, me pirit. Shkuan ta merrnin me zor e ta nxirrnin me dhunë. Kur e preku policia, shokët nuk donin ta linin, se është dinjitet njerëzor. Ti ke punuar e je robtuar për të bërë atë punë, ai vjen e të tërheq. Ishim të detyruar si skllavër. Dhe në kohën e skllavopronarisë, nuk ka qenë më shumë vuajtje. Ata edhe sot nuk e pranojnë që ishte punë e detyruar, pra të bënin me detyrim të punoje dhe kur vjen puna sot, po t'i kthehesh llogarive për realizimin e normës, dokumentet i kanë humbur qëllimisht, i kanë grisur, i kanë fshehur, i kanë vjedhur, se ata çdo gjë e kanë patur të analizuar gjer në detaje. Kur janë ngritur në protesta ish-të dënuarit edhe përpara viteve '92-93 e kanë trajtuar si problem pune të papaguar.

Sa gjëra janë bërë në këtë vend në ato 50 vjet! Unë prandaj nuk flas shumë për burgun, se dua të jetoj lirinë. Më gjetët në një moment, për të thënë kaq gjëra, por s'dua t'i kujtoj, dua të jetoj.

A na tregoni si ndodhi, që ju dënuan për herë të dytë?

Edmond Halimi: Dënimi i parë ndodhi në vitin 1978, në mars. Dënimi i dytë u bë në vitin 1981. Për të mos na lënë tok me dëshmitarët, tre prej nesh i çuan në Burrel. Ne të tjerëve, na çuan

në Ballsh. Kur u hap Qafë-Bari na çuan aty, se kishte nevojë miniera. Në Qafë-Bari efekti i parë i mjedisit qe si më i mirë. Aty ka patur një gjë shumë lehtësuese psikologjikisht, se kur shikoje, malet qenë të veshur me pisha, me bredha. Te njeriu, ndikon natyra. Ne kemi parë edhe ketra që nga brenda gardhit, kur në një bredh po ngjitej një ketër. Ku kishim parë nga këto gjëra në Spaç ne! Spaçi ishte një burg natyral. Të mos harrojmë një gjë, që unë shkova në Spaç, duke humbur lirinë relative, ndërsa kur shkova në Qafë-Bari, shkova drejt e nga burgu. Spaçi ishte një burg natyral: hidh një luan aty, s'kishte ç'të bënte, do të ngordhte. Mos lër as roje, asgjë, as rrugën s'e gjente dot, nga të dilte. Spaçi ka patur edhe atë vrazhdësinë që në fillim. Policët i ka pasur negativë. Asgjë hiç, shkretëtirë gjithandej. Mal i kuq, nga oksidet e mineraleve...

Kur keni dalë përfundimisht, prej burgut?

Edmond Halimi: Në datën 10 janar të vitit 1991. Kam dalë nga Saranda, se më çuan nga Qafë-Bari në Spaç. Pas meje, sollën edhe nja gjashtë a shtatë tjerë. U bëmë grup që rrinim bashkë atje. Pastaj më çuan në Shën Vasil dhe aty e prita ditën e lirit, në vitin 1991.

Si ishte takimi me prindërit?

Edmond Halimi: Kam hequr keq ditën e lirit. Një vëlla më kishte lënë...Tjetrin e kisha lënë me këmbë, e kisha lënë mirë, por e gjeta invalid, me këmbën e prerë deri mbi gju. Kur thanë "Erdhi Mondi, erdhi Mondii!", vëllai ka dalë duke ecur me duar, që të më priste. Vëllai tjetër kishte pirë ilaçet dhe qe i kontraktuar. Singërisht, në atë moment kam thënë: "O Zot, pse më lirove?" Por, ja ku jemi, jeta vazhdon. Vëllai ka familje, e ka ndërtuar familjen mirë. Ne duhet të shohim gjithnjë, që jeta duhet të jetë për më mirë dhe të kontribuojmë për ta bërë më mirë.

Si u integruat në shoqëri, pas daljes nga burgu?

Edmond Halimi: Dyzet ditë mbas lirit, ika në Itali. Fitova azil politik. Kam shitur edhe cigare në mes të Romës, për mos të hipur pa biletë në tren. Jetova ca kohë në Itali. Aty njoha një vajzë

shqiptare, që kishte mbaruar Institutin e Arteve. U martuam dhe kemi tre fëmijë: vajza 27 vjeç, djali 26 vjeç dhe i vogli 21 vjeç. Ndihem mirë.

A i njohin fëmijët vuajtjet që keni kaluar?


Edmond Halimi: Jo, nuk u flas shumë, por i kam edukuar të tillë që të jetojnë të ndershëm. Me fëmijët jam i kënaqur. Por më vjen keq që ca faqe nga jeta fatkeqësisht, m'i gris ai sistem. Ato janë faqe të grisura, që nuk i lexon dot.

Një mesazh për të rinjtë?

Mendoj se këto që po them do t'u bëjnë mirë njerëzve nesër, kur të mos jem më unë. Reflektimi im, që më sollti të jap këtë intervistë tek ju, ishte pikërisht që unë, me aq sa mundem, të jap kontributin tim, për të mirën e njerëzve nesër. Duhet që ata të pyesin, si ka mundësi që kanë ndodhur gjithë këto gjëra. Po të fillojmë të lëshojmë, ngadalë, pak nga pak, na arrin laku sa s'marrim dot frymë. Ç'është në fund të fundit, mungesa e demokracisë, ku arritëm ne në kohën e atij sistemi?

Në fillim, në '44-ën, mblodhën të gjithë kalamajtë, se kalamajtë e rebeluar shkuan për luftën. Luftë bënte edhe Balli, po ndryshe bënte luftë për Shqipërinë... Dhe ç'bënë? Avash-avash filluan t'u thonë "do bëhet kjo... do bëhet ajo". Ua mbushën mendje, se do kishin vetëm të mira. E, pavarësisht ngjarjeve, njerëzit thanë "Hë, mo, se më mirë do të bëhet". Edhe ai laku i madh, që njerëzit nuk e imagjinonin dot, u ishte hedhur në qafë dhe filloi të mblidhej dalëngadalë. Toleruan pak e nga pak, por kur ju erdhi këtu, te fyti, nuk e hiqnin dot dhe morën në qafë veten. Për mendimin tim, nuk duhet lejuar shtrëngesa që në hapin e parë, se pastaj nuk e liron dot. Për çdo gjë, mos thoni se është gjë e vogël.

Unë kam qenë nga njerëzit e zakonitë. Nuk më kanë marrë për ndonjë politikë, apo dhunë ndaj të tjerëve. Më kanë marrë, se kam folur. Por unë kam folur ashtu si e kam menduar, sepse e mendoj këtë, si pjesë të lirisë time. E kam menduar dhe e mendoj! Atëherë, nuk e kam gëzuar lirinë si sot, nuk e thoja dot kudo. Sot e them kudo. Sot, unë e gëzoj lirinë!



Musa Hoxha

“Ç’është kjo akuzë
‘minim i pushtetit
popullor’, kur as kam
parë minë me sy, as që
nuk e di ç’është mina?”

Musa Hoxha, i biri i Ibrahimit dhe i Naxhijes, lindi më 12 prill 1954. U arrestua me akuzën “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”³² më 28 prill 1978. Qëndroi 4 muaj në hetuesi. U dënua në korrik të vitit 1978, me shtatë vjet burg dhe u dërgua në Spaç. U lirua duke përfutur nga amnistia e nëntorit të vitit 1982.

E keni parë dosjen tuaj në AIDSSH?

Musa Hoxha: Para disa muajsh bëra një aplikim pranë AIDSSH për të parë dosjen time. Çudinë më të madhe të dosjes e kisha pas daljes nga burgu. U ndodha përpara disa gjërave të papritura. Kurse për periudhën e burgimit, pak a shumë, ishte e konsumuar: di çfarë ndodhi, çfarë u bë, si e pata të gjithë atë persekutim.

A mendoni që arrestimi juaj ka ndodhur prej raporteve që ishin dorëzuar për ju?

Musa Hoxha: Ashtu është. Historia e përndjekjes sime ka nisur që kur isha ushtar në Qafë- Prush, në Tropojë. Ishte dimër dhe unë isha komandë truproje. Nuk kisha asnjë oficer, asnjë kapter aty dhe, si komandë truproje, kisha të drejtë të hapja televizorin që ishte në pikën e shërbimit. Në televizor po shfaqej një koncert nga një grup çek, që kishte ardhur në Beograd. Kërcenin çekët simpatikë me veshjet e bukura dhe me muzikën e tyre të gjallëruar. Po kërcenin edhe ca valle ruse. Ne që po e shihnim, ishim të gjithë të rinj. U ekzaltuam dhe njëri nga ushtarët që quhej Genc Leka, jo poeti, por një ushtar nga Skrapari, me katër klasë shkollë, ia pret: “Shih çfarë bukurish, çfarë mrekullish ka bota jashtë! Me këto që po shoh, dua të iki. S’kam për të ndenjur më këtu”. Unë e mora kështu si me shaka këtë dhe i thashë: “Mbylle gojën, more idiot”. Mbasi e pamë atë koncert, mendova se u mbyll kjo punë, por njëri nga ushtarët, të cilit ende nuk ia di emrin, kishte

32. Fondi nr.1, hetimore-gjyqësore Dosje nr. 10892, Vendim nga Gjykata e Rrethit Tiranë, nr.296 i Aktit, nr.307 i Vendimit, datë 24.07.1978, Arkivi i AIDSSH-së.

raportuar për atë që u tha aty. Që nga ai moment, besoj se u hap dosja. Të them të drejtën, unë kam qenë njeri i pafajshëm, pa ndonjë bindje të kundërt politike, por nëse të hapej dosja për gjëra si: agjitacion, propagandë a ndonjë arratisje, i shkonin deri në fund.

Kështu që gjatë asaj kohe edhe më provokuan disa persona, te të cilët kisha besim. Njëri prej tyre ishte edhe djali i një ish-koloneli të ushtrisë. I shpreha keqardhjen dhe e ngushëllova që babain ia kishin shkarkuar dhe si duket, kam thënë edhe ndonjë fjalë të pamenduar mirë. Ky paskësh qenë denoncuesi kryesor! Nuk kishte nevojë për shumë dëshmitarë, se për agjitacion propagandë ishte shumë e lehtë ajo punë; nuk ishte nevoja të kishim ndonjë grup armiqësor, të shpërndanim trakte etj. Dosja për agjitacion propagandë plotësohej shumë shpejt, se edhe dy-tre dëshmitarë të të nxirrnin që ke thënë "këtë e këtë", ti nuk kishte mundësi ta vërtetoje të kundërtën. Ishte e pavërtetueshme.

Përpara se t'ju arrestonin, a e keni ndjerë që ju përgjonin, që ju ndiqnin, etj.?

Musa Hoxha: Ndoshta, në arrestimin tim, ka ndikuar edhe një ndodhi tjetër. Duke qenë të rinj e duke mos ditur gjë, kam biseduar dhe me një shokun tim nga Elbasani që e kam patur ushtar, njeri shumë i mirë dhe i kam thënë: "Ali, po m'u dha rasti, do të arratisem". E ftova edhe atë, duke patur besim se e kisha shok. Ai, kur shkoi në Elbasan, e bisedoi edhe me dikë tjetër që e kishte të atin të burgosur politik dhe ky tjetri, si duket ishte bërë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit për përfitime materiale, se kishte mbaruar dhe shkollën e lartë. Këtij i kishin premtuar punë, si shef plani në Cërrik. Ne kishim besim tek ai, si person nga një familje e persekutuar, ndërsa ai u bë njeriu kryesor që na provokoi edhe për datën kur donim të iknim, edhe për mendimet politike që kishim...

Të them të drejtën, më lindën disa dyshime që para se të arrestohesha. U çudita kur erdhi një shok i shokut tim nga Shkodra dhe më gjeti shtëpinë ku banoja. E bisedova më vonë edhe me shokun tim, Mondin, sesi e gjeti Spaso shtëpinë time. Varianti që ai më kishte dhënë, që gjoja e gjeti nga zyra e adresave, ishte gënjeshtër. Në qytet një zyrë

adresash ishte, por atje shtëpia ishte në emër të kryefamiljarit, të babait tim, jo në emrin tim. Ai nuk kishte mundësi ta gjente me emrin tim, adresën. Dhe darka që na ftoi te hotel "Arbëria", si duket ka qenë me sugjerim nga Sigurimi i Shtetit. Ai vazhdoi me provokime të ndryshme, që na bënë ne të dyshonim shumë. Ne e mbyllnim bisedën, ai e rihapte dhe këmbëngulte, megjithëse ne nuk i dhamë shumë material, ngaqë po dyshonim. Vetë ky, jetonte në zonë kufitare, në Kopluk. Mbase u larguam nga aty, i thashë, shokut tim, Mondit, se më dukej që ishim në përgjim. U munduam të tregoheshim të kujdesshëm më pas, por dosja ishte hapur.

Arrestimi im u bë me 28 prill. Unë punoja në Valias edhe bëja një kurs 9-mujor me ca kinezë. Ishte koha kur po shkëputeshim nga kinezët. Arrestimi im ishte spektakolar. E kishin organizuar në një mënyrë të tillë, që të më arrestonin në sytë e 2000-3000 vetëve.

Në orën 3:30, mbaronte puna. Valiasi ishte minierë qymyrguri. Në atë kohë, ishte miniera më e madhe. Ishin nja 10 autobusë fizarmonikë, që merrnin secili nga 200-300 vetë. Bënin transportin e minatorëve, që ishin më shumë nga Tirana.

Unë, për fat të mirë a për fat të keq, ndodhesha në autobusin e fundit. Pasi morën kthesën, të gjithë autobusët ndaluan. Njerëzit filluan t'i bërtisnin shoferit: "Ec, more, se plasëm vapel!". Atëherë, nëpër autobusë nuk kishte kondicioner. Ulërinin dhe shanin në mënyrë vulgare shoferin. Më kujtohet si tani, shoferi u ngrit nga sedilja dhe iu kthye atyre: "Mos më shani mua, se unë nuk e di se çfarë ka ndodhur. Te kthesa e Kamzës, ka ndaluar autobusi i parë dhe të gjithë autobusët. Po zbresin të gjithë njerëzit".

Ata e dinin shumë mirë, që unë isha në autobusin e fundit. E kishin lënë GAZ-in mu te kthesa e Kamzës, një GAZ sovjetik nga ata të vjetrit, që e përdornin ata të Sigurimit, në atë kohë.

Po i zbrisnin njerëzit kot, se e dinin ku isha unë. Njerëzit ankoheshin te shoferi, bërtisnin. Shoferi thoshte që po zbresin nga të gjithë autobusët. Derisa erdhi radha tek autobusi im. Shoferi hapi dyert dhe u futën dy persona, që u nisën në

drejtimin tim. Tani, unë e kam kuptuar që duhet të ishte dikush mbrapa meje, që ua ka bërë me gisht në drejtimin tim dhe ata erdhën drejt e tek unë. Më pyetën, për emrin. -Musa Hoxha. - Emri i babait? - Ibrahim. -Në emër të popullit, je i arrestuar!

Në atë kohë e humba fare, me thënë të drejtën, u shushata komplet dhe nxora duart përpara. Më thanë: - Qen, mbrapa, duart mbrapa, qen!

Ktheva duart mbrapa. Më zbritën nga autobusi. Pashë që ishte formuar një kordon i gjatë që nga kthesa e Kamzës, deri te kthesa për Tiranë: të gjithë autobusët rresht. Ishin mbi 2000 vetë. U traumatizova. Jam i sigurt që edhe shumë prej tyre, pavarësisht bindjeve të tyre politike, kur e panë sesi më arrestuan e gjersa më çuan te GAZ-i, janë traumatizuar.

E kisha humbur fare. Kur u futa dhe pashë veten te pasqyra sa isha zverdhur, u tremba edhe më shumë. Aty më kapi ankthi... Mbas asaj, për çerek ore a njëzet minuta, GAZ-i më çoi në hetuesi, në një qeli. Mbaj mend, qelia numër 24.

Pas një ore, kur kishte përfunduar edhe kontrolli në shtëpi, më thirrën në hetuesi. Kjo ka mbetur e paharruar, në kujtesën time. Sa naiv isha në atë moshë! Hetuesi më lexoi akuzën. Dhe e padëgjuar dhe e paparë ndonjëherë: - Musa Hoxha, i biri i Ibrahimit dhe i Naxhijes, arrestohesh për agjitacion dhe propagandë, për minimin dhe rrëzimin e pushtetit popullor.

Unë isha aq naiv sa, kur ai tha "për minimin", desha ta bind hetuesin tim, që unë nuk kisha parë minë me sy në jetën time e ndoshta, më kishin marrë gabim, se unë as nuk e dija çfarë ishte mina. Me ironi në fytyrë, hetuesi e preu shkurt: - Kështu formulohet aktakuza. Nuk bëhet fjalë për vënie të mirëfilltë mine.

Mbas nja dy-tri minutash, firmosi diçka, shkroi dhe më pyeti: - Ke ndonjë gjë për të thënë? Unë mblodha veten aq sa mund ta mblidhja dhe e pyeta sesa ishte dënimi. Më tha që ishte nga tre gjer në dhjetë vjet.

Në atë kohë, sa kisha mbaruar ushtrinë, një a dy vite më parë dhe më ishte dukur aq i gjatë edhe shërbimi ushtarak, prandaj menjëherë i them hetuesit: - Si, more, tre vjet? - Po kush të tha ty,

që do dënohesh tre vjet? - tha ai. - Po sa? - e pyeta unë.

Unë mendoja se do të më jepnin minimumin, trevjetëshin, se s'kisha bërë gjë. - Jo, mo. Duke qenë se ti je i ri, partia i ka parasysh këto gjëra, prandaj ti do të dënohesh 7-8 vjet, - ma ktheu hetuesi.

Me gjithë mend, kur dola në gjyq, prokurori kërkoi 8 vjet dhe gjykata aq vendosi.

Gjatë hetuesisë ose më pas, a tentuan që t'ju tërhiqnin në bashkëpunim? A ushtruan dhunë?

Musa Hoxha: Pasi më dhanë aktakuzën, më çuan poshtë në qelinë që ju thashë. Më ka bërë përshtypje mirëdashja e një polici, Rustemi, mbiemrin e të cilit e kam harruar. Kur hyra në qeli ai më mbylli derën, por si duket e kishin si procedurë që të të shihnin nga një vrimë. Unë po qëndroja i hutuar. Mbas nja dhjetë minutash, hapi derën, mori batanijen, ma shtroi vetë dhe më tha: - "Shtrihu dhe qaj, se do të lehtësohesh". Këto tha dhe më mbuloi. Dhe unë qava. Nuk e di sa qava, gjysmë ore apo një orë, por me gjithë mend u ndjeva i lehtësuar. Më ka bërë shumë përshtypje, sjellja e atij polici. Mora vesh, që ky polic i kishte trajtuar disa të burgosur politikë, në mënyrë shumë njerëzore.

Gjatë seancave të thërrisnin disa herë, por mesa kuptoj tani, në akuzën për agjitacion e propaganda, nuk kishte ndonjë hetuesi të rëndë. Ndryshe ishte hetuesia për ata që ishin në grup ose ata që shpërndanin trakte, apo lidheshin me diversantë. Gjatë hetuesisë, megjithëse ngula këmbë disa herë, që unë nuk i kisha thënë ato që më akuzonin, hetuesi ma preu: - "E ke thënë, s'e ke thënë, pavarësisht çfarë thua, ti do të dënohesh, se nuk ka gjë që e verifikon".

Çfarë tjetër, më bëri përshtypje në hetuesi, pa dashur t'i zmadhoj gjërat, ishte që rastësisht, apo jo, më sollën një që kishte punuar me mua, në Valias. Mbas e mori vesh, se kush isha, menjëherë tha: - Ti je ai, që ke dashur të hedhësh në erë fabrikën e Valiasit? Respiratorin, që të vdisnin tremijë vetë? E mori vesh gjithë Valiasit që ti do të vrisje nja tremijë vetë dhe njerëzit u revoltuan.

**“Kur hapej dosja
“për agjitacion-
propagandë ose
arratisje”, i shkronin
deri në fund.**

Dy-tre dëshmitarë:

**“Ke thënë këtë e
këtë.” Ti nuk mund
të vërtetoje të
kundërtën. Ishte e
pavërtetueshme.”**

Edhe pse i thashë që nuk ishte e vërtetë, ai ishte i bindur që unë, me gjithë mend, isha ai që do të kisha hedhur në erë dhe do të kisha vlarë trekatër mijë vetë.

Ai mund të ishte bashkëpunëtori i tyre. Mund të kishte hyrë aty për t'ju ngacmuar se çfarë kishit në plan ose që t'ju shpëtonte ndonjë fjalë e të thonit, se kishit edhe një grup, në mënyrë që edhe akuza të ishte sa më e fortë dhe që t'ju dënonin sa më shumë.

Musa Hoxha: Ky që erdhi në qeli, ashtu mendoj se ka qenë, i shtyrë nga Sigurimi i Shtetit, për të marrë edhe ndonjë informacion më shumë, për gjëra që ata nuk ishin të bindur plotësisht, nëse i kishin zbuluar apo jo. Dukej i frikësuar edhe si i tromaksur, ndaj nuk dhashë shumë material. U mundova ta kaloja sa më lehtë.

Hetuesia zgjati katër muaj. Hetuesi ishte pak tendencioz dhe cinik. Dukej që ishte nga ato komunistët e bindur ndoshta, në ideologjinë e tij. Ma përsëriti edhe një herë, se vendimi për mua ishte marrë që në hetuesi. – Ti, - më tha, - aty je, te shtatë a tetë vjet. Edhe pastaj shtoi: - Digjet dhe i njomi për të thatë. Ashtu siç të kemi marrë ty, kemi marrë dhe shumë të tjerë...

Ishte koha e prishjes me Kinën. Me një fjalë, unë isha një viktimë e revolucionit, isha i njomë dhe do të digjesha për të thatë. Kjo ishte e gjithë ironia. Mbas katër muajsh hetuesi, erdhi data e gjyqit. Kryetar ishte Bashkim Xholi, ndërsa prokurorja e kishte mendjen më shumë, se çfarë po shisnin në mapon që ishte përballë gjykatës sesa të lexonte akuzën time.

Aty në gjyq më erdhi shumë keq që ishte dhe nëna ime, bashkë me dy motrat. Kjo ishte befasia më e madhe, tragjedia më e madhe. Nënë e kisha të sëmurë. Mudohesha ndonjëherë që shikimet e mia të kapnin ato të nënës, që më shikonte me shumë dhembshuri dhe me lot në sy. Kjo më lëndonte më shumë dhe unë përpiqesha të mos qaja, dhe të mos e rëndoja më shumë nënën time. Një gjë më bëri përshtypje. Kishim edhe një shok, Ali Garunja dhe na dënuan që të treve. Ky shoku që e kam pasur ushtar, Mondit, vinte nga një familje fshatarësh, punëtorësh të ndershëm, në Elbasan. Prokurorja i kthehet Aliut, me tri a katër

klasë shkollë dhe i thotë, për mua: - Ky është i dekluar, po ti, çfarë deshe me këtë, ti je nga një familje punëtore. Kë deshe më shumë ti, Partinë apo Musain? Në mënyrë të pandërgjegjshme, apo nuk e di sesi, ai i thotë: "Musain". Kjo më ka mbetur në kujtesë. Ai e tha dhe u shtangën të gjithë. Oshëtijnë zërat, se salla ishte plot. Ndoshta për këtë, nga tre vjet ia dhanë dënimin pesë vjet.

Unë isha tramautizuar edhe nga historia që më tregoi Aliu, sesi e kishin arrestuar. Kishte vetëm tri ditë që i kishte lindur fëmija dhe po e çonte për t'i vënë emrin, në gjendjen civile. E kishin arrestuar atje, te sportelet. I kishin thënë: - Ali Garunja? - Po. - Jepja fëmijën gruas. E shoqja, quhej Marjeta. Sa i dha fëmijën gruas, i vunë prangat. Dhe e lanë gruan me gjithë fëmijë, te sporteli.

Pas gjyqit, na çuan në "kaush". Mua më dënuan 8 vjet, siç kërkoi prokuroria. Me sa kuptova unë, të gjitha ishin të përgatitura që më parë nga hetuesia, se ishin gjyqe false, pa asnjë provë... Kryetari i Gjykatës, Bashkim Xholi, tha se, meqë ishim të rinj, do të na ulte nga një vit. Aliut ia la pesë vjet, mua dhe Mondit, shtatë.

Arrestimin e Ali Garunjës, e mora vesh pasi më arrestuan mua. Ndjeva shumë keqardhje, se Aliu sa ishte martuar dhe priste që t'i lindte fëmija. Gjatë hetuesisë nuk kishim asnjë lloj komunikimi. Vetëm një si lloj ballafaqimi, mes dy shqiptarëve dhe dy hetuesve: "E keni thënë, s'e keni thënë..." Pavarësisht se e mohojë ose e pohojë, vendimi ishte marrë.

Me një fjalë, ne si shokë kemi mbajtur qëndrim shumë të mirë në hetuesi, shumë miqësor me njëri-tjetrin, sa edhe vetë hetuesi na pohoi: "Keni qenë ndër çunat më dinjitozë, që kam kaluar nëpër hetuesi". Mendoj se kjo ishte arsyeja që nuk pati ndonjë iniciativë nga ana e hetuesisë, që të na thërriste për ndonjë bashkëpunim ose për ndonjë gjë tjetër. Ata e kuptonin karakterin dhe personalitetin e të tjerëve. Pasi dolëm nga hetuesia, kishim takim me familjen, që mund të na sillte ushqime. Unë nuk e pija duhanin, por nëna ime solli katër-pesë paketa. Si duket edhe nga gjendja ekonomike, nuk ishim mirë. Me thënë të drejtën, e ndieja atë dhimbje, atë mundim që bënin ata për mua. Lagjja e kishte marrë vesh menjëherë, dënimin tim. Kishte dhe dashamirës

që i kishin thënë nënës: “O Naxhie, shpëtove! Pak e dënuan, shtatë vjet.” Ata mendonin se kush ishte për arsye politike, mund të pushkatohej ose dënohej 15-20 vjet. Me një fjalë, ishte njëfarë ngushëllimi për nënën dhe familjen time, që u dënova 7 vjet. Mbas gjyqit, për tri-katër javë, na çuan në kampin e burgut, në Spaç.

Po dëshmitar kush doli dhe a jeni befasuar nga dëshmitë e tyre?

Musa Hoxha: Gjatë procesit gjyqësor në gjykatë, doli një që nuk e njihja unë direkt, por ishte i njohur i shokut tjetër, Mondit. Unë nuk e dija çfarë roli ka luajtur ai në të gjithë këtë tragjedi që na ndodhi. Habia ime më e madhe, ishte Hasan Mërkuri, me formim intelektual, i biri i një ish-koloneli madhor të korpusit të Enver Hoxhës. Jo vetëm doli dëshmitar, por ishte dhe shumë intrigues. Bënte çmos për të na ngatërruar më keq edhe për të rënduar situatën dhe dosjen tonë. Pak para arrestimit, ky po bënte ç’ishte e mundur që të sajonte një ikje nga liqeni i Pogradecit, megjithëse ishte dimër. Na thoshte se kishte disa pajisje që, me gjithë ujin e ftohtë, ne mund të kalonim. Mirëpo ne e dinim se ujërat e liqenit të Pogradecit, vështirë të kalohen në verë dhe jo më në dimër. Ai përpiqej që të na kapnin në flagrancë në kalim kufiri ose ndoshta edhe të na pushkatonin, të na vrisnin në vend, siç ka ndodhur edhe me shumë e shumë raste të tjera. Për fatin tonë, ndoshta edhe duke dyshuar tek ai, në momentet e fundit, nuk e morëm atë iniciativë. Ky, Hasan Mërkuri, bënte çmos për të na shtyrë për arratisje. Njeri me karakter të keq. Ndoshta dinte që në momentin e arratisjes edhe mund të pushkatohej, mund të vriteshe ose që dënimi për arratisje ishte nga 10 deri në 25 vite. Kurse në gjendjen tonë, që nuk kishim tentativë për arratisje, shumë, shumë do të na dënonin për *agjitacion e propagandë* dhe dënimi shkonte, nga tre deri në dhjetë vjet.

Ne ishim aq të pafajshëm, saqë gjatë gjithë kësaj historie, nuk po i jepnim drejtim përse u dënuam, çfarë bëme dhe cila ishte arsyeja për burg që na dhanë. Kur shkuam në “kaush”, sikur morëm frymë pak më lirisht, se kishte dhoma të veçanta me nga 15 - 20 veta. Kur hymë, u takuam për herë të parë pas kaq kohësh, me njëri-tjetrin, unë, Aliu dhe Mondit. Midis njerëzve, gjetëm edhe

intelektualë. Aty mendova: “Dënimin e mora që e mora, por tani të përfitoj nga këto 7 vite dënimi, që të rri me njerëz me shkollë, më të shkolluar se unë, më intelektualë. Të mësoj ndonjë gjuhë të huaj, se kjo ishte kohë e humbur kot”.

Periudha në “kaush” ishte si njëfarë pushimi pas presionit në hetuesi. Edhe ideja që kishim familjet afër e mund të na sillnin ndonjë ushqim. Mbas tre -katër javësh erdhi një lloj makine që quhej autoburg. Ishte e mbyllur. Aty na futën nga pesë-gjashtë vetë brenda, duke na lidhur këmbë dhe duar, dhe që nga burgu 303 na nisën për transferim në Spaç.

Nuk jam i sigurt për sa orë e bëmë atë rrugë, për tri apo katër orë. Një moment, kur po kalonim para shtëpisë sime, tek Unaza, pashë për herë të fundit ndoshta, pallatin tim, pashë motrën mu te shkalla e parë, duke hyrë për në shtëpi. Megjithëse më vinte të klithja, nuk mund të bërtisja. Ajo as nuk e dinte që në atë makinë që po kalonte, ishte vëllai i saj. Kur mbërritëm në Spaç, ishim si të hutuar. Pavarësisht se mund të kishim lexuar libra romantikë, ishte hera e parë që u ndeshëm me realitetin e burgut. Policët, të egër që nga paraqitja e tyre, sjellja e tyre, mënyra e trajtimit dhe e të folurit. P.sh., nëse ishe nga Tirana, të thoshin “Hë, gangster Tirone...!” Mbërritja e makinës së burgut, ishte një ngjarje për të gjithë të burgosurit e tjerë që shihnin me kuriozitet, sepse të burgosurit e rinj që mbërrinin, sillnin edhe informacione të reja. Kur na zbritën poshtë, ishin dhjetëra e dhjetëra që na prisnin me kuriozitet. U afruan dashamirës dhe jo dashamirës, të cilët u munduan të na jepnin ndihmën e parë për disa rregulla të burgut.

Mbas tri ditësh, pa pritur të hynte muaji i ri, na futën në organikën e kampit. Menjëherë më çuan në zonën më të vështirë të kampit, që quhej “zona 2”. Aty çonin ata për të cilët komanda nuk kishte mendim të mirë dhe atje kam punuar deri ditën që jam liruar. Kam pasur në brigadë Bedri Blloshmin dhe kemi punuar bashkë, për pesë vjet, në të njëjtën zonë. Me sa kuptova, u mundova të mos bëj rolin e heroit, se nuk isha i përgatitur as psikologjikisht, as fizikisht. Ruhesha nga përplasjet me policinë, që ishte shumë e ashpër dhe shumë e egër. Për arsye fare absurd, mund të të fusnin në birucë. Njëherë më futën në birucë për një absurditet, që ta thuash tani,

shumë njerëzve do t'u duket e pabesueshme. Atëherë nëpër kamp qarkullonte njëfarë literature dhe unë po mundohesha të mësoja një çikë frëngjisht. Ishin ca libra për fillestarë, që na jepnin të burgosurit e mëparshëm dhe që i kalonim dorë më dorë. Ndër ta ishte dhe fabula e Ezopit "Gjinkalla dhe milingona". Një polic, Pjetër Koka, u ngjiti në krevatin e tretë ku flija unë dhe më kapi librin. Ishte libër shumë i vjetër, i konsumuar, se kishte kaluar dorë më dorë. E pa që ishte gjuhë e huaj, por ai nuk mund ta përcaktonte dot se çfarë dhe më pyeti: - Ça po lexon? Kush është ky? I thashë se ishte fabul dhe autori ishte një klasik. Ai i indinjuar shumë, më mori edhe më çoi lart tek oficeri roje, Sazan Blaca. Ishte gjirokastrit, por më i zhvilluar dhe më i civilizuar. Edhe thotë, Pjetër Koka: "Ky thotë që autori i librit është një klasik. Klasik është vetëm Enver Hoxha."

E mori librin ky oficeri dhe e pa si me habi: "Për këtë dënohesh, por nuk po ta jap sot dënimin." Megjithatë më çuan në birucë dhe kam ndenjur atje një muaj, vetëm se kisha lexuar fabulën e Ezopit "Gjinkallat dhe milingonat"! Edhe më ra në muajin shkurt, që ishte i tmerrshëm. Edhe biruca ishte e tmerrshme: - dy-tre metra katrorë dhe ti ishe vetëm me një palë çorape, me uniformë, flije edhe me pallto, edhe me triko leshi. Për t'u mbuluar të jepnin vetëm një batanije dhe atë vetëm kur ngrysej, në orën 7:00 të darkës. Mbaj mend që kur na jepnin bukën, mezi prisja të më binte korja e bukës, se ishte më e shijshme, po edhe pak më e madhe se pjesët e tjera të bukës. Kur dola nga biruca, kisha rënë nja katër a pesë kile nga pesha dhe isha zbehur fare.

Koha që punova në zonën e dytë ishte si stazh, se ishte zona më e vështirë: nuk kishte asnjë lloj sigurimi teknik, nuk na dhanë asnjë informacion, nuk na treguan asgjë për rregullat teknike. Na futën direkt atje, na dhanë nga një vagon dhe nga një kandil me karbit. Punonim në temperaturën 45-50 brenda, ndërsa jashtë kur dilje ishte -10 . Duhet të bëje patjetër normën. Kur minatori bënte plasjen e minave dhe dilte material, atëherë duhet ta nxirrje të gjithë materialin jashtë, shtatë vagonë, apo dhjetë vagonë, sa ishin. Duhej fuqi. Unë fizikisht nuk isha shumë i përgatitur, se nuk kisha punuar kurrë në bujqësi dhe disa herë nuk munda ta bëj normën, jo për kokëfortësi, se nuk desha të merresha dhe me policinë. Nuk

mundesha ta realizoja, prandaj dy-tri herë më kanë lidhur me pranga për dy-tri orë, te shtylla në mes të të ftohtit, në dëborë, me duar mbrapa. Kishin ca hekura gjermane që t'i shtrëngonin duart. Një polic me emrin Laze, ia kam harruar mbiemrin, m'i shtrëngoi aq fort duart sa që më plasi gjaku nga damarët dhe gati më ra të fikët. Kur më panë ashtu, policët sikur ndjenë njëfarë përgjegjësie, më liruan dhe më hodhën ujë. Duart m'u buhavitën dhe gjaku vazhdoi të më dilte nga damarët.

A keqtrajtoheshin të burgosurit?

Musa Hoxha: Të realizoje normën ishte shumë e vështirë, por varej edhe nga fiziku që kishe. Për mosrealizimin e normës kishe lidhje direkt me policin e brigadës, i cili për të mbrojtur punën e vet, raportonte në komandë. Të gjithë ata që nuk kishin kontribuar në realizimin e normës, kishin pasoja të tmerrshme fizike dhe dënimin në birucë. Tjetër gjë që më ka bërë përshtypje pas arrestimit tim, ishte terrorizimi që na bënë me ngjarjen e Xhelal Koprenckës dhe Fadil Kokomanit. Xhelalin ma kishin prezantuar, kishim pirë një kafe rastësisht, si me të gjithë të burgosurit. Na mblodhën lart te sheshi, në katin e dytë. Ishte hera e parë që merrja pjesë dhe nuk kisha informacion, se çfarë bëhej ose për çfarë flitej, por e mora me mend, se diçka jo e zakonshme po ndodhte. Kur u mblodhëm aty, isha i hutuar i frikësuar dhe i habitur. Më kujtohet, kur Xhelal Koprenckës i thanë: - "Në emër të popullit, je i arrestuar!" Koprencka ishte disa hapa larg meje dhe shkuan nja dy police, ta merrnin. Ai u tha: - "Jo, se ngjitem vetë." Kur hipi atje lart, u tha: - "Jo në emër të popullit, por në emër të armiqve të popullit". Dhe të gjithë ne u shtangëm sesi mundi ta thoshte. Një nga policët, bërtiti: - "Lidheni qenin, tërhiqeni zvarrë!" Ata ishin tre: - Xhelal Koprencka, Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho, por Xhelali ishte i vetmi që kur u arrestua, tha diçka të paimagjinueshme për atë kohë.

A mund të na përshkruani një ditë në burgun e Spaçit?

Musa Hoxha: Kur shkova unë, kishte ndodhur revolta e Spaçit dhe policët ishin më të gatshëm për të dhunuar. Disa të drejta që i kishin pasur të burgosurit për kuzhinën ose për gjëra të tjera, ishin hequr.

Çdo ditë duhet të ngriheshe rreth orës 5:30 të mëngjesit, të shkoje në tualet dhe të haje mëngjesin. Pastaj viheshim në rresht dhe do t'i ngjiteshe qafës së malit. Ngjitja ishte shumë e vështirë, kur ishte ftohtë. Dimri kishte të ftohtë të madh. Ajo ngjitja e kodrës, në atë të ftohtë të Spaçit dhe në dëborë, të ngjante sikur ishe në Siberi. Të miniera ndaheshim, merrnim kandilat me karbit dhe secili shkonte në frontin e paracaktuar, bashkë me minatorin, që e dinte ku e kishte vendin e punës.

Gjendja e minierës ishte jashtëzakonisht e keqe, ndoshta e konstruktuar që në kohën e italianëve. Edhe shinat po ashtu. Kur binin vagonët, e kishim shumë të vështirë për t'i ngritur sërish mbi shina dhe vagoni mund të binte çdo pesëqind metra. Ishe me fat po të kishe rrugë të mirë ose duhet t'ia kishe marrë dorën shumë mirë rrugës, që të eliminoje rrëzimin e vagonëve. Gjithmonë duhet të ndihmoje shokët, për ta ngritur vagonin sërish mbi shina. Nëse nuk arrije ta bëje normën, do të përfundoje i lidhur dhe policët do të të raportonin, kështu që do të shkoje në birucë. Në të kundërt, ktheheshe në kamp, ku të bënin një kontroll përpara se të futeshim. Disa të burgosur mundoheshin të merrnin brenda ndonjë copë dru ose ndonjë gjë tjetër. Varej nga polici, nëse të lejonte. Me atë copë dru bënim ndonjë gjellë ose kafe.

Kur mbërrije në kamp, haje bukë. Ushqimi aty, për disa arsye, ishte disi më i mirë sesa i atyre që nuk punonin në minierë, se që të kishe fuqi për të punuar të nesërmen, nevojiteshin disa kalori. Kurse ata që nuk punonin e kishin shumë keq. Sa kam ndenjtur unë i papunë, për një muaj kam pasur si ushqim vetëm një tas supë dhe gjashtëqind gramë bukë. Plus kësaj, mund të merrnim ndonjë ndihmë nga familja. Në kamp ishte shumë e bezdisshme kur, me detyrim, lexoheshin librat e Enver Hoxhës ose kur na kërkonin gjoja mendime sesi duhet ta bëjmë këtë, apo atë pas 10-15 vitesh. Ne ishim në luftë për të ekzistuar çdo ditë, ata të thoshin që ti do të jesh rob edhe pas 15 viteve të tjera. Pas vdekjes së Mehmet Shehut, u bë një amnisti dhe unë përfitova, sepse ishte për të gjithë të dënuarit nga 8 vjet e poshtë. Unë isha dënuar shtatë vjet. Amnistia më kapi kur kisha bërë pesë vite burg. Kur dola, kisha turp të shkoja në shtëpi. Isha me shokun tim Argjentin dhe po mundoheshim të sorollateshim sa të ngrysej që,

të mos më shikonte njeri kur të shkoja në shtëpi, se mund të më prishte komshiu... Kur arrita, po më prisnin dhe ishin bërë merak. Nëna kishte vdekur. Mbas disa ditëve, nisën të vinin njerëz për vizita dhe atë kohë fillova që të kërkoj për punë. Kur më thanë që të shkoja sërish në minierën e Valiasit, kundërshtova meqë atje ishte një që kishte dalë dëshmitar.

Më kujtohet që, gjatë gjithë kësaj kohe isha dhe i mbikëqyrur. Herë pas here, këta të lagjes vinin në shtëpi dhe më shtynin të gjeja punë sa më parë. Më dhanë një letër, për të filluar punë te Fabrika e Qelqit, në Kombinat. Një pjesë e madhe e punëtorëve aty, ishin ordinerë. Shefi i kuadrit, sa mori vesh që kisha qenë i dënuar politik, nuk më pranoi, por nuk ma tha troç, vetëm se tha që nuk kishte vende pune tani për tani dhe më sorollati për tri-katër javë. Isha keq nga gjendja ekonomike. Dikush atje më tha të bisedoja me kryeinxhinierin, një djalë i ri me mbiemrin Cici. E takova kryeinxhinierin dhe i thashë se nuk më pranonin në punë meqë kisha qenë i dënuar politik, për agjitacion-propagandë. Kryeinxhinieri vendosi të më çonte te një brigadë për gratë e sëmura, meqë kishin nevojë për një mashkull që t'i ndihmonte për arkat dhe ambalazhimin. Fillova punë. Më ka bërë përshtypje se aty ishin të gjithë komunistë, por shumë të ndershëm, shumë të mirë dhe më kanë trajtuar njësoj si të gjithë të tjerët.

Për çudinë time, në vitin 1988 më thirrën në Komitetin e Partisë. Nuk e dija, se isha përsëri i gjurmuar. Vetëm kur pashë dosjen time, ajo kishte qenë 2-A, që nga viti 1982 deri në 1990-ën, pa dijeninë time dhe pa asnjë lloj faj. Në vitin 1988 ishte një moment që mua më kishin kaluar nga 2- A në 2-B, një gradë më poshtë dhe në këtë fazë, duhej vetëm të më këshillonin. U habita, përse më kishin thirrur në Komitetin e Partisë, ku më prisnin sekretari i partisë, operativi dhe nja dy-tre të tjerë. Më thanë, se kishin një dosje për mua dhe duhet të mos vazhdoja me rrengje armiqësore. Unë kundërshtova menjëherë, por u kujtova për absurditetin e fjalëve "E kam thënë, s'e kam thënë". Mënyra sesi më thirrën, tregonte që nuk bëhej fjalë për të më arrestuar, se ndryshe do të vinin drejt e te puna, në prani të 500 a 1000 vetëve... Kohët kishin ndryshuar. Kuptova që më kishin thirrur, për të më vënë në dijeni. U thashë, se do të isha më i kujdesshëm herën tjetër. Mora

vesh që isha ende me dosje, por se çfarë kishte ajo dosje, nuk dija gjë.

Kur u hapën ambasadat, mendova të futesha në Ambasadën Çeke, meqë vetë presidenti i tyre kishte qenë i dënuar pesë vjet për agjitacion e propaganda, si puna ime. Mendova që sido që të shkonte puna, vetë presidenti nuk do të më dorëzonte aq kollaj. Kështu mbërrita në Çeki e prej andej, në Austri dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas sa kohësh jeni rikthyer në Shqipëri?

Musa Hoxha: Kam ardhur në 1994-ën. Kur mora dosjen time, çudia më e madhe ishte biografia që më kishin bërë: Musa Ibrahim Hoxha i datëlindjes 1954, indiferent dhe pa vese. Ta kishin thënë këtë fjali para se të më arrestonin, vetëm me këto dy fjalë do të isha i pafajshëm. Të të përndjekin që nga 1981 deri në 1990, duke filluar me fjalët “indiferent dhe pa vese”, ky ishte absurditeti më i madh. Edhe të të vënë njerëz për të të gjurmuar, edhe dosjen ta vendosin në nivelin 2-A për nëntë vjet, të përndiqesh nga dega e Elbasanit, Durrësit, Fierit, Tiranës megjithëse je një qytetar krejt “indiferent dhe pa vese”, kjo ka qenë habia më e madhe, urrejtja më e madhe për atë pushtet dhe absurditeti më i madh. Nuk kam urrer kurrë në jetën time, aq shumë sa urreva pasi lexova dosjen. Paskam qenë aq pranë një arrestimi të dytë, që do të kishte qenë fatal për mua dhe familjen time, sa që nuk e kisha menduar kurrë! Ditë të tëra mbeta i frikësuar, vetëm nga ato që lexova. Kjo ishte trauma ime, ndër më të mëdhatë e gjithë jetës sime: leximi i dosjes.

Si mendoni, përse u krijua kjo gjendje?

Musa Hoxha: Epo ja, dikush që ishte mik familjeje dhe e kishim ftuar në dasmën e motrës sime kishte ardhur aty të më regjistronte me aparat. Nuk e mendonim kurrë këtë, se ishte mik familjeje prej vitesh. Materiali që kishte regjistruar nuk ishte aq komprometues për Degën e Punëve të Brendshme, por shpirtligësia e tij, siç e pashë në dosje, ia kalonte regjistrimit që më bëri. Nuk e prisja kurrë, nga një mik i familjes. Në fillim u revoltova shumë. Nuk e dija në jetonte apo jo. U revoltua edhe motra ime... Kjo lloj sjelljeje është një fatkeqësi!

Mendoj se një nga gabimet e mëdha që janë bërë, ishte moshapja e dosjeve. Dosjet duhet të ishin hapur. Ka edhe arsye psikologjike, për mbarëvajtjen e vendit, por ka edhe arsye të tjera. Po të ishin hapur dosjet që në vitet e para, ndoshta shumë prej këtyre fëmijëve dhe nipërve të tyre, nuk do të kishin këto pozicione sociale që kanë sot.

Çfarë mendoni se mund të bëhet sot që ju dhe bashkëvuajtës si ju të ndiheni më të lehtësuar dhe më të vlerësuar?

Musa Hoxha: Mendoj se mund të bëhet një përmendore qoftë edhe pa emër, për mijëra e mijëra të burgosur. Mbase aty tek Liqeni, mund të vendoset një përmendore e thjeshtë, simbolike, kushtuar të gjithë atyre që u persekutuan dhe u vranë. Unë mendoj që e meritojmë të gjithë, një përmendore. Nuk është mungesë mjetesh financiare, por shoh se mungon vullneti politik, jo vetëm nga e majta, por edhe nga e djathta. Duhet ta kishte bërë dikush!

Po lidhur me vendin ku kanë vuajtur dënimet ish-të burgosurit politikë, kryesisht për burgun e Spaçit, çfarë mendoni se mund të bëhet?

Musa Hoxha: - Nëse është e mundur, burgu i Spaçit të kthehet në një muze, që të shërbejë edhe si ndërtesë edukimi për brezat e rinj. Besoj se të gjithë ne që kemi qenë të burgosur, ndoshta edhe pjesa tjetër civile e Shqipërisë, duhet të kontribuojmë në një farë mënyre, për ndërtimin e këtij muzeu, për ta mbajtur të gjallë kujtesën e këtyre mijëra e mijëra të burgosurve dhe të përndjekurve.

A keni ndonjë send nga burgu, që nëse ngrihet një muze, ta vendosim aty?

Musa Hoxha: E ruajta për shumë vite veshjen time të burgut, e mbajta pikërisht me këtë mendim, se do të më duheshin mua dhe familjes sime, apo dikujt që të ishte i interesuar. Por motrave të mia ai kostumi i punës u ndillte keqardhjeje dhe bezdi, dhe vitet e fundit e kishin hedhur.

Ilir Malindi

**“U gjeta midis
një populli të
indoktrinuar:
Asnjërit nuk i
vinte keq për të
burgosurit, na
shikonin shtrembër
dhe me urrejtje”**

Ilir Malindi, i biri i Anës dhe i Skënderit i, lindur më 29 gusht 1958. U arrestua më 10 maj 1978 me akuzën “për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”. U mbajt 4 muaj në hetuesi, ndërsa dënimi iu dha më 15 gusht 1978³³. U dënua me 7 vjet heqje lirie. Hyri në burg në tetor të 1978-ës dhe doli prej aty në tetor të vitit 1982.

Zoti Malindi, a mund të na përshkruani historikun e arrestimit tuaj; për çfarë ju akuzuan, si ju hetuan, a kanë ushtruar dhunë, si u gjykuat, çfarë dënimi ju dhanë, ku e kryet dënimin e të tjera ngjarje që hedhin dritë mbi vuajtjen tuaj padrejtësisht në burgjet e diktaturës?

Ilir Malindi: Më falni, po sesi ndihem...Natyrisht që ishte një traumë shumë e rëndë në atë kohë, por parë nga sot në të shkuarën, ishte gjëja më e bukur që ndodhi në jetën time. Mendoj që vitet e burgut, që nuk ishin dhe aq shumë në krahasim me vitet që kishin kryer të tjerë, ishin vitet më të bukura të rinisë sime, sepse aty jeta ime mori një farë kuptimi. Ajo rezistencë mund të ishte fare e parëndësishme në sensin social të përgjithshëm, por nën optikën personale, si njeri, ishte shumë e rëndësishme, ishte një faktor që e mbushi krejtësisht jetën time. I dha kuptim ekzistencës sime.

E them këtë se mbas burgut e deri tani jam në një rutinë mjerane përditshmërie, pa asnjë lloj motivi, pa asnjë lloj shprese dhe komplet në një zhgënjim total, prej kësaj që quhet historia jonë, që në sensin social është komplet një dështim.

Çfarë ndodhi mbasi ju arrestuan?

Kur më arrestuan, s'e mora vesh se për çfarë, s'kuptova gjë. Ishte ajo drama që “Upupu, më kapën”... Isha komplet i pandërgjegjshëm për “krimin” që kisha bërë. Kur më komunikuan arrestimin për motive të agjitacionit e të propagandës për rrëzimin e pushtetit, atëherë e kuptova më mirë se ato që kisha thënë, ishin kundër sistemit. Në këtë sens, arrestimi im ishte plotësisht i drejtë. E meritoja totalisht, e kisha konsumuar agjitacionin dhe propagandën në

mënyrë shteruese. Për të mos thënë që hetuesi kishte ngelur pa mend nga dosja e cila ishte shumë voluminoze për të gjitha ato “vepra penale” që unë kisha konsumuar.

Mua më arrestuan vetëm. S'isha pjesë e ndonjë diçkaje të organizuar kundër pushtetit. Kisha thjesht një shprehje personale dhe autentike kundër përditshmërisë që jetoja. Shaja, tallja ato që unë shikoja përditë në të gjitha senset. Kështu që edhe hetuesia ishte relativisht e shkurtër, sepse nuk kishte çështje grupesh a çështje që duheshin kopsitur në shumë drejtime. Isha vetëm unë, thëniet e mia, të cilat i kishin regjistruar, i kishin dokumentuar, se unë isha krejtësisht i pakujdesshëm në këtë drejtim. Madje “krimet” e mia i kishin kërkuar që nga moshja gjashtëmbëdhjetë vjeçare(!) Më kishin mbikëqyrur që gjashtëmbëdhjetë vjeç. Duhet thënë, që unë nuk vija nga një familje e dekluar. Deri në 1974-ën, im atë, Skënder Malindi, ishte Shef i Shtabit Mbrojtës për të gjithë Republikën, pra kuadër i lartë. Në momentin që Enver Hoxha e përmendi si njeri me biografi të dyshimtë, filluan dramën e familjes. Dhe kjo solli si pasojë edhe dramën time personale. Deri në atë kohë ne jetonim në Bllok. E kisha shtëpinë mu përballë Ramiz Alisë. Ramizin dhe Enverin i shihnim që kalonin përditë aty e na ishin bërë surretërit e tyre rutinë e përditshme.

Sa zgjati hetuesia, a u përdor dhunë gjatë qëndrimit në të?

Hetuesia zgjati rreth katër-pesë muaj. Më pas u bë gjyqi. Ndaj meje nuk u përdor dhunë, se çështja ime nuk kërkonte ushtrim dhune fizike, as nevojë për ballafaqime. Kur je pjesë e ndonjë grupi bëhen këto gjëra. Tek unë ishin çështje që nëse do, pranoje, nëse do mos e prano, ata e kishin të regjistruar. Kështu që më dënuan 7 vite dhe më çuan në Spaç. Në moshë aq të re unë nuk isha i ndërgjegjshëm për rrezikun që po kaloja.

Ndodhi që drama ime në atë sistem nuk erdhi ngaqë isha antiregjim. Ishte psikologjia ime kundërpedal. Në çdo sistem, unë do të isha opozita. Gjithmonë në qoftë se lufton, do të thotë që e ke një kauzë. Në momentin që kauza jote

33. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 10920. Vendim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.326 i Aktit, nr.327 i vendimit, datë 03.08.1978, Arkivi i AIDSSH-së.

fiton, duhet ta braktisësh, s'është më e jotja. Duhet të jesh me opozitën. Është imoralitet të bëhesh me ideologjinë sunduese, të bëhesh me të fortin, me fitimtarin, me të pasurin. Jam kundër gjithandej, kështu që kjo, kundërshtia ime, ishte më tepër psikologjike, sesa politike, gjë e cila jam i sigurt as ju intereson këtu fare, se ju doni aspektin politik apo jo?

Po, është e vërtetë. Ne e duam rrëfimin tuaj, ashtu siç e ndjeni.

Ilir Malindi: Kjo që them unë hyn në një portret psikologjik. Arrestimi im ndodhi në 10 maj 1978, te zona që njihet si rrugica e Oxhakut. Ka qenë një dyqan vajguri aty. Është ende si godinë.

10 Maj, një ditë e bukur me diell. Bëja stazhin te një pallat, diku aty afër. Më thirrën gjoja për një punë. Më futën brenda në një makinë tip GAZ. Nuk nuhata asgjë. Do të thotë ndonjë: "Kaq i trashë ke qenë, o t'u mbylltë"? Jo, nuk e nuhata. Vetëm kur u futa brenda, dëgjova: "Në emër të popullit, je i arrestuar!" Për çfarë? Mos kisha kryer ndonjë vjedhje? Jooo, hiç asgjë nga këto! Vetëm më pas, mora vesh që unë isha armik! Më çuan menjëherë në Degë, më zhveshën lakuriq. Kjo procedurë e kontrollit trupor, ishte shumë poshtëruese. Prej aty, drejt e në birucë. Thonë se sot birucat e Burgut 313 në Tiranë janë shumë më të mira sesa ato biruca. Kam parë një film gjerman për kohën e Hitlerit, ku birucat ishin ndërtuar me dimensionet reale dhe me pajisjet e asaj kohe dhe ku çdo gjë tjetër ishin paraqitur sipas të dhënave të procesverbaleve. Vura re që birucat tona ishin ku e ku më të mjerueshme: nuk ishte as dyshek, por vetëm një batanije të vjetër që duhet ta mblidhje në orën 6 të mëngjesit dhe kishte të drejtë ta hidhje mbi trup vetëm në orën 9 të mbrëmjes. Procesi hetimor filloi pasi më lanë një javë të vetëm në birucë, procedurë kjo që shërbente si përpunim psikologjik. Ndaj meje nuk u ushtrua ndonjë dhunë fizike, kurse dhunë psikologjike po, që në sekondat e para dhe deri në fund. Hetuesi im quhej Nasho Gjonopulli. Dhuna psikologjike ishte e natyrave të ndryshme dhe përfshinte kërcënime të karakterit fizik, kërcënime për familjen e kështu me radhë.

Akuza ndaj meje mbështetej në të dhënat e mbledhura nga informatorë të Sigurimit të Shtetit,

të caktuar posaçërisht për të më survejuar. Ishin njerëz të ndryshëm duke filluar nga disa që banonin në lagjen time, një berber ku qethesha, deri tek të tjerë që i kisha në shkollë, të cilët kishin detyrë të më provokonin për të testuar mendimet e mia, të cilat unë i shprehja lirisht pa asnjë lloj pengese. Nga hetuesit nuk më është bërë asnjë lloj propozimi për bashkëpunim. Si duket e panë nga karakteri im që nuk isha i atij profili, por kur më çuan në burgun e Spaçit, po, atje më kanë bërë presion të madh për bashkëpunim. Pas hetuesisë, në gusht, më qethën dhe më bënë gati për të më gjykuar. Gjyqi u zhvillua paradite dhe me dyer të mbyllura,

Prokuror kisha Aldo Zadrime, tashmë shahist i njohur. Shumë vetë që i kam takuar mbas burgut këmbëngulin sesa djalë i mirë ishte Aldo Zadrime, ndërsa unë e mbaj mend në gjyq duke më sulmuar me epitetet "armik i rrezikshëm për shoqërinë tonë të lumtur", "i poshtër", "maskara", "mosmirënjohës për sistemin dhe Enver Hoxhën". Ky është Aldo Zadrime për mua. Kur luante shah, nuk e di si ishte.

Në gjyq nxorën si dëshmitarë katër shokë, të cilët dukej qartë se ishin instruktuar nga hetuesia dhe nga Nasho Gjonopulli. Ato që thoshin për mua ishin të renditura në mënyrë të atillë që të plotësohej kuadri i akuzave, sidomos neni 1 që kishte cilësimin "armik i popullit", ku armiku isha unë. Në sallën e gjyqit nuk ishte thirrur, as lejuar asnjë familjar i imi. Vetëm disa njerëz dhe salla bosh. Gjyqi mbaroi brenda ditës. Më dënuan 7 vjet dhe më dërguan menjëherë prapë në burg. Aty më nxorën në "kaush". "Kaush" quhet ambienti ku rri në pritje të transferimit, për në burgun ose në kampin ku të caktonin për të kryer dënimin. Mua më caktuan për në Spaç.

Sa mbërrita në Spaç, më sollën nja dy-tre vetë për të më matur pulsën nëse pranoja që të punoja me komandën apo jo. Sapo e kuptuan që nuk isha i asaj "lagjeje", menjëherë më caktuan të punoja si minator në zonën më të vështirë të Spaçit. Burgu i Spaçit kishte 1000 burra, mirëpo edhe Spaçi, si puna e ferrit të Dantes, kishte rrathët e tij. Shumë vetë që bënë burg në Spaç, krahasuar me të tjerët, i kishin kushtet si "hotel", të themi, nuk i çonin në punë, luanin shah, domethënë rrinin aty. Kishte disa që punonin në bibliotekë, kuzhinë,

“Këtu njerëzit janë vrarë,
janë pushkatuar,
familjet janë shkatërruar
dhe e tëra kjo është një
tragjedi që sot e kësaj dite
është e pashprehur.”

depo. Pjesa tjetër ishin nëpër galeri, por edhe këtu kishte dallime, sepse varej në çfarë galerie, apo në çfarë fronti punoje. Aty ku kam punuar unë, zona e dytë, ishte tmerr absolut. Kam lexuar disa libra të famshëm që tregojnë për burgjet dhe s'më kanë bërë pikë përshtypjeje. Puna e galerive atje s'ngjante fare me realitetin e Spaçit: ishte ku e ku më tmerr Spaçi, më i lemerishëm, një punë rraskapitëse që vetëm mosha ime e re mund ta përballonte. Fati im i mirë që më liruan me një amnisti, në vitin 1982, e para amnisti mbas 20 e ca vitesh.

Orari i veprimeve në burgun e Spaçit zbatohet me përpikmëri. Policët kontrollonin me rreptësi dhe duhet t'i zbatoje patjetër urdhrat, sepse kishte edhe kuota prodhimi që duhej të realizoheshin. Kushtet e regjimit të jetesës së burgut ishin të përcaktuara nga komanda. Dhoma ku flinin kishte përmasat 4 me 5 metra dhe aty flinin rreth 50 vetë, në krevate me tre kate. Na jepnin kashtë

për të bërë dyshekë dhe i mbushnim vetë. Të mbyste ajri i keq. Na jepnin nga dy batanije të vjetra, me te cilat mbulohehim në dimër, se në verë nuk kishte problem. Fjetoret tona ishin kaq të mbushura dhe kaq të ngjeshura me të dënuar, sa që ata që flinin në katin e tretë duhet të kishin kujdes kur ngriheshin nga krevati se i binin tavanit me kokë. Ishin shumë afër tavanit.

Kurse përse i takon ushqimit, merrnim tre vakte në ditë dhe, për arsye se punonim në minierë, i interesonte edhe vetë komandës që ne të kishim fuqinë e duhur për të nxjerrë mineral nga i cili shteti kishte një përfitim shumë të madh. Na jepnin një normë ushqimi minimale, e cila na lejonte të kishim një fuqi punëtore relativisht efikase për të plotësuar planet që vendoste komanda për nxjerrjen e mineralit. Si minator, punoja në zonën e dytë. E vetmja zonë e Spaçit që nxirrte pirit. Piriti është një material që thith shumë ujë dhe e njëjta sasi minerali peshon gati

dyfish. Duhej të nxirreshin katër vagonë nga një ton e gjysmë, dy ton për çdo njeri, që me peshën e tij të shtuar, i binte afro 8 tonë për person. Meqë ne ishim të organizuar në grupe me 3 veta, duhet të nxirnim rreth 20 tonë material jashtë minierës. Piriti ka veçanti që krijon temperatura të larta, hyn në reaksion me ujin, prandaj në vendin e punës temperaturat shkonin deri në 45-50 gradë. Njerëzit punonin lakuriq aty. Nuk mbaje dot asgjë sipër. Edhe çizmet mbusheshin me djersë dhe llokoçisnin. Atë material duhet ta nxirrje jashtë për ta zbratur.

Nga mbi 45 gradë do të dilje në ngricë, në -15 gradë dhe këtë punë duhet ta bëje gjatë gjithë ditës. Por njeriu qenkësh kafshë shumë e fortë! Në qoftë se nuk realizoheshin ato norma, policët kishin një shprehje: "O normën, o shpirtin!" Mosrealizimi i normës nënkuptonte birucë dhe ajo ishte një lemeri më vete në krahasim me atë të kampit. Aty të izolonin vetëm dhe të linin zhveshur vetëm me një këmishë të hollë në kulmin e dimrit, në -20 gradë. Shumë vetë dilnin me një koleksion sëmundjesh nga biruca. Unë kam bërë birucë vetëm një herë dhe më kanë lënë 15 ditë. Një tmerr i paparë! Kurse në kamp, në kohën jashtë punës, gëlonin spiunët. Nga 1000 burra, një pjesë e madhe ishin spiunë, bashkëpunëtorë të operativit. Këtë e provova në kurrizin tim dhe të mos kisha dalë në 1982, me siguri do të ridënohesha prapë. Ma ka thënë vetë operativi, Shyqyri Toska. E kam takuar këto vite te Medreseja, ku ka një pijetore dhe më tha se të mos isha liruar, patjetër që do të haja edhe një dhjetëshe tjetër. Të mendosh, 1000 vetë në një pëllëmbë vend, nuk ke asnjë lloj privatësie, një tmerr në të tëra kuptimet. Shumë interesante ta shohësh edhe nga ky këndvështrim.

Për çfarë arsyesh, ju futën në birucë?

Illir Malindi: Ndodhi sepse më kapën larg frontit të punës dhe kjo ishte rreptësisht e ndaluar. I trembeshin ndonjë tentative për arratisje. Ishim turni i tretë dhe unë po kërkoja ndonjë vegël pune. Si duket isha larguar. Polici i turnit, sa më pa, më vuri menjëherë hekurat e më lidhi. Më mbajti nja 2-3 orë jashtë, në mes të natës, të lidhur aty si qen deri sa erdhi një polic nga kampi që më mori dhe më dorëzoi te polici i turnit, i cili më futi drejt e në birucë. Të nesërmen, oficeri që kishte turnin

e rojës më dënoi me 15 ditë birucë. Ka qenë shkurt. Binte dëborë. E mbaj mend si tani. 15 ditë në birucën që ishte fare e vogël, 1 metër e gjysmë e gjerë me katër veta brenda. Në orën 9 të mbrëmjes na jepnin nga një batanije dhe na i merrnin në orën 5 të mëngjesit. Gjatë gjithë ditës kërcenim përpjetë, se ishte shumë ftohtë dhe po të mos lëvizje, pa diskutim që merrje plevitin.

Ja, një ngjarje interesante që e mbaj mend e, që të mos ishte tragjike, do të ishte shumë për të qeshur. Kisha një shok nga Vlora, që vinte nga një familje ballistësh, i dënuar me 14 vjet. Quhej Pëllumb Lamaj. Sot është në Amerikë. Pëllumbi ishte djalë i njomë fare. Në kamp kishte edhe pedofilë dhe shumë nga këta e shikonin me lakmi. Lu qep njëri, me shpresë mos e korruptonte. Mënyra krejt të ulëta: "Do të të jap vajzën, për grua, do të të bëj dhëndrin tim", e gjëra të tilla. Pëllumbi, si lab i zgjuar që ishte, bënte sikur s'kuptonte, bënte sikur ishte dakord. Ai tipi mendoi se Pëllumbi pDego, ishte dakord me gjithë këtë që po i propozonte dhe iu afrua më shumë. Në galeri kjo punë. Aty Pëllumbi një të marrë një kazmë, i ra mirë e mirë, mori sqeparin i preu hundën, i preu dy veshët. Ia mori hundë e veshë e ia hodhi aty ku hidhnim mineralet. Doli jashtë qetë-qetë dhe i thotë kapterit që kishte brigadën aty "Shkoni merreni, se e keni në galeri filanin. - Mos! - bërtiti kapteri, që u tremb se mos ky e kishte vrarë". E morën atë të shkretin, urgjent në spital. Ishte bërë gjithë gjak. Imagjino, kur ka ardhur nga spitali pas një 1 muaji e gjysmë ka qenë korrik a gusht dhe bënte vapë. Ai, ngaqë i vinte turp se i kishte veshët e prera, mbante një kokore me veshë mu në mes të gushtit. Hundës nuk kishte ç'i bënte, se e kishte të prerë.

Në një moment i vjen motra në takim këtij tipit dhe e pyet: "Vëlla i dashur, ç'të kanë bërë kështu? Kush të ka masakruar?" Dhe vëllai i rrëfen motrës që e kishin bërë armiq të e popullit. E motra qante me lemeri: "Armiq të e poshtë! Oh, vëllai im i dashur, si të paskan katandisur kështu?" Nuk e dinte motra e shkretë se vëllai i saj ishte pedofil. Po raste të tilla të panumërta ishin të fshehta, nuk shikoheshin. Di të them që komanda mbyllte një sy dhe të dy veshët kur i leverdiste që të kishte degjenerim moral, sepse ka qenë edhe një parullë e Enver Hoxhës që "degjenerimi moral çon në degjenerim politik". Atyre u interesonte që

të shikonin edhe të tjerët, pra punëtorët e lirë dhe t'u thoshin atyre: "Shikoni cilët janë armiqtë, të degjeneruar edhe moralisht". Kështu që komanda në këtë drejtim as dënonte, as bënte për të tilla çështje, përkundrazi i inkurajonte. Sa për çështjen e detyrimit për t'u bërë bashkëpunëtor, unë mbaj mend se kanë ardhur e më kanë zgjuar në mes të natës dhe më kanë çuar te zyra e operativit. Ky, nga ana e tij, nisi të më përpunonte që të bashkëpunoja me Sigurimin dhe me Komandën.

Më vonë, mora vesh që një njeriu im kishte ndërhyrë për të më krijuar ndonjë lehtësi në burg, mirëpo, ishte rregull që nuk mund të të bënin ndonjë favor po të mos i jepja komandës informacione të kësaj natyre: të bëheshe spiun. Operativi i kampit, Shyqyri Toska, me gjithë shefin e policisë së kampit më mbajtën rreth nja dy orë

në tentativë për të më përpunuar. Kur e kuptuan që kjo nuk bëhej, më përzunë. Pastaj më trajtuan si një maskara, si një armik i papendur kundër sistemit. Me një fjalë, kjo ishte e gjitha.

Në '82-in, kur u bë amnistia e parë pas 20 e ca vjetësh, meqë kisha një dënim 7 vjet, më futën në listën e njerëzve që përfitonin e kështu jam liruar në 15 tetor. Erdhën e na morën me disa furgonë të mëdhenj dhe na shpërndanë në qytetet nga kishim ardhur. Ajo që më bëri përshtypje kur më liruan ishte se u gjeta midis një populli krejtësisht të indoktrinuar. Asnjërit nuk i vinte keq për të burgosurin. Të tërë na shikonin shtrembër dhe me urrejtje. Një popull i tërë i shpëlarë nga trutë dhe i kthyer në vegël të sistemit. Shumë vetë thonë se ky popull ishte i detyruar nga diktatura të ulte kokën. Kjo s'është krejt e vërtetë.

Një pjesë shumë e madhe e këtij populli ishin bashkëpunëtorë të sistemit, një popull që bënte luftë klasash në mënyrën më të rreptë kundër të dënuarve dhe "armikut" të klasës. Ta mendosh, të të shikonte njeriu yt i afërm i familjes dhe ndërronte rrugë, bënte sikur nuk të shihte! Me lirim nga burgu, mua më thirrën ushtar, se më kishte mbetur ushtria pa bërë. Si ish-të dënuar më çuan në repartin e xhenierëve, se aty i çonin të gjithë. Në repartet ushtarake të xhenios ushtarët shfrytëzoheshin si forcë punëtore për hapje tunelesh, llogoresh, fortifikimesh, bankash, për ndërtim pallatesh, etj. Në këtë repart ushtarët nuk kanë të drejtë të mbajnë armë, prandaj aty çonin për të kryer shërbimin ushtarak edhe të gjithë personat me biografi të keqe, si edhe të gjithë ata që ishin piketuar që më parë për t'i futur në burg.

Kur u ktheva për në shtëpi, mora vesh që na kishin larguar nga apartamenti ku kishim banuar dhe na kishin çuar në periferi, te Varri i Bamit, te Oxhaku, në një pallat me tulla silikate, ironikisht të ndërtuar nga ish-të dënuar jopolitikë, ordinerë. Dhe kryesisht, i tërë kontingjenti që banonte në atë pallat ishin punonjës të Sigurimit. Imagjinoni, të banosh në një pallat ku të tërë komshinjët janë spiunë! Kur kam hapur dosjen e babait tim, mora vesh që shtëpia jonë ishte e pajisur me mikrofona që përgjonin të tëra muhabetet e shtëpisë. Apartamenti ngjitur me ne ishte kthyer një dhomë operative, ku rrinin me turne punonjësit e Sigurimit dhe mbanin procesverbal kush hynte e kush dilte dhe çfarë bisedohej tek ne. Në dosjen e babait unë kam gjetur procesverbalet e bisedave tona, kur hanim bukë, kur shikonim televizor... Polici i turnit e dëgjonte aty, ngjitur. Kam lexuar në procesverbale që edhe kur kishim qenë në Bllok, na përgjonin telefonin. Madje që atëherë ishte diskutuar nga Sigurimi që të ngrinin një qendër përgjuese për ne në apartamentin ngjitur. Diskutimin se ku u bëhej më lehtë, ta vendosnin aparaturën e përgjimit, duke përmendur se fqinj me ne ishte një ambasador në Kili, pastaj përmendnin një dhëndër, sekretar rinie...

Duhej të përgjonin tim atë, Skënder Malindin, i cili në moshën 16 vjeç kishte hyrë në Akademinë Ushtarake në Milano dhe që, kur erdhi koha e diplomimit, refuzoi të bënte betimin në emër të flamurit fashist. E përcollën në Shqipëri, por e mobilizuan në luftimet kundër grekut. Trupat shqiptare dezertuan. Bie rob i grekëve, të cilët

“Në qoftë se nuk realizoheshin ato norma, policët kishin një shprehje: “O normën, o shpirtin!”
Mosrealizimi i normës nënkuptonte birucë dhe ajo ishte një lemeri më vete në krahasim me atë të kampit.”

e degdisën në burg në Kretë. Kur Gjermania pushtoi Greqinë, mundi të dalë dhe të kthehet në Shqipëri, por menjëherë doli partizan në mal. Që 22 vjeç kishte 200 burra nën hyqëm. Si komandant batalioni u plagos 3 herë. Ky njeri luftoi për mbrojtjen e kufijve kundër provokacioneve greke të gushtit 1949. Pas lufte mbaroi edhe akademinë ushtarake në Moskë, student i shkëlqyer. Ishte komandant i Divizionit të Jugut. Dhe më në fund, një ditë prej ditëve, Enveri tha që ky ishte me biografi të dyshimtë dhe duhej përjashtuar. Këtu filloi i gjithë kalvari i kësaj përndjekjeje. Skënder Malindi u gjurmua tërë jetën, sepse u sajua dyshimi për agjent italian, pastaj grek, anglez, rus apo, ku ta dish, edhe amerikan. Mendojeni një çast: kanë marrë rroga të majme një grup njerëzish në Ministrinë e Brendshme, vetëm e vetëm për të gjurmuar një shqiptar të thjeshtë, kaq patriot, që nuk kishte asnjë gjë tjetër veç shpirtit shqiptar, nisur nga hamendësime që s'i besonin as ata që i kishin lëshuar nga goja. Pasi kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe u lirova nga ushtria, kisha nevojë të nisja një punë, por nuk më pranonin askund, në asnjë lloj pune. Kur them punë, çfarëdolloj të ishte. S'më pranonin as punëtor me kazmë, në Komunale. M'u desh një vit e gjysmë vërdallisje nëpër zyra e nëpër shefa kuadri, në një peripeci mjerimi e depersonalizimi, që më në fund të më pranonin në Komunale. Luftën e klasave më shumë e bënin ata që punonin aty, nuk ishte vetë shefja e kuadrit, se shefen e kuadrit pa ta shikoje njëherë në muaj atje, kurse ata ishin përditë dhe përditë të kujtonin që: "Ti ke qenë armik, ti ke qenë në burg". Ai njeri pa asnjë shkollë, aty, që i binte kazmës, ai ishte konsekuenti. Ideologjinë e bënte partia, për ta konsumuar e konsumonin këta, populli.

Një shoku im shkrimtar, Visar Zhiti, diku në një emision, del e kërkon një muze për rezistencën që i bëri populli shqiptar komunizmit. "O, Visar, - i thashë unë, - e çfarë rezistence ka bërë populli, populli e mbështeti, s'ka bërë rezistencë". Unë nuk di që ky popull të ketë bërë një revoltë në kohën e komunizmit. Të ketë bërë qoftë një akt mosbindjeje. Përkundrazi, ishin të zjarrtë, të angazhuar. Prandaj duhet të sqaroj diçka për komunizmin. Kur dëgjoj ca analiza nga sociologët, janë shumë zhgënjyese. Periudha e komunizmit, periudha e komunizmit...

Njerëzimi ka nxjerrë kriminelë gjatë gjithë

kohërave, por ata ndahen në kriminelë ordinerë dhe kriminelë politikë. E kështu, si punëtor i Komunales, i Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, punova deri sa ra sistemi. Si kryeinxhinier kisha Uran Sakiqin, i cili bëri përpjekjet që të më lejonin të nisja atje punë. Me atë biseduam dhe ia paraqitëm si ishte puna, që u interesua që mua të më jepnin një lopatë në dorë. S'bëhej fjalë për ndonjë lloj privilegji. Kaq. Ama, një gjë është interesante, që gjatë gjithë kohës që punoja në Komunale, Urani mbajti një vijë ndarëse me mua. As nuk më fliste, as më shikonte. Tek ai person unë kam parë njeriun e terrorizuar nga sistemi, njeriun që kish merak se mos dyshohej se ai ishte më tolerues kundrejt një ish-të dënuari. Ishte i terrorizuar, i denatralizuar. Kjo ishte mënyra si më ka trajtuar mua: si qen i zgjebosur.

Çfarë bëtë, gjatë viteve të demokracisë?

Në atë vend pune më gjeti demokracia. Unë nuk kam besuar asnjë sekondë në ardhjen e demokracisë në Shqipëri. Im atë shkonte nëpër sallat e studenteve, nëpër këto tubimet që bëheshin. Më pati thënë edhe mua: "Po ti, more djalë, ke qenë edhe në burg, pse nuk vjen?" Nuk shkoja sepse nuk kisha asnjë lloj besimi tek ata njerëz. Unë pata punuar ca kohë në Qytetin Studenti dhe kisha vënë re se mjaft studentë ishin si një tufë e intoksikuar, e shpëlarë nga trutë, pa gjurmën më të vogël të disidencës: të tërë ishin bij besnikë të sistemit, që u kishte nxjerrë të drejtën e studimit, kështu që nuk kisha asnjë besim te ta. Nuk kishte asnjë lloj rinie studenteske dhe kjo mua më shkaktonte vetëm neveri, asgjë tjetër.

Ato vite isha njohur edhe me gruan time dhe, me rastin më të parë, sapo ra sistemi, u largova për në Greqi, ku qëndrova 20 vjet. Kthehesha nganjëherë këtu, herë mbas here, kthehesha vetëm për prindërit se, për shpirt, nuk doja t'i shihja as bojën këtij vendi. Nëse gruaja ime kishte nostalgji të vinte në Tiranë, takonte shoqet, tezet e ku di unë, mund ta them me gojën plot se mua atdheu më fuste në depresion. Pse? Sepse më kujtonte veten time, në momentet më të këqija, më të mjera. Ky atdhe ishte gjëja e fundit ku unë do të doja të vija. Jam kthyer këtu vetëm i detyruar nga gjendja ekonomike, se nuk kisha më punë në Greqi. U detyrova të kthehesha atëherë, në Shqipëri. Kthim nga halli. Ato pallavrat për dashurinë, as i njoh fare, fare, fare.

Si jeni trajtuar, pas demokracisë?

Lidhur me trajtimin e shtresës sonë të ish-të dënuarve politikë, dua të bëj një sqarim. Unë kam qenë vetë dëshmitar okular: kam jetuar vetëm me të persekтуuarit. Të gjithë të persekтуuarit, qoftë si klasa ekonomike, qoftë si shtresa politike, unë i respektoj për vuajtjen e tyre. Këtu njerëzit janë vvarë, janë pushkatuar, familjet janë shkatërruar dhe e tëra kjo është një tragjedi, që sot e kësaj dite është e pashprehur. Trajtimi ynë tani, nga ana e shtetit, e kësaj klase politike, është trajtimi më i keq i mundshëm. Shteti dihet që është armiku numër një i individit, por këtu te ne, nëse shteti ka për detyrë t'ia nxijë jetën një ish-të persekтуuari, ia ka arritur me sukses të madh.

Flas tani, personalisht, nga përvoja ime. Nga shteti nuk kam parë as edhe një lloj trajtimi të veçantë ose që të kem pasur ndonjë përfitim dinjitoz, për vuajtjen që kam kaluar. Shpërblimi që u caktua në bazë të një vendimi të Kuvendit Popullor, ka qenë një shpërblim qesharak, krejtësisht i papërfillshëm, që na e dhanë me pjesëza për shumë e shumë vite. Nuk gëzojmë asnjë pension të veçantë, asnjë trajtim të diferencuar në kuptimin mjekësor, asnjë trajtim në çështjet e banesave. Ata që mund të kenë marrë ndonjë apartament, kanë përfituar nga disa iniciativa më tepër private të disa organizatave ose me donacione nga Europa, sesa nga ndonjë politikë shtetërore afatgjatë.

Për këtë arsye, mund të them që shtetin e shoh si një armik, i cili nuk ka as më të voglën delikatesë apo ndjeshmëri për këtë grupim njerëzish, siç jemi ne, ish-të dënuarit kundër diktaturës, vuajtës nëpër burgje, ku unë bëj pjesë. Dhe kur them shteti, nënkuptoj me këtë të gjithë klasën politike dhe të gjitha partitë. Sepse të tëra kanë vetëm motivin për ta shfrytëzuar popullin për çështje elektorale dhe më tutje interesimi i tyre është zero.

Meqë më lart, përmendët edhe çështjen e një muzeu kujtese, a keni ruajtur ndonjë gjë nga burgju, apo si natyrë rebele, nuk do të donit që t'i riktheheshit vuajtjes, qoftë edhe duke e kujtuar?

Ilir Malindi: Jo, përkundrazi: s'kam dalë asnjëherë nga burgju. Do të ishte ideale që data si 50- vjetori i revoltës së Spaçit jo vetëm të përkujtoheshin, por

të materializoheshin kjo kujtesë për atë periudhë ferri të diktaturës me një muzeum dhe me aktivitete të shumta. Megjithatë, që të jem i sigurtë, nuk besoj që ky popull e ka dëshirën dhe respektin e duhur për vuajtësit e asaj skëterre që quhet Spaç. Fakt është që ai burg në vend që të ishte një vend muze kujtese për të gjitha ato lemeri që ka parë, është kthyer në vend grabitjeje, plaçkitjeje, është zhveshur i gjithë kampi nga hajdutët e ndryshëm rreth e qark, që i marrin materialet për të bërë ndërtime të tyre...Plus kësaj, me këto që kam parë, mendoj se sot kemi një popull pa kujtesë, një popull që nuk respekton, dhe nuk kemi respektuar të paktën deri më sot asnjëherë viktimat e çdo lloj sistemi që ka kaluar. Edhe kur i kujtojmë, ajo kujtesë shfrytëzohet për rrethana politike të momentit dhe nuk na intereson kurrë kujtesa afatgjatë që duhet të shërbente pikërisht që të mos përsëritej historia.

Më kujtohet se ndërmjet të dënuarve kishim një nga Saranda, i cili kishte qenë refugjat në Amerikë. Siç duket, fukarain e kish marr malli për atdheun, si me thënë, për familjen. Po edhe ia kishin mbushur mendjen që po të vinte, nuk do ta dënonin. Në fakt, sapo zbriti nga avioni, i vunë menjëherë hekurat. E dënuan me 15 vite burg. Nga depresioni që pësoi, tentoi të vriste veten. Dhe një ditë, në momentin që po ktheheshim nga puna, u shkaput nga rreshti, ku ecnim dorë për dorë dhe u hodh te telat e klonit, që rrethonin burgun. Ushtarët kishin urdhër që, sapo dikush t'i afrohej zonës së telave të klonit, të qëllonin me breshëri automatiku. Aty e qëlluan të varfrin. Nuk e duroi dot sistemin rraskapitës dhe nuk mundi të mbijetonte dot në atë lloj regjimi tmerrri, vuajtjeje fizike dhe pune që ishin të papërballueshme, për çdo njeri në kushte normale.

Çfarë mesazhi mund të japësh, për rininë?

Po të pyesësh rininë e sotme për ngjarjet e asaj kohe, asnjë nuk njeh asgjë. Pyes unë njerëz të rinj nga Burreli, vendi ku ka qenë burgju më i tmerrshëm, dhe u them: "A ju thotë gjë, shprehja "Burrel, ku hyn e s'del?" " Ngrenë supet, shohin me sytë e lopës.

"E kemi dëgjuar si shprehje," thonë, sepse nuk e dinë fare që aty ka qenë burgju i Burrelit, ndërtuar që në kohën e Zogut. Ky popull vuan nga forma më e rëndë e Alzheimerit - Alzheimeri historik.

Dësh
nga
family

mi

Leonard Bejko
Menduhije Pojani
Ioann Çeli

jarët

“Ende ne nuk dimë gjë se ku janë varrosur, ku t’i kërkojmë eshtrat e babait.”

Dëshmi nga Leonard Bejko
(I biri i Dervish Bejkos)

Dervish Bejko, i biri i Ikbales dhe Enverit, lindur në vitin 1946 në Starovë të Pogradecit, i dënua me 12 vjet heqje lirie³⁴. Ai u arrestua më 19 gusht 1971 në Korçë, me akuzën “ për tentativë arratisjeje”. U dërgua për të vuajtur dënimin në burgun e Spaçit, ku u vu ne krye të revoltës së 21 majit 1973. Pas shtypjes së revoltës, 4 të dënua politikë u ekzekutuan me pushkatim, mes tyre edhe Dervish Bejko. Eshtrat e tij dhe të të ekzekutuarve të tjerë nuk janë gjetur ende.

Ju falënderojmë që keni pranuar të jepni intervistë duke na treguar çfarë dini për aktivitetin e babait tuaj të ndjerë z. Dervish Bejko?

Leonard Bejko: Unë kam qenë shumë i vogël në atë periudhë. Të isha i madh, do ta kisha përjetuar shumë më keq sesa e kam përjetuar. Mua më rriti më shumë gjyshja, sesa mamaja ime, e cila u nda nga babai, për arsye se e internuan në Shtyllë. Këto i kam mësuar pasi mbarova klasën e tetë, kur arrita moshën 15-16 vjeç. Nuk kisha asnjë lidhje me sojin e babait, por megjithatë ata, domethënë xhaxhai, hallat e të gjithë njerëzit e babait më vëzhgonin nga larg. Kishin drojë se po të vinin të më takonin, ndoshta e rëndonin gjendjen time.

Jam i ditëlindjes 1968 dhe kam qenë 5 vjeç kur babai është pushkatuar. S’e mbaj mend fare babain. Siç më kanë thënë, babai është arrestuar në Pogradec në vitin 1970. Duke biseduar me dy-

34. Fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, Dosje nr.2364, Dosja e Hetuesisë, nr.Regj. 24, Aktakuza, Arkivi i AIDSSH-së. Aktakuza mban vetëm datën nisi më 21, mbaroi më 23 maj 1973, çështja kalon për gjykim para Gjykatës së Lartë po në datën 23 maj dhe gjykimi zhvillohet në Spaç. Gjykata e Lartë ka dalë me Vendim të formës së prerë në datën 24 maj 1973, por për të dënuarit me vdekje vendimi nuk mund të vihej në ekzekutim derisa të kthente përgjigje Presidenti i Kuvendit Popullor për faljen e jetës së tyre. Shih Vendim i Gjykatës së Lartë, po aty.

tre shokë, kanë lëvduar qytetin e Ohrit që duke përballë Pogradecit plot drita. Këta po thonin se kushedi sa i bukur duhet të ishte, sepse këtej s'kishte drita. Dhe duke folur kështu thanë: "Ah, të kishim të iknim andej!". Njëri nga shokët që ishte aty ku po bëheshin këto muhabete, i spiunoi. Kaq duhej. I arrestuan dhe pastaj i dënuan "për tentativë arratisjeje" pa bërë asnjë gjë për t'u arratisur.

Sa vite u dënua babai juaj dhe a dini gjë për revoltën e tyre në Spaç?

Leonard Bejko: Babain e dënuan 10 vjet dhe e çuan në burgun e Spaçit. Atje ndodhi një kryengritje. Për këtë ka dëgjuar i gjithë populli dhe tani e dinë njerëzit si është bërë kryengritja dhe si u zhvillua. Ndër organizatorët ishin Zef Pali, Dervish Bejko edhe të tjerë. Por katër u seleksionuan dhe u pushkatuan. Ende ne nuk dimë gjë se ku janë varrosur, ku t'i kërkojmë eshtrat e babait. Mua më vjen keq që qeveria nuk ka bërë asgjë për të gjetur eshtrat e tyre.

Çfarë ndodhi kur babai juaj doli në gjyq? Ku u zhvillua gjyqi? Po me familjen tuaj ç'ndodhi pastaj?

Leonard Bejko: Me aq sa di unë, gjyqi u zhvillua në Korçë dhe me dyer të mbyllura. Pas dënimit të babait na internuan mua dhe nënën, se isha fëmija i vetëm i tyre. Unë isha i vogël fare. Të dy u internuan në Shtyllë. Kushtet ishin mizerje, për këtë arsye mamaja ishte e detyruar që të bënte ndarjen nga babai, me qëllim që të na kthenin në Korçë. Mbas nja tre-katër muajsh në internim, bëri ndarjen nga babai.

Meqë mamaja juaj ka bërë ndarjen, mbetet që ajo të mos ketë shkuar asnjëherë për ta takuar babain në burg?

Leonard Bejko: Jo, s'mundi të shkante, se po të shkante atje, atëherë duhet të rrinte e internuar në Shtyllë, domethënë nuk do ta linin të dilte nga internimi. Këtë e di, sepse kam folur me mamanë.

Pavarësisht faktit që mamaja juaj u detyrua të bënte ndarjen nga bashkëshorti, për

shkak se e internuan, si e ka përjetuar ajo shpirtërisht gjithë këtë ngjarje?

Leonard Bejko: Shumë keq e ka përjetuar. Ka pasur vuajtje që është ndarë nga babai im, sepse e ka dashur atë njeri. Atë e kanë detyruar të ndahet. I kanë thënë: "Ose do të bësh ndarjen, që të kthehesh në Korçë te prindërit, ose ndryshe, do të jesh e vetme në internim".

Madje tentuan që të internonin dhe sojin e mamasë. Kështu që edhe soji i mamasë i ka bërë presion... Ndarjen me babanë mamaja e ka vuajtur, aq më tepër që më kishte edhe mua fëmijë të vogël. E kishte edhe këtë brengë, po ndërkaq, mua nuk më tregonte dot asgjë. Pasi mamaja u nda prej babait dhe u largua prej internimit, prindërit e detyruan që të martohej dhe mamaja shkëputi të gjitha lidhjet me fisin e babait. As njerëzit e babait nuk lejoheshin të vinin të më takonin mua. Por, nga ana tjetër, edhe vetë ata bënë kujdes, që të mos më afroheshin me qëllim që të mos më rëndonin mua.

A i keni takuar gjyshërit nga babai?

Leonard Bejko: Jo, vetëm gjyshen, sepse vetëm ajo mundi të arrinte e gjallë ndryshimin e sistemit.

Si e ka përjetuar gjyshja? A mundi t'ju tregonte ajo ndonjë gjë për babain?

Leonard Bejko: Kur jam takuar me gjyshen, kam qenë 20 vjeç. E mbaj mend si tani. Me ardhjen e demokracisë e kam takuar në Pogradec, në shtëpi. Ata të gjithë kanë qarë sikur u shkoi vëllai në shtëpi domethënë, sikur ishte babai im që po i takonte, se dhe unë i ngjisja. Isha pak më i dobët atëherë dhe ngjaja shumë nga babi.

Të gjithë kanë qarë, sikur kishin një mort të dytë. Vërtet u gëzuan shumë, por dhe qanë aq shumë, se kur më shihnin mua u është shfaqur prapë para syve djali i tyre ose vëllai. Dhe, që atë kohë, gjithmonë më kanë ndenjur afër, më kanë ndihmuar sa kanë pasur mundësi. Gjyshja ka vdekur. Xhaxhai im, Agim Bejko, tani është në Francë dhe gjithmonë kur vjen, më kërkon patjetër që ta takoj. Ai më ka folur për babain.

Po shokët e babait a i keni takuar?

Leonard Bejko: Kam takuar Ylberin në Korçë, kam takuar Thimin që vdiq. Shumë shokë të babait që unë s'i njihja, sa kanë marrë vesh që jam djali i Dervish Bejkos më janë afruar vetë. Më kujtohet një rast në Pogradec. Ishte dikush që po lexonte një libër për vuajtjet dhe dënimet ne Spaç. Mua më shkuan sytë te libri dhe i thashë: "A ka mundësi ta shikoj atë librin?" Më pyeti përse po interesohesha dhe kur i tregova arsyen, m'u hodh në qafë. Kishte qenë i dënuar në Spaç. Më foli fjalë të mira për babain, për trimërinë e tij.

Unë kam një boshllëk. E kam brengë shumë të madhe mungesën e tij. U rrita pa të dhe më duket sikur s'kam një krah domethënë, nuk mund ta shpjegoj dot me fjalë. Vështirë të shpjegohet me fjalë kjo gjë, sikur të thuash kam pasur dhimbje. Unë pavarësisht vuajtjeve të tjera, u detyrova të nis punë që 14 vjeç, sepse s'kishte kush të më ushqente. Jo vetëm kaq, por kudo në jetë hasja probleme. Kur shkova ushtar, më çuan në xhenio, se aty shkonin ata me biografi të keqe. Nuk më jepnin armë mua, se isha i persekutuar.

Unë që kur kish ndodhur ngjarja kisha qenë fëmijë i vogël fare, e ke idenë? Regjimi i asaj kohe për çdo gjë të vinte gishtin "O, është i biri filanit". Pavarësisht se mamaja u nda, mua gjithmonë më kanë nxjerrë anash. E kam ndier veçimin edhe në shkollë, edhe në ushtri. Me zor ma kanë dhënë shkollën e minierave, me zor gjeologjiken. Këto vuajtje i kam mbajtur gjithmonë përbrenda dhe që t'i shpreh, sesi më vjen. Kam shumë gjëra për të thënë që të nis tani, kushedi se kur mbarojnë, po kam dhe shumë që nuk më kujtohen, se nuk mbahen mend të gjitha.

Nuk mjafton ajo vlerë monetare që mund të na japë shteti. Unë dua të gjenden eshtrat e babait. I kam bërë një varr në Pogradec dhe kujdesem të mos i humbë kuadrati dhe emri. Gjithmonë që kaloj, kthehem dhe nder një cigare, po kujt ia nder? Tokës? Mermerit që i vura unë? S'kanë vlerë. Ne i kemi kërkuar eshtrat. Xhaxhai ka gërmuar shumë, por asgjë. Tani kërkoi si mundet të më ndihmoni vetëm për këtë gjë? Duket sikur nuk e çan kokën njeri, për këtë histori.

Nuk është krejt ashtu. Diktatura ka bërë çdo gjë për të zhdukur çdo gjurmë. Sot po ndeshim në mungesë dokumentesh, që të mund t'i gjenim gjurmët.

Leonard Bejko: Mua më kanë thënë që trupat e tyre i kanë shpënë në laborator. Domethënë, pas pushkatimit, i kanë sjellë në morg. Kjo ka qenë. E kam vështirë ta shpreh me fjalë. Më nisin emocionet dhe humbas memorien. Më vjen mirë kur takoj ndonjë shok të babait, kur ma kujtojnë. E dua dhe një përqaftim të ngrohtë. Po është diçka tjetër ta vuash dhe ta kesh hequr në kurriz gjithë jetës, atë mungesë dhe veçim.

A keni marrë vesh si e kanë vuajtur gjyshërit nga babai arrestimin dhe më pas, vrasjen e babait?



Leonard Bejko: Shumë e kanë vuajtur. Xhaxhai më ka treguar se vinte e më shihte nga larg, por kishin frikë të afroreshin se s'deshën të kisha pasoja. Të paktën të më linin asnjans. Kur u rrita, desha t'i takoja, i kërkoja nënës dhe ajo më thosh se do t'i takonim po s'ishin këtu dhe që ata do të vinin vetë të më takonin.

Po nëna juaj i ka takuar njerëzit e babait?

Leonard Bejko: I ka takuar gjithmonë. Dhe sot e kësaj dite i takojmë dhe i ftojme kur kemi gëzime e hidhërime. Ato vetë, hallat e mia, motrat e Dervishit, e dinë si ka qenë puna dhe historia, e dinë më mirë se unë. Kanë qenë katër vëllezër dhe tri motra.

Tri hallat e mia dhe dy vëllezër të babait janë gjallë. Njëri nga vëllezërit ka vdekur. Kam marrëdhënie shumë të mira. Hallat i takoj gjithmonë, sikur njihemi prej një jete. Tani mund të them se më shumë kam marrëdhënie me njerëzit e babait sesa me të mamasë.

Më vjen mirë, sidomos kur nga institucionet shtetërore e kujtojnë dhe e nderojnë aktin e babait tim. Shokët e tij, ish-të dënuar, që e kanë parë skenën siç ka ndodhur atje, më kanë thënë që babai është treguar një hero.



Main body of text, mostly illegible due to fading and bleed-through from the reverse side of the page.

“Koha ecën, çdo gjë ndryshon, por unë për çdo gjë fajësoj komunizmin, se prishi njeriun.”

Dëshmi nga Menduhije Pojani
(E bija e Njazi Bylykbashit)

Njazi Bylykbashi, i biri i Sibes dhe Arifit, lindur në vitin 1933 në Pilur të Korçës dhe banues në Lushnjë, vuajti dënimin me dhjetë vjet heqje lirie³⁵ në Kampin e Riedukimit 303³⁶ në Spaç me akuzën e agitacion-propagandës. Në vitin 1972 u dënua sërish me 10 vjet burg, për të njëjtën akuzë. Për shkak të revoltës së 21 majit, megjithëse nuk mori pjesë në të, sepse ishte në turnin e punës kur revolta shpërtheu, u ridënua edhe me katërmbëdhjetë vite të tjera burg dhe u transferua në burgun e Burrelit.

Zonja Menduhije, ne dëshirojmë që ju të na tregoni ato që ju dini për jetën e babait tuaj, i ndjeri z. Njazi Bylykbashi. Për çfarë u dënua, si vuajti në burgun e Spaçit, çfarë pësuar ju si familje, si jeni ndier e të tjera

ngjarje, që ndodhën pas dënimit të tij.

Menduhije Pojani: Mamaja ime ishte vetëm 27 vjeçe kur babai u dënua. Unë me mamanë kemi jetuar në Lushnjë brenda, ndërsa familja e babait u internua në Gradishtë.

Unë jam Menduhije Bylykbashi, e datëlindjes 1963, lindur dhe rritur në Lushnjë. Babai im është Njazi Bylykbashi. Në kohën kur nisi të zbatohet reforma agrare në fshat, pushteti i kërkoi ndihmë gjyshit që t'i mblidhte fshatarët, duke qenë se ishte një zë që e dëgjonin dhe t'i bindte ata të dorëzonin tokat në kooperativë. Gjyshi nuk e mbështeti këtë reformë. Jo vetëm që nuk i bindi fshatarët e tjerë, por vendosi që bashkë me të vëllain dhe nipat e vet, të arratiseshin në Greqi.

35. Fondi nr.1 Hetimor-gjyqësor, Dosje nr.8406,Vendim i Gjykata e Rrethit Lushnjë, nr.24 Aktit, nr.23 i Vendimit, datë 12 prill 1972, Arkivi i AIDSSH-së.

36. Burgu i Spaçit quhej kamp riedukimi dhe kishte numrin 303. Fondi nr. 1 Hetimor-gjyqësor, Dosje nr. 2354 A,Vendim iGjykata Popullore e Rrethit Mirditë, nr. 32 Regj. Themeltar, Nr. 34 i Vendimit, datë 13.07.1973, Arkivi i AIDSSH-së.

“Meqë babai nuk tregoi, e futën në burg. Ishte vetëm 17 vjeç. E dënuan me 8 vite. Kur kujtonte burgun, babai thoshte se ishte vetëm një fëmijë që e kishin mbajtur gjallë më të vjetrit.”

Këtu filloi kalvari i vuajtjeve. Më parë, familja e babait ishte thjesht, familje fshatare, jo shumë e pasur, por jetonin mirë.

Gjyshja ime dhe halla, domethënë nëna e babait dhe motra e tij u internuan, fillimisht në Valias, pastaj i çuan në Tepelenë, në kampin e Tepelenës dhe ato kanë një histori më vete.

Babai im, sapo mbaroi shkollën 7-vjeçare, rreth 16-17 vjeç, u bashkua me lëvizjet për luftën kundër analfabetizmit dhe shkoi për të punuar si mësues, në Kukës.

Në pushimet e verës u kthye në fshat që të takonte gjyshen. Njëri nga të afërmit e tij të arratisur ishte kthyer. Në atë kohë i quanin diversantë.

Po e kërkonte Sigurimi i Shtetit, ndaj ata i kërkuan ndihmë babait tim. Ky u përgjigj që nuk dinte gjë. Një kushëri që kulloste bagëtitë u tregoi diçka dhe forcat e ndjekjes e morën babain, e vunë

përpara dhe shkuan drejt një pylli ku ishte fshehur “diversanti” i cili, për të mos rënë në duart e Sigurimit, vrau veten.

Meqë babai nuk tregoi, e futën në burg. Ishte vetëm 17 vjeç dhe e dënuan me 8 vite burg. Kur kujtonte burgun, babai thoshte se ishte vetëm një fëmijë që e kishin mbajtur gjallë më të vjetrit duke i dhënë nga racioni i tyre i bukës, sepse shpresonin që ky, si më i ri, të tregonte çfarë u kishte ndodhur në burg. Prandaj racionin e tyre të bukës ia jepnin babait, që të dilte gjallë dhe të tregonte ato histori.

Dolipasi bëri tetë vite burg. Ishte rreth 25-26 vjeç. E ëma e tij, gjyshja ime, gjatë atyre viteve ishte në internim. Para se babai im të burgosej, halla ime ishte e martuar dhe jetonte në qytetin e Korçës. Burri i saj ishte oficer dhe halla ime atë periudhë e kujton si një jetë të bukur: dilnin për serenata në lokale mbrëmjeje, por zgjati shumë pak, sepse kur gjyshi u arratis, atë e internuan. Madje, Sigurimi

thirri edhe burrin e hallës dhe i kërkoi të vendoste: ose të ndahej nga gruaja, ose të linte uniformën. Burri i hallës u tha: “Unë këtë e kam nënën e dy fëmijëve të mi dhe kurrsesi, nuk mund ta lë”. Kështu që edhe atë e internuan në Fier, madje bashkë me vëllain e tij, i cili nuk kishte asnjë lidhje me këtë gjë, por kështu veprohej atëherë. Ai mori edhe gjyshen time, e cila kishte mbetur e vetme në internim, pas arratisjes së gjyshit. Kur babai mbaroi tetë vjet dënim, u vendos në Lushnjë. Ndenji aty dy-tre vjet. Me anë të një miku të tij, edhe ai i persekutuar, vendosën lidhjen me mamanë time.

Mamaja ime është nga një fshat i Beratit. Familja e saj ka qenë shumë e pasur, sepse kanë qenë bejlerë. Gjatë luftës kanë pritur e përcjellë edhe partizanët, edhe ballistët. Por gjyshja ime ishte tezza e Abaz Ermenjtit, ndërsa e bija e saj, tezza ime, ishte martuar në një familje dëshmori.

Për shkak të reformës agrare, familjes së gjyshes ia morën tokat edhe e shpallën kulak. Unë e kam përjetuar këtë ndasinë e dy biografive të ndryshme. Tezza e mamasë sime, çunat i kishte oficerë me grada, kolonelë, mirëpo ironia e fatit për mamanë time ishte se ajo e kishte ditëlindjen në vitin 1944 dhe mamanë time e zuri periudha e reformave, kur familja e saj u shpall kulake. Si përfundim, ajo duhej të martohej me një të deklasuar, siç cilësoheshin në atë kohë, domethënë me një si vetja. Prandaj e martuan me babanë tim.

Mamaja ishte vetëm 17 vjeçe. Më ka treguar sesi njëherë, kushëriri i saj, djali i tezes, që ishte kolonel, i kishte ndeshur në rrugë gjyshin tok me mamanë dhe me dy fëmijët, unë dhe vëllai i madh. Ai pyeti gjyshin: - Po kjo, kush është? Nuk e njihnte mamin tim dhe gjyshi i tha që ishte Azbija, vajza e vogël. - Po ku është martuar kjo? - pyeti ai. - Në Devoll - i thotë gjyshi. - Aaaa, me ata ballistët? Do ta ndash këtë vajzë ti, se nuk mund ta shtyjë kjo vajzë kaq e bukur, kaq e re, të rrijë e të merret me ata. Gjithë jetën, probleme do të ketë.

Mamaja ime, me një natyrë shumë të prerë dhe që vlerësonte moralin njerëzor, i thotë: - Pa m'u qëro e mos të të shikoj më me sy. Dhe unë s'kam më punë me ty.

Babai im atë kohë ishte i lirë, por ky koloneli e

dinte fatin që e priste babain, si familje e shpallur e deklasuar.

Kaluan dhjetë vite. Ne u bëmë katër fëmijë të lindur në ato dhjetë vite. Unë kam një vëlla, një motër edhe pastaj vëllai vogël. Në ato vite babai punoi në ndërtim nëpër fshatra, edhe siç është ky komunikimi njerëzor që ti nga qyteti mund të çosh çdo gjë në fshat për ta këmbyer, edhe babai çonte ndonjë bukë dhe e këmbente, për shembull, me vezë. Pas dhjetë vjetësh babai u gjend përballë akuzave, se kishte bërë propagandë në fshat, duke thënë: “Po vdesin fshatarët, se po hanë bukë misri”, s'kanë ç'të hanë” etj. Ishte duke punuar për ndërtimin e një mapoje në Fier-Shegan të Lushnjës dhe atje e arrestuan për herë të dytë.

Në akuza i përmendnin edhe lidhjet familjare, se për hir të së vërtetës, gjyshi im nuk ka hesitur, edhe në emigracion ka bashkëpunuar me Zogun, kundër komunizmit... Ai na dërgonte ndonjë pako dhe para prej andej, por këtu kursi i këmbimit ishte i pafavorshëm, prandaj nuk dërgonte shumë.

Kështu ia arritën qëllimit ata njerëz dhe një ditë e arrestuan babain. Kur u arrestua për herë të dytë, në vitin 1972, unë isha 9 vjeçe, kurse vëllai i vogël 11 muajsh. Ishim me radhë: 9 vjeç, 6 vjeç, 3 vjeçe motra dhe 11 muajsh vëllai i vogël. E kujtoj atë ditë, si sot. U ktheva nga shkolla pasdite. Shtëpinë e gjeta të rrethuar me policë. Mamaja nuk kishte ardhur ende nga puna.

Ne jetonim me gjyshen 72 vjeçe - një grua e dobët, e vogël nga trupi, e kërrusur nga reumatizma dhe shëndetligë. Kishte qenë shtruar në spital, në Sanatoriumin e Lushnjës. Në moshën e saj zor se dilnin gjallë njerëzit nga Sanatoriumi, por kujdesi i babait bëri që ajo të dilte gjallë, sikur e përgatiti për një betejë të re. Gjatë kohës që gjyshja ishte tre muaj në spital, na erdhën shumë njerëz nga fshati i saj. Prindërve u dukej pak si çudi: “Pse duhet të vinin këta njerëz që nuk ishin edhe aq të afërt?” Për njërin prej tyre, gjyshja na tha që e kishin pasur si punëtor në shtëpi. Ata vinin dhe hapnin biseda. Kur mamaja i tha njërit prej tyre: “Njazi nuk është, vjen vonë”, ai ia ktheu: - “S'ka gjë. Po shkoj te një kushëri dhe kur të kthehet Njazi, të vijë të më takojë atje”. Sikur duhej medoemos ta takonte. Dukej sikur ai kishte një plan të caktuar. Domethënë gjatë kësaj kohe ishin shfaqur këto

si sinjale dhe babai sikur parandiente se diçka e keqe po vinte. Atë ditë, policët bënë një kontroll shumë të madh nëpër shtëpi, siç dinin t'i bënin ata. Mamaja ende s'kishte ardhur nga puna. Sa erdhi, u kërkoi leje të ulej për t'i dhënë pak për të pirë djalit, që po qante shumë. -Jo, nuk do t'i japësh. Pse çfarë ka ai? - iu përgjigjën. - Ky është foshnjë. Si mund ta lë, pa pirë? Ka gjithë ditën që nuk ka pirë. - Ky do të paguajë gjynahet e babait të vet, kurse babai i tij të babait të vet - ia kthyen ata mamasë.

Domethënë brez pas brezi, për shkak të arratisjes së gjyshit tim, ne do të vuanim. Kur bënë kontrollin, morën ca gjëra, po nuk mbajtën asnjë procesverbal, ndërkohë që edhe për një mjet bëhet procesverbal, se çfarë është në rregull e çfarë është prishur. Aty nisi edhe lufta jonë. Mamaja ishte vetëm 27 vjeçe. Ajo punonte gjithë ditën në bujqësi. Mbante dhe dru në kurriz, që na i sillte për t'u ngrohur.

Pas tre muajsh, babai u dënua, iu bë gjyqi. Atje, në hetuesi, kishte edhe pyetje të tipit: - Si je martuar ti, me mbesën e Abaz Ermenjit? - Po ti, do të ma jepje motrën tënde që unë të krijoja familje, të krijoja jetën time? - ia kishte kthyer babai.

Për hir të kësaj, nuk u fut vetëm babai im në burg, por edhe dy çunat e hxaxhait të babit. Ishte 1 shkurt, kur morën babain në burg. Vëllai im, i madhi, ishte në klasën e parë dhe e përjetoi si shok, se ishte shumë i vogël dhe kur shkoi mami në takim me mësuesen, ajo duke mos e ditur se çfarë na kishte ndodhur, i shprehu shqetësim mamasë, që vëllai nuk ishte si në fillim, sikur kishte pësuar një tronditje. Mamaja ia shpjegoi, çfarë na kishte ndodhur. Atëherë mësuesja, shumë mirëkuptuese, i tha mamasë: "Merru me tre fëmijët e tjerë, se me këtë do të merrem unë". Në shkollë, përgjithësisht kemi qenë nxënës të mirë, kemi mësuar. Ndoshta kjo ishte arsyeja që pasi hyri babai në burg, ne plotësuam një formular dhe na lejuan të banonim në Lushnjë, megjithëse gjendjen civile e kishim në Plug. Gjithashtu, ne nuk banonim në ndonjë banesë shtetërore, që mund të na urdhëronin për ta liruar, me qëllim për të strehuar banorë të tjerë. Ne banonim në një shtëpi private. E kështu na lejuan. Në këshillin e lagjes ishte diskutuar: "Çfarë po na bën neve ajo çupëlinë, me disa fëmijë të vegjël? S'po e heqim.

Ajo në bujqësi punon, nuk është se ka zënë ndonjë vend pune që e duan të tjerë."

Kështu mamaja iu nënshtrua punës në bujqësi. Bënte punët më të vështira, se duhet të ushqente fëmijët. Kur mbarova shkollën 8-vjeçare, më duhej të filloja punë të ndihmoja mamanë time, por nuk më jepnin vend pune se isha e vogël. Duhej të ishe 14 vjeç dhe shteti të paguante dy orë. Mua më quajtën minorene, nuk më dhanë punë që të paguhesha nga shteti, por me shumë të tjerë e kishin bërë këtë.

Për të mos ndenjtur pa shkollë, bëra një vit gjimnazin dhe pastaj shkova përsëri për punë. Kemi pasur një sekretare këshilli, që më duhet ta them me emër se s'bën: Marjeta Dushi. Kur shkoi mamaja dhe i kërkoi me lutje të më merrte me vete atje ku punonte vetë në bujqësi duke e sqaruar se ne ishim të ardhur në Lushnjë, nuk kishim asnjë njeri në këtë qytet, prandaj mamaja donte të më kishte pas vetes, se kishte frikë që vajza të mbetej rrugëve e të merrte drejtim të keq, ajo me një përbuzje poshtëruese i tha: "E di ti se kush je, apo jo? Ti nuk duhet, as të hysh në zyrën e Këshillit Popullor. E di ti me kë je martuar, apo s'e di?"

Mua nuk më çuan për të punuar atje ku ishte mamaja ime, por në Tërbuf, në Çermë - sektor, ku shkonim që në orën pesë. Kam qenë shumë e vogël, e imët me trup. Më zinte gjumi ndonjëherë dhe ashtu përgjumësh, dëgjoja njerëzit që pëshpëritnin e thonin: "Gjynah, presin babai dhe e ëma e kësaj, të hanë nga kjo. Kjo është fëmijë për vete".

Natyrisht, nuk e dinin historinë tonë. Kur u bë gjyqi ku babai u dënua me 10 vjet burg, nuk mori pjesë asnjë njeri nga familja. Ishte vetëm Kurt Kola, shok i babait tim në shkollë të mesme dhe dashamirës i tij. As kushërinjtë e babait nuk shkuan në gjyq. Babain e çuan në Spaç në vitin 1973, kur ndodhi revolta. Ne shkonim vetëm një herë në vit në takim, se nuk kishim mundësi. Babai im, ishte djalë i vetëm, me tre motra. I ati, që nga Amerika, nuk dërgonte më para, se këtu paratë shkëmbeheshin vetëm me një paketë cigaresh.

Mbaj mend që në pushimet e verës, pasi mbaroi shkolla, unë, gjyshja, vëllai dhe një kushëri i babait

që e kishim aty në Lushnjë, shkuam për ta takuar. Kur mbërritëm atje, na thanë që s'kishte takim, se babai ishte i dënuar. Nuk dinim asgjë se çfarë ishte bërë në 21 maj. Nëna e mamasë në fshat rriste zogj. Kishte therur gjelin, e kishte gatuar sipas mënyrës saj dhe pak ushqime të tjera për t'ia çuar babait në burg. Dhe të mendosh që mamaja ishte një grua 30 vjeçe, me katër fëmijë, me vjehrrën pleqëri edhe me të vëllain që ia futën në burg, sepse ata ashtu i bënëin gjërat. Mamaja ime ishte një femër e pambrojtur nga asnjë mashkull, se një vëlla të vetëm kishte. Vëllai në burg, burri në burg dhe ajo kishte mbetur e vetme.

Kur mbërritëm në Spaç, na thanë që babai nuk ishte aty. U kthyem pa bërë takim. Kushëriri i babait, bashkë me vëllain, u kthyen në Lushnjë. Na thanë të shkonim në Tiranë dhe të pyesnim ku e kanë çuar. Mua më duhej të shkoja me gjyshen nga pas, bashkë me gjelin dhe ushqimet e gatitura... Arritëm në Tiranë. Nuk mbaj mend, se në cilin burg vajtëm, se në 1973-in unë isha 10 vjeçe. Pyet andej e këtej, gjeli zuri krimba.

Më vonë, babai na tregoi që na kishte dëgjuar kur shkuam atje dhe pyetëm, edhe që na ndoqën. Ikëm. Gjyshja, nuk dinte ç'të bënte. Pleqëri. Kishte një kushërirën e vet në Elbasan dhe donte ta takonte, se mbase ajo merrte vesh ku ishte babai, sepse asnjë nuk na jepte informacion. Meshkuj të rritur në familje, që të shkonin të trokisnin, për të marrë vesh diçka, nuk kishim. Vajza e tezes së gjyshes sime ishte martuar me vëllain e Kadri Azbiut dhe gjyshja mendonte se, meqë ai ishte atje lart, do t'u thoshte ndonjë gjë. Shkuam të takonim Havanë, por ajo duke qarë i tha gjyshes: "Motër, nuk mundem. S'të bëj dot gjë. Nuk mundem..." Gjithandej, dyert të mbyllura. Ngado. Asnjë derë nuk na hapej.

Më pas u bë edhe gjyqi dhe babai mori edhe 14 vjet të tjera dënim. Domethënë, fillimisht ishte dënuar 10 vjet dhe kur u ridënua, i dhanë edhe 14 vjet të tjera. Luftë prapë. E çuan në Burrel. Akoma më keq për ne, se duhet të çonim dy kile ushqime në muaj, gjer në Burrel, por ne nuk shkonim dot një herë në muaj. Mezi shkonim dy herë në vit: një herë kur ne mbaronim shkollën dhe herën tjetër shkonte mami në vjeshtë ose në dimër, e shoqëruar me ndonjë nga hallat.

“Familja e mamasë ka qenë shumë e pasur, prisnin e përcillnin partizanë dhe ballistë. Me reformën agrare ua morën tokat dhe i shpallën kulakë.”

Ai vazhdonte burgun, ndërsa ne luftën për të mbijetuar. Bëra një vit shkollë, gjimnaz ditën, pastaj e kalova natën, derisa e mbarova. Një gjë më ka bërë përshtypje dhe e mbaj mend si sot, kur në lëndën "Njohuri për marksizmin" mësuesja më vlerësoi me notën nëntë, disa vajza që ishin bërë kandidatë për anëtare partie, i thonë mësueses se përse ajo më kishte vlerësuar mua me atë notë, domethënë, mua nuk duhej të më vlerësonte me notë të lartë...

Babai bëri burgjet në Spaç, Qafë-Bari, në Ballsh. Këto për kohën kur ishte i martuar. Dhe ne e kemi ndjekur kudo, deri në fund, kur e çuan në Ballsh dhe prej aty e liruan në vitin 1985.

Unë mbarova shkollën e mesme pa shpëputje nga puna. Punoja në Tërbuf, pastaj pas dy a tre

vitesh u afrova pak më afër, në Dushk. Punoja në bujqësi, korrnim grurë dhe misër. Nga Dushku në Lushnjë shkoja në këmbë për shkollën. Kur mësuesi i matematikës e mori vesh gjendjen time, mendoi se ishte për faj të babait dhe tha: "Çfarë babai kriminel. Gjynah kjo vajzë, të ngelet pa shkollë!" Nuk më erdhi mirë që e tha ashtu, por ai gjykonte sipas sistemit. Mbarova shkollën, vazhdoi jeta. Punoja gjithmonë në bujqësi, sepse s'kishte shanse të merrja punë tjetër. Vëllai dhe motra vazhduan gjimnazin ditën, rregullisht. Vëllai i vogël vazhdoi shkollën e mesme bujqësore.

A mbani mend, si shkonit në burgun e Spaçit?

Menduhije Pojani: Për të shkuar në Spaç, duhet të qëndronim njëherë në Laç. Atje ishte një

fushë me dru, ku gjenim ndonjë makinë. Qëllonte të hipnim edhe në makinat e kromit. Por, nuk na merrnin gjithmonë. Për mua dhe gjyshen sikur kishin mëshirë, kurse mamanë e shikonin edhe të re, edhe të veshur, se gjyshja, duke e pasur nusen e djalit të vetëm, i kishte bërë një pallto të mirë dhe një orë dore, dhe shoferët thonin: "S'e shikon si vishet, me pallto të madhe?" Ajo të "çan kokën" me orën e dorës. Këto fjalë i kishin gjithmonë si sulme meshkujt. Mbaj mend, kur mamaja vishte një palë çizme që ia kishte blerë babai, përpara se të hynte në burg, të gomuara nga jashtë, me push nga brenda. I ishin grisur. Kontakti i vetëm që kishte familja jonë, ishte postieri që na sillte lajmet: letrat nga babai një herë në dy javë ose letra nga gjyshi nga Amerika.

Kur duhet të çonim pakot në burg, ishte siklet. Siklet ka qenë. Që dhjetë vjeç duhet të bëja një pako për në Burrel, me bukë të thatë dhe disa gjëra të tjera, që duhet t'i fusje brenda dhe t'i transportoje. Ne nuk kishim asnjë pako, ku t'i fusnim. Duhej edhe ta lidhnim, sepse kishte disa rregulla të caktuara, por ne as lidhëse nuk mund të siguronim. Njëherë do të shkonte mamaja me hallën dhe burrin e hallës në Qafë-Bari. Rrugës ndalën një makinë, brenda saj ishte një oficer dhe pasi ata hipën, ai ndezi një çakmak dhe pyeti: - Ti, je Azbia që jeton në Lushnjë dhe ke katër fëmijë? Mamaja shtangu dhe i erdhi zor: "Nga po e njihite ky njeri?" - Po, - i tha mamaja, - unë jam.

Oficeri nuk foli më. Kur shkoi mamaja për të bërë takimin, policët atje i thanë që atë takim e kishte me leje nga Sali Skënderi. Kështu quhej oficeri. Ai kishte bërë punën fizike në brigadën e mamasë sime. E kishin çuar me qëllim, apo rastësisht, nuk e di, por ai atje kishte mbledhur opinionet rreth mamasë. Kur babai do të dilte për takim, i thanë që atë takim e kishte prej gruas që kishte një sjellje shembullore në punë, që ishte shumë korrekte, se të ishte për të, atij nuk duhej t'i lejohej fare të bënte takim.

Ky ishte takim special?

Menduhije Pojani: Jo, jo. Takim special nuk bëri asnjëherë mamaja. Në herë tjetër ishte dimër, mot i ftohtë dhe mamasë nga të ftohtët iu ngjir zëri. Kanë qenë disa lavanderi, ku flinin njerëzit. Kur shkoi ditën tjetër për në takim, mamaja nuk kishte

fare zë, të fliste. Shkoi nga Lushnja në Qafë-Bari dhe nuk bëri as atë dhjetë minutëshin e takimit, se e pyetën çfarë po thoshte me zë të ulët. - Ju lutem, po nuk kam zë - u përgjigj mamaja. Mirëpo ata e mbyllën derën e takimit. Për një takim, ne thurnim ëndrra gjithë vitin, se çfarë do t'i thoshim babait. Unë kam të gjithë korrespondencën e burgut, nga të gjitha burgjet - një kuti plot. E kam ruajtur.

A mund të na i jepi, t'i skanojmë, për t'i pasur edhe ne?

Menduhije Pojani: Pse jo? Unë e kam arkivin të plotë, pas vdekjes së babait.

Babai juaj e fitoi lirinë në vitin 1985. Si e pritët ditën e parë kur erdhi në shtëpi? Çfarë ndodhi me jetën e tij? Po me ju? A ndryshoi ndonjë gjë?

Menduhije Pojani: Babai erdhi në darkë vonë edhe ne na kishin zënë disa frikëra të tmerrshme. E kemi përjetuar me frikë të madhe, duke menduar se mos e kishin arrestuar prapë. Gjyshja lutej që të kishte mundësi të vdiste në duart e djalit. Asaj i kishte vdekur djali tjetër 27 vjeç, që kishte ikur në Amerikë, dhe i kishte mbetur vetëm babai.

Babai filloi punë në një frigorifer, ku punonte me turne. Njëherë ishte turni i dytë dhe po punonte me orar të zgjatur. Ne u shqetësuam pse ende nuk po vinte në shtëpi. Frika ishte e pranishme gjatë gjithë kohës.

Atë kohë, vëllai kishte shkuar ushtar, prandaj unë me motrën dolëm dhe shkuam atje ku ishte hetuesia, për të parë a për të dëgjuar ndonjë gjë. Na pa një polic dhe na pyeti se çfarë kërkonim atje. I treguam shqetësimin tonë për babain, sepse s'na kishte ardhur akoma, ndërsa polici na largoi, duke na thënë të shikonim se mbase babai mund të ishte duke pirë ndonjë teke raki. Si përfundim, babai erdhi shumë vonë. Këto frikëra, na kanë shoqëruar gjatë gjithë jetës.

Natën që erdhi në shtëpi, a e dinit se ai e përfundoi dënimin dhe se do të kthehej, apo ishte e papritur për ju?

Menduhije Pojani: Babai, kreu katërmëdhjetë vite burg.

“Në Spaç mezi shkonim një herë në vit. Nuk dinim, çfarë kishte ndodhur më 21 maj. Na thanë që babai, s’ishte aty. Asnjë informacion. Gjithandej, dyer të mbyllura. Asnjë derë nuk na hapej.”

A ju lajmëroi dikush, apo i kishit llogaritur vetë ditët dhe e dinit që atë ditë, do të lirohej? Si erdhi babai, që nga burgu? E sollën me ndonjë makinë, apo i gjeti vetë mjetet e transportit?

Menduhije Pojani: Ne i kishim llogaritur ditët dhe e dinim se do të dilte në atë ditë. Babai erdhi vetë. Ne dolëm e pritëm atje, te treni, por frikën e kishim...

A e keni harruar momentin e ardhjes së babait në shtëpi, për shkak të këtyre frikërave, apo jo?

Menduhije Pojani: Jo, jo, nuk e kam harruar, por frikën e kishim. Babai sapo na erdhi në shtëpi dhe parapë ishim të trembur, se mos e arrestonin sërish. Kujtoj që, kur babai ishte në burg, kishim dy kushërinj të tij që jetonin në Gradishtë dhe kur shkoja atje, kisha një ndjesi më të paqtë me veten. Shikoja që kisha njerëz rreth vetes me të cilët unë mund të flisja lirshëm, kurse aty ku banonim ne ishim fare vetëm, nuk kishim askënd me të cilin të flisnim. I vetmi avantazh që kishim, ishte që ne si fëmijë e kishim shkollën afër shtëpisë. Me gjithë ato siklete që kishte, mamaja ime e konsideronte babain si idhull. Kam ndër mend skenat e përgatitjes së gjërave që çonim në burg ose kur nisnim pako. Halla ime që rriste nja tre-katër pula, gatuante ndonjë prej tyre, përgatiste edhe një si kulaç dhe e sillte për t’ia çuar vëllait të saj. Ne ishim të vegjël dhe vëllezërit kërkonin të provonin ndonjë gjë prej gatimeve: - O ma, o ma! Po unë, o ma, po unë? Shihja sesi ajo, nga një anë, donte t’u plotësonte fëmijëve dëshirën, duke u dhënë nga një çikëz dhe, nga ana tjetër, kujdesej të mos pakësonte sasinë që do t’ia çonte burrit në burg. Shpesh na thoshte: “Prisni, se kjo është për babain, kurse për ju do të përgatis një tjetër”.

Këto skena më kanë shoqëruar gjithë jetën. Kjo është ajo që na bëri komunizmi. Nuk kishim asgjë tjetër. As lekë burgu, absolutisht nuk kemi marrë gjë...

A arriti babai të gëzohet prej jush si fëmijë, prej familjes?

Menduhije Pojani: Po, e arriti atë ditë. Në vitin 1990 unë mbarova shkollën në Elbasan, pa

shkëputje nga puna. Dhe në vitin 1991 fillova punë si edukatore atje. Pastaj, po në atë kohë, u bë edhe fejesa ime dhe më pas u martova. Motra vazhdoi studimet për drejtësi në Tiranë dhe filloi punë në gjykatën e Tiranës, si ndihmësgjyqtare. Vëllai mbaroi për gazetari, mirëpo persekutimi përsëri vazhdoi. Unë kam shkuar disa herë në Elbasan për të filluar punë në arsim.

Në seksionin e arsimit më kërkoni të lija numrin e telefonit. Prisja, por asnjëherë nuk më morën. Punova si zëvendësuese disa kohë dhe pas lindjes së fëmijëve, shkova prapë që të kërkoja, por nuk kisha mundësi që të shkoja e të rrija atje çdo ditë.

Babai juaj, punoi në shoqatën e të përndjekurve, në Lushnjë?

Menduhije Pojani: Po.

Po me gjyshin tuaj, çfarë ndodhi? A arritët të takoheshit, ndonjëherë? Kur është ndarë nga jeta, gjyshi juaj?

Menduhije: Asnjëherë nuk u takuam dot, prandaj gjyshin nuk e kujtoj mirë. Mund të jetë ndarë nga jeta, para viteve '80, kur babai ishte ende në burg. Edhe xhaxhai vdiq.

A keni ende të afërm, në SHBA?

Menduhije Pojani: Sot unë kam motrën në SHBA. Motra që punonte në gjykatë, nuk bënte kompromise me gjyqtarët dhe për këtë arsye e hoqën nga puna. Atëherë, ajo aplikoi për të nxjerrë licencën për avokate, por njëherësh aplikoi edhe për lotarinë amerikane. Ishte përpara dy zgjedhjeve dhe vendosi që cila nga këto do të dilte e para, atë rrugë do të ndiqte.

Nga gjyshi që ishte arratisur në SHBA, a keni ndonjë lloj trashëgimie ose sende të ruajtura, libra, korrespondencë?

Menduhije Pojani: Absolutisht asgjë, nuk na ka mbetur. Gjyshi përfundoi në një shtëpi pleqsh.

Po me mamanë tuaj, çfarë ndodhi? Pas gjithë atyre viteve vuajtje, a arriti të gëzojë bashkimin me bashkëshortin e saj?

Menduhije Pojani: Mamaja ime vdiq 62 vjeçe dhe babai ngeli vetëm.

A ju ka treguar babai, për vuajtjet që ka kaluar?

Menduhije Pojani: Një nga torturuesit e babait tim ka qenë Mehdi Bushati. Dy herë në hetuesi dhe të dy herët, babai ka pasur atë si hetues, edhe në hetuesinë e parë, por edhe pas revoltës së Spaçit, prapë atë ka pasur dhe nga torturat i kishte mbetur një dëmtim shumë i madh në kockën e këmbës. Babai e ka përmendur Bushatin si njeriun që i kishte bërë shumë tortura. Kur ishte i dënuar, babai ka punuar edhe në Valias, edhe në kënetën e Maliqit, kudo ku kanë qenë kampet e të burgosurve.


Çfarë ju ka treguar baba, për revoltën në burgun e Spaçit?

Menduhije Pojani: -Babai tregonte që, sa i përket masave kundër revoltës, të gjitha ishin të programuara. Babai nuk ishte pjesë e revoltës, sepse ishte në turnin e punës. Kur u kthyen këta, revolta kishte shpërthyer, mirëpo ata vetëm pse ishte ai që ishte, vendosën ta dënonin. Megjithëse babai kishte qenë në punë në galeri, në kohën që gjithçka kishte ndodhur.

Po fëmijëve a ua keni transmetuar këtë pjesë të dhimbshme të historisë, që ajo të ruhet ndër breza?

Menduhije Pojani: Kur fituan komunistët, këta që kishin qenë në Francë, me Enver Hoxhën dhe e njihnin mirë, para se të largoheshin si kundërshtarë politikë, paralajmëruan të afërmit e tyre dhe u thanë: "Ne nuk kemi çfarë t'u bëjmë më, por këta do të hanë kokat me njëri-tjetrin, se kjo ideologji e tillë është. Populli do ta kuptojë ç'është komunizmi, pasi ta pësojë në kurriz".

Unë nuk i harroj fjalët e gjyshes time, gjithmonë i kujtoj, edhe ua them edhe fëmijëve të mi. Koha ecën, çdo gjë ndryshon, por unë për çdo gjë fajësoj komunizmin edhe Enver Hoxhën, për çdo gjë që ndodh këtu, për çdo sjellje të shëmtuar, vetëm atij i drejtoj gishtin, se prishi kishat, xhamitë, prishi njeriun. Ka njerëz që mendojnë ndryshe. Është e drejtë e tyre, por unë kështu e mendoj dhe prapë e shoh se ata janë të fuqishëm, e drejtojnë këtë vend.



“Fjala Spaç, nuk ishte vetëm thjesht godina, vendi, fjala Spaç edhe për ne ishte ferri!”

Dëshmi nga Ioann Çeli
(I biri i Njazi Petro Çela)

Petro Çela,³⁷ i biri i Uranisë dhe Naumit, me detyrë oficer, i cili në vitin 1986, një vit pas vdekjes së diktatorit, kur ishte 54 vjeç, së bashku me të tjerë, një grup prej shtatë vetësh, u akuzuan për veprimtari armiqësore. Petro Çela u arrestua në 14 gusht 1986. Gjatë hetimeve në Burgun 313, iu nënshtrua torturave ku pësoi një infarkt miokardi, pasi qëndroi i mbyllur në një arkivol kapakun e të cilit, ia mbërthyen me gozhdë. Në qershor 1987, doli në gjyq dhe u dënua 7 vjet. Një pjesë të dënimit, e vuajti në Spaç. Për shkak të torturave, që dëmtuan rëndë shëndetin e tij, Petro Çela u nda nga jeta, në vitin 1996.

Ioann Çeli: Babai im quhej Petro Çela. Është arrestuar më 14 gusht 1986. Ka dalë në gjyq në qershor të vitit 1987. Babai u dënua 7 vjet nga 10 vjet që ishte pretenca. Për periudhën e hetuesisë, ka qenë në burgun “313” në Tiranë, kurse mbas gjyqit ka qenë te “kaushi” i Tiranës, nga ku u

transferua për në Spaç, ku kreu pjesën tjetër të dënimit. Në fund të dënimit ka qenë në Shën Vasil të Sarandës.

A keni shkuar në ato vite në takim me babain tuaj dhe si kanë qenë përshtypjet tuaja?

Ioann Çeli: Një fëmijë gjashtëmbëdhjetë vjeçar, që ka takimin e parë me babain e vet, në kushte komplet ndryshe, me mjekër e flokë të qethura, veshur keq, të shpërftyruar në fytyrë, që dridhej. Takimi i parë ishte gjatë periudhës së hetuesisë. Mesa duket e përdorën si presion ndaj tij, duke i nxjerrë përpara fëmijën. Babai kishte nëntë muaj në hetuesi, te burgu 313, kati i dytë. Te dhoma e pyetjeve, që duhet të jetë akoma besoj, kishte tavolina të ngulura në beton dhe dy karrige te ngulura në beton. Im atë kishte kaluar disa peripeci nëpër spitalet e burgut dhe kishte

37. I ati i z. Ioann Çeli ka mbiemrin Çela, verifikuar sipas dosjes, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, Dosje Hetimore-gjyqësore nr. 16207, Vendim i Gjykatës së Rrethit Durrës, Kolegji Ushtarak, Nr.16 i aktit, Nr. Vendimit 16, data 22.06.1987 si edhe Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Ushtarak, nr. 70 i Regj. Themeltar, nr. 78 i Vendimit, data 22.07.1987, Arkivi i AIDSSH-së.

kërkuar të shikonte nëse ne të familjes ishin mirë apo jo. Kishte dy hetues. Njëri prej tyre pati fat të mirë dhe vazhdoi karrierën si gjyqtar në gjykatën e apelit të krimeve të rënda. Sot nuk rron më. Tjetri u bë avokat dhe është akoma sot avokat, në profesion.

A mbani mend, nëse ju thërrisnin në takim, apo kërkonit ju që të shkonit?

Ioann Çeli: Në burgun e Tiranës, një herë në pesëmbëdhjetë ditë kishte takim me familjarët. Në takim çonim vetëm ushqime: një kg sheqer, një bukë, tesha dhe biskota dhjetë lekëshe. Kaq ishte.

Si ndodhi që ju, megjithëse ishit fëmijë i mitur, ju lejuan të hynit brenda, deri te dhoma në katin e dytë, që na e përshkruat?

Ioann Çeli: Jo. Ishte dita që do të lija ushqimet. Në atë moment, nuk i pranuan ushqimet. Oficeri i policisë, që ishte te paradhoma me një dritare të vogël, më tha që të prisja, se me mua kishin punë. Unë zakonisht shkoja në mëngjes. Nga ora dhjetë deri në orën dymbëdhjetë ose trembëdhjetë mbaroja punë. Vinte oficeri, në bazë të kërkesave që ne bënim, pyeste “Për filanin, kush ka sjellë?”, merrte sheqerin, biskotat, bukën dhe ndonjë teshë dhe pastaj ikje.

Mua nuk më morën asnjë nga ushqimet dhe më thanë: “Ti do të rrish të presësh, deri sa të të themi ne”. Nga ora gjashtëmbëdhjetë pasdite, isha unë edhe më duket se ishin edhe fëmijët e njërit nga anëtarët e grupit të tim eti. Në fillim u futën ata. U vonuan nja një orë dhe ikën. Unë ende prisja. Erdhi një moment që pyeta: “Hej, më keni harruar këtu?” U tremba, se ishte edhe errësirë. Prapë më thanë, se do të prisja edhe ca. Mund të ketë qenë ora 19:30, kur më thirrën lart. Më bënë disa pyetje që s’i kuptoja.

Filluan: - Si quhesh? Po babai? Gjyshi? Xhaxhai? Në cilën shkollë je? Çfarë mësimesh bën?

Dhe ndërsa më pyeste diçka për shkollën, si: - Me sport, a merresh? - Pyeste edhe: - Po filanin, e njuh? Çfarë e ke?. I thoja p.sh.: - X-in s’e njoh. Vazhdonin: - Po këtë e njuh? Këtë shokun e babait? Ua ktheja: - Jo, nuk e njoh.

A ju kanë pyetur se cili nga shokët e babait, ju vinte në shtëpi? Kërkonin që ju si fëmijë, të nxirrnit ndonjë emër?

Ioann Çeli: - Po. Babai im ishte me të tjerë, një grup prej shtatë vetësh, që u akuzuan për agjitacion dhe propagandë. Të paktën për pesë nga këta, mbaj mend që kishte shumë fotografi, kurse të tjerët nuk i njihja. Madje, më pyetën edhe çfarë dija unë për Rrahman Parllakun.

Im atë, gjatë periudhës së diktaturës, kishte punuar me Rrahman Parllakun dhe mendohet se, qysh më parë deri sa u arrestua, ka qenë në survejim. Kur im atë doli nga burgu, pasi kreu dënimin, përpara se të ndërronte jetë, thoshte që në prokurori i kishin thënë që duhej të kishte qenë më i kujdesshëm, sepse qysh nga viti 1974 e më pas kishte qenë nën survejim. Po si mund t’u përgjigjej atyre pyetjeve, një fëmijë gjashtëmbëdhjetë vjeç? Pyesnin: “Shikonit televizor tek italianin, apo jugosllavi?”

Babai u dënua veç apo bashkë me grupin dhe nga sa vite u dënuan?

Ioann Çeli: Dënimet e të gjithë grupit, mesatarisht ishin nga 10, 8, 7 vjet.

Pas dënimit, ku e dërguan babanë tuaj?

Ioann Çeli: Në Spaç... Besoj se ka punuar në minierë, por ai nuk thoshte asnjëherë që punoj, nuk donte të na tregonte. Këtë e kuptova rastësisht. Zakonisht, ne dërgonim telegram kur caktonim ditën e takimit. Një ditë u nisëm në takim. Rastësisht, na doli përpara një kamion që shkonte për në Shkodër dhe do të ndalte te kthesa e Shpalit, në Mirditë. Nga aty e kishim kollaj: Nga Shpali për në Repe dhe pastaj për në Spaç. Nga Repe për në Spaç e kam bërë gjithmonë në këmbë, me ngarkesë dhe fiks duheshin pesëdhjetë e pesë minuta, me ato torbat e asaj periudhe që kanë pasur ca rripa të hollë prej cope, që vareshin te shpatullat dhe që të shkaktonin dhimbje. Gjithmonë kam qenë i shoqëruar me një nga xhaxhallarët e mi dhe në këtë rastin që shkova në burgun e Spaçit pa lajmërim, e kuptova që im atë u vonua në takim. Erdhi një nga ushtarët që tha: “Prit të mbarojë turnin, pastaj do të dalë”. Kur e takuam, e pyetëm

“Nuk e di çfarë propagande ishte bërë në kokën e ushtarëve lidhur me ne, armiqtë, që na drejtonin gjithmonë automatikun.”

se ku ishte dhe na u përgjigj që kishte ndihmuar një shok e prandaj ishte vonuar pak, domethënë nuk e pranonte asnjëherë që ishte në punë ose nuk donte të na e tregonte neve.

Sa vjet burg, bëri babai juaj?

Ioann Çeli: Ka bërë katër vite e ca. U lirua, me dekretin e vitit 1990.

A e mbani mend si ndodhi lirimi? Si u kthye në shtëpi babai? A shkuat ju për ta marrë?

Ioann Çeli: Periudha e lirit besoj që ka qenë me dekret të Ramiz Alisë. Në dhjetor të vitit 1990 ka dalë im atë. Kur ka ardhur në shtëpi, ne nuk e prisnim fare, sepse në atë periudhë ishte zhvendosur në burgun në Shën Vasil, në Sarandë.

Le të rikthehemi te fillimet e ngjarjeve. Çfarë ndodhi me familjen tuaj, pasi u arrestua babai?

Ioann Çeli: Këtu fillon historia. Motrën e madhe, që ishte studente në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë në Universitetin e Tiranës, e përjashtuan nga

shkolla. Motra e dytë, të cilës atë vit i kishte dalë e drejta e studimit për infermieri, nuk shkoi. Mamaja punonte në rrobaqepësi dhe nuk e lëvizën nga puna.

Të gjithë familjarët e mi, si xhaxhallarët, kushdo që pati një pozicion të caktuar, i lëvizën: njërin që ishte inxhinier e dërguan në prodhim, tjetrin që ishte mekanik në flotë, e dërguan në peshkim. Këto ishin lëvizjet e brezit të parë.

Ne e kishim shtëpinë në bulevard dhe, nga dritarja, shikonim që kishte njerëz që shikonin drejt ballkonit tonë. Ne nuk e dinim për çfarë. Shokët e pallatit tim që rrinin poshtë, vinin e më thonin që një xhaxhi me gruan e vet, po thonin për shtëpinë tonë “kjo duhet të jetë shtëpia”...

Mos bëhej fjalë për t'ju larguar edhe juve nga shtëpia, megjithëse ishte viti 1986?

Ioann Çeli: Po, tani kuptohet, por atëherë, kur shikoje persona civilë, nuk ngrije dot hipoteza që të thojë: “Po, ka diçka”. Kur shihnim persona të veshur me uniformë ushtarake, që

“Zhgënjimi ishte se ai ideal për të cilin u mundua gjatë gjithë jetës, ajo gjë për të cilën ai punoi, iu kthye kundër...”



qëndronin me minuta përpara ballkonit dhe e kuptonim se bëhej fjalë për ne, aty fillonte gjithë vuajtja psikologjike, nisnin pyetjet: “A do të na heqin, nga këtu? Ku do të na çojnë? Çfarë do të bëhet?”

A ju lëvizën nga shtëpia?

Ioann Çeli: - Jo, ne nuk na lëvizën. Nuk e di pse, por ishim me fat, me shumë fat. Me këtë rast mësuam edhe sesa hipokritë ishin njerëzit. Një pjesë që nuk na flisnin rrugës dhe na shmangeshin dhe të tjerë, që pasi im atë u dënua, vijuan të sillen njësoj si më parë, kur nuk ishte i dënuar.

Ju keni qenë në shkollë, kur iu është arrestuar babai. A pati ndryshime në qëndrimet e mësuesve dhe të shokëve, ndaj jush?

Ioann Çeli: Unë kam qenë në gjimnaz. Në fillim, kur ndodhi ngjarja, njerëzit nuk shpreheshin, sepse u bë edhe një bujë të madhe, ngaqë ishin shtatë ushtarakë. Qarkullonte një version që këta të shtatë do të bënin një vepër armiqësore: do të godisnin me top vilën e shokut Enver dhe që

këta propagandonin e mbillnin urrejtje kundër pushtetit popullor. Qarkullonte edhe thashethemi që këta do të pushkatoheshin të gjithë. Në këto kushte, as nuk të shkonte mendja fare sesi reagonin mësuesit. Fundja, për ata mund të ketë qenë më e thjeshtë të mendonin që ky djalë sot është, nesër nuk është më këtu...

A keni ndier ndonjë trajtim ndryshe, ngaqë babai juaj, sipas akuzës, mbetej të ishte armik i popullit?

Ioann Çeli: Jo, jo nuk më shikonin me sy diferencues, por shikoja që kishin keqardhje ndaj meje. I vetmi ndryshim në shkollë ishte që më vëzhgonin, të mos mbaja këmishën jashtë, se quhej shfaqje e huaj, flokët nuk duhet t'i mbaja të krehur sipas modës...

Për këto kishit marrë sugjerim nga familja, nga shkolla, apo vetë u treguat më i kujdesshëm?

Ioann Çela: Mua më thanë në familje, por familjarëve u kishin thënë se që nga ky moment e mbrapa duhej të kishim kujdes edhe mënyrën se si flisnim, edhe me kë rrinin, edhe si visheshim, sepse meqë mamaja ishte rrobaqepëse, ne kishim mundësi të qepnim diçka ndryshe nga të tjerët. Kështu që edhe unë duhej të isha si gjithë të tjerët. Për këtë u detyruam në atë periudhë. Gjithashtu edhe të ardhurat na u kufizuan. Mamaja punonte natën në shtëpi, fshehur, qepte ndonjë fustan për gratë, ndonjë pallto. Mundoheshim të mos bënim zhurmë, por makina qepëse bënte shumë zhurmë. Komshinjtë dëgjonin shumë mirë që punohej, por asnjë nga ata nuk u ankua asnjëherë.

A keni ndonjë kujtim sesi ka ardhur nga Shën Vasili, në çfarë makine hipi, a ishte i lodhur?

Ioann Çeli: Dekreti ishte lexuar dhe ne prisnim, por nuk e dinim se kush do të dilte. Një ditë në mëngjes, kur unë kisha dalë nga shtëpia, më lajmëruan komshinjtë të kthehesha në shtëpi, se më kishte ardhur babai e po priste te shtëpia... Mua më kishte ardhur njoftimi që duhet të shkoja ushtar, sepse e kisha mbaruar gjimnazin, por nuk mund të shkoja ushtar pa më dalë babai nga burgu. Ishte edhe koha që shumë nga brezi ynë

donin të arratiseshin...Kur u ktheva në shtëpi, e gjeta aty babanë. Kishte ardhur nga Shën Vasili me një makinë të rastit deri në Vlorë, pastaj deri në Fier, me një makinë tjetër, pastaj nuk e mbaj mend... Babai kishte frikë a do të na gjente apo jo në të njëjtën shtëpi. Mendonte që neve mund të na kishin lëvizur nga shtëpia dhe ne mund t'ia kishim fshehur këtë gjë për të mos e mërzhitur e për të mos e ngarkuar, meqë atij i binte pesha e përgjegjësisë për këto ngjarje...

A ju ka treguar babai, rreth jetës në burg?

Ioann Çeli: Im atë ka qenë tip studios, mbante shënime. Ka mbajtur shënime kudo ku mund të mbante shënime...

A ju ka treguar për dhunën që është ushtruar ndaj tij?

Ioann Çeli: Ka qenë një rast konkret që ne e dimë qoftë nga ai, qoftë nga ish-të dënuarit në burgun 313, në Tiranë. Çfarë metodologjie është përdorur ndaj tyre nuk e di, por dy nga këta persona ish-ushtarakë humbën memorien dhe në sallën e gjyqit nuk njihnin fare as familjarët e tyre. Tim atë, gjatë periudhës së hetuesisë, e kanë vendosur brenda në një arkivol, që e kanë gozhuar. Këtë e morëm vesh, gjatë periudhës kur shkonim për takim, te burgu 313 në Tiranë, kur na thanë që atë javë nuk do ta takonim dot dhe as javën tjetër. Dikush erdhi në shtëpi, takoi xhaxhain edhe i tha që babai ishte në spitalin e burgut, se kishte kaluar infarkt.

Nga ai moment, ne shkuam në spital për takim. Ishte edhe gjyshja, mamaja, motrat e mia, xhaxhallarët. E nxorën me shumë vonesë. Babai ecte shumë avash. Ishte skenë shumë e keqe. Hera e parë që e shikoja babain ashtu. Në fillim fare, nuk e njoha, vetëm zërin edhe vështrimin e syve. Ishte tretur. Aty na tha që kishte kaluar një infarkt, që e kishin dhunuar, torturuar. Polici që ishte pranë, na thoshte se e kishte nga ilaçet, që fliste kot. Nuk e harroj atë skenë. Më trembi shumë.

Kur doli nga burgu, mbas shumë vitesh, kur e pyetëm si ishte puna që kaloi infarkt, se kishim dëgjuar edhe nga të tjerët, atëherë na tregoi që gjatë hetuesisë e kishin futur në një arkivol dhe e kishin mbyllur brenda, duke e gozhuar,

që të pranonte atë që ata kërkonin. Kur erdhi demokracia, babai na tha që ai ishte përgjegjës për të gjetur të drejtën dhe prandaj do të merrej vetë me ata, sepse e dinte kush ia kishte bërë dhe pse ia kishte bërë. Donte t'i sqaronte vetë gjërat. Babai ishte në shoqatën e të përndjekurve politikë, në Durrës. Kishte mundësinë që t'i luftonte edhe nga ana morale, por nuk e bëri...

Njëherë ka ardhur një ushtarak në shtëpinë tonë për takim, një komandant që kishte qenë në Spaç. Unë mund të kem qenë nja 22 vjeç. E pashë si çudi: "Çfarë donte ky, që takonte babain?" Babai më tha që ai njeri, kishte qenë komandanti i tij në burgun Spaçit. Kur unë e pyeta sesi ai kishte ardhur për ta takuar, babai m'u përgjigj që ai ishte sjellë mirë me të. Nuk e di, ndoshta ai kërkoi diçka. Di që kishte mbledhur tim atë dhe disa të tjerë aty, në një lokal dhe ndoshta u ka kërkuar të falur.

Pasi doli nga burgu, a ka takuar babai ndonjë nga anëtarët e tjerë të grupit?

Ioann Çeli: Po, ka pasur lidhje me dy prej tyre. Të tjerët janë larguar. Me këta të dy ka pasur marrëdhënie.

Sa vjeç ishte baba, kur doli nga burgu?

Ioann Çeli: Ishte 58 vjeç.

Si e siguronte jetesën më pas?

Ioann Çeli: Me pensionin që merrte... Babai u aktivizua me shoqatën e të përndjekurve politikë dhe me një parti të djathtë të asaj kohe.

A keni shkuar ndonjëherë personalisht, në Spaç?

Ioann Çeli: Po, shumë herë...

Çfarë ndjesie keni pasur, duke kaluar nëpër ato oborre? A e keni imagjinuar babain atje, si viktimë e sistemit?

Ioann Çeli: Fjala Spaç nuk ishte vetëm thjesht, godina, vendi. Fjala Spaç edhe për ne ishte ferri: fillonte qysh një javë para se të shkonim në takim. Kemi pasur të drejtën për një takim në muaj dhe për pako me ushqime, dy herë në muaj. Një

herë në muaj i dërgonim ushqimet me postë dhe një herë në muaj, shkonim vetë edhe çonim edhe ushqimet. Kalvari i Spaçit, fillonte qysh kur niseshim për në Spaç. Problem ishte me çfarë të shkoje. Duhej të niseshim që herët dhe të dilnim te kodrat e Rrashbullit në Durrës e atje të gjenim makinat që shkonin për në Fushë-Krujë. Nëse nuk ishte atje deri në orën 8:30 ose 9 të mëngjesit, nuk mund të gjeje më mjete për të shkuar për në Spaç.

Kur shkoje për të kërkuar mjete, nuk duhej asnjëherë t'u thoshe që po shkoje për në burg të Spaçit, por sikur do të shkoje për në Shkodër ose për në Pukë, sepse makinat brenda kishin tre vende dhe shoferi nuk merrte dikë që shkonte për në kampin e të dënuarave politikë përpara dikujt tjetër, që do të shkonte për në spital ose që kthehej për në shtëpinë e vet. Ne ishim edhe të ngarkuar me çanta.

Deri te kthesa e Shpalit, duhej të ndërronim tri apo katër makina. Në pjesën më të madhe të kohës, na duhej të hipnim sipër në karrocieri dhe ta quanim fat që ishim mes dymbëdhjetë, apo katërbëdhjetë vetësh atje sipër, në këmbë. Nëpër kthesa duhet të kapeshim kryq, për të mos rënë. Frynte erë, binte shi, ishte me fat që ishte në makinë që mund të arrije sa më parë atje.

Rruga për në Spaç ishte kalvar më vete. Fillonte persekutimi dhe urrejtja e pasqyruar nga sjellja e njerëzve dhe e shoferëve gjatë rrugës. Nuk të merrnin në kamion, pa u plotësuar vendet me persona te tjerë. Kjo sjellje arrinte pikën më të keqe, kur prioritet u jepnin personave të cilët shkonin në burgun e Spaçit për të dënuarit ordinerë. Vetëm pastaj, po të kishte vend, hipnim ne që shkonim tek të dënuarit politikë.

Njëherë, nga lodhja, i thashë xhaxhait që të thoshim edhe ne sikur, gjoja po shkonim te të dënuarit ordinerë. "Të ikim, se ngelëm këtu në Rubik. – Jo, - më tha xhaxhai. – Ta di se në këmbë shkojmë edhe për dy ditë dhe nuk pranoj të them që im vëlla është i dënuar ordiner".

Kur mbërrije në Shpal, duhej gjetur mjet nga Shpali për në Repe. Po pastaj, me çfarë do të shkoje nga Repe, në Spaç? Kalvar. Dukej

sikur Spaçi ishte afër, por vetëm kur ecje, e shikoje. Edhe ngarkuar me ushqime. Kur mbërrije tek kampi i Spaçit, ishin dy kolibe të ndërtuara një majtas e një djathtas. Në kohë dimri, tek ajo majtas ndizej zjarri, kurse djathtas nuk ndizej zjarr. Kolibja majtas, në Spaç, ishte për të afërmit e të dënuarave politikë. Kur isha fëmijë i vogël, u thoshte xhaxhai:

- A mund të vijë ky, fëmija i vogël, të ngrohet, se është ftohtë? Përgjigjja ishte: - Jo!

Më tej, ishte faza tjetër. Afroheshe tek ushtari dhe duhet të shtypje një lloj butoni, që i binte ziles. Afrohej ushtari. Duhej të kishe se s'bën telegramin me njoftimin, përndryshe duhej të prisje. Pas gjithë peripecive, duhej të prisnim sa të vinte im atë që nga përroi, siç thonin ata. Ishte një distancë e largët. Kur hapej dera dhe më në fund hynim, na bëhej një kontroll fizik i trupit.

Mbaj mend njëherë që pashë sipër, në krah të djathtë, një ushtar me automatik në dorë dhe disa të tjerë të rinj që rrinin gati. Nuk e di çfarë propagande ishte bërë në kokën e tyre lidhur me ne, armiqtë, që e mbanin gjithmonë drejt automatikun. Pasi mbaronte kontrolli fizik, na pyesnin se çfarë kishim çuar.

Ushqimet kalonin në katin e parë. Poshtë, para derës, para traut të dytë, nga krahu i djathtë qëllonte gjithmonë një oficer i burgut, ezmer, i thatë. Nga dialekti dukej se ishte nga Shqipëria e mesme.

Nuk e harroj asnjëherë, kur kam shkuar herën e parë. Gjyshja kishte bërë byrek me spinaq, si për djalin e vet. Oficeri e mori byrekun e bëri kadaif, duke e kontrolluar, po ashtu edhe ushqimet e tjera. Sheqerin e hidhte në një qese edhe e kalonte nëpër gishta si në sitë, se mos kishte ndonjë letër. Bukës i ngulte diçka ose e hapte dhe e bënte gati, si për papare ose trahana. Cigaret nuk i pranonte nëse paketa ishte e hapur, duhet të ishte e mbyllur. Atëherë e hapte, duke numëruar deri në 100, i hidhte cigaret, pjesën tjetër e kthente mbrapsht...

Kur vinte babai, kalonte nga një dhomë e ndarë me hekura në mes, për tek një dhomë e vogël që ishte në krah të majtë. Babai rrinte brenda hekurave, ne rrinim nga jashtë

Sa minuta ishte takimi?

Ioann Çeli: Ishte 15 minuta, por të paktën neve na dhanë mundësinë që para se të futej te dhoma, babai të na takonte jashtë, të na puthte e përqafohte.

Si e keni përjetuar takimin me babain, po babai vetë?

Ioann Çeli: Ai qante. I mbusheshin sytë me lot. Unë të them të vërtetën, nuk qaja dot. Gjithmonë shkoja i shoqëruar nga xhaxhallarët. Mamaja dhe gjyshja kanë shkuar dy herë me taksì. Për taksinë që e merrnin nga Durrësi deri në Spaç, duhet të gjenin një justifikim, gjoja se po shkonin në Shkodër ose diku tjetër, se ndryshe nuk merrnin dot autorizimin për ta marrë.

Periodha e burgut të babait tuaj zgjati rreth pesë vjet. A ruani diçka nga ato vite, letra, artefakte, dëshmi të vuajtjeve në burg?

Ioann Çeli: Letra, nuk para dërgonte im atë. Nuk e di pse nuk dërgonte. Për Vit të Ri na ka dërguar një letër. Ndoshta ngaqë ne shkonim shpesh, kështu që nuk ishte ajo ndjesia e letrave. Kishte ruajtur një kokore nga burgu i Spaçit dhe vonë-vonë, para se të ndërronte jetë im atë, unë me shumë ngulm i kërkova që ta zhdukte atë kokore. Ai e donte. Thoshte që i kishte shpëtuar kokën, e mbante ngrohtë, kurse mua me atë kokore më sillte shumë kujtime të trishta! Ishte një kokore nga ato të minatorëve të lindjes, jo me plush nga brenda, por me një beze, një kokore pune, që të jepte bezdi. Nuk kam parë ndonjëherë, kokore më të shëmtuar se ajo!

Babai juaj, ka ndërruar jetë?

Ioann Çeli: Po, ka ndërruar jetë, në vitin 1996.

Si i kaloi ditët e fundit?

Ioann Çeli: Keqardhje kishte për ne, sepse në atë periudhë që ishte mosha më delikate, nuk na u krijua mundësia për një shkollim ose për një jetë normale. Edhe zhgënjim kishte, por im atë ishte idealist. Ai ishte komunist. Ne nuk vinim nga shtresa e të përndjekurve. Zhgënjimi ishte se ai ideal për të cilin, babai u mundua gjatë gjithë jetës, ajo gjë për të cilën punoi, iu kthye kundër. Ishte idealist!

“Kur mbërrije në Shpal, duhej gjetur mjet nga Shpali për në Reps. Po pastaj, me çfarë do të shkoje nga Repsi, në Spaç? Kalvar. Dukej sikur Spaçi ishte afër, por vetëm kur ecje, e shikoje.”

Metodologjia

Nga mbledhja e dëshmive tek arkivimi

Ky libër ka në thelb dëshminë gojore, me fokus ish-të dënuarit politikë në kamp-burgun e Spaçit e familjarë të tyre, për të kuptuar përmes tyre mbi jetën e përditshme në burg, punën që duhet të përballonin, kushtet, dinamikat që të çojnë në një revoltë, ecuria e saj, ridënimet e të tjera të dhëna që do t'u vijnë në ndihmë kërkimeve shkencore të mëtejshme.

Mbledhja e dëshmive 'të gjalla' kaloi në disa faza, të cilat do t'i sjellim në vijim:

Kërkimi paraprak

Para se të ndërtohej pyetëtori që do të përdorej për marrjen e dëshmive, u identifikua dhe hulumtua i gjithë dokumentacioni lidhur me kamp-burgun e Spaçit, si dhe u mblodh e gjithë literatura që i referohen këtij kamp-burgu dhe revoltës së zhvilluar në të; u grumbulluan të gjitha të dhënat historike. U përgatit një skedar me të dhëna dhe materiale mbi jetën dhe veprimtarinë e personave që do të merreshin në intervistë.

Për çdo person u përgatit një skedar biografik ku u përfshinë: dokumente të gjetura në arkivin e AIDSSH, dëshmi të dhëna më herët, artikuj gazetalesh, punime dhe materiale të tjera.

Si hap i parë u verifikua baza e të dhënave të AIDSSH, në mënyrë që të evidentoheshin aplikimet e qytetarëve që i përkisnin ish - të burgosurve të kamp-burgut të Spaçit, apo familjarëve të tyre. Pas shfletimit të dokumenteve, u përpilua një listë

në të cilën u përfshinë emrat e atyre që do të intervistoheshin dhe familjarë apo të afërm të tyre. Pas njohjes me dosjen ORV të Spaçit, u hartua një pyetësor me pyetje të pastrukturuara, për një target grup të caktuar të cilët ishin: vuajtës të dënimit në burgun e Spaçit, si edhe një pyetësor me pyetje të pastrukturuara për familjarët e tyre.

Hartimi i pyetësorit

Për hartimin e pyetësorit si fillim u identifikuan çështjet kryesore për të cilat duhej të mblidhej informacion si: përvojat, emocionet dhe refleksionet personale mbi ndodhitë e çdo të burgosuri apo familjari të tyre.

Qëllimi i pyetjeve gjysmë të strukturuar ishte që të inkurajoheshin intervistuesit në mënyrë që të merreshin përgjigje sa më të hollësishme.

Paralelisht u ndërtua edhe një skedë, në mënyrë që i intervistuari të përshkruante llojin e akuzës, kohën e dënimit, sa herë ishte dënuar, vendin ku ishte dënuar dhe lejimin për ta publikuar dëshminë e tij, apo të të afërmit të tij.

Pyetësori u zbatua duke u dhënë intervistuesve kohën dhe hapësirën e nevojshme për të shprehur mendimet dhe përvojat e tyre në raport me historinë personale apo të të afërmeve të tyre, me zhvillimin e një regjistrimi të saktë dhe të plotë të çdo interviste.

Intervistat u zhvilluan në vendin/ qytetin e zgjedhur nga i intervistuari, në AIDSSH, Tiranë, Elbasan, Korçë, Berat, Durrës, Lezhë, Kavajë e Mamurras.

Përmbledhja e dëshmime, vëllimi i parë:

Njëzet dëshmi të transkriptuara janë pjesë e këtij vëllimi të parë. Rendi i ndjekur për vendosjen e tyre është bërë sipas vitit më të hershëm të dënimit, në grupin e parë të mbledhur. Dëshmitë e familjarëve të ish-të dënuarve janë në një kapitull të veçantë.

Nga përgjigjet e pyetësorit nuk është bërë një analizë. Dëshmia është lënë autentike, në mënyrë që të përcillet emocioni i rrëfimit sa më i plotë tek lexuesi. Nga të dhënat në përgjigjet e personave të intervistuar, mund kryqëzohet informacioni duke rrëfyer një kronologji të saktë të mënyrës se si ndodhi revolta, rrëfim i turneve të punës në minierë dhe si vijonte jeta sipas tyre. Në libër janë evidentuar citime të rëndësishme për të forcuar argumentet dhe për të ilustruar dëshmitë e të intervistuarve.

Gjatë intervistave herë-herë fjala kyç është puna e detyruar, e papaguar. Nisur nga kjo u zhvilluan disa tryeza të rrumbullakëta rreth punës së papaguar në minierë dhe fitimit që kishte patur shteti shqiptar i asaj kohe nga ish-të burgosurit politikë.

Përgjatë intervistës me ish-të burgosur politikë, por edhe familjarë të tyre, pasqyrohet se si shkonte në zinxhir persekutimi dhe vuajtjet e familjarëve të tyre. Nisur nga rrëfimet e familjarëve të ish-të dënuarve në kamp-burgun e Spaçit, AIDSSH krijoi dhjetë silueta shoqëruar me emrin e rrëfenjësit në trupin e tyre me një copëz përshkrimi nga historia e tyre, të cilat u vendosën në kilometrin e fundit para se të mbërrihet në kampin burg të Spaçit, pikërisht aty ku nuk mund të vazhdonte rrugën makina e mund të ecej në këmbë për të takuar të afërmin.

Duke ndjekur këtë metodologji, është krijuar një libër i pasur me dëshmi, i cili rrëfen jetën në kampin burg të Spaçit, përjetimet e familjarëve i cili do të ketë vëllim pasues.



Pranga që janë pëdorur në Spaç.
Objekt nga arkivi i ish- të dënuarit politik,
Fatos Lubonja.

Rëndësia e dëshmisë 'së gjallë'

Dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, sikurse studimi dhe hulumtimi në to ka vërtetuar, nuk sjellin të vërtetën e pakontestueshme. Për shkak të natyrës përmes së cilës ky informacion është mbledhur nga ish-Sigurimi, përmes torturash, manipulimesh, të shkruara nën ndikimin e fortë ideologjik të kohës, bën që këto dokumente të lexohen e trajtohen me kujdes dhe plotësohen me burime arkivore të tjera, por edhe me zërin të mbijetuarve të periudhës së diktaturës.

Historia përmes dëshmisë gojore është një mjet i fuqishëm për të mësuar rreth ngjarjeve të së shkuarës e personazheve të saj. Intervistat zbulojnë faktorë personalë, socialë, ekonomikë e kulturorë që ndikojnë në përvojat perspektivën dhe identitetin e një personi apo kulture.

Ajo çfarë e bën të rëndësishme e të pazëvendësueshme dëshminë gojore është elementi njerëzor. Dokumentimi i kujtimeve të dëshmitarëve okularë, duke ruajtur dëshmitë unike dhe autentike të së kaluarës, të cilat do të humbnin nëse nuk kushtohet rëndësia e duhur është i domosdoshëm për ta lexuar e kuptuar të shkuarën në të gjitha dimensionet e saj.

Historia gojore i ka rrënjët në shumë disiplina. Ajo bashkon të gjithë aktorët e kujtesës dhe të së shkuarës. Bëhet pjesë kyçe e historisë së komunitetit, si dhe e kërkimit akademik. Regjistrimi dhe ruajtja e këtyre dëshmive të gjalla bën të mundur ruajtjen e zërit autentik të së kaluarës.

Dëshmia gojore ka një rëndësi të veçantë, sidomos për shoqëritë post-totalitare, ku historia është shtrembëruar dhe instrumentalizuar bazuar në ideologjitë totalitare, siç është rasti i periudhës komuniste në Shqipëri.

Arkivi i dëshmive gojore në AIDSSH

Të gjitha dëshmitë e mbledhura janë bërë pjesë e Arkivit të dëshmive gojore në AIDSSH dhe do të ruhen, përpunohen, rifreskohen dhe aksesohen sipas standardeve të përcaktuara arkivore, për formatin mediatik të përdorur. Përkatësisht janë ruajtur të gjitha regjistrimet audiovizuale, së bashku me transkriptet, të dhënat dhe dokumentacioni që përcakton lejimet/kufizimet e përdorimit, përmbajtjen e intervistës. Çdo intervistë, po ashtu, shoqërohet, nëse ka, me dokumentacion që mund të përfshijë shënime ose deklarata, fotografi ose imazhe.

AIDSSH tashmë zotëron një arkiv të pasur me dëshmi të gjalla e që pasurohet çdo ditë, duke u dhënë vlerë fakteve që na ndihmojnë në ndërtimin e analizës juridike, se si përdorëshin ligjet penale të kohës për të ndëshkuar kundërshtarët politike, duke sjellë kështu një kontribut më shumë në mbështetje të kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar.

Dëshmitë administrohen me kujdes pranë arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe vihen në dispozicion të çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes marrëveshjes së nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH merr përsipër të administrojë dhe ruajë këto regjistrime, me standardin e një arkivi të vyer historik.

Po kështu, një pjesë e madhe e tyre janë zbardhur, redaktuar e botuar në vëllime të dedikuara sipas projekteve për qëllim të të cilëve janë mbledhur. Dëshmitë e gjalla shërbejnë edhe si bazë audiovizuale për Platformën - "Të mësojmë për të shkuarën- burime arsimore të hapura 1944-1991", materiale këto që do t'u vijnë në ndihmë mësuesve të historisë, me qëllim përcjelljen e historisë tek nxënësit e sistemit parauniversitar.

Vendimet gjyqësore mbi të dënuarit e Spaçit

Shpërfaqje e botëkuptimit antiliri shprehjeje

Punoi Jonida Dervishi, Eksperte ligjore pranë AIDSSH

Vendimet gjyqësore të dënimit të të gjithë atyre që vuajtën dënimin në burgun e Spaçit, duke përfshirë edhe vendimet e ridënimit³⁸ ndërsa vuanin një vendim të mëparshëm dënimi në repartin nr. 303, dëshmojnë, sot, për një histori të përmasave ekstreme të kufizimit të lirisë për të menduar e për t'u shprehur, deri në asgjësim tërësor të saj. E bashkë me të, të çdo lirie e të drejte tjetër. Në disa raste edhe asaj për të jetuar. Ajo që duket menjëherë nga dosjet hetimore gjyqësore të atyre që vuajtën dënimin e tyre në

Burgun e Spaçit, është dominimi i dënimeve për veprën e 'agjitacionit dhe propagandës'³⁹. Në rreth 30⁴⁰ vendime dënimi⁴¹, midis viteve 1957-1981, vepra penale e "agjitacionit dhe propagandës" është trajtuar në së paku 20 vendime⁴² e për të janë dhënë rreth 75 dënime⁴³. Prej këtyre, nga 8 vendime gjyqësore⁴⁴, midis viteve 1973-1981, dhënë personave ndaj të cilëve ekzekutohej në Spaç, një vendim i mëparshëm dënimi, të gjitha vendimet përfshijnë veprën e "agjitacionit dhe propagandës" dhe 44 herë të pandehur janë

38. Me termin 'ridënim', për qëllime të këtij studimi, do të kuptohen dënime të personave që ishin ndërkohë duke vuajtur dënimin me burgim në zbatim të vendimeve të mëparshme, duke përfshirë dënimet e reja të të burgosurve të repartit nr. 303 Spaç, në lidhje ose jo me revoltën.

39. Fondi nr.1, hetimor-gjyqësor, AIDSSH.

40. Pa numëruar vendimet e një shkalle më të lartë, që lënë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët, të cilat janë analizuar për qëllime të studimit, por pa u numëruar për efekte të kësaj shifre. Së bashku me këto të fundit, numri total i vendimeve të analizuara, për qëllime të këtij studimi, është 46.

41. Që përfshijnë vendime dënimi që vuheshin nga të dënuarit në Spaç dhe vendime dënimi të reja gjatë kohës që të dënuarit ishin duke vuajtur dënimin në Spaç.

42. Në shumicën e rasteve, një vendim përfshin disa të pandehur.

43. Kjo shifër përfshin rastet kur nga i njëjti vendim, për këtë vepër, janë dënuar disa persona (duke e numëruar individualisht si dënim për secilin) e gjithashtu rastet kur i njëjti person është dënuar për këtë vepër nga vendime të ndryshme, duke e numëruar për secilin dënim të marrë.

44. Fondi nr. 1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2364, vendimi nr. 1, datë 23/5/1973 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2354, vendimi nr. 34, datë 13.07.1973 i Gjykatës së Rrethit Mirditë, lënë në fuqi me vendimin nr.1301, datë 8.9.1973 të Gjykatës së Lartë; fondi nr. 1 hetimor-gjyqësor, dosje nr. 2918, vendimi nr. 4, datë 18.05.1979 i Gjykatës së Lartë; fondi nr. 1, hetimor-gjyqësore dosje nr. 12403, vendimi nr. 46, datë 20.10.1979 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë, fondi nr. 1, hetimor-gjyqësor, dosje nr.11597, Vendimi nr.37, datë 12.09.1980 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë; fondi nr. 1, hetimor-gjyqësor, dosje nr. 12455, vendimi nr. 68, datë 11.11.1981 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë, lënë në fuqi me vendimin nr. 298, datë 5.12.1981 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë; fondi nr. 1, hetimor-gjyqësor, dosje nr.12459, vendimi nr. 49, datë 28.8.1981 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë; fondi nr.1 hetimor-gjyqësor, dosje nr.12465, vendimi nr. 32, datë 02.07.1981 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë.

gjetur fajtorë, kryesisht ose ndër të tjera, edhe për këtë vepër⁴⁵. Njohja me këto vendime hedh dritë mbi një botëkuptim antiliri mendimi dhe shprehjeje, që, në një sistem antiliri, përshkon gjithçka: nga politika penale dhe legjislacioni penal⁴⁶, te masat e ashpra të dënimeve të parashikuara, dhënë për vepra të "agjitacionit e propagandës"⁴⁷; zbatimimi në praktikë, brenda dhe jashtë burgut; mungesa e ndarjes së pushteteve; gjyqësori i politizuar e në vend, se garant i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe forum i vlerësimit objektiv të fakteve, mbrojtës i vijës ideologjike të partisë; vendimet gjyqësore që 'ratifikojnë' asgjësimin e kësaj lire; arsyetimet gjyqësore të njëanshme, të politizuara, jo-objektive, joproportionale, plot indoktrinim ideologjik e patetizëm partiak e botëkuptimor; standardi i të provuarit dhe përcaktimit të fakteve, të cilat, në masë të madhe e më së shumti, konsistojnë në mendime e fjalë; e deri te shproporcionaliteti, në kufijtë e absurdit, në atribuimin e rrezikshmërisë shoqërore autorëve, për vepra të konsumuara me mendime e fjalë.

Pozicionimi dhe njëanshmëria e gjyqësorit shfaqet e qartë në togfjalëshat e kudondodhur "*partia jonë/partisë sonë*" dhe ato për "*mësimi dritëdhënëse nga partia*"⁴⁸, apo "*siç na mëson partia*"⁴⁹. Gjyqësori e konsideron detyrë të vetën "*vigjilencën revolucionare*" dhe "*zhvillimin e luftës së klasave me forcë dhe pa ndërprerje dhe*

lëkundje, deri në fitoren përfundimtare".⁵⁰

Nuk mungojnë dhe shprehje që nxjerrin në pah atë që, *apriori*, gjyqësori e konsideron të drejtë (e rrjedhimisht, të kundërtën të padrejtë) të tilla, si "*ka folur kundër vijës së drejtë marksist-leniniste... Ka folur kundër sistemit tonë demokratik dhe ka thënë se këtu nuk ka liri dhe demokraci*"⁵¹. Apo "*duke qenë armiq të vjetër të partisë, të popullit e të shtetit tonë, njerëz të degjeneruar nga ana politike dhe me tendenca të theksuara armiqësore kundër diktaturës së proletariatit në Shqipëri*".⁵² Ose "*Kanë zhvilluar veprimtari armiqësore, sa të egër aq edhe cinike...; me dashje kundërrevolucionare... kanë mohuar përparimet kolosale që janë bërë në vendin tonë, si në industri, bujqësi dhe degë të tjera të ekonomisë dhe për pasojë, edhe rritjen në një shkallë të paparë, të mirëqenies së masave tona punonjëse*".⁵³

Vendimet dëshmojnë për konsiderimin 'normal' nga regjimi komunist, të absurdit dhe jetësim të tij përmes gjykimeve. Ato duket se shpërfaqin dhe përfaqësojnë një botëkuptim të një regjimi-botëkuptim antiliri mendimi dhe shprehjeje. Që nuk pranon as fare ekzistencë të mendimit ndryshe duke, madje, i atribuuar këtij të fundit rrezikshmëri të lartë. Pasojat në jetët e njerëzve, nga këto procese tërësisht pa garancitë e një procesi të rregullt ligjor për nga këndvështrimi i

45. Vetëm në tri prej këtyre vendimeve (vendimi nr. 1, datë 23/5/1973 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 34, datë 13.07.1973 i Gjykatës së Rrethit Mirditë, lënë në fuqi me vendimin nr.1301, datë 8.9.1973 të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 4, datë 18.05.1979 i Gjykatës së Lartë) krahas veprës së agjitacionit dhe propagandës, të pandehurit dënohen edhe për vepra të tjera. Të tjerët janë ekskluzivisht për veprën e agjitacionit dhe propagandës.

46. Shih nenin 73/1 "agjitacioni dhe propaganda" të Kodit Penal të kohës (sipas viteve të vendimeve të cituara) dhe më pas atë 55/1 "agjitacioni dhe propaganda kundër shtetit...", si dhe veprat e dënimit e parashikuara për vepra të tjera në tërësi.

47. Po aty.

48. Vendimi nr. 76, datë 20.09.1977 i Gjykatës Popullore të Kavajës

49. Po aty.

50. Shih pjesë nga vendimi nr. 76, datë 20.09.1977 i Gjykatës Popullore të Kavajës "*Të pandehurit, duke e shkëputur vëmendjen nga mësimet dritëdhënëse të partisë, u bënë një terren i përshtatshëm për të ushtruar influencë mbeturinat e së kaluarës dhe presioni i madh e gjithanshëm i botës kapitaliste dhe revizioniste... dalëngadalë u bënë njerëz të çthurur dhe me vese të dobëta morale, si: pijanecë, bixhozçinj, matrapazë e vjedhës dhe që dëgjonin radiot e huaja... Por, siç na mëson partia, detyra jonë kryesore është që përpara kësaj domosdoshmërie të mos mbyllim sytë dhe të vëmë në gjumë vigjilencën revolucionare të masave, por të zhvillojmë luftën e klasave me forcë dhe pa ndërprerje e lëkundje deri në fitoren përfundimtare, e cila është në favorin tonë sepse nën udhëheqjen e partisë, në shtetin tonë të diktaturës së proletariatit të gjithë armiqtë kanë përfunduar e do të përfundojnë në banën e të akuzuarve... Të pandehurit e tjerë jo vetëm që i kanë aprovuar këto gënjeshtra të standardit të lartë të jetesës në vendet kapitaliste revizioniste, të trilluara me qëllim armiqësor nga i pandehuri, por i kanë shprehur edhe vetë, duke thënë se jeta jashtë shtetit është më e mirë."*

51. Vendimi nr. 241 datë 31.8.1978 i Gjykatës së Lartë

52. Vendimi nr. 4 datë 18.maj 1979 i Gjykatës së Lartë

53. Fondi: Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje hetimore-gjyqësore nr. 1620

sotëm, konsistojnë në dënime me disa vite burgim, ndonjëherë me ridënime me shumë vite të tjera burgim, krahas dënimeve plotësuese, si dhe në disa raste edhe me vdekje⁵⁴. Këto tregojnë për një regjim që ngre një sistem të tërë për asgjësimin e lirive, mbahet në këmbë përmes asgjësimit të lirisë së fjalës dhe duket se frikën më të madhe e ka pikërisht prej mendimit e fjalës së lirë.

Ilustruese për këtë janë: dispozita penale e agjitacionit e propagandës; numri i lartë i dënimeve e ridënimeve për të; ashpërsia e dënimeve të parashikuara për këtë vepër; arsyetimet gjyqësore me citime të fjalëve a shkrimeve të të pandehurve, së bashku me dënimet e ashpra për mendime e fjalë, duke përfshirë edhe për të drejtën për të shprehur për ndryshim⁵⁵; si dhe ato pjesë të arsyetimeve gjyqësore të mbushura plot pathos ideologjik në mbrojtje të partisë e udhëheqjes e me cilësime e etiketime⁵⁶ joetike, fyese e dehumanizuese për të pandehurit, të papërshtatshme për gjuhë gjyqësori. Këto të fundit, ndër të tjera, pasqyrojnë edhe aspektet botëkuptimore, aftësitë profesionale dhe etikën gjyqësore. Të gjitha këto nxjerrin në pah, përtej së dukshmes e statistikores, në kufijtë e absurdes, halucinantes e deri qesharakes - për nga perspektiva e standardeve të kohës sonë, të të drejtave të njeriut, të procesit të rregullt dhe e konceptimit të realitetit e të vërtetave të pakontestueshme⁵⁷ - atë që duket si një frikë e tmerrshme, gjithnjë prezente, e të gjithëve - edhe vetë gjyqtarëve, nga e vërteta,

mendimi dhe fjala e lirë.

Me një politikë dhe legjislacion penal të ashpër e një gjyqësor të politizuar e mbrojtës të ideologjisë partiake, duket se ato që mendohen, thuhet e shkruhen nga të pandehur, përveçse konsiderohen të mjaftueshme për ta çuar dikë përpara gjyqit dhe dënuar ashpër, nuk i nënshtrohen ndonjë vlerësimi objektiv (a) nëse mund të jenë të vërteta ndonjëse të papëlqyeshme nga udhëheqja, apo (b) në ekziston mundësia reale që përmes mendimeve, komunikimeve të zakonshme, midis të zakonshmeve, jashtë burgut a të burgosurish, në kushte vuajtje dënimi me burgim, fjalëve, shkrimeve, a poezive të arrihen synime, a shkaktohet ndonjë pasojë konkrete në drejtim të "*dobësimi të pushtetit popullor*", "*minimit të pushtetit të partisë dhe popullit*", "*shtrirje veprimtarie armiqësore në drejtime të politikës së jashtme dhe të brendshme*", etj.

Për nga thelbi i vendimeve, duket se standardi i gjykimit në themel është i tillë që realitetin dhe të vërtetën e konsiderohen '*jashtë realitetit*' dhe '*trillime*' dhe e anasjellta. Kështu, gjyqtarët konsiderojnë jashtë realitetit dhe të pavërteta a trillime: çdo fjalë nga të pandehur që flet për jetë më të mirë në vende kapitaliste; për të mirat e pronës private; që nuk njeh, a më keq akoma, mohon ato që gjyqësori i sheh e i njeh, si arritje të mëdha në të gjitha fushat e mirëqenie e lartë;

54. Ndërsa zakonisht dënimet plotësuese janë ato të humbjes së të drejtës elektorale, nuk mungojnë as ato vendime ku krahas dënimit me vdekje me pushkatim, të dënuarit me vdekje i është dhënë edhe dënimi i humbjes së të drejtës elektorale për periudha 5-vjeçare.

55. Shih për shembull "*Si armik konsequent i partisë dhe pushtetit edhe gjatë vuajtjes së dënimit në 303 Spaç ka zhvilluar biseda me karakter armiqësor e duke shprehur për ndryshimin e situatës në vendin tonë...*" (vendimi nr. 46, datë 20.10.1979 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë)

56. Të tilla si "*i shthurur*" "*i deklasar*" "*veprimtari armiqësor sa e egër aq dhe cinik*", "*pijanecë*" "*batakçinj*", "*matrapazë*", "*bixhozçinj*" "*vjedhës*" "*njeri me mjaft çfaqje mikroborgjeze, duke përfshirë këtu edhe qëndrimet e tij liberale, egon e theksuar personale dhe mendjemadhësinë*", "*armik konsequent*", "*me mbeturina mikroborgjeze në ndërgjegje "të degjeneruar nga ana politike"* (shih vendimet: vendimi nr. 30, datë 13.9.1977 i Gjykatës Popullore të Rrethit Korçë, kolegji ushtarak; vendimi nr. 76, datë 20.09.1977 i Gjykatës Popullore të Kavajës; vendimi nr. 46, datë 20.10.1979 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë; vendimi nr. 30 datë 13.9.1977 i Gjykatës Popullore të Rrethit Korçë; fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje hetimore-gjyqësore nr. 1620; vendimi nr. 327 datë 03.08.1978 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 241, datë 31.08.1978, etj.)

57. Me standarde të kohës sonë të të drejtave të njeriut dhe proceseve të rregullta, kuptojmë parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, akteve ndërkombëtare të ratifikuara ndërkombëtare dhe rajonale, duke përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht, por pa u kufizuar, në lidhje me procesin e rregullt ligjor dhe lirinë e shprehjes (shih edhe udhërrëfyesit përkatës https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/guide_art_6_criminal_eng; https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/guide_art_10_eng). Ndërsa, me të vërteta të pakontestueshme për nga perspektiva e sotme, kemi parasysh, faktet e njohura botërisht të tilla, si qenia e Shqipërisë diktaturë në vend se demokraci, prishja e marrëdhënieve me shtete të tjera, kushtet jo të mira ekonomike, varfëria e zbrazja e dyqaneve nga artikujt ushqimor deri në kolapsim të sistemit ekonomik, standardin më të lartë të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të kushteve ekonomike në të njëjtën periudhë në vendet perëndimore.

që tregon me gisht mangësitë e sistemit e të të drejtave dhe lirive; evidenton vuajtjen e popullit a fshatarësisë, prishjen e marrëdhënieve me shtete të tjera, apo mungesën e artikujve ushqimore nëpër dyqane; apo artikulum se sistemi, nuk është demokratik.

Vendimet gjyqësore tregojnë për konsiderim nga gjyqtarët, si të vërtetë dhe brenda realitetit: *arritjet kolosale në të gjitha fushat; mirëqenien e paparë të popullit në sistemin tonë demokratik; mësimet dritëdhënëse nga partia. Ato ekzaltojnë mësimet e partisë e, ngandonjëherë, evidentojnë mundësinë e riedukimit*" dhe të të drejtës për të punuar, që partia u njeh dhe jep edhe "armiqve e familjeve të tyre" ndërsa, në të njëjtën kohë, kërcënojnë edhe me "shpatën e mprehtë" të saj, në varësi të qëndrimit të "armiqve".⁵⁸ Me patetizëm të skajshëm, krahas mësimëve të partisë, gjyqësori nuk ngurron të evokojë edhe popullin dhe nënat shqiptare në ekzaltimet partiake dhe në atribuimin e rrezikshmërisë së veprave dhe autorëve.⁵⁹ Analizat e elementeve të figurave të veprave penale është e mangët. Për elementet e anës objektive, duket se veprimet dhe faktet që shpjen në dënim konsistojnë në mendime e fjalë, që i nënshtrohen vlerësimit mbi bazë pozicionimi ideologjik të gjyqtarëve. Vlerësimi mbi elementet

e anës subjektive, si qëllimet dhe synimet e hiperbolizuara, është jorealiste dhe duket i paarsyeshëm. Elementet, përgjithësisht, provohen me thënie të të pandehurve, bashkëpandehurve dhe dëshmitarëve përpara hetuesisë dhe gjyqit.

Vendimet pasqyrojnë aktakuzat (që janë më të detajuara në përshkrimin dhe analizimin e fakteve). Ato gjithmonë lihen në fuqi, nga gjykatat më të larta. Thjesht, të menduarit dhe folurit ndryshe, apo kundër nga cilido, me cilindo e kudo, siç del qartazi nga këto vendime, barazohet pa ekuivok, me veprimtari armiqësore të denjë për dënimet më të ashpra. Kështu, mund të përfundojë në Spaç nëse veprën e "agjitacionit dhe propagandës" e kishte konsumuar duke lavdëruar jetën në vende kapitaliste, duke u tallur me udhëheqësit, duke mos njohur "fitoret e mëdha të partisë" e duke "ëndërruar për shkuar jashtë shtetit"⁶⁰. Ose duke u shprehur kundër vijës marksist-leniniste, simpatizuar jetën në Perëndim e folur për liri dhe të drejta në këto vende, si dhe duke shfaqur mospëlqim për programet televizive vendase.⁶¹ Mund të ridënoheshe ndërsa vuaje dënimin në Spaç, për veprën e "agjitacionit dhe propagandës" të konsumuar me fjalë që konstatonin prishjen e marrëdhënieve me shtete të tjera, a duke shfaqur mendime personale, mbi

58. Shih për shembull "Partia dhe pushteti popullor u ka dhënë mundësi armiqve të brendshëm dhe familjeve të tyre të punojnë e të riedukohen. Çdo gjë varej e varet nga qëndrimi i tyre. Këtë gjë na ka thënë me kohë edhe partia, por ata në qoftë se do të ngrënë dorën karshi saj, karshi popullit e diktaturës së proletariatit, shpata e saj do të jetë kurdoherë e mprehtë për ta dhe për të gjithë kundërrevolucionarët....." (vendimi nr. 30 datë 13.9.1977 i Gjykatës Popullore të Rrethit Korçë)

59. Shih për shembull "...Një krim nga më të shëmtuarit dhe i ulët që dënohet mjaft rëndë dhe moralisht nga populli ynë e mallkohet nga nënat tona që rritën bijë e bija të denja për mbrojtjen e kufijve të paprekshëm..." (vendimi nr. 94 datë 18.4.1980 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier)

60. Shih për shembull "përmes lavdërimit të jetës në vendet kapitaliste e duke nxirë atë të vendit tonë; ... duke u tallur me udhëheqësit e proletariatit ndërkombëtar e të partisë tonë, duke ngritur lart forcën ushtarake të vendeve të huaja në krahasim me forcat tona ushtarake, duke shprehur keqardhjen për asgjësimin e grupit puçist të B.B. dhe duke shprehur ëndrrat për të shkuar jashtë shtetit e për të bërë qejf nëpër kabare, klube nate e shtëpi publike; duke u shprehur ndaj udhëheqësit me shprehjet më të ulëta, deformuar emrin; duke folur me ngjyrat më të errëta për fitoret e mëdha të partisë dhe të pushtetit tonë popullor, në të gjitha fushat dhe për këtë gjithmonë kanë marrë si shembull vendet kapitaliste" (vendim i Gjykatës Popullore të Kavajës datë 20.09.1977; vendimi nr. 375 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë datë 10.11.1977)

61. Shih për shembull "...me shfaqje mikroborgjeze duke përfshirë edhe qëndrimet e tij liberale, egon e theksuar personale e mendjemadhësinë, nën ndikimin e ideologjisë borgjeze dhe revizioniste; duke zhvilluar biseda të ndryshme me persona ku i është kundërvënë vijës politike marksist-leniniste të partisë sonë; masave të marra prej saj në luftën kundër shfaqjeve të huaja, revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës në vendin tonë, etj.; është shprehur kundër mënyrës së jetesës, duke simpatizuar jetesën në perëndim e në vendet revizioniste dhe duke u shprehur për "të drejtat" dhe "liritë" e pakufizuara që gjoja ekzistojnë në vendet borgjeze dhe revizioniste; edhe përmes barsoletave thellësisht reaksionare që u ka treguar dëshmitarëve; është shprehur kundër programeve televizive duke thënë se janë të dobëta e boshe ..." (vendimi nr. 327 datë 03.08.1978 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë me vendimin 241, datë 31.08.1978)

çfarë mund të ndodhë në këto drejtime⁶²; duke shfaqur mospëlqim për kooperativizimin e duke thënë se përmes pronës private jetohet më mirë, duke u shprehur se në vende kapitaliste ka më shumë bollëk, në diferencë me Shqipërinë, ku njerëzit vuajnë nga të ardhurat e pakta dhe dyqanet janë bosh⁶³; apo duke shprehur mendime mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare në raport me Kosovën, a shfaqur mospëlqim për tufëzimin e bagëtive⁶⁴.

Në vendimet kundër të përfshirëve në atë që njihet dhe përkujtohet si “Revolta e Spaçit”⁶⁵, krahas veprës së “agjitacionit dhe propagandës”, dënimet përfshijnë dhe veprat e “terrorit” dhe “pjesëmarrjes në organizatë kundër pushtetit popullor me qëllim kryerjen e krimit të sabotimit ekonomik”. Ndërsa arsytetime të njëjta, a ngjashme, evidentohen në lidhje me veprën e parë që përgjithësisht “konsumohet” me fjalë dhe parulla, për veprat e tjera të rënda, mungon një analizë e mirëfilltë e secilit element të veprës penale, vlerësim objektiv i fakteve, mjeteve në dispozicion dhe mundësive konkrete të realizimit të qëllimeve të pretenduara.

Analiza e vendimeve gjyqësore ndihmon ta shohësh e vlerësosh gjyqësorin e komunizmit përmes fjalëve të veta.

Gjyqësori, në fjalët e veta, na vjen si pjesë e një sistemi pa ndarje dhe balancim pushtetesh e përgjithësisht, pa balancë; si një gjyqësor i politizuar e mbrojtës i vijës ideologjike të partisë; me shproporcionalitet në arsytetime dhe refrere ideologjike patetike; me mungesë objektiviteti e njëanshmëri të skajshme në gjykim; me mungesë garancish, për të pandehurit e mungesë mbrojtësi; me vlerësime të mangëta; i indoktrinuar e me gjuhë të papërshtatshme për vendime gjyqësore.

Gjyqësori, në fjalët e veta, vjen si një hallkë e rëndësishme e mbajtjes në këmbë të një regjimi diktatorial. Gjyqësori, në fjalët e veta, na vjen si shpërfaqës dhe jetësues i botëkuptimit antiliri mendimi dhe fjale, po ashtu edhe si ekzekutor i çdo lirie tjetër.

Mbetet e rëndësishme ta studiojmë dhe analizojmë gjyqësorin e komunizmit, ndërsa aspirojmë për rezultate konkrete, të zbatimit efektiv në praktikë, të standardeve më të mira të të drejtave të njeriut dhe proceseve të rregullta, siç ato parashikohen sot nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

62. Shih për shembull “...në lidhje me marrëdhëniet shtetërore të shtetit me vende të tjera; ka thënë se shteti shqiptar nuk e ka mirë me asnjë shtet tjetër në botë, se këta janë të destinuar të vdesin, se peshku i madh ha të voglin; ka ushqyer iluzione te të pandehurit e tjerë, për një sulm ushtarak kundër Shqipërisë, duke thënë se “Jugosllavia e Rusia, tani që u prishën punët e Kosovës, me siguri do të sulmojnë vendin tonë”; “nuk duhet të punojmë se humbasim shëndet, se na duhet për më vonë”; ka udhëzuar të dënuarit e tjerë, të mos punojnë por “i ruajnë energjitë dhe shëndetin, për ditët kur ata do të marrin pushtetin...” (vendimi nr. 68, datë 11.11.1981 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë, lënë në fuqi me vendimin nr. 298, datë 5.12.1981 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë)

63. Shih për shembull “...biseduar me të tjerë se pushteti popullor nuk vepron në të mirë të popullit por kundër tij; ka quajtur të padrejtë marrjen e tokave nga persona privatë; ka goditur sistemin kooperativist; mburr pronën private duke thënë se ashtu jetohet më mirë gjë që vjen në kundërshtim me realitetin; ka folur për jetën në SHBA duke e konsideruar si një sistem bollëku ndërsa tek ne ka vetëm vuajtje ekonomike; ka thënë se populli po vuan dhe dyqanet janë bosh e ka mungesë artikujsh; se fshatarësia vuan nga të ardhurat e pakta; duke dëgjuar radiot e huaja ka thënë se këtu nuk ka liri të plotë por ka diktaturë kundër popullit” (vendimi nr. 23, datë 12.04.1972 i gjykatës së rrethit Lushnjë)

64. Shih për shembull “...ka bërë agjitacion dhe propagandë, duke synuar e patur si qëllim minimin dhe dobësimin e Partisë e të shtetit, si dhe për të bërë të pakënaqur dhe për të futur në veprimtari armiqësore të dënuar të tjerë; e ka shtrirë veprimtarinë armiqësore në politikën e brendshme dhe të jashtme të partisë; ka shtrembëruar qëndrimin që ka mbajtur partia e shteti ynë në ngjarjet në Kosovë, duke thënë se shkaktare për këto që po ndodhin në Kosovë është qeveria jonë; ka shtrembëruar vendimin e qeverisë për tufëzimin e bagëtive dhe ngushtimin e oborrit kooperativist duke i thënë dëshmitarit se “se kjo është diplomaci për vuajtjen e njerëzimit...” (vendimi nr. 49, datë 28.8.1981 i Gjykatës Popullore të Rrethit Mirditë)

65. Vendimi nr. 1, datë 23/5/1973 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr. 34, datë 13.07.1973 i Gjykatës së Rrethit Mirditë, lënë në fuqi me vendimin nr.1301, datë 8.9.1973 të Gjykatës së Lartë.

AIDSSH, Hetim administrativ për 44 të zhdukurit në burgun e Spaçit

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit vendosi më 2 qershor të vitit 2023 nisjen e procedurës së hetimit administrativ për verifikimin e vendvarrimeve të dyshuara, qartësimin e fatit të dyzet e katër të zhdukurve, bashkëpunimin me organet e pushtetit lokal për ruajtjen nga tjetërsimi, si dhe bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese për rikuperimin e eshtrave të personave të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit, në burgun e Spaçit.

Të dhënat dokumentare, dëshmitë dhe faktet paraprake, janë tregues të pasojave që shkaktoi, shfrytëzimi i punës dhe dhuna ndaj të dënuarve në kampin e punës së detyruar-Spaç.

Nisur nga analiza e dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve të tjera zyrtare mbi punën e detyruar, ndikimin e saj në ekonominë e vendit, dëshmitë gojore të ish-të burgosurve politikë në këtë kamp, si dhe nga komunikimi me institucione vendore, Autoriteti ndërtoi narativën mbi ngjarjen dhe historinë e kamp-burgut të Spaçit.

Verifikimi i dyshimeve të raportuara për vendvarrimet e fshehta dhe qartësimi i fatit të personave që kanë humbur jetën në burgun e Spaçit, si rezultat i ekzekutimeve, vrasjeve apo edhe vdekjeve të të burgosurve gjatë vuajtjes së

dënimit, janë pjesë e rëndësishme e procesit të hetimit administrativ, me qëllim hedhjen dritë mbi fatin e të zhdukurve.

Nga kërkimet e bëra në dokumentet që gjenden në Arkivin e Autoritetit, apo në institucione të tjera, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, rezultojnë 44 (dyzetë e katër) ish-të dënuar, që janë ekzekutuar, vrarë ose kanë vdekur nga puna e rëndë, sëmundjet gjatë vuajtjes së dënimit, aksidentet në punë apo në tentativë arratisjeje.

Sipas hetimeve paraprake të grupit të punës janë siguruar fakte të tilla si: Personat që ekzekutoheshin, apo vdisnin gjatë vuajtjes së dënimit, varroseshin nga personeli i burgut në vende jashtë territorit të burgut, duke u pamundësuar të afërmeve të tyre, në çdo rast që të merrnin trupin.

Vendet që kanë shërbyer si vendvarrime për të burgosurit që kanë humbur jetën në Spaç, dyshohet se gjenden pranë varrezave të fshatit Shpal, në fshatin Gëziq, Kodër Spaç, rreth 1 km në jug-perëndim të Burgut të Spaçit, si dhe në disa raste ekzekutimet janë kryer në vende, ku si kriter i vetëm ishte largësia nga zonat e banuara.

Ekspozita

“Gjurmë Qëndrese dhe Solidariteti”

#KurrëMëDiktaturë

SPAÇ 1973-2023
G.JURMË QËNDRERE
DHE SOLIDARITETI
50 VJET NGA REVOLTA

#KurrëMëDiktaturë

Instalacion artistik me 10 silueta në përmasa njerëzore me informacion mbi përjetime e ndiesi të familjarëve të ish-të dënuarve të burgut të Spaçit, me qëllim njohje dhe reflektim mbi të shkuarën, në rrugën që kanë përshkuar sa herë gratë, fëmijët dhe familjarët e të dënuarve.

Kampi i punës së detyruar i ashtuquajtur "Reperti i riedukimit nr. 303", u vendos në Spaç në vitin 1968 dhe funksionoi deri në qershor të vitit 1990. Të dënuarit politikë që u sollën në burgun e Spaçit, punuan në minierë për nxjerrjen e mineralit të bakrit dhe piritit. Ata ishin të detyruar të punonin me tre turne dhe në kushte të rrezikshme për jetën e tyre. Nëse "thyhej disiplina apo nuk realizoheshin norma" të burgosurit ndëshkoheshin me 4-30 ditë në muaj qëndrim në birucë.

Revolta e Spaçit nisi në mëngjesin e herët të datës 21 maj, si protestë e të burgosurve politikë që vuanin dënimin në atë burg, dhe zgjati deri më 23 maj të vitit 1973. Revolta u shtyp me dhunë, pasi si pasojë e saj u arrestuan 68 të dënuar, brenda 24 orësh, u ridënuan 8 të burgosur me 25 vjet heqje lirie dhe 4 me pushkatim.

Revolta e Spaçit përbën një pikë kulmore në historinë e qëndresës antikomuniste, por edhe të lëvizjes për liri e demokraci.



AUTORITETI PËR MBROJTJEN E
DOKUMENTET E DËR-SIGURIMIT TË SHTETIT



SPAÇ 1973-2023
GJURMË QËNDRËSE
DHE SOLIDARITETI

"Pata frikë ta takoja, pasi ai donte të më përqafoje, por unë isha një fëmijë që trembeshja ta prekja këtë të huaj. Në takim babai i dha nënës një qese, ku kishte futur dhëmbët. Ata i ishin thyer nga torturat e mëdha".

Ometa Vrapiti
Nëna e Ometës, bashkë me bashkëshortin, prapëprapë i ka mbetur me dhëmbët e fëmijës.



SPAÇ 1973-2023
GJURMË QËNDRËSE
DHE SOLIDARITETI

"Nuk harroj, isha 14 vjeç. Bashkë me motrën e vogël mbërritëm rreth orës dy në Spaç. Polici nuk na lejoi ta takonim babanë atë ditë, pasi na tha që ishte në punë. Fjetëm pas një barake të komandës, të rrahur nga era e ftohtë e grykës së Spaçit".

Nigolton Gurmani
Një nga djemët e Ometës, i cili ka mbetur me dhëmbët e fëmijës.



SPAÇ 1973-2023
GJURMË QËNDRËSE
DHE SOLIDARITETI

"Pas arrestimit të babait, motra e madhe, që ndiqte studimet në Fakultetin e Filozofisë, në Tiranë, u përjashtua nga shkolla me ceremoni. Kërkuan ta nxirrnin për demaskim para shkollës".

Ioan Çoll

Ishte 16 vjeç kur arrestohet i nëntorin dhe me detyrë për të shprehur mendimet për demaskimin.



SPAÇ 1973-2023
G.JURMË QËNDRESE
DHE SOLIDARITETI

**“Babanë e kam
brenjë. Kam
shumë boshllëk, se
u rrita pa të. Në
Pogradec i kam
ngritur një varr në
kujtim të tij. Kur e
vizitoj, ndez një
cigare. Po kujt t’ia
ndez?! Nuk ka
eshtra. Ia ndez
tokës, mermerit të
ftohtë”.**

Leonard Bejko

Ishte 5 javë që kuptohesha
bosh. Derisa Spaci bëri me
një vit 97-tinë dhe gjatë
kësaj periudhe kam qenë një
nga të rinjtë me vdekje të
shpejtë në Spaci që
shpeshherë 21 maj të vitit
1973.



SPAÇ 1973-2023
G.JURMË QËNDRESE
DHE SOLIDARITETI

**“Shkova ta takoja me
djalin e vogël. Prela e la
6 muajsh. I përmalluar,
i lëndon të voglit sandalet:
Sa të bukura! Djali ia
kishte marrë borxh një
shoku sa për takimin
me babanë”.**

Intervistë e dhënë për Memorand

Lirke Syku

Grupi i Pritjeskut i
amatorit dhe aktivistit me 20
vite të punës në
agjencinë dhe propagandë.

SPAÇ 1973-2023
G.JURMË QËNDRESE
DHE SOLIDARITËTI

“Pas arrestimit të bashkëshortit, m'u mbyllën të gjitha dyert para fytyrës. Askush nuk donte të kishte të bënte me mua. Të afërmit më thonin: "Erdhe sot, mos hajde përsëri! Njerëzit largoheshin dhe ndërronin rrugë, ngaqë nuk donin të më flisnin, pasi isha me njëllë në biografi. Nuk mund të ndaja babain e vajzave të mia. Pranova fatin tim!”

Lirja Alball
Gratërore Mirëkollit dhe
Lundës Xhevat Alballit,
si të bën me mua,
që jeni me qendrë.

SPAÇ 1973-2023
G.JURMË QËNDRESE
DHE SOLIDARITËTI

**“Pengu im është se...
nuk munda të përcjell
për në banesën e fundit
babain Teme, vëllain Sokol
e të mirën nënën time,
Shpresa. Ende nuk
e dimë ku u prehen
eshtrat”.**


Rajmond Seljo
Duke menduar Teme Seljën,
strukturën dhe shkollën
që jeni në prapësi, me
shprehur në SPAÇ.



SPAÇ 1973-2023
GJURMË QËNDRËSE
DHE SOLIDARITËTI

**“Pas dënimit të babait,
mamaja duhet të rriste
katër fëmijët. Punonte
gjithë ditën në bujqësi,
mbante dru në kurriz,
për të na ngrohur
e ushqyer”.
Na ndihmonte edhe
gjyshja në moshë
të thyer.”**

Mendohje Pogani
Vajza e Nënë Gjyeshtrës dhe
lidhurat për ngjashmëri
propozimi i vetëdijshëm
i bashkëpunimit



SPAÇ 1973-2023
GJURMË QËNDRËSE
DHE SOLIDARITËTI

**“Çanga e zgjimit binte
në orën 5. Pas apelit, në
orën 6, dilnim nga
kampi dhe i ngjiteshim
malit. Ecnim një orë e
gjysmë, derisa
mbërrinin në galeri. Aty
përhëndeteshim me
shprehjen ‘Mirëdalsh!’,
se edhe mund të mos
dilnim më gjallë”.**

Iliaz Kaja

Ishtë lidhur me Shqipëri
qëllimisht propozimi i Mirë
dijshëm me SPAÇ burime SPAÇ

Aktivitetet e AIDSSH-së në përkujtim të ngjarjes historike 50- vjet - revolta e Spaçit

AIDSSH pelegrinazh në Spaç

Mirditë, 21 maj 2023

Në kuadër të 50-vjetorit të Revoltës të Spaçit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit organizoi një pelegrinazh në ish-kampin-burg të Spaçit. Të pranishëm ishin SH.T. z. Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë, Arqipeshkvi i Dioqezës së Rrëshenit, Dom Gjergj Meta, përfaqësues të pushtetit lokal dhe të trupit diplomatik, ish-të përndjekur politikë dhe organizatat që veprojnë në fushën e kujtesës historike.

Gjatë pelegrinazhit, të pranishmit, panë edhe instalacionin artistik “Gjurmë qëndrese dhe solidariteti”, të krijuar nga AIDSSH-ja, në shenjë kujtimi dhe përjetimi të dhimbjes, vuajtjes dhe qëndresës që kalonin çdo ditë gratë, fëmijët dhe familjarët e të dënuarve politikë.

“Kjo është një ngjarje që bashkon njerëzit për të nderuar ata që kanë humbur, të gjejnë ngushëllim dhe mbështetje tek njëri-tjetri, si dhe të zhvillojnë një ndjenjë solidariteti që na ndihmon të punojnë së bashku për t’u rikuperuar dhe rindërtuar.”

Dr.Gentiana Sula

Kryetare e AIDSSH-së

Presidenti i Republikës, Sh.T. Z. Bajram Begaj dhe bashkëshortja, znj. Armalda Begaj, Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula në pelegrinazhin e organizuar nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, me rastin e 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit

Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit Ylber Merdani, ish-i burgosur politik Spaç, Albert Mëlyshi, Kryetari i Bashkisë Rrëshen, Mirditë Selami Zalli, Drejtor i Informacionit, AIDSSH

Spaçi në arkiva - 50 vjet nga revolta

Tiranë, 4 maj 2023

AIDSSH-ja organizoi “Spaçi në arkiva - 50 vjet nga Revolta” me dokumente nga arkivi e ish-Sigurimit të Shtetit për kampin e punës së detyruar në Spaç, revoltën, vendimet me vdekje dhe ridënimet.

Studentë dhe studiues duke parë ekspozitën arkivore për Spaçin.

Aktiviteti synoi nxitjen e analizës dhe debatit profesional juridik mbi zbatimin e ligjeve të kohës parë nga perspektiva e shkeljes së të drejtave të njeriut.

U bënë të njohura edhe dokumente të tjera, zyrtare, të siguruara në kuadër të bashkëpunimit institucional, mbi natyrën e punës së detyruar gjatë diktaturës në angazhim e të burgosurve politikë në nxjerrjen e mineralit të bakrit dhe piritit.

Anëtar i AIDSSH, z. Gjergj Marku në fjalën e tij gjatë aktivitetit.

Të pranishëm ishin partnerë akademikë të Autoritetit, Shkolla e Magjistraturës, Universiteti Evropian i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, përfaqësues të trupit diplomatik, ekspertë të punë, studiues e aktivistë të shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut.

Ekspertët diskutojnë punën e papaguar në minierën e Spaçit

Tiranë, 7 prill 2023

Ekspertë financiarë, akademikë dhe inxhinierë të industrisë minerare diskutuan në një takim për punën e papaguar të kundërshtarëve politikë në miniera, si një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut në diktaturë.

Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula, anëtar z. Gjergj Marku. Dr. Viktor Doda, ish-ministër i Energjetikës dhe Minerave, Dr. Femi Sufaj, nëndrejtor i përgjithshëm i burgjeve, Prof. Dr. Kimet Fetau, pedagog në Gjeologji-Miniera, Ing. Fran Gjergji, Agron Hoxha, ish-i dënuar në burgun e Spaçit

Tryeza u mbajt në kuadër të aktiviteteve të AIDSSH-së në përkujtim të 50-vjetorit të revoltës në burgun e Spaçit, dhe kishte si qëllim krijimin e narrativës për Spaçin, si burg dhe si kamp pune.

Konkurs për logon e 50 vjetorit të revoltës së spaçit

26 prill- 23 maj 2023

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, AIDSSH-ja zhvilloi një konkurs me nxënës të shkollave artistike të vendit, për krijimin e një logoje kushtuar 50-vjetorit të Revoltës së Spaçit ku u shënua një pjesëmarrje e gjerë. Fitues u shpall punimi i nxënësit Rodjon Zhuri, klasa XII-të, shkolla e mesme artistike "Ajet Xhindole" Berat. Logoja e krijuar prej tij u përdor gjatë vitit 2023 në komunikimin shkresor zyrtar të AIDSSH-s.

Revolta e Spaçit, orë mësimore në sistemin parauniversitar

Tiranë, 22 maj 2023

Ora e parë e mësimit në sistemin parauniversitar iu kushtua përkujtimit të 50-vjetorit të revoltës së burgut të Spaçit si nevojë për ndërgjegjësimin e brezave mbi të shkuarën e vendit. Në këtë ditë u prezantua materiali i parë informues për Spaçin, i përshtatur për arsimin parauniversitar.

Përfaqësues të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndoqën orën mësimore të zhvilluar në gjimnazin "Qemal Stafa", Tiranë. Nxënësit, të pajisur me njohuri mbi kampin e punës dhe burgun e Spaçit, drejtuar nga mësuesja e historisë, referuan dhe ngritën pyetje për revoltën, si dhe rreth të shkuarës totalitare në vendin tonë.

Zv. Ministria e Arsimit, Znj. Nina Guga, Drejtora e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, Dr. Ornela Arapi, Drejtore e gjimnazit "Qemal Stafa", në Tiranë, znj. Klotilda Jaupi.

50 vjet nga revolta në burgun e Spaçit :
dëshmojnë të mbijetuarit dhe familjarët
e tyre / përgat. Brunilda Çërraga, Rovena
Rrozhani ; red. Brunilda Loci, Elona Baçi.
- Tiranë : Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet
e Ish-Sigurimit të Shtetit - AIDSSH, 2024.
... f. : me foto ; ... cm.

ISBN 9789928480118

- | | |
|--------------------------|-------------------------|
| 1. Persekutimi politik | 2. Të burgosur politikë |
| 3. Lëvizje antikomuniste | 4. Rrëfime vetjake |
| 5. Biografia | 6. Dokumente |
| | 7. Spaç (Mirditë) |


323.282(496.524-22) (093.3)

929(496.5)

**50 VJET NGA REVOLTA
NË BURGUN E SPAÇIT**
DËSHMOJNË TË MBIJETUARIT
DHE FAMILJARËT E TYRE



9 789928 480118 >



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT